



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

UNIVERSITETI I TIRANËS

FAKULTETI I HISTORISË DHE I FILOLOGJISË

DEPARTAMENTI I HISTORISË



**Tema: Koçi Xoxe në kontekstin e marrëdhënieve shqiptaro - jugosllave
1945-1948**

Kandidati:

Msc. Ornela SHAMETI

Udhëheqës shkencor:

Prof. Dr. Ksenofon KRISAFI

Tiranë, 2021



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

UNIVERSITETI I TIRANËS

FAKULTETI I HISTORISË DHE I FILOLOGJISË

DEPARTAMENTI I HISTORISË



Disertacion i paraqitur nga

Ornela SHAMETI

Në kërkim të gradës shkencore

DOKTOR I SHKENCAVE

Tema: Koçi Xoxe në kontekstin e marrëdhënieve shqiptaro - jugosllave 1945-1948

Specialiteti: HISTORI

Udheheqës shkencor

Prof. Dr. Ksenofon KRISAFI

Mbrohet më datë/...../2021

- 1.(Kryetar)**
- 2.Anëtar (oponent)**
- 3.Anëtar (oponent)**
- 4.Anëtar**
- 5.Anëtar**

Tiranë, 2021

PËRMBAJTJA

PARATHËNIA.....	I
HYRJE.....	VI

KREU I

ORIENTIMI I SHQIPËRISË DREJT JUGOSLLAVISË

1.1 Partia Komuniste Shqiptare dhe misionarët jugosllavë në Shqipëri.....	1
1.2 Organizimi politik dhe ekonomik i vendit pas luftës.....	16
1.3 Koçi Xoxe në politikën shqiptare.....	36

KREU II

ROLI I KOÇI XOXES NË MARRËDHËNIET SHQIPTARO-JUGOSLLAVE

2.1 Intensifikimi i marrëdhënieve politike.....	44
2.2 Bashkëpunimi në fushën ekonomike.....	49
2.3 Qëndrimet Pro dhe Kundër vijës jugosllave.....	61
2.4 Koçi Xoxe në vijën e parë të frontit pro-jugosllav.....	63
2.5 Rikthimi i projekteve spekulative të Beogradit për Konfederatën Ballkanike dhe presionet ndaj udhëheqjes shqiptare.....	67

KREU III

PRISHJA E MARRËDHËNIEVE SHQIPTARO-JUGOSLLAVE DHE ROLI I KOÇI XOXES NË KËTO MARRËDHËNIE

3.1 Plasaritjet e para dhe fillimi i kthesës në marrëdhëniet shqiptaro-jugosllave.....	73
3.2 Presioni jugosllav për afrimin e Shqipërisë me Bashkimin Sovjetik.....	84
3.3 Përkeqësimi i marrëdhënieve sovjeto-jugosllave, ndikimi në Shqipëri.....	87
3.4 Fundi i marrëdhënieve shqiptaro-jugosllave	104

KREU IV

QËNDRIMET PRO-JUGOSLLAVE TË KOÇI XOXES DHE FUNDI I TIJ POLITIK

4.1 Spastrimi i fajtorëve në Partinë Komuniste Shqiptare.....	112
4.2 Gjyqi i Koçi Xoxes.....	120
4.3 Pasojat e gjyqit dhe lufta kundër pro-jugosllavëve.....	142

PËRFUNDIME.....	144
-----------------	-----

BIBLIOGRAFIA.....	14
-------------------	----

ABSTRAKTI

PARATHËNIA

Periudha e Luftës së Ftohtë është cilësuar si një periudhë me problematika të mëdha në histori. Historianë dhe studiues të shumtë kanë ngritur pikëpyetje të shumta, si dhe e kanë analizuar këtë periudhë të rëndësishme historike. Studime të shumta janë bërë për të dhënë përgjigje, të cilat janë të njëjëndësie të madhe, si për të kaluarën ashtu edhe për të ardhmen. Vitet e luftës duhet të shërbenin si shembulli më i mirë i dështimit të sistemeve totalitare dhe pasojave që ato shkaktuan nga implementimi i tyre. Viti 1945 nuk iu dha fund regjimeve diktatoriale; përkundrazi, në disa vende strukturat e këtyre sistemeve të tipit komunist u forcuan akoma edhe më shumë.

Përhapja e komunizmit u kthye tashmë në një kërcënim real për të ardhmen e kontinentit, si edhe u bë një faktor shumë i rëndësishëm në hartimin e politikave, gjatë dhe pas Luftës së Dytë Botërore. Kjo luftë nuk vuri vetëm përballë njëri-tjetrit aktorët kryesorë ndërkombëtarë, por edhe i drejtoi ata drejt aleancave ideologjike të kundërta.

Historia e popullit shqiptar ka kaluar nëpër një kalvar të gjatë mbijetese. Në trojet e saj u panë të gjitha ushtritë e luftërave botërore që ndiqnin rrugën perëndim-lindje e anasjelltas; ky popull ka përjetuar e ka mbajtur në ndërgjegje çdo lloj ideologjie, të majtë e të djathtë, ndërsa shpesh reputacioni i Shqipërisë në botë pësoi edhe shformim. Pozicionimi i vendit tonë në arenën ndërkombëtare në periudhën e pasluftës iu detyrohet si faktorëve të brendshëm ashtu edhe atyre të jashtëm. Orientimi drejt Jugosllavisëmund të konsiderohet si zgjedhje e qeverisë së asaj periudhe, por edhe neglizhencë nga ana e Fuqive të Mëdha. Qeveria e pas luftës, me synimin për ta mbajtur me çdo kusht pushtetin, vendosi që të përqafoje ideologjinë Marksiste-Leniniste, si dhe aleat kryesor Jugosllavinë.

Tema “Koçi Xoxe në kontekstin e marrëdhënieve shqiptaro - jugosllave 1945-1948” synon të paraqesë një pjesë të rëndësishme të historisë së politikës së jashtme të Shqipërisë. Studimi i saj ka ngjallur kuriozitetin dhe interesin e shumë historianëve shqiptarë dhe të huaj, për shkak të specifikave të veçanta në marrëdhëniet bilaterale. Bazuar në faktet konkrete që evidentohen në burimet arkivore të kohës, me anë të kësaj teme synohet të analizohen me një sy kritik marrëdhëniet dypalëshe në kompleksitetin e tyre. Një analizë e hollësishme iu është bërë marrëdhënieve politike ndërmjet dy vendeve, duke iu kushtuar vëmendje interesave dhe ndikimit të Jugosllavisë në politikën e brendshme dhe të jashtme të Shqipërisë. Rolin më të rëndësishëm në këtë punim e zë figura e Koçi Xoxes dhe roli i tij politik në këto marrëdhënie.

Në tezën time të doktoraturës, synoj të realizoj: trajtimin me realizëm të marrëdhënieve politike, diplomatike, ekonomike, kulturore etj., ndërmjet Shqipërisë dhe Jugosllavisë gjatë viteve 1945-1948; publikimin e dokumenteve të panjohura më parë, lidhur me marrëdhëniet midis të dy vendeve; arsyetimet e aspekteve politike të Shqipërisë

së asaj kohe, në kuadrin e marrëdhënieve ndërkombëtare; statusin politik të Shqipërisë, në kuadrin e bllokut komunist; statusin e Shqipërisë në raport me Jugosllavinë dhe statusin e brendshëm politik dhe ekonomik – shoqëror të Shqipërisë dhe impaktin e rëndësishëm të Xoxes në këto marrëdhënie.

Teza ime e doktoraturës synon të analizojë, të argumentojë dhe të konkludojë mbi disa hipoteza të rëndësishme të marrëdhënieve shqiptaro-jugosllave si: Arsyet e orientimit të Shqipërisë kah Jugosllavisë? Përse Shqipëria u përfshi në sferën ekskluzive të Jugosllavisë? A duhej Shqipëria të pranonte e përlurur çdo marrëveshje ekonomike me Jugosllavinë? Procesit politik të Koçi Xoxes, në këto marrëdhënie i është dhënë një rëndësi e veçantë, duke u nisur nga roli i tij kyç në të. Trajtimi i thelluar i rolit të tij në këto marrëdhënie, si edhe pikëpyejet e shumëta që janë ngritur për të, si nje ‘pro-jugosllav’ i devotshëm, a ka qënë i një rëndësie të veçantë në këtë studim? A e meritonte vërtet Koçi Xoxe nofkën “titist” dhe pse pikërisht ai? A nuk ka pasur ‘titistë’ të tjerë në ato marrëdhënie, dhe pse Koçi Xoxe u bë ‘kurban’ në prishjen e këtyre marrëdhënieve?

Në këtë punim timin, jam përpjekur të sjell atë pjesë të historisë së mesit të shekullit XX që ka ndikuar aq shumë në ecurinë e politikës shqiptare, të atyre që e kanë udhëhequr deri më tani në rrugën e saj të gjatë e të mundimshme të mbushur plot me suksese dhe gabime, të cilat lanë gjurmë të pashlyera e që ky popull po i ndjen edhe në ditët e sotme. Një periudhë e veçantë e me karakteristikat përkatëse për fatet e Shqipërisë e të klasës së saj politike, është edhe ajo e viteve 1941-1948, periudhë kjo që ndahet në dy etapa kohore, në atë gjatë Luftës së Dytë Botërore dhe në atë të katër viteve të para të regjimit komunist, e cila përkon me marrëdhëniet shqiptaro-jugosllave.

Në këtë studim do të përdoret një metodologji mikse, bazuar kjo mbi vetë burimet e larmishme të përdorura për realizimin e tij. Metoda e përdorur do të jetë cilësore e me karakter krahasues, me qëllim që të evidentohen faktorët që influencuan në vendosjen dhe shkëputjen e marrëdhënieve dypalëshe.

Procesi i përzgjedhjes së materialeve për këtë periudhë ka qënë relativisht i vështirë, pasi dhe kjo temë është një temë e studiuar edhe nga historianë e studiues të tjerë. Shfrytëzimi i burimeve primare është hapi i parë drejt një studimi cilësor historik, ndaj jam bazuar në materialet arkivore, kryesisht në dosjet që disponon Arkivi Qëndror Shtetëror. Ndër dokumentet e studiuar mund të veçoj: fondi Nr. 14/AP (Arkivi Partisë), 14/AP MPKJ (marrëdhëniet me Partinë Komuniste të Jugosllavisë), fondi 14/APOU (fondi i organeve udhëheqëse), etj. Për të pasur një pasqyrë më të qartë të ngjarjeve kam hulumtuar gjithashtu fondin e Këshillit të Ministrave dhe të institucioneve të tjera shtetërore. Dokumentacionin e detajuar të problemeve kryesore e kam siguruar nga Arkivi i Ministrisë së Punëve të Jashtme. Gjithashtu, një ndihmesë të madhe më kanë dhënë dokumente nga

arkivi i Institutit të Historisë dhe Arkivit të Ministrisë së Brendshme. Do të veçoja këtu dokumentet që kam siguruar edhe nga arkivat e huaja.

Vlerë e shtuar e punimit kanë qenë botimet me dokumente, si: “Marrëdhëniet shqiptaro–jugosllave, 1945 – 1948” (dokumente) dhe botime të Drejtorisë së Përgjithshme të Arkivave, përgatitur për botim nga Ndreçi Plasari dhe Luan Malltezi, Tiranë 1996; “Shqipëria në dokumentet e arkivave ruse”, nga Islam Lauka dhe Eshref Ymeri. 2006. Prej dokumenteve të botuara nga arkivat e huaja, dëshiroj të veçoj botimet dokumentare autentike me bazë arkivat ruse, në mënyrë të veçantë botimin e vitit 2006 nga Islam Lauka, “Shqipëria në dokumentet ruse”, të cilat përmbajnë dokumente sovjetike, gjë që më ka mundësuar vlerësimin e fakteve dhe të dhënave arkivore për trekëndëshin Shqipëri-Jugosllavi-Bashkim Sovjetik.

Nuk mund të paraqitej një trajtë e plotë e studimit pa shfrytëzuar literaturën, e cila trajton marrëdhëniet bilaterale në dritëhijet e kohës. Të tilla botime mund të përmendim: “E vërteta e fshehur e një procesi”, përgatitur nga Kastriot Dervishi, e cila ka qënë e një rëndësie të vecantë sidomos përsa i përket figurës së Koçi Xoxes, Historia e Popullit Shqiptar, Vëllimi III dhe IV, përgatitur nga Akademia e Shkencave të Shqipërisë (Tiranë 2007, 2008), botimi i prof. Lisen Bashkurti, “Diplomacia shqiptare në fillimet e Luftës së Ftohtë, 1945-1961” (Tiranë 2003), punimi i studiuesit Kastriot Dervishi, “Historia e shtetit shqiptar 1912 - 2005” (Tiranë 2006), Hamit Kaba, “UNRRA në Shqipëri 1944-1947” (Tiranë, 2000) etj. Do të vlerësoja shumë literaturën e huaj, të cilën kam shfrytëzuar. Të tilla botime kanë marrë përsipër të hedhin dritë mbi ngjarjet e kohës në një këndvështrim global, të tilla si Vladimir Dedijer, “Marrëdhëniet jugosllavo-shqiptare 1939-1948” (Beograd, 1949), Bernard Fischer, “Diktatorët e Ballkanit”, botuar nga Instituti i Botimeve Ndërkombëtare (AIIS) (Tiranë, 2009), Nina Smirnova, “Historia e Shqipërisë përgjatë shekullit XX” (Tiranë, 2004), Jozhe Pirjevec, “Tito dhe shokët” (Tiranë, 2020), Dimitr S. Çuvahin, “Shërbimi im diplomatik në Shqipëri” (Tiranë, 2009), Herman Neubacher, “Guvernatori i Hitlerit për Ballkanin – Misioni i posaçëm në Europën Juglindore 1940 – 1945: Detyra ime në Shqipëri, e jashtëzakonshme” etj.

Studimit nuk i mungojnë edhe burimet të tjera nga shtypi i kohës, duke përfshirë revistat, gazetat e përditshme apo dorëshkrime të personave që e kanë jetuar atë kohë. Të tilla përmendim gazetat e ndryshme të botuara në atë kohë, si “Borba”, “Bashkimi”, por edhe gazeta të tjera të huaja dhe vendase që kanë shkruar mbi marrëdhëniet dypalëshe.

Ky disertacion është konceptuar nga Parathënia, Hyrja dhe katër kapituj që trajtojnë në mënyrë të detajuar marrëdhëniet ndërmjet dy vendeve dhe rolin kyç të figurës së Koçi Xoxes. Kapitujt në vetvete janë të ndarë në çështje që hedhin dritë mbi qëndrimet dhe politikat e ndjekura gjatë atyre viteve nga udhëheqësit e shtetit shqiptar dhe të huaj. Disa nga çështjet më të rëndësishme që kam prekur janë: si filluan të intensifikoheshin këto

marrëdhënie, marrëveshjet më të rëndësishme ekonomike të asaj kohe, impakti i rëndësishëm që pati Jugosllavia në politikën e brendshme dhe të jashtme të Shqipërisë, figura e Koçi Xoxes dhe 'spastrimi' i të ashtuquajturve 'titistë'.

Kapitulli I – “Orientimi i Shqipërisë drejt Jugosllavisë”, trajton fillesat e krijimit të Partisë Komuniste të Shqipërisë, si edhe rolin e rëndësishëm të misionarëve jugosllavë në politikën shqiptare. PKSh, në fakt e shihte bashkëpunimin me partinë dhe shtetin jugosllav si një mundësi për rindërtimin dhe zhvillimin e ekonomisë së vendit të sapo dalë nga lufta. Për më tepër, qeveria e përkohshme e Hoxhës kërkonte njohjen e saj dhe të shtetit të pavarur shqiptar në arenën ndërkombëtare. Intensifikimi i marrëdhënieve të Shqipërisë me Jugosllavinë, po ashtu u bazua në pasigurinë e qeverisë së Enver Hoxhës, për sa i takon ruajtjes së tërësisë dhe pavarësisë territoriale të Shqipërisë. Gjithashtu, në këtë kapitull hidhet dritë mbi figurën e Koçi Xoxes dhe fillesat e tij në katërveçarinë më të vrullshëm në marrëdhëniet me Jugosllavinë.

Kapitulli II – “Roli i Koçi Xoxes në marrëdhëniet shqiptaro-jugosllave”, trajton intensifikimin e marrëdhënieve politike midis dy vendeve, si edhe bashkëpunimin e ngushtë që ato patën kryesisht në fushën ekonomike. Marrëdhëniet e krijuara me Jugosllavinë këto vite patën interpretime të ndryshme nga individë të ndryshëm politikë, vendas dhe të huaj. Në këtë kapitull do të vërehen disa nga qëndrimet ‘pro’ dhe ‘kundër’ vijës jugosllave. Koçi Xoxe takohej shpesh me palën jugosllave dhe ishte mjaft i angazhuar në politikën e jashtme. Nëse iu referohemi korrespondencave që përfaqësues të Jugosllavisë kanë pasur me qeverinë shqiptare dhe PKSh-në, “emri më i përmendur, për të mos thënë i vetmi, është ai i Xoxes. Një gjë e tillë mund të konfirmohet edhe në korrespondencat që Xoxe pati me përfaqësuesit e Ministrisë së Jashtme të Jugosllavisë, gjatë vitit 1947, Ranković, Markos etj.” Një tjetër aspekt shumë i rëndësishëm në këtë kapitull është edhe trajtimi i projekteve spekulative të Beogradit, lidhur me Konfederatën Ballkanike, si edhe presionet e bëra ndaj udhëheqjes shqiptare, lidhur me këtë çështje.

Kapitulli III – “Prishja e marrëdhënieve shqiptaro-jugosllave dhe roli i Koçi Xoxes në këto marrëdhënie”, trajton plasaritjet e para dhe fillimin e kthesës në marrëdhëniet shqiptaro-jugosllave. Cilat ishin nyjat që u këputën, dhe pse pikërisht në këtë periudhë, janë disa nga pikëpyetjet që shfaqën për t’u trajtuar në këtë kapitull. Presioni jugosllav për afrimin e Shqipërisë me Bashkimin Sovjetik filloi të ndihej së tepërmi, duke u pasuar më pas me përkeqësimin e marrëdhënieve sovjeto-jugosllave dhe ndikimet që kjo e fundit pati në vendin tonë. Fundi i marrëdhënieve shqiptaro-jugosllave intensifikoi marrëdhëniet e Shqipërisë me Bashkimin Sovjetik, dhe këtu fillon një kalvar tjetër politikash dhe marrëdhëniesh. Roli i Koçi Xoxes dhe qëndrimet e tij kur këto marrëdhënie u prishën dhe Shqipëria u orientua drejt Bashkimit Sovjetik”.

Kapitulli IV – “Qëndrimet pro-jugosllave të Koçi Xoxes dhe fundi i tij politik”, trajton “spastrimet” e herë pas hershme të partive komuniste dhe strukturave të tyre të pushtetit. Duke përmendur këtu gjyqet e internimit dhe të dëbimit, denoncimet e ndërsjella

të palëve dhe autokritikat e të akuzuarve. Kështu, “Terrori nuk ishte vetëm një instrument politik që ushtrohej rregullisht, por edhe kusht psikologjik i nënshtrimit të masave popullore. Koçi Xoxes iu bë një nga gjyqet ndoshta më të rëndësishme në historinë e këtij vendi, duke u akuzuar si ‘pro-jugosllav’ i devotshëm, në një vend ku kryetari, Enver Hoxha, iu linte vend të lirë emisarëve jugosllavë të ndërhyjnë në politikën tona të brendshme dhe të jashtme. Në vazhdimësi, regjimi i ashpër diktatorial detyrohej të Partisë së Punës, me në krye Enver Hoxhën, u karakterizua nga mbyllja totale e Shqipërisë ndaj botës, nga izolimi i saj jo vetëm me Perëndimin, por edhe me aleatët e saj të dikurshëm të Lindjes, nga zhdukja e opozitës politike dhe intelektuale, nga represioni i vazhdueshëm politik, ku përfshiheshin kampet e detyrueshme të punës, pushkatimet pa gjyq dhe ekzekutimet e antikomunistëve të piketuar.

Duke përfunduar këtë parathënie, e ndjej si detyrim të falënderoj gjithë stafin pedagogjik të Departamentit të Historisë së Shqipërisë për dashamirësinë e treguar në miratimin e kërkesës sime për mbrojtjen e doktoraturës, si dhe ndikimin e tyre me sugjerimet e vyera gjatë diskutimeve të realizuara për këtë qëllim.

Dëshiroj të jem mirënjohëse kundrejt mentores sime të parë, e cila më ka orientuar në punimin e dy kapitujve të parë të temës sime, prof. as. Pranvera Dibra. Një falënderim të veçantë i dedikoj prof. dr. Ksenofon Krisafi, për pranimin si mentor i punimit tim shkencor, si edhe për ndihmën e kualifikuar këshilluese, drejtimin, orientimin dhe udhëheqjen profesionale në arritjen e këtij studimi. Me sugjerimet dhe njëpunë të mirëfilltë shkencore, prof. Krisafi u bë mbështetja kryesore për ndërtimin e strukturës së studimit, sigurimin e informacionit bazë të nevojshëm e konkret për kapitujt, thellimin e mendimit, vërejtjet dhe këshillat, duke mundur realizimin me sukses të këtij punimi. Profesorit i shpreh mirënjohjen time për ngulmimin e tij, për të dhënë maksimumin tim dhe për kontributin në drejtim të rritjes së nivelit argumentues dhe shkencor të punimit.

Falënderoj punonjësit e Arkivit Qendror Shtetëror, AMPJ për ndihmën e dhënë në gjetjen, grumbullimin dhe shërbimin e dokumentacionit të nevojshëm arkivor. Një falënderim gjithashtu shkon për kolegët e mi, debatet konstruktive me të cilët kanë qënë të vyera, për një sy kritik mbi këtë temë, si dhe të gjithë mbështetësit, të cilët më mundësuan dhe më ndihmuan me materiale arkivore të huaja të cilat kanë qënë të një rëndësie të veçantë në këtë punim.

Ky punim i dedikohet familjes time, për mbështetjen e madhe që kanë treguar kundrejt meje gjatë gjithë këtyre viteve, sidomos vajzës time, të cilës shpeshherë i kam marrë kohë nga koha e saj, për të punuar mbi disertacionin.

*Solei, ky punim të dedikohet ty!
Faleminderit!*

HYRJA

Fillimet e marrëdhënieve shqiptaro-jugosllave, përgjatë viteve 1918-1944

Në këtë pjesë të studimit do të fokusohemi mbi fillimin e marrëdhënieve shqiptaro-jugosllave, përpara se këto marrëdhënie të formalizoheshin dhe të intensifikoheshin më tej përgjatë viteve 1945 deri në vitin 1948, kur këto marrëdhënie filluan të shkatërroheshin. Marrëdhëniet shqiptaro-jugosllave janë të rëndësishme për t'u studiuar, për vetë faktin se ato janë baza dhe themeli i marrëdhënieve dypalëshe, të cilat, në njëfarë mënyrë dhe mbizotëruan marrëdhëniet e mëvonshme të të dy shteteve. Marrëdhëniet shqiptaro-jugosllave në vitet e luftës, jo pak herë janë bërë objekt i studimeve dhe diskutimeve të shumta nga një numër autorësh shqiptarë, por sidomos nga autorë dhe studiues të huaj.¹ Janë pikërisht këto punime, të cilat “kanë dhënë pikëpamje dhe detaje të histografisë së huaj, lidhur mes fondin në të cilën u ngritën marrëdhëniet midis dy vendeve”.²

Siç dihet tashmë, mbretëria serbe, kroate, sllovene u krijua zyrtarisht në vitin 1918. Ajo u përbë fillimisht nga bashkimi i përkohshëm i shteteve sllovene, kroate dhe serbe, dhe u quajt, në bazë të shteteve përbërëse të saj ose specifikisht nga bashkimi i ish-territoreve të Perandorisë Austro Hungareze me ish-mbretërinë e Serbisë.³

Fillesat e marrëdhënieve shqiptaro-jugosllave nuk ishin edhe aq pozitive. Ndërhyrjet e para jugosllave vihen re në zbatimin e vendimeve të Konferencës së Ambasadorëve, në të cilat Jugosllavia e asokohe kishte vendosur pengesa të shumta për rastin shqiptar. Kjo, për shkak se Beogradi lloboi përgjatë konferencës së Fuqive të Mëdha, kundrejt faktit se ajo duhej të mbante tokat që okuponte midis “*vijës strategjike*” dhe kufirit të vendosur që në vitin 1913. Kjo taktikë e Beogradit justifikohet duke vënë në dukje se ky ishte, në fakt, një “*garanci*” përkundrejt ndonjë sulmi të Italisë, të nisur pikërisht nga territori shqiptar, për shkak të afërsisë kur, në fakt, Beogradi synonte ta aneksonte shtetin shqiptar, për të predominuar Ballkanin dhe për të pasur daljen në det. Pas tërheqjes së Italisë nga Vlora, ky argument, në fakt nuk kishte ndonjë vlerë, por Beogradi argumentonte se mund të zihej “*vendi bosh*” që kishte lënë Italia dhe të kthehej në këtë mënyrë Shqipëria

¹**Shënim:** Përmendim këtu autorë si V. Dedier me librin “*Marrëdhëniet jugosllavo-shqiptare 1939-1948*”; po ashtu autorin S.V. Tempo me librin “*Revolucioni që ecën*” apo “*Lufta për Ballkanin*”; punimet e autores sovjetike N.D. Smirnova, librin “*Lufta e popullit shqiptar për çlirimin e tij kombëtar dhe shoqëror 1941-1944*”; nuk mund të lëmë mënjatë po ashtu dhe autoren angleze E. Barker me librin “*Politika britanike në Europën Juglindore në vitet e Luftës së Dytës Botërore*”; dhe së fundi autorin gjerman B. Tones me librin “*Shqipëria një rast i veçantë*”, publikim ky i vitit 1980 në Gjermani.

² Xhelal Gjeçovi, *Marrëdhëniet shqiptaro-jugosllave në vitet e Luftës Antifashiste Nacionalçlirimtare. Nëntor 1941 – Nëntor 1944*, Akademia e Shkencave e RPS të Shqipërisë, Instituti i Historisë, Tiranë: 1986, f. 5-6.

³ Ali Hadri, *Historia e Popullit Shqiptar*, II, Enti i Teksteve dhe Mjeteve Mësimore i KSAK (Krahina Socialiste Autonome e Kosovës), Prishtinë, 1979, f.793-795.

në një vend të lidhur pas saj. Nëpërmjet kësaj strategjie, Beogradi kërkonte ta aneksonte edhe Shqipërinë në anën jugosllave. Megjithatë, qeveria shqiptare e asokohe, me në krye Sulejman Delvinën, nuk u pajtua, pasi ishte me rëndësi mos të cenohej sovraniteti dhe pavarësia e vendit, e arritur me aq mund deri në atë pikë.⁴ Duhet theksuar pra, se në këtë periudhë u bënë shumë përpjekje nga ana e Beogradit për të vendosur marrëdhënie normale midis Shqipërisë dhe Jugosllavisë, por këto përpjekje nuk patën asnjë rezultat real.

Acarimi i marrëdhënieve nisi pikërisht në vitin 1920, për shkakun e Vlorës, ku qeveria jugosllave e priti krijimin e qeverisë shqiptare me një ndjenjë të dyfishtë. Kjo, sepse nga pikëpamja strategjike “asaj i interesonte politika e re e Tiranës në adresë të Italisë, për vendosjen e sovranitetit kombëtar mbi Vlorën e hinterlandin e saj në largimin e forcave ushtarake italiane nga Shqipëria”.⁵ Në momentin e krijimit të qeverisë nga Kongresi i Lushnjës, Beogradi përmes konsullit jugosllav në Shkodër, në shkurt të vitit 1920, përcolli mesazhin për domosdoshmërinë e bashkëpunimit shqiptaro-jugosllav kundër ndërhyrjes italiane në Ballkan e, mbi të gjitha në Shqipëri. Ky bashkëpunim, sipas palës jugosllave, “mund të formalizohej menjëherë, duke dërguar në Beograd një grup deputetësh shqiptarë për të biseduar me anëtarët e qeverisë jugosllave”.⁶ Kësaj kërkesë, qeveria shqiptare iu përgjigj menjëherë me aprovim, duke theksuar rëndësinë e largimit të italianëve, si dhe rëndësinë e bashkëpunimit dypalësh Shqipëri-Jugosllavi.

“Në gjysmën e dytë të marsit, jugosllavët, përmes ministrit të tyre në Uashington shprehën gatishmërinë për të njohur qeverinë shqiptare, sapo të kishte një kërkesë zyrtare të saj apo nëpërmjet dërgimit të delegacionit në Beograd.”⁷ Më 2 prill të vitit 1920, Mehmet Konica i dërgoi një letër zyrtare ministrit të Jashtëm jugosllav, Trumbiç, në të cilën kërkonte “vendosjen e marrëdhënieve diplomatike midis dy vendeve dhe dërgimin e një përfaqësuesi diplomatik në Beograd”.⁸ Beogradi i miratoi bisedimet sekrete me përfaqësuesit e palës shqiptare, po në prill të atij viti. Në këtë takim, palës jugosllave iu kërkua ndihmë dhe municione për të larguar italianët. Ndër këto bisedime, Vllamasi, përfaqësuesi shqiptar në këto bisedime, kërkoi po ashtu “t’i ktheheshin Shqipërisë disa qytete që ndodheshin pranë kufirit shqiptaro-jugosllav, të cilat do ndihmonin të forconin Shqipërinë në këtë luftë kundër italianëve, nga pikëpamja ekonomike, dhe kështu Shqipëria të bëhej një mburojë për Ballkanin kundër synimeve italiane”.⁹ Të dyja kërkesat dështuan. “Ekzistonte një mosbesim reciprok midis të dyja palëve.”¹⁰

⁴ Arben Puto, *Shqipëria Politike 1912-1939*, Tiranë: Botimet Toena, 2009, f. 305.

⁵ Paskal Milo, *Politika e Jashtme e Shqipërisë*, Tiranë: Botimet Toena, 2013, f. 488-489.

⁶ *Arkivi Qendror Shtetëror* (më tej: *AQSH*), Fondi 222, Dosja nr. 28/1, Viti 1920, fl. 81.

⁷ *Arkivi i Ministrisë së Punëve të Jashtme* (më tej: *AMPJ*), Dosja nr. 31, Viti 1920, faqe 41. **Shënim:** Letër e K. Çekrezit për Mehmet Konicëndhe Sulejman Delvinën.

⁸ *AMPJ*, dosja nr. 34, viti 1920, faqe 409. **Shënim:** Letër e Mehmet Konicës.

⁹ P. Milo, *Politika e Jashtme...*, f. 490.

¹⁰ *Po aty*.

E njëjta situatë vijoi edhe me ndryshimin e qeverisë, dhe me zëvendësimin e Sulejman Delvinës nga Iliaz Vrioni. U bënë sërish përpjekje “për normalizimin e marrëdhënieve dhe për zgjidhje paqësore në normalizimin e këtyre marrëdhënieve”,¹¹ ndaj të cilave Beogradi vetë i përgjigjej nëpërmjet kushteve politike. Në këtë kuadër, në fund të muajit prill, në vitin 1921 u dërgua në Beograd një delegacion, i cili kishte në kryesi të tij Ali Kolonjën. Ky delegacion çoi në Beograd një projekt-marrëveshje, i cili kërkonte t’i zbuste marrëdhëniet, duke i adresuar shqetësimet e Beogradit e duke deklaruar se Shqipëria nuk donte të nënshkruante asnjë traktat, i cili mund të ishte ofensivë për ndonjë shtet, pasi e konsideronte veten si një shtet neutral. Në këtë projekt-marrëveshje, gjithashtu theksohej se, pas një vendosjeje të marrëdhënieve diplomatike ndërmjet dy shteteve, “Shqipëria do të ishte e gatshme të nënshkruante me Jugosllavinë një marrëveshje tregtare dhe konventë doganore, mbi një bazë reciprociteti”.¹² Megjithatë, përpos përpjekjeve, delegacioni u kthye pa një përgjigje konkrete.

Në vjeshtë të vitit 1921, vetë Beogradi ndërmori një aksion në kufirin verilindor, i cili synonte të destabilizonte gjendjen e brendshme të vendit, duke nxitur tendenca separatiste në funksion të destabilizimit të pushtetit qendror. U zgjodh Mirdita, duke qenë se kishte pasur njëfarë autonomie të kufizuar në kohën e Turqisë. Në Mirditë, Preng Bib Doda (zëvendësministër i Shqipërisë së asaj kohe) kishte vdekur pa lënë asnjë trashëgimtar të tij, gjë që u përdor nga kushëriri, njëkohësisht edhe rivali i tij Markagjoni. Markagjoni, në fakt, deri në atë kohë nuk jetonte në Mirditë, jetonte në Prizren si i arratisur. Me vdekjen e Preng Bid Dodës, Markagjoni mori menjëherë vendin e kushëririt të tij, i cili vendosi të vihej në krye të një minishtetit në Mirditë, të shkëputur nga Tirana. Markagjoni, përpara se të merrte zyrtarisht pozicionin, erdhi në Tiranë bashkë me një përfaqësues tjetër mbështetës të tij, ku paraqitën kërkesën që “t’iu njiheshin privilegjet që kishte krahina e Mirditës në kohën e Turqisë, pra të përjashtoheshin mirditorët nga taksat dhe shërbimi ushtarak, gjë që u refuzua nga qeveria e Tiranës”.¹³ Për të arritur objektivin e tij, Markagjoni kërkoi kështu ndihmën e jugosllavëve në të holla dhe armë. Pasi u kthye në Prizren, ai mblodhi të gjithë mirditorët, duke i shpërblyer dhe armatosur, dhe në fund të qershorit sulmoi qeverinë e Tiranës. Megjithatë, ai nuk gjeti asnjë mbështetje dhe, përkundër kundërveprimit të forcave të qeverisë, të cilat reaguan menjëherë, u detyrua të hidhej sërish në Jugosllavi dhe të vendosej prapë në Prizren. I nxitur nga Beogradi, ai më tej vuri në dispozicion të tij reparte ushtarake të pajisura me armë të rënda, nga ku filloi sulmet në zonën ushtarake. “Qeveria në këtë pikë nuk arriti dot t’i bënte ballë situatës, për shkak se pati sulme nga të dyja anët dhe luftimet u zgjatën shumë në kohë, kjo për shkak të të dyja palëve.”¹⁴ Në këtë pikë, Beogradi e ndihmoi Markagjonin jo vetëm me armë, por edhe me diplomaci. Delegati jugosllav paraqiti në Asamblenë e Lidhjes së Kombeve, në shtator të vitit 1921, dy

¹¹ *Po aty*, f. 305.

¹² *Po aty*, f. 306.

¹³ Mehdi Frashëri, *Kujtime (1913-1922)*, Tiranë: 2005, f. 97.

¹⁴ *Po aty*.

telegrame, në të cilat nënshkruhej “Republika e Mirditës”, duke theksuar se kjo “republikë” nuk kishte të bënte me Qeverinë e Tiranës, madje se nuk e njihje atë.¹⁵ Në telegramin e dytë, përshkruhej gjendja e Mirditës, në të cilën thuhej se, “*pas shumë shkatërrimesh, një grusht agjitorësh xhonturq masakronin të krishterët në sytë e gjithë botës. Këta detyrohen të lënë vatrën e tyre dhe të strehohen nëpër male, ku vdesin me mijëra*”, dhe vijonte me kërkesën që “*kjo luftë, e nisur nga qeveria e Tiranës për të shfarosur të krishterët të marrë fund*”.¹⁶ Përkundrejt kësaj deklarate reaguan njëri pas tjetrit kreu fetar, po ashtu dhe deputetët katolikë të parlamentit shqiptar, për të protestuar “*kundër ndërhyrjes së Serbisë, e cila shkaktonte trazira te ne, për të realizuar synimet e saj imperialiste*”.¹⁷

Ndërhyrja e hershme jugosllave ishte një sfidë kundër Lidhjes dhe opinionit të gjerë europian. Ndaj kësaj ndërhyrje pati reagime të shumta nga diplomatë, kolonelë etj. Ndër to, kryeministri britanik Lloyd George iu drejtua personalisht Lidhjes së Kombeve, në një telegram dërguar Sekretarit të Përgjithshëm, në të cilin ai dënonte ashpër “*ndërhyrjen e vazhdueshme të ushtrisë jugosllave në Shqipëri, që mund të cenonte paqen botërore*”; ai po ashtu “*tërhiqte vëmendjen e Këshillit për këtë ngjarje dhe lutej që të thirrej mbledhja e Këshillit, për ta studiuar situatën dhe për të marrë masat që parashikonte neni 16 i këtij pakti, në rast se qeveria serbo-kroate-slllovene do të refuzonte t’u përgjigjej detyrimeve që impononte pakti*”.¹⁸ Çështja u mor menjëherë në shqyrtim të Këshillit për t’u studiuar, vetëm disa ditë mbas vendimit të 9 nëntor 1921 të Konferencës së Ambasadorëve për çështjen e kufijve të Shqipërisë. Në këtë mbledhje morën pjesë po ashtu dhe përfaqësuesit e dy palëve, ai shqiptar dhe ai jugosllav, të cilët dhanë secili shpjegimet e tyre. Në seancën e tij të tretë, më 19 nëntor të vitit 1921, Këshilli mori shënim deklaratën e bërë nga kryeministri jugosllav, i cili citoi se “*do të merreshin të gjitha masat për të siguruar zbrapsjen e menjëhershme të territorit shqiptar nga trupat jugosllave*”.¹⁹

Në kontekstin e marrëdhënieve të para shqiptaro-jugosllave, ky ishte një rezultat i rëndësishëm për Shqipërinë, e cila e detyronte Beogradin të hiqte dorë nga orvatjet për destabilizim të shtetit shqiptar; megjithatë, ngriti themelet po ashtu për një marrëdhënie të destabilizuar dhe mosbesimi midis dy shteteve. Në atë kohë, Këshilli i Lidhjes, më 19 nëntor të vitit 1921, vendosi krijimin e një komisionit të posaçëm hetimor, i cili do të shkonte ta shihte situatën më nga afër dhe të hartonte kështu një raport përfundimtar. Veprimtaria e Komisionit në këtë kuadër vijoi deri në datë 20 dhjetor 1921. “Komisioni

¹⁵ Arben Puto, *Shqipëria Politike 1912-1939*, Tiranë: Botimet Toena, 2009, f. 307.

¹⁶ Justin Godart, *L’Albanie en 1921*, Paris, 1922, f. 244-245.

¹⁷ *Po aty*, f. 152.

¹⁸ André Simonard, *Essai sur l’indépendance albanaise*, Paris, 1942, f. 389.

¹⁹ *Po aty*.

shkoi në vend dhe mbi bazën e vëzhgimeve hartoi raportin përfundimtar mbi ngjarjet në Mirditë, duke shkuar fizikisht në Orosh, në javën e parë të dhjetorit në vitin 1921.”²⁰

Në mbarim të këtij konflikti dhe dhënien e verdiktit nga ana e Këshillit në raport, qeveria e Tiranës bëri një gjest të parë pajtimi. “Qeveria e Tiranës dërgoi në Orosh, si të deleguar vetë Ahmet Zogun, i cili e qetësoi përfundimisht gjendjen, duke shpallur amnistinë e përgjithshme, me rastin e festës së pavarësisë më 28 Nëntor”.²¹ Në fillim të shkurtit 1923, Këshilli i Lidhjes gjykoi se komisioni hetimor e kishte kryer misionin e tij në Shqipëri dhe e ndërpreu veprimtarinë. Përfaqësuesit e Shqipërisë u bashkuan me vendimin. “Në fund të misionit, u paraqit edhe raporti përfundimtar i situatës.”²² Në kuadër të saj, duhet thënë se u bë shkas për një normalizim të marrëdhënieve të Shqipërisë, jo vetëm me vendet fqinje, por edhe me Jugosllavinë.

Përgjatë vitit 1923, “konfliktet shqiptaro-jugosllave qëndronin në kuadrin e qëndrimit jugosllav dhe zvarritjen e tyre në çështjen e kufijve”.²³ Zogu në politikën e jashtme ripohonte vazhdimisht qëndrimin e tij anti-rendentist (Kundër Komitetit të Kosovës), duke iu shmangur komplikacioneve me Jugosllavinë, duke deklaruar se: “*Me shtetet fqinje ne do jemi miq, ne do t'i respektojmë dhe do të kërkojmë ta respektojnë pavarësinë tonë politike e ekonomike dhe integritetin*”.²⁴

Më 10 qershor 1924, në Shqipëri shpërtheu një lëvizje që në histori njihet si Revolucioni i Qershorit, e cila çoi në rrëzimin e qeverisë së Zogut dhe zëvendësimin me një qeveri demokratike. Qeveria e re u kryesua nga intelektual i njohur i kohës, i cili kishte vepruar në Shqipëri dhe jashtë saj, Fan Noli. “Qeveria e Nolit nuk do të gjente mbështetjen e Jugosllavisë, as të Italisë. Zogu do të rikthehet në pushtet me ndihmën e Beogradit.”²⁵

Ka qenë përgjatë gjithë marrëdhënieve shqiptaro-jugosllave, “një konstante e politikës jugosllave në Shqipëri të pasurit një rrjet agjentësh në shërbim të saj”.²⁶ Në forma e mënyra të ndryshme, ky sistem kishte funksionuar ndër vite dhe kishte pasur në përbërje të tij elementë nga të gjitha shtresat sociale të shoqërisë shqiptare të kohës. Të tillë ishin edhe kategori njerëzish nga politika e partisë shqiptare, të cilët i shërbenin Beogradit. “Këta elementë u riaktivizuan në pranverën e vitit 1927, për të përmbysur Ahmet Zogun nga pushteti.”²⁷ Megjithatë, kriza e kësaj kohe me Jugosllavinë shërbeu vetëm për ta afruar më

²⁰ Raporti komisionit hetimor, dt. 19.11.1921, SdN Journal Officiel, Janvier 1922, faqe 152-156. Përkth: *Çështja shqiptare në aktet ndërkombëtare...*, v. III, f. 308-313.

²¹ A. Puto, *Shqipëria Politike...*, f. 309.

²² Societe des Nations, Rapport de la VI Assenblee, faqe 26-28.

²³ Oë en Pearson, *Albania and King Zog*, London, 2004, f. 221.

²⁴ Teki Selenica, *Shqipëria më 1927*, Tiranë, 1928, f. 55.

²⁵ Iliaz Fishta, *Ndërrhyrja e kapitalit tëhuaj dhe pasojat e saj skllavëruese nëShqipëri (1931-1936)*. Tiranë, 1989, f. 2.

²⁶ P. Milo. *Politika e Jashtme...*, f. 732.

²⁷ *Po aty*.

tepër Zogun me Musolinin, duke e bërë Musolinin që të udhëzonte Beogradin për tërheqje. Gjithnjë me konsultime të ngushta me Romës, më 5 qershor të vitit 1927, qeveria shqiptare “njoftoi zyrtarisht përfaqësuesit diplomatikë të Fuqive të Mëdha në Tiranë dhe Sekretariatit e Lidhjes së Kombeve për tërheqjen e personelit diplomatik jugosllav”.²⁸ Beogradi nuk arriti të gjente mbështetje nga Fuqitë e Mëdha as në këtë rast, përveç Francës, ndaj “për të provokuar një debat jo aq shumë për marrëdhëniet shqiptaro-jugosllave, por për ato jugosllavo-italiane, kërkoi diskutim në Këshillin e Lidhjes e Kombeve”.²⁹

Dështimi edhe i këtyre përpjekjeve çoi në masa të tjera, “duke mbyllur konsullatat jugosllave në Shkodër, Vlorë e Korçë”.³⁰ Si kundër-reagim, Zogu po ashtu urdhëroi tërheqjen e personelit diplomatik nga Beogradi. Në po këtë vit, kriza e marrëdhënieve shqiptaro-jugosllave rrezikoi të dilte jashtë kontrollit. Megjithatë, me ndërhyrjen e shteteve, si Britania e Madhe, Franca, Italia dhe Gjermania, më 8 gusht u rivendosën marrëdhëniet diplomatike midis dy vendeve. Megjithatë, në nëntor marrëdhëniet shqiptaro-jugosllave u polarizuan edhe më tej. Jugosllavia, më 11 nëntor të viti 1927 nënshkroi me Francën Traktatin e Miqësisë dhe Bashkëpunimit, ndërsa Shqipëria përfundoi me Italinë Traktatin e Aleancës Mbrojtëse. Megjithatë, mund të thuhet, në njëfarë mënyre, se “fondi i viti 1927 shënoi triumfin e politikës italiane në Shqipëri e dështimin e synimeve jugosllave”,³¹ kjo ndikoi drejtpërsëdrejti në përkeqësimin e marrëdhënieve shqiptaro-jugosllave.

Ndërkohë, më 1 shtator të vitit 1928, “Shqipëria u shpall mbretëri me ndihmën e Italisë; Jugosllavia, do ta njohë mbretërinë më 13 shtator të 1928, kjo sigurisht për mos të lënë një përshtypje të keqe edhe te Fuqitë e Mëdha”.³²

Vitet e mëpasshme ishin në fakt asgjë më shumë sesa një pasqyrim i marrëdhënieve shqiptaro-jugosllave të ngritura midis problemeve tashmë të trashëguara. Përpos faktit që shtetet tashmë gjendeshin në rrethana të reja politike, po aq sa dhe ekonomike, dhe duke rikujtuar që Jugosllavia tashmë kishte një aleancë të formalizuar me Francën dhe Shqipëria me Italinë, kjo e fundit çoi edhe në ndihmë ekonomike për Shqipërinë. Shqipëria ndodhej tashmë midis influencës italiane, e cila ishte e interesuar për rajonin e Ballkanit, duke përfutur nga mungesa e fuqive perëndimore, e cila binte ndesh me dëshirën jugosllave, po ashtu për të qenë dominante në Shqipëri me influencën e saj politike po aq sa dhe ekonomike.

²⁸ AMPJ, dosja nr. 116, viti 1927, f. 50, 51; 123-124.

²⁹ P. Milo. *Politika e Jashtme...*, f. 738.

³⁰ AQSH, Fondi 152, dosja nr. 80, viti 1927, f. 45; 49; 51.

³¹ P. Milo. *Politika e Jashtme...*, f. 744.

³² Patrice Najbor, *Monarkia Shqiptare 1928-1939*, Botim i Qendrës së Studimeve Albanologjike, Instituti i Historisë, Tiranë: Botimet Toena, 2011, f. 319.

Beogradin me Tiranën i lidhte lufta ndaj emigracionit politik në atë kohë. Gjatë viteve 1928 deri në vitin 1931, shteti shqiptar u përpoq të ruante marrëdhënie të mira me Beogradin, duke mos e përkrahur veprimtarinë e emigracionit politik shqiptar. Gjatë kësaj periudhe, megjithatë, “u shtua ndjeshëm edhe numri i organizatave dhe i individëve të arratisur në Jugosllavi, Rumani, Turqi, si kundërshtarë të mbretit Zog, i cili nuk e përkrahu emigracionin”.³³

Nevoja për përmirësimin e marrëdhënieve u vu re edhe me kërkesën e Zogut kundrejt Jugosllavisë për bashkëpunim, për ta larguar rrezikun italian nga Shqipëria. Në fakt, “deri në gjysmën e parë të viteve 1930 dukej se marrëdhëniet shqiptaro-jugosllave ishin përmirësuar”.³⁴ Kjo më së shumti, sepse Zogu kishte filluar të largohej nga Italia. Përgjatë vitit 1932 pati një intensifikim gjithashtu në marrëdhëniet ekonomike midis të dy shteteve, me bashkëpunime dhe marrëveshje të shumta. “Në vitin 1932, Shqipëria importonte nga Jugosllavia mallra në vlerë mbi 2 milionë franga ari”.³⁵

Marrëdhëniet shqiptaro-jugosllave në këtë periudhë herë normalizoheshin dhe herë përkeqësoheshin. Afrimi i Shqipërisë me Jugosllavinë përkoj me periudhën ku “në rajonin ballkanik do të zhvilloheshin Konferencat e para Ballkanike”.³⁶ Në vitin 1934, “Zogu bëri përpjekje të vazhdueshme për t’u afruar me fqinjët e tij rajonalë, sidomos me Beogradin”.³⁷ Diplomacia italiane e kohës tregon se marrëdhëniet shqiptaro-jugosllave kishin rifilluar në qershor të vitit 1935, dhe se marrëdhëniet shqiptaro-jugosllave ishin shpeshuar dhe, mbi të gjitha, ishin formalizuar nëpërmjet traktateve të nënshkruara në muajt korrik dhe gusht të vitit 1935. Zyra e atashut ushtarak në Tiranë bënte të ditur se “*Beogradi që moti punon me mbretin Zog*”.³⁸

Në vitin 1936 dukej se marrëdhëniet italo-shqiptare po përmirësoheshin; kjo vihet re “nga ndihma financiare që Musolini i dha mbretit Zog”.³⁹ Gjatë vitit 1938 u bënë disa përpjekje për intensifikimin e tregtisë midis dy vendeve fqinje. Megjithatë, vitet 1935-1938 i intensifikojnë veprimet e qeverisë jugosllave në hartimin e politikave të veçanta për zhdukjen e shqiptarëve, me anë të kolonizimit dhe dëbimit nga tokat ku ata jetonin. Kulmi

³³ AMPJ, fondi 151, dosja 300, faqe 1-5. **Shënim:** Korrespondencë e MPJ jugosllave me vendet e Ballkanit, në lidhje me organizimin e emigracionit politik shqiptar kundër mbretit Zog.

³⁴ P. Milo, *Politika e Jashtme...*, f. 858.

³⁵ AMPJ, Fondi 151. Dosja 339, viti 1933, faqe 40. **Shënim:** Notë e MPJ të Shqipërisë me Legatën Jugosllave në Tiranë.

³⁶ *Historia e Shqipërisë 1912-1939*, vëll. III, botim i Akademisë së Shkencave të Shqipërisë, Instituti i Historisë. Tiranë: 1984, f. 386.

³⁷ P. Milo, *Politika e Jashtme...*, f. 818.

³⁸ Izber Hoti, *Qëndrimi i diplomacisë italiane ndaj Shqipërisë dhe shqiptarëve 1930-1997*, Prishtinë: 1999, f. 75.

³⁹ P. Milo, *Politika e Jashtme...*, f. 843.

i politikës antikombëtare ndaj shqiptarëve ndodhi në vitin 1938, kur “Jugosllavia do të nënshkruante marrëveshjen turko-jugosllave për dëbimin e 200.000 shqiptarëve”.⁴⁰

Megjithatë, deri në vitin 1939 do të karakterizohet më tej nga ngjarje të rëndësishme politike për vetë shtetin shqiptar. Në këto vite, përveç problemeve të trashëguara lindën dhe mosmarrëveshje të reja midis dy shteteve ku, midis tyre mund të përmendim “trajtimin e popullsisë shqiptare në mbretërinë serbo-kroate – sllovene, çështja e emigrantëve politikë kundërshtarë të Zogut, çështja e kufijve etj”.⁴¹Në vitin 1939, Jugosllavia e mbështeti pushtimin fashist, duke e miratuar në mënyrë të fshehtë, si dhe duke heshtur ndaj pushtimit të Shqipërisë nga fashizmi italian; pas kësaj, “trupat ushtarake italiane e pushtuan Shqipërinë më 7 prill 1939”.⁴²Vlen të theksohet se marrëdhëniet shqiptaro-jugosllave të viteve 1928-1939 nuk mund të shiheshin vetëm në kuadër të marrëdhënieve bilaterale, por shiheshin dhe analizoheshin të ndara në trekëndëshin Itali-Shqipëri-Jugosllavi.

Periodha vijuese, periodha e luftës antifashiste, pasqyrohet nga marrëdhënie, pozita dhe “qëndrime të kundërta të mbajtura nga PKSh dhe PKJ, për një numër problemesh parimore, si dhe qëndresën e PKSh dhe Enver Hoxhës kundër ndërhyrjes jugosllave në këto vite”.⁴³ Kjo periudhë në historinë e marrëdhënieve shqiptaro-jugosllave ka pasur “*më shumë acarime dhe tensione sesa zhvillime të një bashkëpunimi normal*”⁴⁴.

Më 8-14 nëntor të vitit 1941 u krijua PKSh, “në mbledhjen e përfaqësuesve të grupeve komuniste”.⁴⁵ Krijimi i Grupit të Korçës do të shënonte dhe fillimin e lëvizjes së organizuar komuniste në Shqipëri. Histografia jugosllave e kohës tregonte se në verën e vitit 1941 “u dërgua nga shtabi i Titos, Miladin Popoviç, për t’u vënë në radhët e partisë komuniste dhe lëvizjes së re komuniste”,⁴⁶ madje duke drejtuar lëvizjen. Gjë që u hodh poshtë nga pala shqiptare, edhe pse vetë “pala shqiptare konfirmoi prezencën e tij në radhët e lëvizjes së partisë”.⁴⁷

Po ashtu, në konferencën e parë të vendit të Partisë Komuniste të Shqipërisë, në mars të viti 1943, përmenden emrat e dy të dërguarve, Bllazho Jovnoviç dhe Miladin Popoviç, nga ku Partia Komuniste vlerësoi kontributin e tyre, ndërkohë që pala jugosllave këmbëngulte se ata “ishin në krye të lëvizjes komuniste dhe ishin ndër themeluesit e Partisë Komuniste në vend, ndërsa pala shqiptare hidhte poshtë këtë tezë”.⁴⁸ Pala jugosllave, po ashtu, përgjatë kësaj periudhe kohore merrte meritat për përpunimin e

⁴⁰ Valentina Duka, *Histori e Shqipërisë 1912-2000*, Tiranë: Kristalina, 2007, f. 245.

⁴¹ *Po aty*.

⁴² Bernd Fischer, *Shqipëria gjatë luftës 1939-1945*, Tiranë: Botimet Çabej, 1999, f. 15.

⁴³ Xh. Gjeçovi, *Marrëdhëniet shqiptaro-jugosllave në vitet e Luftës Antifashiste Nacionalçlirimtare...*, f. 29.

⁴⁴ Ramiz Alia. *Vija e drejtë e Partisë – burim i sukseseve tona*. Tiranë, 1984, f. 37.

⁴⁵ *Historia e PPSH*, Tiranë, 1981, f. 12.

⁴⁶ Enver Hoxha, *Titistët (Shënime historike)*. Tiranë, 1982, f. 32-33.

⁴⁷ Xh. Gjeçovi. *Marrëdhëniet shqiptaro-jugosllave në vitet e Luftës Antifashiste Nacionalçlirimtare...*, f. 34.

⁴⁸ *Po aty*, f. 39.

vijës për periudhën e Luftës Antifashiste Nacionalçlirimtare. “Pala shqiptare e hidhte poshtë tezën, duke përmendur letrat e dërguara nga vetë Titoja për palën jugosllave të ndodhur në Shqipëri.”⁴⁹

Siç u tha dhe më lart, ka qenë përgjatë gjithë marrëdhënieve shqiptaro-jugosllave, një “konstante e politikës jugosllave në Shqipëri të pasurit një rrjet agjentësh në shërbim të saj”,⁵⁰ fillimisht me elementë të riaktivizuar për të përmbysur Ahmet Zogun nga pushteti, dhe më vonë, bazuar dhe në dokumentet, librat dhe botimet e partisë komuniste, ku reflektohej bindshëm ideja se shumë prej lëvizjeve të kohës, ngjashëm si lëvizja për ngritjen e partisë komuniste, ishin të nxitura nga vetë pala jugosllave, nëpërmjet të dërguarve të “*infiltruar*”, për të gjeneruar të tilla lëvizje. Ndërkohë që pala shqiptare e hidhte poshtë këtë tezë, duke thënë se kjo lëvizje ishte nisur nga ata vetë, edhe pse “konfirmohej pjesëmarrja e të dërguarve jugosllavë të kohës, madje edhe brenda radhëve të partisë dhe elitës politike”.⁵¹ Përplasjet e marrëdhënies së dy vendeve vazhduan në vitin 1943, lidhur me qëndrimin dhe marrëdhëniet e mbajtura nga PKSh me Ballin Kombëtar, të cilën Jugosllavia e cilësoi si një qëndrim oportunist dhe “*sektar*”.⁵²

Partia Komuniste Jugosllave, në tetorin e vitit 1943 paraqiste hapur dhe ritheksonte në letrën dërguar nga Tito, lidhur me qëllimet e tij për mbizotërim në Ballkan, duke deklaruar hapur se “*Jugosllavia ka në çdo pikëpamje rol udhëheqës në Ballkan*”⁵³, dhe se “*ne duhet të jemi qendër për vendet ballkanike, si në pikëpamjen ushtarake, ashtu dhe në pikëpamjen politike*”.⁵⁴

Për palën shqiptare, plani i Titos për krijimin e shtabit ballkanik përputhej me projektet e politikanëve anglezë për “krijimin pas luftës të Federatës apo Konfederatës Ballkanike”,⁵⁵ për të cilin Enver Hoxha shkruante se pala jugosllave “*u përpoq të krijonte Shtabin Ballkanik dhe ta lidhte e ta vinte atë, d.m.th. ushtritë tona nën drejtimin e anglo-amerikanëve*”.⁵⁶ Pra, se pala jugosllave, përveçse kërkoi të krijonte Shtabin Ballkanik, ajo po ashtu dëshironte të përdorte në këtë kuadër edhe ushtrinë shqiptare për arritjen e këtij qëllimi, i cili për Enverin shkonte përtej vetëm dëshirës jugosllave, nën urdhrat dhe drejtimin e anglo-amerikanëve.

Megjithatë, Shqipëria përpiqej në mënyrë të vazhdueshme që të krijonte marrëdhënie me palën jugosllave. Përpjekje të tjera u vunë re edhe në vitin 1944, ku

⁴⁹ *Po aty*.

⁵⁰ P. Milo, *Politika e Jashtme...*, f. 732.

⁵¹ Enver Hoxha, *Kur u hodhën themelet e Shqipërisë së re (Kujtime e shënime historike)*. Tiranë, 1984, f. 215.

⁵² Xh. Gjeçovi, *Marrëdhëniet shqiptaro-jugosllave në vitet e Luftës Antifashiste Nacionalçlirimtare...*, f. 50.

⁵³ Svetozar V. Tempo, *Lufta për Ballkanin*, Lubjanë, 1981, f. 132.

⁵⁴ *Po aty*.

⁵⁵ Arben Puto, *Nëpër analet e diplomacisë angleze*, Botimi II, Tiranë, 1980, f. 433.

⁵⁶ Enver Hoxha, *Vepra*, Vëll. 19, Botimet: "8 nëntori", Tiranë, 1975. 433.

“Shqipëria tregoi mbështetjen e saj kundrejt luftës në Jugosllavi, e cila kishte filluar të ashpërsohej”.⁵⁷ Marrëdhëniet dypalëshe shqiptaro-jugosllave, në periudhën e Luftës Nacionalçlirimtare, pavarësisht se iu larguan trekëndëshit Itali-Shqipëri-Jugosllavi, tashmë ishin bërë më komplekse, “për shkak se ishin në mes të tjera troje me popullsi shqiptare, si Kosova dhe Maqedonia, ku në qershor të vitit 1944 Shqipëria dërgoi dy brigada për të ndihmuar, me kërkesë të vetë Jugosllavisë”.⁵⁸

Marrëdhëniet shqiptaro-jugosllave karakterizohen që në formësinë e tyre nga problematika të shumta, duke filluar nga ndikimi i Jugosllavisë, për të aneksuar Shqipërinë dhe për të qenë një forcë predominuese në Ballkan, kjo nëpërmjet taktikave të shumta politiko-strategjike.

Në të njëjtën kohë, karakterizohen dhe nga nevoja e Shqipërisë për të pasur marrëdhënie të mira fqinjësie në rajon, jo vetëm në kuadër të politikave strategjike të politikës së jashtme, si shtet i ri i pavarur, por, mbi të gjitha kryesisht për nevojat ekonomike ushtarake të Shqipërisë, që shpesh e çonin në pozita për të ndërtuar marrëdhënie diplomatike me Jugosllavinë. Ka qenë përgjatë gjithë marrëdhënieve shqiptaro-jugosllave një konstante e politikës jugosllave në Shqipëri të pasurit e një rrjet agjentësh në shërbim të saj. Të dyja shtetet karakterizoheshin padyshim nga një mosbesim i dyanshëm, i cili vihet re edhe më shumë pas viteve 1941, me influencat e brendshme dhe të dërguarit e Jugosllavisë në shtresat politike të kohës. Përmendim po ashtu se problemet e shumta të marrëdhënieve të të dyja vendeve çuan dy herë në ndërhyrjen, së pari të Aleancës së Kombeve të Bashkuara, po ashtu dhe të Fuqive të Mëdha. Baza e marrëdhënieve të ngritura Shqipëri-Jugosllavi, nga viti 1918 me krijimin e shtetit jugosllav deri në vitin 1944, do të reflektohej bindshëm edhe në marrëdhëniet e tyre përgjatë viteve ‘45-’48 ku do të pasqyrohet gjerësisht edhe figura dhe procesi politik i Koçi Xoxes.

⁵⁷*Po aty.*

⁵⁸ Xh. Gjeçovi, *Marrëdhëniet shqiptaro-jugosllave në vitet e Luftës Antifashiste Nacionalçlirimtare...*, f. 50.

KREU I

ORIENTIMI I SHQIPËRISË DREJT JUGOSLLAVISË

1.1. Partia Komuniste Shqiptare dhe misionarët jugosllavë në Shqipëri

Pas përfundimit të Luftës së Dytë Botërore dhe çlirimit të Shqipërisë nga Italia dhe Gjermania, PKSh, me në krye Enver Hoxhën, i cili në këtë periudhë mbante edhe rolin e kryeministrit, ministrit të Punëve të Jashtme, ministrit të Mbrojtjes, si dhe udhëhiqte ushtrinë e vendit, premtoi ndërtimin e një shoqërie të re, të sapo dalë nga “gryka e pushkës”. Vitet pasuese sollën ndryshime radikale në vendet komuniste të Europës Lindore, duke krijuar të ashtuquajturin “Bllok Socialist”, me një lloj të ri të sistemit shtetëror-politik, sistemin një-blokësh totalitar, drejtpërdrejt nën sundimin e Moskës, ku një politikë e përbashkët dominonte të gjitha sferat. Në vitet e para të pasçlirimit, edhe shqiptarëve, ashtu si gjithë bllokut komunist, iu paraqit një projekt ambicioz për zhvillimin ekonomik, arsimor, kulturor dhe shoqëror të vendit. E gjithë kjo, duke shfrytëzuar mobilizimin e masave, tipike për sistemet totalitare, për të rënë në diktaturën e egër komuniste 40-vjeçare të Enver Hoxhës.

Historia e lindjes dhe rritjes së lëvizjes komuniste në Shqipëri është disi e veçantë, duke marrë në konsideratë kohën e shkurtër brenda së cilës komunistët arritën të merrnin pushtetin në një vend si Shqipëria, ku komunizmi nuk ishte fort i njohur, pasi para luftës vendi kishte qenë në diktaturën vetjake të Mbretit Zog. Zanafilla e komunizmit në Shqipëri daton qysh në vitin 1929, ku funksionuan katër grupe komuniste: Grupi i Korçës, Grupi i Shkodrës, Grupi i Zjarrit dhe Grupi i të Rinjve. Grupi i Korçës, ndryshe prej grupeve të tjera, dallohej nga përbërja intelektuale, ku përfshiheshin edhe punëtorë e ku propagandonte për një qëndresë të përgjithshme kundër pushtuesit. Grupi i Shkodrës kishte më shumë mbështetje nga rinia dhe shkollat, bazat e tij ishin propaganda ndaj sloganeve bolshevike për revolucionin socialist të klasës punëtore. Grupi Zjarri njihej si grup trockist dhe anarkist, të cilët e shikonin si të nevojshëm bashkëpunimin me Italinë. Ndërsa Grupi i të Rinjve u shkëput nga Grupi komunist i Korçës, i cili kishte si themelues dhe kryetar të saj Koçi Xoxen, e që më pas u bë një ndër elementët kryesorë të Partisë Komuniste Shqiptare. Kjo shkëputje u bë për arsyen se anëtarët e Grupit të Korçës “ishin të mendimit që fshatarët shqiptarë ishin aq konservatorë, saqë nuk ekzistonte një bazë reale për krijimin e një partie”.⁵⁹

Qysh në vitin 1941, Komiteti Qendror i PKJ arriti të krijojë kontakte të ngushta me komunistët e Shqipërisë, duke dërguar atje instruktorin Miladin Popoviç, me detyrën e organizimit të lëvizjes së rezistencës. Më vonë shkoi edhe Dushan Mugosha dhe të dy,

⁵⁹ Valentina Duka, *Histori e Shqipërisë 1912-2000*, Tiranë: Botimet Albas, 2014, f.208.

sipas urdhrorit të Kominternit, nga grupe të përçara komuniste formuan një parti të bashkuar, PKSh. “Miladin Popoviç ka qenë partizan jugosllav, sekretar politik i komitetit Krahinor të Partisë Komuniste Jugosllave për Kosovën dhe organizator i Partisë Komuniste të Shqipërisë. Pas pushtimit të Mbretërisë Jugosllave, më 8 korrik 1941, u arrestuan në Rozhajë, teksa po udhëtonin nga Kosova për në Mal të Zi vetë Miladini, i vëllai Mihajlo Popoviç dhe bashkëpunëtori i tyre Kristo Filipoviç. Tre të arrestuarit u mbajtën të internuar në Peqin.”⁶⁰

“Dushan Mugosha, në gushtin e vitit 1941, pas arrestimit të Miladin Popoviçit dhe kërkesës së Fadil Hoxhës, gjeneralmajor në Luftën Nacionalçlirimtare, me vendim të Komitetit Qendror të Partisë Komuniste të Jugosllavisë udhëton drejt Shqipërisë.”⁶¹ Këta arritën t’i bindnin përfaqësuesit e grupeve komuniste të Shqipërisë të takoheshin me ta në Tiranë, në fillim të nëntorit 1941. Mbledhja e themelimit të Partisë u mbajt në datat 8 deri 14 nëntor 1941, nën organizimin e këtyre dy emisarëve të Titos dhe udhëzimeve të Kominternit. Enver Hoxha, si përfaqësuesi intelektual i Grupit të Korçës, njëherësh ishte edhe mik i Miladin Popoviçit dhe u ndihmua e u përkrah prej tij për të marrë kreun e Partisë. Sipas fjalëve të hapura aso kohe, thuhet se pjesëmarrja e Hoxhës në atë mbledhje ishte thjesht rastësi, por që nga ajo mbledhje të gjitha atributet i mori ai, ku vendosi përfundimisht autoritetin e tij absolut prej 40 vjetësh në Shqipëri. Fjalimi i hapjes, i mbajtur nga malazezi Miladin Popoviç, kishte për qëllim koordinimin dhe bashkimin e të gjitha grupeve, gjithnjë sipas udhëzimeve të Kominternit, duke u nisur edhe nga praktika e ndjekur pas luftës, ku çdo orientim dhe direktivë për çështje organizative në Parti vinte nga Beogradi. Gjatë atyre ditëve u arrit të kapërceheshin të gjitha mosmarrëveshjet lokale dhe, në këtë mënyrë, u formua Partia Komuniste Shqiptare (PKSh). Çështjet themelore dhe imediate të objektivave kryesore të PKSh-së që u trajtuan ato ditë në këtë mbledhje ishin dëbimi i fashistëve italianë, spastrimi i mbetjeve të qeverisë monarkiste dhe vendosja e republikës popullore. Organi drejtues i saj përbëhej prej shtatë anëtarësh, Sekretar i Përkohshëm i Partisë u caktua Enver Hoxha. Ideja për krijimin e një partie të vetme lindi në kushtet e ekzistencës së realitetit konkret dhe objektiv. Në historiografi është fiksuar teza se themeluesi i PKSh ka qenë Enver Hoxha, ku edhe ai vetë, në librin e tij “Kur lindi Partia”, përshkruan një histori të gjatë mbi krijimin e kësaj partie, si edhe për rolin e tij si themelues i kësaj partie. Por Ndreçi Plasari, në veprën “Studime historike”, shprehet se “kjo histori është kokë e këmbë një gënjeshtëri”.⁶² Këtë mendim ai e arsyeton me faktin se “Enver Hoxha nuk ka qenë asnjëherë kryetar i ndonjë prej grupeve të vogla komuniste që ekzistonin asokohe”. Kemi edhe një dëshmi tjetër: “*Ishin Miladin Popovic dhe Dushan Mugosha, dy emisarët jugosllavë, ata që drejtuan mbledhjen, nga e cila arritën që prej*

⁶⁰Kastriot Dervishi, *Lëvizja komuniste në vitet 1924-1944 dhe formimi i PKSH-së*, Tiranë: 55, 2016, f. 184-187.

⁶¹ *Po aty*, f. 184-187.

⁶²Ndreçi Plasari, ‘*Studime Historike*’, 1994(1-4), f.116

grupeve marksiste të palidhura midis tyre të krijonin partinë e unisuar".⁶³ Duke analizuar pikërisht këtë moment, studiuesi gjerman Jens Reuter u shpreh se "Të dy misionarët e PKJ-së (Miladin Popovic dhe Dushan Mugosha) kanë pasur rolin kryesor në themelimin e PKSh, më 8 nëntor 1941".⁶⁴ Ndërsa Liri Belishova, anëtare e Byrosë Politike dhe e Komitetit Qendror të PPSH-së, një nga drejtueset kryesore të Partisë Komuniste, që në vitet e para të krijimit të saj, në një nga bisedimet e saj shprehet se "Miladin Popovic e parapëlqeu Enver Hoxhën qysh në krye, për arsye se ky i fundit 's'kishte të kaluar revolucionare', dhe prandaj ishte 'kandidati i bindur'.⁶⁵

Që kur u themelua PKSh – në përbërje të saj ishin kryesisht njerëz me nivel të ulët kulturor e arsimor – i ngarkoi vetes detyra strategjike: "Të luftohet për pavarësinë kombëtare të popullit shqiptar dhe për qeverinë popullore demokratike, në një Shqipëri të lirë prej fashizmit."⁶⁶

Partia Komuniste Shqiptare fillimisht pati një rritje të ngadaltë në numër të anëtarëve të saj. Enver Hoxha, që në fillimet e drejtimit të tij, nisi të përballej me një luftë ideologjike që vinte si nga brenda edhe nga jashtë partisë. "Grupi Zjarri, i cili nuk kishte marrë pjesë në krijimin e Partisë Komuniste vazhdonte të luftonte në pozitën e vet ndryshe nga Kominterni. Ai që bëhej shqetësues përherë e më shumë ishte Grupi i të Rinjve, i cili ishte tërësisht kundër zgjerimit të partisë nëpërmjet fshatarëve analfabetë.⁶⁷ Por këmbëngulja e vazhdueshme e Enver Hoxhës bëri që në vitin 1942 të spastroheshin nga radhët e partisë elementë të ndryshëm, të etiketuar si përçarës dhe të pabindur.

Më 16 shtator 1942, Enver Hoxha organizoi një Konferencë të fshehtë në Pezë, e cila pati për qëllim mobilizimin e forcave të ndryshme politike në një luftë të përbashkët kundër Italisë fashiste. "Kjo konferencë, jo pa qëllim u organizua në këtë vend, sepse Hoxha, për të rritur numrin e komunistëve dëshironte ta lidhte emrin e partisë me Myslym Pezën, i cili tashmë ishte një figurë e njohur në Shqipëri.⁶⁸ Në këtë konferencë morën pjesë përfaqësues të nacionalistëve, të rrymës që më vonë u quajt Balli Kombëtar, vijues të porositve të Mbretit Ahmet Zogu, disa udhëheqës çetash patriotë të pavarur, britanikë për luftë të përbashkët kundër pushtuesit, por sigurisht edhe përfaqësuesit e Partisë Komuniste. Por aty u vu re mungesa e disa elementëve të tjerë, siç ishin bejlerët, liberalët dhe republikanët. Ky fakt domethënës tregoi se komunistët ishin e vetmja parti politike që e

⁶³ S.V.Tempo, *Revolucija koja tece' (Memoari)*, Beograd, 1971, f.334.

⁶⁴ Jens Reuter, *Die Albanen in Jugoslaë ien*, Munchen, 1982, f.35.

⁶⁵ Bashkim Shehu, "Liri Belishova dhe koha e saj" Botimet: UET, Tiranë 2020, f.44

⁶⁶ *Dokumenta kryesore të PPSH, Rezolucioni I Mbledhjes së grupeve komuniste të Shqipërisë*, vëll.I, Tiranë 1960, f.22-23

⁶⁷ V. Duka, *Histori e Shqipërisë...*, f.209.

⁶⁸ *Po aty*, f.210.

ndërmori këtë takim e që pati për qëllim organizimin e forcave të ndryshme politike, në një luftë të përbashkët kundër Italisë fashiste.

Synimi i Konferencës së Pezës ishte sheshimi i mosmarrëveshjeve politike midis grupimeve. “Abaz Kupi, një ndër organizatorët dhe pjesëmarrësit kryesorë të kësaj konference, kundërshtoi përdorimin e termit “partizan” prej komunistëve dhe vendosjen e yllit të kuq në kapelat e tyre, sepse, sipas tij, këto ishin huazuar nga jugosllavët, siç ishin edhe disa nga vendimet politike që u hodhën për diskutim në konferencë.⁶⁹ Në këtë konferencë u hodhën bazat e krijimit të një lëvizjeje kundër pushtuesve italianë, e cila u quajt Fronti Nacionalçlirimtar.

Këshilli i Përgjithshëm, që u zgjodh në Konferencën e Pezës, miratoi të gjitha propozimet e hedhura nga PKSh, ndërsa pikat kryesore të këtij organi ishin: lufta pa kompromis kundër pushtuesve fashistë dhe tradhtarëve, organizimi i shqiptarëve në një front për çlirim kombëtar, ngritja e këshillave nacionalçlirimtare. Por duke u prezantuar me këto zhvillime, liberalët nacionalistë kuptuan se thjesht duhet të manifestonin solidaritet me komunistët, dhe jo të mos i miratonin.

Në nëntor 1942 u krijua Balli Kombëtar, një organizatë kjo nacionaliste, antikomuniste dhe me përbërje të elementëve që vinin nga monarkia shqiptare, e cila edhe pse nuk besonte te komunistët, u përpoq të realizonte një bashkëpunim me PK nëpërmjet Marrëveshjes së Mukjes, më 2 gusht 1943, të firmosur nga ballistët dhe komunistët. Krijimi i kësaj organizate ishte qartazi një reagim i drejtpërdrejtë ndaj themelimit të LNÇ-it. “Milovan Gjilasi, politikani dhe shkrimtari jugosllav, e përshkruan Ballin Kombëtar si një “*minoritet fashist shqiptar*”.⁷⁰ Ashtu si Fronti, i dominuar nga komunistët, kishte krijuar lidhje me organizatat ose partitë komuniste në shtetet e tjera, edhe Balli Kombëtar vendosi lidhje me organizata të ngjashme në Jugosllavi dhe në Greqi.

Në vitin 1943, Lufta Nacionalçlirimtare kishte marrë përmasa të mëdha dhe një shtrirje të gjerë në të gjithë Shqipërinë. Formacionet partizane, që sa vinin e shtoheshin, kërkonin domosdoshmërisht një shtab qendror drejtues që do të drejtonte dhe organizonte betejat e vërteta luftarake. “Në mars 1943, në fshatin Labinot u mbledh Konferenca mbarë-shqiptare e komunistëve, ku Enver Hoxha u zgjodh Sekretar i Përgjithshëm i PKSh-së dhe, duke ndjekur shembullin jugosllav, formoi Ushtinë Popullore, së cilës iu bashkua edhe Balli Kombëtar. Sidoqoftë, bashkëpunimi mes ballistëve dhe komunistëve u ndërpre në fund të vitit 1943, sepse kjo kërkohet nga jugosllavët, të cilët kishin frikë nga nacionalizmi i Shqipërisë së madhe. Sigurisht, marrëdhëniet mes dy partive, PKJ-së dhe PKSh-së, nuk mund ta anashkalonin çështjen e Kosovës, por, për shkak të pikëpamjeve dhe konsideratës së veçantë të Titos për serbët, ata vetëm sa e cekën si çështje dhe vendosën që, për kufirin

⁶⁹ *Po aty*, f.211.

⁷⁰ V. Duka, *Histori e Shqipërisë...*, f.212.

dhe të drejtën e popullit shqiptar për vetëvendosje të diskutonin vetëm pas humbjes së okupatorit.”⁷¹

Më 10 korrik 1943, Këshilli i Përgjithshëm i Frontit Nacionalçlirimtar vendosi të krijonte Shtabin e Përgjithshëm të Ushtrisë Nacionalçlirimtare. Enver Hoxha u caktua komisar i Shtabit të Përgjithshëm, ndërsa Spiro Moisiu komandant ushtarak i tij. Për të zbutur tensionin që mund të kishin midis njëri-tjetrit, për shkak të funksioneve të reja, si dhe për të gjetur një formulë për veprim të përbashkët kundër pushtuesve italianë, në qershor kishte shkuar në Labinot grupi i parë i një misioni anglez, i cili ishte nën komandën e majorit Bill Meklini. Enver Hoxha, që në fillim krijoi një antipati për Meklinin dhe e priti atë shumë ftohtë. Komunikimi i keq i Hoxhës dhe mungesa e organizimit ishin dhe arsyeja pse Meklini vonoi të vendoste lidhje të shpejta me Këshillin e Përgjithshëm të Frontit Nacionalçlirimtar.

Pas vendosjes së lidhjes midis tyre, prania e britanikëve në Shqipëri u bë shumë e rëndësishme. Në këto momente, Fronti Nacionalçlirimtar kishte vendosur të organizonte njësi të përhershme më të mëdha ushtarake, si dhe të hidhte hapat drejt ndërtimit të një ushtrie të rregullt. Misioni anglez u përpoq të ndihmonte edhe në krijimin e urave të bashkëpunimit midis Luftës Nacionalçlirimtare dhe organizatës së Ballit Kombëtar.

Pas presionit anglez, për një takim organizues midis këtyre dy kampeve, i cili u organizua më 1-3 gusht 1943, pas shumë diskutimesh dhe lëshimesh në të dy krahët, nga përfaqësuesit e të dy kaheve u arrit marrëveshja për luftë të përbashkët dhe të menjëhershme kundër pushtuesit përkrah aleatëve të tyre të mëdhenj. Për kohën dhe kushtet, në të cilat u mbajt ky takim, kjo ngjarje, pra Konferenca e Mukjes, hyri në histori. “Platforma politike e Konferencës së Mukjes buronte pikërisht nga Rezoluta e Konferencës së Parë Nacionalçlirimtare të mbajtur në Pezë, ku u konfirmua karakteri kombëtar dhe pluralist me strategjinë e luftës për Shqipërinë e lirë, të pandashme, të pavarur dhe demokratike.”⁷²

Në Konferencën e Mukjes, numri i barabartë i përfaqësuesve, 12 përfaqësues nga Fronti Nacionalçlirimtar dhe 12 përfaqësues nga organizata e Ballit Kombëtar, në marrëveshjen e tyre bënë thirrje për krijimin e një Komiteti të ri Kombëtar për Shpëtimin e Shqipërisë, i cili përbëhej nga 6 përfaqësues të secilës palë. Ymer Dishnica dhe Mustafa Gjinishi u deleguan nga Partia Komuniste të merreshin vesh me Ballin Kombëtar, duke pasur parasysh veprimet e përbashkëta kundër okupatorëve fashistë. Ata firmosën marrëveshjen për formimin e Komitetit për Shpëtimin e Shqipërisë. Në programin e këtij komiteti parashikohej jo vetëm lufta për një Shqipëri të pavarur e të lirë, por edhe për një Shqipëri etnike. Porse kjo marrëveshje për bashkëpunim me Ballin Kombëtar nuk iu erdhi

⁷¹Jozhe Pirjevec, *Tito dhe shokët*, Tiranë, Botimet: BOTART, 2020, f. 161.

⁷² Klement Shalari, *(Mos)Marrëveshja e Mukjes kullon ende gjak*, Tiranë, 1996, f.10.

për shtat të dërguarve jugosllavë, veçanërisht Enver Hoxhës, si ndjekës konsekuent i orientimeve të tyre dhe zbatues i përpiktë i këshillave të tyre. Kështu që kjo marrëveshje u hodh poshtë, si një vijë e huaj për Partinë, ndërsa Ymer Dishnica u përjashtua nga Byroja Politike si oportunist. Ndryshe nga Koçi Xoxe, me një nivel më të ulët arsimor, por që dominonte në Partinë Komuniste, Ymer Dishnica ishte një intelektual me formim francez, por i dyshimtë për udhëheqjen e partisë. “Prandaj Marrëveshja e Mukes nuk u pranua nga Partia Komuniste, i përçau shqiptarët, i nxiti të luftojnë njëri-tjetrin, si dhe u konsiderua kundërrevolucionare nga PKJ. I deleguari pranë PKSh, Svetozar Vukmanović – Tempo, ushtronte ndikim të konsiderueshëm mbi komunistët shqiptarë, veçanërisht mbi drejtuesin e tyre Enver Hoxha. Një grupim i historianëve mendon se Mukja u prish për shkak të ndërhyrjes së jugosllavëve, ndërsa grupimi tjetër mendon ndryshe. Por, më i besueshëm është fakti se komunistët jugosllavë kanë gisht në prishjen e Mukjes. Çështja më e rëndësishme dhe që ata i shqetësonte ishte koncepti i Shqipërisë etnike.”⁷³

Pas pushtimit të gjatë fashist më 7 prill 1939, kohë kur Shqipëria u udhëhoq nga guvernatorë italianë, më 8 shtator 1943, me kapitullimin e Italisë fashiste në Shqipëri ndodhën ndryshime të rëndësishme. Pas armëpushimit dhe daljes së Italisë nga Boshti, forcat gjermane hynë në Shqipëri. Gjermanët favorizuan Ballin Kombëtar mbi legalistët e Mbretit Zogu I. “Situata nuk ishte shumë konfuze. Shqipëria e Jugut ishte pjesërisht në duart e partizanëve komunistë, kundër të cilëve italianët ishin paraqitur me pak sukses. Për këtë arsye, qysh para rënies së Italisë ishte dislokuar një divizion gjerman në Elbasan. Këta partizanë do të ishin nesër kundërshtarët tanë të sigurt gueriles. Luftëtarët nacionalistë, që kishin dalë malit kundër pushtimit italian (Balli Kombëtar), sipas ligjit lidhur me armikun Nr. 1, nuk do të ishin të rrezikshëm për ne. Për ata, si në Greqi dhe Jugosllavi, ishin bërë komunistët armiku Nr. 1. Shqiptarët e dinin fare mirë që ne kishim marshuar në Shqipëri vetëm për arsye të ngutshme ushtarake, për t’u mbrojtur nga sulmi nga krahët, me të cilin na kërcënonin Aleatët nëpërmjet ngushticës së Otrantos. Mua nuk më kujtohet asnjë akt armiqësor i popullsisë kundër Vermahtit gjerman. Veç kësaj, Gjermania gëzonte një emër të mirë në Shqipëri.”⁷⁴ Por edhe ndaj këtij pushtuesi, 1943–1944, Fronti Nacionalçlirimtar dhe Ushtria Nacionalçlirimtare shqiptare organizuan rezistencën dhe luftën. “Që ishte një pushtim i mirëfilltë, nuk vihet aspak në dyshim, sepse, nëse i referohemi dokumentacionit ushtarak dhe konkretisht urdhrin numër 1 të divizionit 297, si një nga dy divizionet që morën pjesë në pushtimin e Shqipërisë, është shumë e qartë që ishte pushtim. Aty shkruhet tekstualisht, mes të tjerave: urdhër për pushtimin e trojeve shqiptare. Pra jo vetëm të Shqipërisë. Edhe mënyra e trajtimit të këtij urdhri. Pra nuk ka dyshim që ka qenë pushtim. Këtu bëhet fjalë për pushtimin e të njëjta territoreve që ishin pushtuar dhe nga Italia.”⁷⁵

⁷³Gazeta shqiptare, Balkan web, Zef Bushati, <https://www.balkanweb.com/roli-i-diplomacise-nderkombetare-ne-kuvendin-e-mukjes/>, 01 Gusht, 2016,

⁷⁴Hermann Neubacher, *Guvernatori i Hitlerit për Ballkanin*, Tiranë, Botimet: BOTART, 2017, f. 163.

⁷⁵ Pjesë nga intervista e Marenglen Kasmit, studiues, historian, në emisionin “Debati në Channel One”.

Me largimin e trupave gjermane nga Shqipëria, në nëntorin e vitit 1944, pushtetin e mori Partia Komuniste Shqiptare. Deri në përfundimin e luftës, komunistët kishin mundur të asgjësonin të gjitha qëndresat antikomuniste të organizuara më parë, të cilat mund të kërcënonin pushtetin e së nesërme. “Nëpërmjet kontrollit të Qeverisë Demokratike të Përkohshme, të Frontit Nacionalçlirimtar, të Ushtrisë, si dhe të Këshillave Nacionalçlirimtare, komunistët i kishin hedhur themelet, mbi të cilat do të ngrihej pushteti i tyre i ardhshëm.⁷⁶ Pavarësisht pushtetit që komunistët aktualisht gëzonin, një sfidë e madhe për ta ishte mbajtja e tij dhe shtrirja e kontrollit të plotë në të gjithë vendin. Për t’i konsoliduar edhe më shumë të gjitha pozitat e tyre, duhej të ndërtohej një rend i ri, një socializëm real, dhe rrjedhimisht një vendosje e sistemit njëpartiak në qeverisjen e vendit.⁷⁷

“Fronti Nacionalçlirimtar, i cili ka qenë një organizim i rezistencës shqiptare gjatë Luftës së Dytë Botërore dhe drejtohej nga komunistët, gëzonte një mbështetje të gjerë në popull, por kjo nuk nënkuptonte që komunistët ishin imunë ndaj ndonjë force të brendshme politike. Sipas statistikave, popullarizimi që gëzonin komunistët ishte 2800 komunistë nga 70 mijë partizanë.⁷⁸ Kjo shprehte qartë se themelet e tyre nuk ishin aq të forta sa ata të rrinin të qetë. Komunistët kishin interesin që të krijonin një terren, ku më vonë të mund të zbatonin reformat e tyre.

Rruga më e drejtë, sipas komunistëve, ishte ajo e ndjekur nga Fronti Nacionalçlirimtar, pasi ai vetë nënkuptonte komunistët. Entuziazmi masiv revolucionar i masave popullore gjatë kohës së luftës, kur propaganda komuniste premtonte drejtësi e barazi për të gjithë e pushteti do të ishte në dorë të vetë popullit, në muajt e parë pas çlirimit filloi të dobësohej pak nga trysnia e ashpër e jetës së përditshme. Filloi të vihej re se veprimet konkrete të pushtetit qendror, shpesh nuk përputheshin me parullat e shpallura zyrtarisht. Rryma nuk të çonte drejt lirive demokratike, por drejt ndërtimit të sistemit totalitar (stalinist) sovjetik. Vija e përgjithshme e PKSh-së ose, më saktë lufta për pushtet në kreun e partisë, u bë shkak i shumë mosmarrëveshjeve në vazhdimësi. Propaganda kundër pluralizmit politik nuk ishte e vetmja mënyrë që ata ndoqën për të shtruar rrugën e tyre. Një tjetër hap që ata hodhën ishte edhe goditja e kundërshtarëve potencialë politikë, të cilët ishin shtresa e mesme dhe ajo e lartë e shoqërisë shqiptare. Masat që komunistët ndërmoren kundër tyre ishin konfiskimi i pasurisë dhe shpronësimet masive, tregtarët u akuzuan si bashkëpunëtorë të fashizmit dhe armiq të popullit, si dhe u zhveshën nga çdo lloj mbështetje në shoqërinë shqiptare.

Që pas Plenumit të Beratit, në 23–27 nëntor 1944, autoriteti i Enver Hoxhës u lëkund dhe u vu re një ashpërsim i rivalitetit për kreun e partisë. Hoxha mbeti pa pasuesit e vet më të afërt, Ramadan Çitakun dhe Liri Gegën, të cilët dolën nga përbërja e udhëheqjes

⁷⁶ V. Duka, *Histori e Shqipërisë...*, f.227.

⁷⁷ *Po aty*, f.227.

⁷⁸ *Po aty*, f.228.

me famën e dyshimtë të aventurierëve politikë. Ishte vrarë miku dhe këshilltari kryesor i Hoxhës, Miladin Popoviçi, dhe në vend të tij kishte ardhur një përfaqësues tjetër i Komitetit Qendror të PKJ-së, Velimir Stoinici, me një prirje krejt ndryshe. Ky i fundit kishte sjellë me vete një sërë këshilltarësh civilë dhe ushtarakë, por Enver Hoxha shpëtoi, sepse së pari “dorëzoi” pa kundërshtim njerëzit e vet dhe pranoi të gjitha gabimet dhe, së dyti, sepse përndjekësit e tij nuk gjetën kushtet e duhura për ta zëvendësuar. Nuk kishte asnjë alternativë tjetër dhe ai e kishte shumë të qartë këtë.⁷⁹

Në fjalën e tij në këtë plenum, Velimir Stojniçi shprehet: “*Nga diskutimet del se shokët ende s’i kanë kuptuar detyrat qind për qind. Pse? S’i kanë kuptuar se nuk kanë bërë autokritikën e tyre. [...] Unë mendoj se diskutimet s’janë në rregull dhe s’kanë dhënë rezultatet e duhura. [...] Unë jam dakord me ju që të shikonit punën e Miladinit e të Dushanit, [...] por nuk jam dakord me ju që keni diskutuar për ta pa e lidhur punën e tyre me punën tuaj. [...] Unë jam dakord me Sejfullain, që thotë se Partia ka marrë rrugën e degjenerimit në një bandë kriminelësh. [...] Pa Jugosllavinë, ju nuk mund ta mbani pushtetin [...] Perspektiva e Jugosllavisë është perspektiva e krejt Ballkanit [...] Emri i Titos ka dalë nga kuadri i Jugosllavisë. Ai është simbol i çlirimit të popujve nga reaksioni e fashizmi. Këtë më së miri duhet ta kuptojë populli juaj. [...] Të shkruhet në shtypin tuaj më shumë për Jugosllavinë”.*⁸⁰

Që në kohën e Luftës, por veçanërisht menjëherë pas çlirimit të vendit dhe marrjes së pushtetit nga komunistët, udhëheqja shqiptare, e ndodhur gati tërësisht nën ndikimin e jugosllaveve, nisi ndërtimin e shumë strukturave shtetërore, sipas modeleve jugosllave. Një prej tyre ishte famëkeqi Sigurimi i Shtetit, i cili nuk i përmbahej emërtimit që kishte e që vërtet nevojitej të ishte i tillë, si organ zyrtar që duhej t’i shërbente shtetit dhe popullit shqiptar. E përmendim veçanërisht këtë hallkë shtetërore, sepse, nëpërmjet saj duket se ka zënë fill veprimtaria e Koçi Xoxes, si politikan dhe ushtarak, një prej figurave dhe elementëve kryesorë të PKSh-së, jo vetëm që nga krijimi i saj më 8 Nëntor 1941, por edhe gjatë periudhës së Luftës Nacionalçlirimtare e deri në vitin 1948, kur karriera dhe jeta e tij u ndërpre përfundimisht. Ky lloj i politikës shqiptare, me dëbime dhe dënime të çdo lloj kundërshtari që binte ndesh me qëllimet dhe interesat e kreut, do të linte gjurmë në zhvillimet e ardhshme në Shqipëri, posaçërisht duke e vënë politikën dhe ekonominë shqiptare asokohe në shërbim të udhëheqjes jugosllave. “Në Shqipëri, roli i shëmbëlltyrës së Titos iu dha Koci Xoxes, atij që ishte numri dy në pushtet, sekretar organizativ i Komitetit Qendror, zëvendëskryeministër dhe ministër i Punëve të Brendshme, duke pasur kësajoh në varësi të drejtpërdrejtë policinë politike, Sigurimin.”⁸¹

⁷⁹ Nina Smirnova, *Historia e Shqipërisë përgjatë shek XX*, Tiranë, Botimet “IDEART”, 2004, f.316.

⁸⁰Bashkim Shehu, *Liri Belishova dhe koha e saj*, Tiranë, Botimet:UET Press, 2020, f. 44-45

⁸¹*Po aty*, f.76

Si datë zyrtare e themelimit të Sigurimit të Shtetit është 14 dhjetori i vitit 1944, kur ngrihet Drejtoria e Mbrojtjes së Popullit, që kishte të njëjtën strukturë dhe veprimtari, madje edhe të njëjtin emër si OZNA jugosllave. Emërtesat e organeve që ngritën komunistët ishin të kopjuara e të diktuar nga jugosllavët, si dhe orientimet e porositë që merrnin vinin po nga Beogradi. Orientimet për krijimin e Drejtorisë së Mbrojtjes së Popullit (DMP), që njihet edhe si emërtesa e parë e Sigurimit të Shtetit, erdhën nga jugosllavët, nëpërmjet Velimir Stojnićit. Kjo drejtori përbëhej në qendër nga 4–5 seksione të ndara sipas profileve dhe kishte në varësi tre seksione të mbrojtjes së popullit: Seksioni i Tiranës (përfshinte edhe Durrësin dhe Elbasanin); Seksioni i Beratit (me Korçën, Gjirokastrën dhe Vlorën); Seksion i Shkodrës (me Kukësin dhe Peshkopinë). Drejtoria e Mbrojtjes së Popullit udhëhiqej nga drejtori Koçi Xoxe. Kjo Drejtori, e njohur edhe si emërtesa e parë e dhunshme e Sigurimit të Shtetit, u forcua dhe u egërsua shumë më tepër në periudhën famëkeqe të drejtuar nga Koçi Xoxes. Vetëm pas arrestimit të tij pasoi një fushatë e hapur denoncimesh, ku u paraqitën qindra dokumente që janë nëpër arkiva, të cilat dëshmojnë format çnjerëzore, si dhe torturat e ushtruara nga punonjësit e Sigurimit, por që më pas, viktimë e këtij sistemi ra edhe vetë drejtuesi i saj i parë, Koçi Xoxe.

Koçi Xoxe u bë figura e dytë pas Enver Hoxhës, të cilit iu besuan poste të rëndësishme dhe u dëshmuar si bashkëpunëtor i ngushtë i tij. Si njeriu më i besuar i Enver Hoxhës, gjatë periudhës së Luftës Nacionalçlirimtare Koçi Xoxe ngarkohej prej tij me detyra delikate konspirative, gjithnjë nën direktivat e Titos dhe interesat e planeve të aleancës Beograd – Tiranë. Me urdhër të Shtabit të Përgjithshëm, Koçi Xoxe dha një kontribut shumë të madh në ngritjen dhe organizimin e Lëvizjes Antifashiste me brigadat partizane. Si njeriu numër dy pas Enver Hoxhës, funksionet dhe titujt ushtarakë më të lartë iu dhanë në Kongresin e Përmetit. Ndërsa nga dhjetori 1944 e deri në mars 1946, ai mbajti postin e drejtorit të Drejtorisë së Mbrojtjes së Popullit. Më pas këtë pozicion e mori zëvendësi dhe i besuari i tij, Nesti Kerenxhi. Detyra e organeve të Sigurimit të Shtetit ishte kryesisht goditja e kundërshtarëve politikë, por edhe mbrojtja e pushtetit. Koçi Xoxe, në një deklaratë të tij u shpreh se “Udhëzimet për organizimin e Drejtorisë së Mbrojtjes së Popullit, formën e organizimit si edhe metodën e punës për organet e sigurimit, i kam marrë nga Velimir Stojnić”.⁸²

Veprimtaria sistematike e udhëheqjes jugosllave për të nënshtruar udhëheqjen shqiptare, për realizimin e planit të saj drejt aneksimit të Shqipërisë, bën një hap tjetër në Plenumin II të KQ të PKSh, mbajtur prej 23 – 27 nëntor të vitit 1944, i cili hapi portat e bashkëpunimit nën diktat midis PKSh-së dhe PKJ-së. Rrjedhimisht, PKSh-ja gjendej në pozitë krejtësisht të varur nën diktatin jugosllav. Vërtet ishte një kohë tjetër nga ajo e viteve të para të Luftës së Dytë Botërore që kishte përfshirë edhe Shqipërinë, kohë kur PKSh-ja, veçanërisht pas prishjes së Konferencës së Mukjes po binte nga gabimi në gabim, nga

⁸²Kastriot Dervishi, *E vërteta e fshehur e një procesi*, Tiranë, Botimet: 55, 2009, f.16.

dështimi në përçarje. Lidhur me këtë, studiuesi kosovar Fehmi Agani pohon se “Që të arrihej ky nënshtrim, PKSh-ja duhej të përçahej. Fara e përçarjes ishte mbjellë një vit më parë me grindjet që kishte ngritur në udhëheqjen partiake S. V. Tempo dhe me favorizimin që i bënte Koçi Xoxes. Por me Stojniçin filloi përçarja e drejtpërdrejtë e PKSh, ndërhyrja më brutale në zhvillimin politik të Shqipërisë me pasoja të rënda e tragjike për Shqipërinë, si dhe për marrëdhëniet shqiptaro-jugosllave”.⁸³ Dokumentet e kohës dëshmojnë se ndërhyrja e PKJ në veprimtarinë e PKSh dhe, përgjithësisht në drejtim të Lëvizjes Antifashiste Shqiptare, si dhe nënshtrimi deri në përulje i PKSh ndaj PKJ, ishin rast i veçantë në raportet e atëhershme midis lëvizjeve antifashiste dhe partive komuniste në Europën Juglindore. Prandaj, në shqyrtimin kritik të marrëdhënieve politike shqiptaro-jugosllave për periudhën në fjalë, në radhë të parë duhet të kemi parasysh ngarkesat dhe divergjencat e mëdha, të cilat i karakterizuan këto marrëdhënie në prag të përfundimit të Luftës së Dytë Botërore. Kjo ndërhyrje e një partie ndaj tjetrës, si dhe ky nënshtrim i një partie ndaj një partie tjetër, nuk ndodhi vetëm pse PKJ vazhdimisht kishte synim ndërhyrjen deri në nënshtrim të PKSh. Përkundrazi, aspiratat e ndërhyrjes së pashembullt të PKJ ndaj PKSh duhen kërkuar qysh nga kohërat dhe vitet e traditës së ndërhyrjeve serbe e jugosllave në punët e brendshme të Shqipërisë. Vërtet, në fund të vitit 1944 dhe në fillim të vitit 1945, komunistët shqiptarë ishin fitimtarë të luftës për çlirim nga nazi-fashizmi dhe nuk kishin pse të ndiheshin inferiorë as ndaj jugosllavëve, mirëpo historia tregon se ata nuk vepruan sipas logjikës historike.

Nga fundi i luftës në Shqipëri dhe fillimi i vitit 1945, raportet politike shqiptaro-jugosllave i karakterizonte ofensiva permanente diplomatike e udhëheqjes jugosllave për të thelluar kursin e bashkëpunimit mbi programin dhe platformën pushtuese jugosllave. Pala shqiptare, konkretisht PKSh dhe udhëheqja e saj, e aprovonin atë rrugë të bashkëpunimit pa hezitim dhe pa ndonjë qëndrim apo vërejtje kritike. Nuk ishte e rastësishme se pse marrëdhëniet shqiptaro-jugosllave, në fillim të vitit 1945 po rrëshqisnin në drejtim të varësisë së plotë të palës shqiptare nga ajo jugosllave, dhe se kjo të linte të nënkuptoje se mund të supozohej që Shqipëria ishte nën sferën e interesit jugosllav. Kjo vërteton konstatimin se PKJ, me ndërhyrjen në veprimtarinë e PKSh-së po vazhdonte traditën e ndërhyrjeve jugosllave në çështjet e brendshme shqiptare dhe realizimin e projekteve të hershme të ish-shtetit serbo-kroato-slloven e më pas të ish-Jugosllavisë për aneksimin e territoreve të Shqipërisë Veriore e Verilindore.

Por, “mandati” jugosllav për t’u kujdesur ndaj zhvillimeve në Shqipërinë e re socialiste ishte siguruar edhe nga zhvillimet diplomatike ndërkombëtare të kohës në gjirin e ish-kampit socialist, që sapo ishte krijuar në rajonin e Europës Lindore. Konkretisht, “Bashkimi Sovjetik gjatë luftës nuk është marrë me Shqipërinë, duke ia lënë kujdesin për të Jugosllavisë, përkatësisht PKJ, përmes Kominternit, qysh nga vitit 1939. Vetëm para

⁸³ Fehmi Agani, *Demokracia, kombi, vetvendosja*, Pejë, Botimet: Dukagjini 1994, f. 66.

përfundimit të luftës, BRSS filloi përmes PKJ të interesohej për Shqipërinë dhe për përbërjen kuadrore të PK të Shqipërisë... Në situatën e pasluftës raportet ndryshuan, sepse përmes Jugosllavisë dhe Shqipërisë, BRSS del në të ashtuquajturat detëra të nxehta...⁸⁴ Pavarësisht nga ky rol prej tutori i Kominternit, që i ishte caktuar PKJ për të bashkëpunuar ngushtë me PKSh, në lidhje me këtë problematikë duhen veçuar edhe disa faktorë kyç që determinuan marrëdhëniet politike shqiptaro-jugosllave për periudhën në fjalë. Ndër këta faktorë vlerësojmë mungesën e nivelit të mjaftueshëm të pavarësimin të PKSh si parti komuniste në raport me lëvizjet komuniste të kohës, pastaj faktin se marrëdhëniet ndërmjet PKSh dhe PKJ gjatë luftës ishin thelluar në shumë dimensione, por edhe nivelin e caktuar të indoktrinimit me bolshevizmin proletar të udhëheqjes së PKSh, e cila i besonte verbërisht atij bashkëpunimi.

Nga ana tjetër, janë edhe dy segmente që kanë ndikuar në përcaktimin jo kritik të PKSh për bashkëpunim me PKJ edhe pas përfundimit të luftës. Në radhë të parë, është tradita e diskutimeve dhe e spekulimeve për krijimin e Federatës Ballkanike, ide që datonte qysh para Luftës së Dytë Botërore, si dhe planet për bashkimin e Kosovës me Shqipërinë. Jugosllavia kishte si synim kryesor përfshirjen e Shqipërisë në Konfederatën Ballkanike. Duke shfrytëzuar vështirësitë ekonomike që po kalonte Shqipëria në ato kohë të vështira të saj, qeveria jugosllave e rriti trysninë mbi udhëheqjen shqiptare, për të shmangur pengesat që i krijoheshin në realizimin e këtij synimi dhe t'i hapte rrugën projektit për bashkimin e Shqipërisë me Jugosllavinë, si Republikë të saj të Shtatë.

Shqipëria pas luftës ndryshonte shumë nga vendet e tjera të Europës Lindore, të cilat pas luftës njohën një qeveri koalicioni. “Vendi ynë nuk kishte pasur një qeveri të konsoliduar shqiptare në mërgim, ndërsa kundërshtarët politikë, si Balli Kombëtar dhe Legaliteti, u venitën pas luftës.”⁸⁵ Duke mos pasur kundërshtarë të tjerë politikë, qeveria e dalë nga lufta kontrollohej tërësisht nga komunistët. Ardhja në pushtet pa asnjë ndihmë nga jashtë dhe mosndërrhyrja e ndonjë fuqie të huaj ishte edhe slogani pse komunistët nuk kërkonin ta ndanin pushtetin e tyre me askënd tjetër. Këtyre mendimeve, në vitet e para të pasluftës iu bashkëngjitej edhe mbështetja e pakursyer e komunistëve jugosllavë, që iu dhanë atyre krahë për të realizuar qëllimet e tyre politike.

“Në vitin 1945 ndodhi ndryshimi i emrit të Frontit Nacionalçlirimtar në Fronti Demokratik, çka u bë vetëm me qëllim që Qeveria e Përkohshme Demokratike të fitonte legjitimitet në sy të perëndimorëve⁸⁶, si dhe për t’ju treguar atyre se komunistët kishin ndër mend të themelonin një regjim demokratik në Shqipëri. Për shkak se kjo qeveri nuk kishte dalë nga zgjedhjet e lira, komunistët u gjendën përballë presioneve të fuqive perëndimore, të cilat nuk e njihnin atë. Në këtë mënyrë, komunistët u detyruan t’i shpallin zgjedhjet në

⁸⁴ Branko Petranović, *Balkanska Federacija 1943-1948*, Beograd, 1991, f.138.

⁸⁵ V. Duka, *Histori e Shqipërisë...*, f.228.

⁸⁶ *Po aty*, f.229.

dhjetor të 1945. Këto zgjedhje ndodhën një vit pas çlirimit, periudhë kjo e mjaftueshme që Enver Hoxha të asgjësonte çdo lloj opozite të mundshme dhe ta kishte plotësisht të sigurt fitoren e partisë të cilën ai drejtonte.

Petro Marko, i cili atëherë ishte kryeredaktor i të vetmes së përditshme në Shqipëri (“Bashkimi”), në vitin 1945 u bë dëshmitar i bisedës së mëposhtme mes dy gazetarëve amerikanë dhe Enver Hoxhës në zyrën e këtij të fundit. Ja një pjesë e dialogut të tyre:

Li Uait: Zoti gjeneral, a bëni pjesë në Partinë Komuniste?

Enveri: Është nder i madh të jesh anëtar i Partisë Komuniste.

Li Uait: Po ju, si President i qeverisë, jeni komunist?

Enveri: Partia është ilegale dhe nuk tregohet, nëse je apo jo komunist.

Li Uait: Ky është një paradoks. Një parti që udhëheq luftën dhe del fitimtare, nga kush ka frikë të jetë legale? Ajo triumfoi.⁸⁷

Pas zgjedhjeve të 1945, Asambleja Kushtetuese, e mbledhur në janar të 1946, e shpalli Shqipërinë Republikë Popullore dhe më 12 janar 1946 u zgjodh Presidiumi i Asamblesë Kushtetuese, ndërsa dr. Omer Nishani si president i parë i saj. Më 14 mars 1946, Asambleja Kushtetuese votoi Kushtetutën e Republikës Popullore të Shqipërisë. Kjo Kushtetutë ishte hartuar mbi bazën e parimeve të “demokracisë popullore”, duke u bërë guri i themelit mbi të cilin do të ngrihej struktura e ardhshme e shtetit komunist. Më 18 mars të 1946, Asambleja ngarkoi Enver Hoxhën të formonte qeverinë, e cila mori votëbesimin pas pak ditësh. “Por duket se me ato çka ndodhën në atë kohë e më pas u legjitimuan deformime të rëndësishme në ndërtimin e një shteti realisht demokratik, mbi bazën e parimit themelor të ndarjes së pushteteve. Duhet të ngriheshin pushteti legjislativ, pushteti ekzekutiv dhe ai gjyqësor, duke ua privuar mundësinë e përzjerjes dhe ndërhyrjes në kompetencat e njëri-tjetrit. Ndodhi e kundërta. Bashkëjetesa e paligjshme midis këtyre institucioneve, ndërvertësia e tyre e plotë theksohet edhe nga fakti se, në çastin e krijimit të tyre, Koçi Xoxe, sekretari organizativ i KQ, në të njëjtën kohë ishte nën-kryeministër, ministër i Brendshëm, kryetar i Gjykatës Speciale dhe drejtor i përgjithshëm i Drejtorisë së Mbrojtjes së Popullit..⁸⁸

Për të rritur rolin e PKSh-së, të gjitha organet e shtetit u mbushën me komunistë të ardhur nga lufta. Në këtë formë vazhdoi dhe rritja përherë e më shumë e numrit të komunistëve. Besnikëria ndaj partisë ishte edhe elementi kryesor i përzgjedhjes së tyre. Në këtë formë, njerëzit e paaftë përzgjidhnin njerëz të pazotë, në mënyrë që të kishin një mbështetje të verbër dhe pa rezerva ndaj Partisë Komuniste. “Pakënaqësitë e shumta filluan të shtoheshin në Frontin Nacionalçlirimtar, kjo për shkak se filluan të kuptonin synimet e vërteta të komunistëve. Por lufta politike nuk u zhvillua vetëm mes komunistëve dhe

⁸⁷ Petro Marko, *Intervistë me vetëveten: retë dhe gurët*, Tiranë, Botimet: OMSCA, 2000, f.459-460.

⁸⁸ Amik Kasoruh, *Një ankh gjysmëshekullor, Shqipëria e Enver Hoxhës*, Tiranë: Botimet Cabej, 1996, f.45.

kundërshtarëve të tyre, por edhe në gjirin e vetë PKSh-së. Me sa duket, lufta brenda llojit ishte pjesë e vetë natyrës së partive komuniste të organizuara sipas modelit bolshevik. Partia Komuniste Jugosllave, siç u tha, ndihmoi në krijimin e Partisë Komuniste Shqiptare, në krijimin e organizatave dhe marrëveshjeve, por ajo që mungonte ishte krijimi i Shtabit Udhëheqës të Partisë. Miladin Popovic dhe Dushan Mugosha nuk kanë punuar siç duhet në këtë drejtim.⁸⁹ Kjo gjë vihet re më poshtë edhe te deviacionet e krijuara më vonë, si dhe tek idetë kundërshtuese brenda partisë.

Në këtë periudhë, pra nga fundi i vitit 1945, në Byronë Politike të KQ të PKSh-së ekzistonin dy qëndrime e qasje divergjente rreth zhvillimit të Shqipërisë në periudhën e socializmit. “Qëndrimi i parë, bartës i të cilit ishte Sejfulla Malëshova, përkrahej nga Enver Hoxha dhe Ymer Dishnica. Sipas mendimit të Malëshovës, reaksionit që kishte pësuar disfatë duhej t’i jepej përsëri mundësia që në kushtet e ndryshuara e me armë të reja të sprovonte forcat e veta kundër revolucionit popullor... Në fushën e politikës së jashtme, sipas mendimit të Malëshovës, Shqipëria nuk duhej të bënte dallim midis marrëdhënieve me Jugosllavinë, me BRSS dhe me vendet e tjera socialiste dhe marrëdhënieve me vendet kapitaliste. Bartësit e këtij qëndrimi ishin kundër asaj që të realizohej ndërtimi socialist i vendit, në bazë të përvojave jugosllave dhe sovjetike.”⁹⁰

Rryma e dytë, sipas Panajot Plakut, cilësohej si “...rryma, e cila përpiquej të konsolidonte sa më parë pushtetin popullor, të ndërtonte dhe të perfeksiononte ekonominë me masa të jashtëzakonshme, duke marrë si shembull pozitiv, para së gjithash praktikën në Jugosllavinë fqinje.... Bartës kryesor i këtij orientimi politik ishte Koçi Xoxe, kurse qëndrimet e tij i përkrahte shumica në Byronë Politike edhe tërë KQ i PK të Shqipërisë.”⁹¹ Ekzistenca e dy rrymave politike brendapërbrenda Byrosë Politike të KQ të PKSh, qysh në fillim të vitit 1945 e kishte acaruar luftën e brendshme të fraksioneve në udhëheqjen më të lartë të KQ të PKSh. Kjo situatë i krijonte mundësi edhe më të mëdha PKJ që të ndërhynte pa pengesa në punët e brendshme të shtetit shqiptar. Në këtë periudhë, qeveria provizore e udhëhequr nga Enver Hoxha përballej para sfidave të rënda, sepse, në të njëjtën kohë duhej të kryente dy detyra: “...Duhej të konsolidonte pushtetin dhe të njëjhej ndërkombëtarisht”.⁹²

Pas përfundimit të luftës, Shqipëria ra në varësi të Jugosllavisë në të gjitha fushat e jetës politike, ekonomike dhe ushtarake. Tashmë, “pozita e Hoxhës, si sekretar i përgjithshëm, në një periudhë të caktuar ishte shumë e kontestuar. Njësoj si Stalini, edhe jugosllavët duhet të kenë parë në të ‘një borgjez të vogël me prirje nacionaliste’.”⁹³ Për këtë

⁸⁹ *Marrëdhëniet shqiptaro-jugosllave*, përgatitur nga Ndreçi Plasari, Luan Malltezi, Drejtorja e Përgjithshme e Arkivave, Tiranë, 1996, f.318.

⁹⁰ Panajot Plaku, *Dhuna ndaj revolucionit në Shqipëri*, Prishtinë, Botimet: Rilindja, 1985, f.64.

⁹¹ *Po aty*, f.65.

⁹² Agim Zogaj, *Marrëdhëniet shqiptaro-jugosllave dhe çështja e Kosovës 1945-1948*, Prishtinë, Botimet: Kosova PEN Center, 2015, f.108

⁹³ *Po aty*.

shkak, Enver Hoxhës iu bashkëngjit Koçi Xoxe, si sekretar i KQ për çështje organizative. “Xoxe vlente si një njeri i besueshëm i udhëheqjes partiake jugosllave, si dhe duhej të kontrollonte sekretarin e përgjithshëm. Ai kishte për detyrë të shkruante ligjet dhe dekretet e udhëheqjes shtetërore shqiptare në emër të KQ. Xoxe mendohej t’iu bënte ballë tendencave pro-perëndimore, për të cilat akuzohej Enver Hoxha, Sejfulla Malëshova, Ymer Dishnica dhe komunistët e tjerë shqiptarë.”⁹⁴

Në gjirin e komunistëve tashmë kishte dy fraksione kryesore: ai i intelektualëve që udhëhiqej nga Nako Spiru, dhe ai me origjinë punëtore që udhëhiqej nga Koçi Xoxe. Enver Hoxha, i cili përfshihej në grupin e intelektualëve, por kishte një mjeshtëri të lartë për të bërë një politikë oportuniste, qëndroi mbi të dyja grupet, si dhe shfrytëzoi përplasjet e tyre për t’i forcuar pozitat e veta. Kjo përplasje midis këtyre dy grupeve vinte si rezultat i luftës që të dy bënin për pushtet dhe që lidhej edhe me ndikimin jugosllav në Shqipëri. Grupi intelektual ishte kundër faktit që fqinji i madh verior ishte zëdhënësi dhe përfaqësuesi i Shqipërisë me botën. Ata kërkonin që Shqipëria të dilte nga izolimi ndërkombëtar, në të cilin ndodhej, dhe të kryente një politikë të pavarur, jo vetëm në politikën e jashtme, por edhe në atë të brendshme, sidomos për sa i përket fushës ekonomike. Ky qëndrim çoi në përplasje midis dy figurave, Nako Spirut dhe Koçi Xoxes, asokohe ministër i Brendshëm dhe kreu i Sigurimit.

Sjellja e pa tolerueshme e Titos arriti kulmin me politikën ndaj Shqipërisë. Qëndrimi i grupit, ku mendohej se drejtonte Nako Spiru, u vu re edhe nga udhëheqësi i Beogradit, Titoja, i cili e shfaqti hapur pakënaqësinë ndaj tij. “Mbas vizitës së parë në Jugosllavi, në dhjetor 1944 ose janar 1945, - kujton Liri Belishova, - Nako Spiru, ndonëse e vlerëson rezistencën e jugosllavëve ndaj pushtuesve, thotë se atyre iu është rritur mendja dhe se, prandaj do shkojnë drejt përplasjes me Bashkimin Sovjetik. Me të vërtetë, kështu do të ndodhte. Dhe, sipas analistit Paul Lendvai (Eagles in cobËebs: nationalism and communism in the Balkans), i tillë ka qenë dhe shkaku i prishjes midis Beogradit dhe Moskës më 1948-n.”⁹⁵ Ndërsa sipas Titos, Nako bënte përpjekje për shkëputjen e Shqipërisë nga Jugosllavia. Në kujtimet e ambasadorit rus Çuvahin, përmenden akuzat e ngritura kundër Nako Spirut. Për këtë çështje, Enver Hoxha u shpreh se “Nako Spiru, duke ndjekur vijën e vet armiqësore ndaj partisë, është përpjekur me të gjitha mënyrat për të demonstruar pozicionin e vet pro-sovjetik, megjithëse, në fakt, ai fliste një mori gjërash të pakëndshme në adresë të Bashkimit Sovjetik... Është mjaft domethënës fakti se, kur Hoxha thoshte gjithë këto, Koçi Xoxe përpiqej të tregonte se ai për gjithçka ishte dakord me Enver Hoxhën”⁹⁶. “Presioni ndaj udhëheqësve shqiptarë ishte aq i madh, saqë njëri prej tyre, Nako Spiru, në shenjë proteste kundër hegjemonizmit jugosllav, vrau veten (të paktën ky ishte

⁹⁴ *Po aty*, f.108-109.

⁹⁵ Bashkim Shehu, “*Liri Belishova dhe koha e saj*”, Tiranë, Botimet: UET, 2020, f.52

⁹⁶ D.S.Cuvahin, “*Shërbimi im diplomatik në Shqipëri*”, Tiranë, Botimet: Almera, 2009, f. 87

shpjegimi zyrtar)⁹⁷. Porse për Enver Hoxhën, Tito kishte një mendim disi më të rrumbullakosur. Thoshte se nuk është me dy fytyra, por mund të bjerë shumë lehtë nën ndikime të ndryshme. Për Titon, udhëheqës më i fortë dhe më konsekuent ishte Koçi Xoxe.⁹⁸ Xoxe ishte zgjedhja e jugosllavëve për të zëvendësuar Hoxhën, i cili ishte për ta një borgjez nacionalist. “Enver Hoxha po e ndjente rrezikun nga qëllimi që kishin jugosllavët, ndaj për këtë arsye tentoi të siguronte mbështetjen e Stalinit, por ai nuk e pranoi kërkesën e tij për të vizituar Bashkimin Sovjetik”.⁹⁹ Në të tilla kushte, i izoluar në arenën ndërkombëtare dhe i dobët brenda vendit, Enver Hoxha e pa më të arsyeshme që t’iu “dorëzohej” jugosllavëve, me qëllim që të mbijetonte e të mund t’i arrinte synimet e tij në një të nesërme.

Në raportin politik, mbajtur në Plenumin e 5-të të KQ të PKSh, më 21 shkurt 1946, Enver Hoxha konstatonte: “Natyrisht, të influencuar nga kjo tendencë oportuniste, nuk e kemi orientuar popullin tonë sa duhet drejt vëllazërimit të shëndoshë me Jugosllavinë, që është një kusht i domosdoshëm për ekzistencën e vendit tonë... Në popull duhet të ngjallim dashurinë dhe vëllazërimin për Jugosllavinë, që u lind në këtë luftë. Jugosllavia ka qenë përkrahësja më e madhe dhe e drejtpërdrejtë në Luftën Nacionalçlirimtare, ajo do të vazhdojë të jetë një nga ndihmëset më të mëdha të popullit tonë dhe të pushtetit. Duhet të luftojmë me mish e me shpirt tendencat shoviniste të atyre shqiptarëve që kërkojnë të ngjallin mërinë e vjetër kundër popujve të Jugosllavisë. Të dy vendet tona duhet të jenë pararojë në Ballkan, për të forcuar bllokun e madh të demokracisë përparimtare dhe të bëhen mbështetje e gjallë për Bashkimin Sovjetik këtë anë”.¹⁰⁰ Në këtë raport, fragmentet e të cilit nuk janë botuar në Vëllimin e 3-të të veprave të Enver Hoxhës (1969), pasi përcakton rolin e Shqipërisë në ruajtjen dhe sigurimin e interesave ruse në Ballkan, ai kritikon mos-përkushtimin e PKSh që të realizojë marrëveshjet bilaterale me Jugosllavinë. “Por këto marrëdhënie ekonomike, sipas mendimit tonë, nuk janë konkretizuar siç duhet, përkundrazi, ato janë të shthurura. Ne nuk ua kemi vënë kujdesin e duhur. Me Jugosllavinë ne duhet të kemi marrëdhënie ekonomike më të vendosura, më konkrete dhe më të ngushta, dhe, pa i konkretizuar këto marrëdhënie do të jetë gabim dhe marrëzi të kërkojmë tregje jashtë, si në Itali, Çekosllovakia e gjetkë”.¹⁰¹

⁹⁷J. Pirjevec, *Tito dhe shokët...*, f. 252.

⁹⁸*Shqipëria në dokumentet e arkivave ruse*, përgatitën Islam Lauka, Eshref Ymeri, Tiranë: Botimet Toena, 2006, f.154.

⁹⁹V. Duka, *Histori e Shqipërisë...*, f.234.

¹⁰⁰AQSH, F.14/AP, dos.1, v.1946.

¹⁰¹AQSH, F.14/AP, dos.1, v.1946.

1.2 Organizimi politik dhe ekonomik i vendit pas luftës

Marrëdhëniet shqiptaro-jugosllave në vitet 1945-1948 kanë pasur një intensitet të lartë ndërveprimi. Këto vite karakterizohen nga problematika dhe qëndrime të ndryshme. Interesat e ndryshme të të dyja palëve, bashkëpunimi, mosbashkëpunimi, intrigat dhe prapaskenat politike shfaqen qartësisht në shkëmbimet telegrafike dhe letrat e shkëmbyera midis figurave politike të të dy vendeve, por edhe të palëve të tjera. Në literaturën jugosllave, kur flitet për raportet shqiptaro-jugosllave të kësaj periudhe, i nënshtrohet veçanërisht rolit të Jugosllavisë, duke e paraqitur atë si faktor pozitiv dhe si aleat të sinqertë të Shqipërisë. Në një kohë kur e vërteta ishte krejt ndryshe, Jugosllavia në çdo çast punonte për vete dhe jo për shqiptarët. Kjo është arsyeja se pse lexohen pohime të tilla, si “Pa luftën e popullit të Jugosllavisë nuk mund të mendohej rezistenca e popullit të vogël shqiptar kundra armikut”.¹⁰² Për këtë gjë, siç duket ishte shumë i bindur edhe vetë populli i indoktrinuar nga propaganda komuniste e nxitur qysh nga koha e formimit të Partisë Komuniste dhe luftës, i cili nuk pushon së falënderuari të deleguarit e Republikës Popullore Jugosllave në Shqipëri, kryesisht Miladin Popoviçin dhe Dushan Mugoshën. Falënderimet e punës së frytshme të delegatëve jugosllavë në Shqipëri shprehen në shumë prej letrave të adresuara për ta. “Për kontributin, sakrificat, këshillat, mendimet dhe vendimet e marra për krijimin dhe ecurinë e PKSh të dhëna nga Dushan Mugosha kanë shkruar Enver Hoxha, Koçi Xoxe, Nexhmije Hoxha, Hysni Kapo, Bedri Spahiu etj.”¹⁰³ Këta, që ishin edhe kryesia e PKSh, nuk ngurrnin të shprehnin lavdet, servilizmin, përluljen dhe gjithçka tjetër për të pasur mbështetjen prej vëllazërimi me Jugosllavinë, si dhe lidhjen e ngushtë të krijuar mes tyre. Në aspektin e politikës së jashtme, për periudhën 1945–1947 Shqipëria u karakterizua nga një afrim gjithnjë e më i madh i saj me Jugosllavinë. Këto marrëdhënie do të bëheshin më të afërta pas Luftës së Dytë Botërore. “Në të dy vendet, në pushtet erdhën partitë komuniste me përvojën e bashkëpunimit që u vendos në luftë e sipër.”¹⁰⁴ Pas Luftës së Dytë Botërore u formuan dy kampe të kundërta: nga njëra anë ShBA dhe aleatët e saj dhe në anën tjetër Bashkimi Sovjetik dhe aleatët e tij. “ShBA dhe Anglia kishin si synim të shkatërronin fashizmin, por edhe ta dobësonin së tepërmi Bashkimin Sovjetik, duke e zgjatur sa më shumë luftën dhe të vendosnin sundimin e tyre në botë.”¹⁰⁵

Në të vërtetë, pesë vitet e para të mbas Luftës së Dytë Botërore kanë qenë të mjaftueshme për të kuptuar se Shqipëria pati shanse historike për t’u vetë-përcaktuar në bllokun perëndimor, por doktrina e regjimit komunist sundues të Tiranës, e cila kishte marrë atributet e fitores së Luftës Nacionalçlirimtare ishte thellësisht e ndikuar dhe e lidhur me rrugën lindore të zhvillimit. Marrëdhëniet dypalëshe tejet të komplikuar midis

¹⁰² Vladimir Dedijer, *Marrëdhëniet shqiptaro-jugosllave 1939-1948*, Beograd, Botimet: ‘Prosveta’, 1949, f.77.

¹⁰³ *Po aty*, f.43-46.

¹⁰⁴ *Historia e Popullit Shqiptar*, Vëll. IV, Grup autorësh, Tiranë, Botimet: Toena, 2008, f.241.

¹⁰⁵ Foto Çami, *Partia Komuniste e Shqipërisë në luftë për rimëkëmbjen e vendit dhe për zhvillimin e mëtejshëm të Revolucionit, 1945-1948*, Tiranë, f.5.

Shqipërisë dhe Jugosllavisë, në vitet 1945–1948, e vërtetojnë më së miri këtë prirje. Që me themelimin e Partisë Komuniste dhe në vazhdim, regjimi komunist i Tiranës ndoqi rrugën jugosllave, për aq kohë sa Shqipëria gjatë historisë së saj nuk pati shumë shanse historike për t’iu bashkuar Bllokut Lindor. Partia Komuniste Shqiptare ishte një parti e ngritur mbi baza ideologjike marksiste-leniniste dhe e shihte ideologjikisht të pamundur bashkëpunimin me Perëndimin kapitalist, kështu që rrjedhimisht u lidh me atë që kishte më afër ideologjikisht, pra me Jugosllavinë, e cila e përshëndeti rezultatin e dalë nga zgjedhjet e para të përgjithshme parlamentare të 2 dhjetorit 1945. Nga këto zgjedhje nis edhe veprimtaria e shtetit komunist. Më 1 maj të vitit 1945, Qeveria Demokratike e Jugosllavisë, nëpërmjet misionit ushtarak në Tiranë e njohu zyrtarisht qeverinë e re shqiptare dhe shprehu dëshirën për lidhjen e marrëdhënieve diplomatike me të.¹⁰⁶ Ky fakt tregon se “qeveria jugosllave ishte e para që e njohu qeverinë tonë si qeveri të ligjshme dhe vendosi marrëdhënie diplomatike me ne, që prej vitit 1945”,¹⁰⁷ u shpreh Enver Hoxha.

Ndërsa përkrahja që Shqipëria i bëri Jugosllavisë ishte dërgimi i divizioneve tona ushtarake përkrah atyre jugosllave në luftën kundra gjermanëve. Mareshali Tito e shprehu mirënjohjen e tij kundrejt këtyre divizioneve, duke u shprehur se kjo ndihmë e tyre ka krijuar lidhje të pashkëputshme mes Shqipërisë demokratike dhe Jugosllavisë Federative demokratike.¹⁰⁸ Milan Gjilasi, me rastin e vizitës së tij në Tiranë, në maj të 1945-s, u shpreh se “ushtria shqiptare ka treguar iniciativë dhe vetëmohim në luftë për çlirimin e Jugosllavisë, sikur të luftonte për vendin e vet.”¹⁰⁹

Menjëherë pas përfundimit të luftës, qeveria e re shqiptare u ballafaqua me vështirësinë e qeverisjes së vendit dhe nevojën e njohjes ndërkombëtare të saj. Për rrjedhojë, ishte e pritshme që marrëdhëniet ndërmjet të dy vendeve të shënonin një zhvillim të dukshëm dhe aleanca me Jugosllavinë u bë domosdoshmëri për qeverinë shqiptare. Më 17 dhjetor 1945, kryesia e KANÇ-it vendosi të thërriste mbledhjen e parë të asamblesë, e cila do të zgjidhte dy detyra të rëndësishme: formën e regjimit dhe Statutin Themeltar (Kushtetutën).

Asambleja i filloi punimet më 10 janar 1946 dhe më 11 janar 1946 ajo e shpalli Shqipërinë Republikë Popullore. Pas gjithë kësaj nis historia e shtetit shqiptar, pas Luftës së Dytë Botërore, e cila çoi në vendosjen e regjimit komunist për gati gjysmë shekulli. Pas marrjes së miratimit të qeverisë, në lidhje me politikën e jashtme, kryeministri Enver Hoxha tha se “qeveriado të mbronte interesat e paqes dhe të demokracisë, ashtu si edhe interesat e vendit”.¹¹⁰ Për sa iu përket marrëdhënieve me Jugosllavinë, Enver Hoxha shprehet se “Nga miqtë më të afërt për popullin tonë janë popujt e Jugosllavisë. Miqësia

¹⁰⁶ Gazeta “*Bashkim*”, Tiranë, 1 maj 1945.

¹⁰⁷ Enver Hoxha, *Një jetë për kombin*, Tiranë, Botimet: Neraida, 2008, f.276.

¹⁰⁸ V. Dedijer, *Marrëdhëniet shqiptaro-jugosllave...*, f.83

¹⁰⁹ *Po aty*.

¹¹⁰ Kastriot Dervishi, *Historia e Shtetit Shqiptar 1912-2005*, Tiranë, Botimet: “55”, 2006, f. 566

mes nesh dhe Jugosllavisë lindi në kohët më kritike nga kalonin kombet tona dhe në përlëshje kundër fashizmit. Populli ynë gjeti shokë dhe miq nga më të sinqertët që i dhanë dorën dhe e ndihmuan pa kursim. Miqësia dhe vëllazërimi që na lidh me popujt e Jugosllavisë do të jetë e përhershme dhe janë vitale për popullin shqiptar, për independencën dhe pavarësinë e tij. Miqësia që na lidh me Jugosllavinë është nga ato miqësi të rralla e të sinqerta që e ndihmojnë aq shumë popullin tonë, e nderojnë dhe e respektojnë independencën dhe sovranitetin e Shqipërisë. Jugosllavia e madhe e mareshalit Tito dhe Shqipëria jonë e vogël kanë gjetur rrugën e demokracisë së vërtetë dhe të shëndoshë e janë bërë faktor i madh i paqes në Ballkan dhe në Europë dhe njëkohësisht shtylla e vëllazërimit ballkanik.”¹¹¹

Nga ky fjalim i kreut të shtetit shqiptar duket qartë se orientimi i Shqipërisë do të ishte drejt kampit të Lindjes, ku vendin e parë do ta zinte Jugosllavia. Pas vendosjes së marrëdhënieve diplomatike shqiptaro-jugosllave të dy vendet shkëmbyen përfaqësuesit e tyre. Ambasadorët shqiptarë në Jugosllavi, gjatë periudhës 1945-1948 kanë qenë: Tuk Jakova, në vitet 1945–1946, Hysni Kapo, në vitet 1946–1947, Ramadan Çitaku, në vitet 1947–1948”.¹¹² Njëri nga ambasadorët shqiptarë në Jugosllavi më me zë ka qenë Hysni Kapo, i cili e përfaqësoi Shqipërinë në periudhën kur marrëdhëniet shqiptaro-jugosllave ishin në kohët më të arta. “Kapo shfaqte lumturinë dhe kënaqësinë që përfaqësonte ‘Shqipërinë e re në Jugosllavinë e Titos’, pasi ky ishte rasti i parë që Shqipëria demokratike dërgonte përfaqësuesin e parë jashtë Shqipërisë. Kapo e quante Jugosllavinë ‘përkrahësen më të sinqertë’, që ishte ‘garanci për paqen në Ballkan’.”¹¹³ Hoxha shprehet se, “në një radiogram urgjent të dërguar nga Hysni Kapo, ambasador në Jugosllavi, thuhej se Tito na donte urgjent në Beograd. U bëmë gati të shkonim, por mendova që t’i çonim edhe një dhuratë Titos. Menduam t’i çonim një pisqollë sermi. Vumë në lëvizje të gjithë njerëzit dhe Sterjo Gjokoreci gjeti tre pisqolla sermi nga konfiskimi i pasurisë së një kriminelit kuisling. Pranë nesh ishte edhe përfaqësuesi jugosllav Josip Gjergjia, i cili e pëlqeu shumë këtë mendim dhe, pa pikë turpi na tha: ‘Titoja do të kënaqet pamasë, dërgojani të tria.’”¹¹⁴

Siç dihet, Shqipëria pas luftës u ndodh në një situatë shumë kritike, në të gjitha aspektet, si të brendshme ashtu edhe të jashtme. Prapambetja e thellë ekonomike, kulturore e trashëguar nga e kaluara, si dhe shkatërrimet dhe dëmtimet që solli lufta çuan në një krizë e paralizë thuajse të plotë të tërë jetës së vendit. Në arenën ndërkombëtare nisi menjëherë bojkotimi dhe lufta e hapur kundër Shqipërisë. Në këto rrethana të vështira që po kalonte vendi, “miqtë” jugosllavë u përpoqën ta shfrytëzonin për qëllimet e tyre, sigurisht duke ndjekur rrugë dhe metoda të tjera të rafinuara. Gjithnjë nën trysinë e madhe të Partisë Komuniste Jugosllave dhe shkallës së lartë të indokrinimit pro-jugosllav të një bërthame të

¹¹¹ *Po aty*, f.567.

¹¹² *Po aty*, f.583.

¹¹³ K. Dervishi, *Historia e Shtetit Shqiptar...*, f.584.

¹¹⁴ Enver Hoxha, *Një jetë për kombin*, Tiranë, Botimet: Neraida, 2008, f.282

udhëheqjes së Partisë Komuniste Shqiptare, të cilën e përfaqësonte Koçi Xoxe, vazhdonin të thelloheshin marrëdhëniet me jugosllavët. “Tito mbetej gjithnjë i pari në shkallëzimin e garantëve të vijës së re, por kishin filluar lidhjet edhe me qeveri të tjera komuniste... Enver Hoxha donte që njerëzit të mendonin se mes të mëdhenjve të Lindjes, ai ishte i barabartë mes të barabartëve”.¹¹⁵ Ai shprehej se “Forcimi i marrëdhënieve ekonomike e kulturore me Jugosllavinë janë aq të rëndësishme sa edhe koordinimi i politikës së jashtme dhe i mbrojtjes nga armiqtë. Kjo çështje është në rend të ditës dhe pret vetëm një zgjidhje të drejtë nga ana jonë”.¹¹⁶

Jugosllavia u tregua e gatshme për ta ndihmuar Shqipërinë në kapërcimin e vështirësive ekonomike dhe në përballimin e problemeve politike, “sidomos në ruajtjen e pavarësisë e të tërësisë tokësore të vendit, si dhe në njohjen e në afirmimin ndërkombëtar të shtetit shqiptar”.¹¹⁷

“Më 14 janar 1946, me rastin e çeljes së Asamblesë së Përgjithshme, gjeneral-kolonel Enver Hoxha, me anë të një telegrami, më 16 janar 1946 i drejtoi një kërkesë presidentit të komisionit përgatitor të Kombeve të Bashkuara për ta pranuar Shqipërinë në Organizatën e Kombeve të Bashkuara (OKB).”¹¹⁸ Kjo kërkesë u kundërshtua dhe nismëtarja kryesore e këtij kundërshtimi ishte Greqia, e cila pretendonte se kishte disa çështje të pazgjidhura me Shqipërinë. Mbas luftës që bëri dhe kontributit të saj që dha në shkatërrimin e fashizmit, Shqipërisë nuk iu dha vendi që meritonte në arenën ndërkombëtare. Kjo ilustron edhe nga mospranimi i kërkesave për t’u pranuar në OKB. Edhe në këtë rast, delegacioni jugosllav i dërgoi një memorandum Shqipërisë, ku rekomandonte se Shqipëria e meritonte plotësisht një vend në OKB. Pavarësisht kësaj, vendi ynë u pranua në OKB vetëm në vitin 1955. Mbrojta e të drejtave të Shqipërisë nga Jugosllavia shihen edhe në konferenca të tjera ndërkombëtare. Rasti ishte konferenca e 12 marsit 1946, UNRRA. Qeveria shqiptare i kërkoi zyrtarisht ndihmë UNRRA-s më 11 janar 1945.¹¹⁹ Fillimisht, UNRRA u tregua e gatshme për të dërguar ndihma në drejtim të vendit tonë, por ajo haste pengesa të mëdha nga shqiptarët, të cilët ndikoheshin drejtpërsëdrejti nga jugosllavët. Për këtë arsye, ajo u tërhoq duke e lënë vendin tonë në mëshirë të fatit dhe të Jugosllavisë.

Me vendosjen e marrëdhënieve diplomatike, Jugosllavia u bë mbështetësja e Shqipërisë në organizmat ndërkombëtarë. Rasti është Konferenca e Paqes në Paris, ku politikani i njohur Moshe Pijade paraqiti kërkesën e Shqipërisë për të marrë pjesë në

¹¹⁵ Amik Kasoruh, *Një ankth gjysmëshekullor*, Tiranë, Botimet: Çabej, 1996, f.61

¹¹⁶ *AQSH.F.14/AP*, dosje.1, viti 1946

¹¹⁷ Xhelal Gjeçovi, *Shteti Shqiptar dhe çështja e Kosovës*, Tiranë, BOTIMPEX, 1998, f.129

¹¹⁸ *AMPJ*, Titulli i Dosjes: ‘*Relacion mbi marrëdhëniet midis dy vëndeve*’, viti 1946, dosja 167, f.22

¹¹⁹ Hamit Kaba, *UNRRA në shqipëri 1944-1947*, Tiranë, Botimet: Akademia e shkencave e Shqipërisë, 2000, f.115.

konferencë, madje propozimi jugosllav u shoqërua me diskutime të shumta pro dhe kundër, ku ra në sy mbështetja jugosllave.

Në këto rrethana, më 12 gusht 1946 konferenca mori vendimin që Shqipëria të ftohej në konferencë dhe të parashtronte pikëpamjet e veta. Në këto kushte u nis delegacioni shqiptar, “fillimisht i kryesuar nga Hysni Kapo, dhe më 18 gusht në krye të tij u vendos Kryeministri i vendit Enver Hoxha.¹²⁰ Në fjalimin e mbajtur në seancën plenare të Konferencës së Paqes në Paris, më 21 gusht 1946, Enver Hoxha, pasi kishte kritikuar qëndrimin e diplomacisë evropiane për të mos e ftuar qeverinë shqiptare, si pjesë të konferencës, kishte konstatuar se “... ajo e kishte ftuar me luftë të drejtën për të marrë pjesë në këtë konferencë, me titull dhe me të drejta njësoj si njëzet e një kombet fitimtare. Populli i vogël shqiptar, i vetëm dhe pa mbrojtje, ka qenë viktima e parë e agresionit italian... Fill të vetëm, përpara një armiku të pamëshirshëm, ne e kemi mbajtur ballin lart në furtunë, ne i shpallëm armikut luftë të ashpër dhe të paprerë”.¹²¹

Për t’i treguar udhëheqjes shqiptare se Jugosllavia ishte mbështetësja e saj më e madhe, në pushimin midis seancave në konferencë, Moshe Pijade denoncoi publikisht propozimin e bërë nga kryeministri grek Caldaris për ndarjen e Shqipërisë midis Jugosllavisë dhe Greqisë.¹²² Por do të ishte Pijade, ai që do të propozonte që kancelaria e Republikës Federative të Jugosllavisë në Beograd të mos kishte gjashtë, por shtatë kabinete, dhe “kabineti i shtatë t’i përkiste “Republikës Jugosllave të Shqipërisë”¹²³. Nga kjo duken qartë rreziqet reale që kërcënonin vendin tonë. Kjo situatë rëndohej dhe më shumë nga qëndrimi që tre vendet aleate që drejtuan koalicionin antifashist në vitet e Luftës së Dytë Botërore, Bashkimi Sovjetik, Shtetet e Bashkuara të Amerikës dhe Britania e Madhe, mbajtën kundrejt kësaj çështjeje. ShBA dhe Anglia shumë shpejt shfaqën rezervat dhe mospajtimet e tyre me politikën e shteti shqiptar, ndërsa Bashkimi Sovjetik, me indiferencën e me mos kujdesin për Shqipërinë dhe preferencën e hapur për Jugosllavinë e Titos, i la kësaj të fundit dorë dhe fushë të lirë veprimi që ta shtrinte ngadalë ndikimin dhe ndërhyrjen e vet në Shqipëri, deri në atë shkallë sa ta rrezikonte seriozisht pavarësinë dhe integritetin e saj territorial. “Diplomatët jugosllavë kishin konstatuar se Enver Hoxha, edhe gjatë qëndrimit në Paris kishte mbajtur shpresë se do të kishte mbështetjen e Francës, për të cilën ishte i bindur se do ta përkrahte, që t’i përmirësonte marrëdhëniet e ftohura me anglo-amerikanët.¹²⁴

Diplomacia jugosllave e kishte vlerësuar si të dobishme mosgatishmërinë e segmenteve të caktuara të diplomacisë ndërkombëtare, në radhë të parë të asaj anglo-amerikane, për të bërë bashkëbisedime me përfaqësuesit shqiptarë dhe personalisht me

¹²⁰ *Historia e Popullit Shqiptar*, vëll.IV..., f.233.

¹²¹ *Gazeta Bashkimi*, 22 shtator 1946.

¹²² Xh. Gjecovi, *Shteti Shqiptar dhe çështja e Kosovës...*, f.130.

¹²³ *Po aty*.

¹²⁴ A. Zogaj, *Marrëdhëniet Shqiptaro-Jugosllave...*, f.155.

Enver Hoxhën. Izolimi ndërkombëtar i Shqipërisë nga shtetet perëndimore, i manifestuar edhe në nivel të Konferencës së Paqes në Paris, e detyronte politikën e jashtme shqiptare që përfundimisht të orientohej vetëm kah Jugosllavisë dhe BRSS, që të mund t'i realizonte dhe mbronte interesat e shtetit shqiptar. “Enver Hoxha në Konferencën e Parisit krijoi përshtypjen reale për marrëdhëniet ndërmjet shteteve të Bllokut Lindor. Ai ishte i ndërgjegjshëm se çfarë do të thotë BRSS si superfuqi, mirëpo vuri re po ashtu se midis BRSS dhe Shqipërisë është Jugosllavia, përmes së cilës Lindja komunikonte me Shqipërinë”¹²⁵ Menjëherë sapo e kuptuan pozicionin e dobët të Enver Hoxhës, në përmasat e diplomacisë ndërkombëtare, në veçanti mospranimin e tij nga diplomacia perëndimore, diplomacia jugosllave u hodh në ofensivën diplomatike dhe të presioneve të reja kundër Enver Hoxhës. “Si e hetoi këtë bisedë me Hoxhën, Gjergja e zmadhoi edhe më shumë çështjen e konventës kulturore, në mënyrë që të thelloheshin marrëdhëniet Shqiptaro-Jugosllave. Hoxha e kishte bërë të ditur Gjergjës se, më 29 shtator, në Plenumin e Frontit Demokratik, do të bënte spastrime të kuadrove, në sajë të përvojave të fituara. Këtë është dashur ta bënte edhe në saj të faktit se autoriteti dhe prestigji i Jugosllavisë në vend ishte rritur, mirëpo në organet udhëheqëse ende kishte njerëz të rezervuar ndaj Beogradit”.¹²⁶

Me vendosjen e marrëdhënieve diplomatike u intensifikua bashkëpunimi Shqipëri – Jugosllavi, gjë që u shoqërua edhe nga tendenca jugosllave për kanalizimin e marrëdhënieve të Shqipërisë vetëm me Jugosllavinë. Jugosllavia ishte i vetmi vend mik, nëpërmjet të cilit kryhej lidhja e Shqipërisë me botën e jashtme dhe, siç thoshte ambasadori sovjetik i asaj kohe, Çuvahin, “në marrëdhëniet shqiptaro – jugosllave të atyre kohëve sundonte parimi i fshehtë: rruga nga Tirana për në Moskë kalon nga Beogradi”.¹²⁷

Megjithatë, politika dhe qëndrimi konkret i Kremlinit në rajon e më gjerë ndikoi fuqishëm në ecurinë e marrëdhënieve shqiptaro-jugosllave. Pavarësisht se ndikimi politik ndaj Jugosllavisë, midis BS dhe Perëndimit u përcaktua në raportin 50 me 50, sipas marrëveshjes së “përqindjeve”, Stalini e vlerësonte Jugosllavinë për luftën dhe rolin e saj në rajon. Në raport me Shqipërinë, duket nga fakti se, krahas vlerësimit, Bashkimi Sovjetik konfirmoi edhe synimin e tij që Shqipëria të mbetej nën “kujdestarinë” e Jugosllavisë, por të kontrolluar me kujdes nga Kremli. Stalini, menjëherë pas lufte e udhëzonte udhëheqjen jugosllave që për vendimet lidhur me Shqipërinë duhej të merrej prerazi mendimi i Moskës.

Në bisedimet e Stalinit të zhvilluara në Moskë, më 9 janar 1945, me Andrija Hebrang, anëtar i udhëheqjes jugosllave, jo vetëm u interesua për procesin e njohjes së Shqipërisë nga Jugosllavia, por, duke folur për lidhjet me Shqipërinë u kujtoi dhe u kërkoi “të dinin edhe mendimin” e tyre, “para se të merrnin vendime të rëndësishme”, ndryshe do

¹²⁵ A. Zogaj, *Marrëdhëniet Shqiptaro-Jugosllave...*, f.155

¹²⁶ *Po aty*, f.156.

¹²⁷ Dimitr S. Cuvahin, *Shërbimi im diplomatik në Shqipëri*, Tiranë, Botimet: Almera, 2009, f.44.

gjendeshin “në një pozitë të vështirë”¹²⁸, duke u shprehur për diçka që ishte si në pronësi të Jugosllavisë, por që kërkonte kontroll mbi të. Nuk është e rastit që Jugosllavia ishte shteti i parë që e njohu qeverinë shqiptare, përpara njohjes nga Tre Aleatët e Mëdhenj. Statusi i “kujdestarit” të Jugosllavisë për Shqipërinë, por nën kontrollin dhe lejen e Kremlinit, konfirmohet edhe nga qëndrimet dhe deklaratimet e vetë udhëheqësve sovjetikë. Në radhë të parë, përcaktimi i një statusi të tillë, shfaqet në idenë e ricikluar sovjeto–jugosllave, për krijimin e Federatës Ballkanike, në të cilën përfshihet edhe Shqipëria. Përgatitja e bërë gjatë vitit 1944, këmbëngulja dhe ngutja e Titos për finalizimin e Federatës midis Jugosllavisë e Bullgarisë, tërhoqi vëmendjen dhe solli reagimin e Perëndimit. Në prag të formalizimit, në janar të vitit 1945, ideja u kritikua me forcë nga britanikët, pasuar nga Departamenti Amerikan i Shtetit. Nga ana e tyre, “Federata e Sllavëve të Jugut u vlerësua si faktor destabilizimi në Europën Juglindore, sepse shtetet jo sllave të Ballkanit do ta konsideronin atë kërcënim të sigurisë së tyre”¹²⁹ Është fakt se, deri sa hynë vetë në konflikt me Titon, udhëheqësit sovjetikë nuk treguan kurrfarë shqetësimi e interesimi dhe nuk shfaqën e nuk lëvizën aspak për fatin e Shqipërisë dhe të shqiptarëve në tërësi. Tek ata mbizotëroi mendimi se “me ta le të merren jugosllavët”. Vetë Molotovi, numri dy në udhëheqjen sovjetike në atë kohë deklaronte se “ndihmat ekonomike për Shqipërinë ne i japim nëpërmjet Jugosllavisë”.¹³⁰

“Bashkimi Sovjetik nuk donte të kishte ngatërresa me Perëndimin, duke qenë se Greqia ishte në sferën anglo-amerikane të influencës. Sipas Tony Judt (PostËar), “Përkrahja provokuese e Titos ndaj kryengritësve grekë e shqetësonte Stalinin... e largonte edhe më tepër nga ithtari i tij ballkanas”. Edhe pretendimet e Titos ndaj territoreve italiane në kufi me Jugosllavinë, qarqet ushtarake perëndimore besonin që rajoni i Triestes përbënte detonatorin e një lufte të tretë botërore. Tito kishte pretendime territoriale edhe ndaj Austrisë, por Stalinin nuk i interesonte prishja e një *statu quo*-je që i jepte mundësi të mbante trupa në Austri dhe, rrjedhimisht, edhe në Hungari. Prandaj Stalini e shihte se Tito kërkonte ta shfrytëzonte idenë e Konfederatës Ballkanike për të vendosur hegjemoninë jugosllave në Ballkan.”¹³¹

Ndërkaq, Enver Hoxha, ashtu si edhe në vitet e luftës, plotësisht i varur nga politika jugosllave, deklaronte në Shqipëri se rruga “për në Moskë kalonte nëpërmjet Jugosllavisë”. Në këtë mënyrë, deri në vitin 1947 qeveria shqiptare, edhe pse ishte njohur nga vendet e Lindjes, duke përfshirë këtu edhe Bashkimin Sovjetik, ndodhej në një izolim të plotë ndërkombëtar, si brenda ashtu edhe jashtë bllokut komunist.

¹²⁸Shqipëria në dokumentet e arkivave ruse... f.101.

¹²⁹D. S. Cuvahin, *Shërbimi im diplomatik në Shqipëri...*, f.382.

¹³⁰Xh. Gjecovi, *Shteti Shqiptar dhe çështja e Kosovës...*, f.131

¹³¹Bashkim Shehu, “*Liri Belishova dhe koha e saj*”, Tiranë, Botimet: UET, 2020, f.76

Ky qëndrim sigurisht që nuk është i rastit. Jugosllavia kishte punuar me kohë për të fituar të drejtën dhe besimin që të vepronin lirisht e të bënin si të donin me Shqipërinë. Me shpifje e disinformata mbi gjendjen e Shqipërisë, ata kishin hedhur hije dyshimi në aftësinë e shtetit shqiptar për të zotëruar dhe përballuar situatën në vend e, për rrjedhojë, kishin arritur të krijonin përshtypjen se ishin ata që e mbanin Shqipërinë në këmbë, që ushqenin popullin e saj të varfër dhe se nga ata varej ose jo ekzistenca e shtetit shqiptar. “Një qëndrim diskriminues u duk qartë në rastin e krijimit të Byrosë Informative të Partive Komuniste në vitin 1947, në të cilën u përfaqësuan të gjitha partitë komuniste të vendeve ish-socialiste, si dhe ato të Francës dhe Italisë. Kurse jashtë saj mbeti vetëm Partia Komuniste e Shqipërisë, e një vendi që konsiderohej socialist.¹³² Tendencat e Jugosllavisë ishin afrimi ekonomik dhe politik që, si qëllim përfundimtar kishin përfshirjen e Shqipërisë në Federatën Jugosllave. Përfshirja e Shqipërisë në këtë Federatë Jugosllave argumentohej edhe si zgjidhje e problemeve të vështira të shqiptarëve etnikë në shtetin jugosllav. Në presionin jugosllav, Enver Hoxha dhe udhëheqja komuniste shqiptare nuk kishin qëndrim të prerë rreth bashkimit të Kosovës me Shqipërinë. Nuk ka dyshim se, në rrethanat e vështira që po kalonte vendi, shteti shqiptar ishte i detyruar dhe i interesuar që të kërkonte aleatë dhe të siguronte miq, në radhë të parë rreth kufijve, në vendet fqinje, që ta ndihmonin dhe ta mbështesnin në kapërcimin e vështirësive e në zgjidhjen e problemeve të mprehta, me të cilat po ballafaqohej. Këtë mendoi se e gjeti, para së gjithash, te Jugosllavia, vend fqinj dhe aleat në luftën e përbashkët kundër fashizmit. Çlirimi i Shqipërisë dhe i Jugosllavisë do të ishte oguri i parë i nisjes së këtyre marrëdhënieve.

Si rezultat i këtij “vëllazërimi ideologjik”, në vitin 1946 lidhet edhe një traktat miqësie dhe bashkëpunimi, i cili parashikonte koordinimin dhe miratimin e kuadrit juridik e atë të planeve ekonomike të dy vendeve, rregullimin e sistemit monetar, një bashkim doganor, tregtaro-industrial dhe një sistem i përbashkët çmimesh. Me këtë traktat, komunistët shqiptarë u konsideruan si pasues të jugosllavëve dhe Shqipëria u bë një shtet satelitor jugosllav. Kjo etapë njeh një rëndësi të veçantë, sepse këtu fillon edhe zanafilla e varësisë sonë ekonomike ndaj Jugosllavisë. Sipas Enver Hoxhës, një vend të rëndësishëm në bisedimet e Beogradit zunë çështjet ekonomike. Tito e kishte informuar Enverin se gjatë qëndrimit në Moskë, Stalini kishte deklaruar se, “Shqipërinë, qeveria sovjetike e konsideron si një republikë motër, së cilës i duhet dhënë një ndihmë e gjithanshme. Madje, Stalini kishte theksuar se Bashkimi Sovjetik do ta ndihmojë Shqipërinë përmes Jugosllavisë.¹³³ Gjatë vizitës në Beograd të ministrit të Ekonomisë, Nako Spirut, në gjysmën e parë të muajt prill të vitit 1946, Eduard Kardeli, një nga udhëheqësit kryesorë të Jugosllavisë, sipas udhëzimeve të Titos i shprehu përfaqësuesit të qeverisë shqiptare

¹³²Po aty, f.132.

¹³³Shqipëria në dokumentet e arkivave ruse..., f.123.

vullnetin për nënshkrimin e traktatit, por pritej mendimi i Moskës për karakterin dhe përmbajtjen e tij.¹³⁴

Pak më vonë, më 27 maj të vitit 1946, vetë Tito, në takimin me Stalinin në Moskë kërkoi mendimin e tij për mundësinë e nënshkrimit të Traktatit të Miqësisë e Ndhmës Reciproke me Shqipërinë dhe përfshirjen e saj në Federatën Jugosllave. Në këto bisedime, Stalini e pyet Titon, “nëse Enver Hoxha ishte dakord që Shqipëria të përfshihej në përbërjen e Jugosllavisë Federative”. Ndërsa Tito u përgjigj në mënyrë pohuese, si vullnet i shprehur edhe nga Enver Hoxha”.¹³⁵ Sipas shpjegimeve të Titos, traktati ishte i domosdoshëm për “mbrojtjen e tërësisë territoriale dhe pavarësisë së Shqipërisë”.¹³⁶ Një qëndrim i tillë, i ndihmës së Shqipërisë nëpërmjet Jugosllavisë, “iu komunikua Enver Hoxhës personalisht nga Stalini, në vizitën e parë në Moskë në korrik të vitit 1947”.¹³⁷ Në mbledhjen e Byrosë Politike më 27 korrik, Enver Hoxha informonte se Stalini ishte shprehur se do t’ju japim “ndihmë me anën e jugosllavëve... Ju keni nevojë për atë ndihmë, ata janë njerëz të mirë...”¹³⁸

Në takimin Tito-Stalin, mbajtur më 9 qershor në Moskë, ky i fundit e kishte pyetur udhëheqësin e PKJ nëse e njihte Enver Hoxhën. Tito i ishte përgjigjur: “Nuk e kam parë Enver Hoxhën, është njeri i ri, por gjatë luftës është bërë i popullarizuar... Përgjithësisht, njerëzit në udhëheqjen e partisë shqiptare janë të rinj. Sa dimë ne, nuk ka probleme të theksuara ndërmjet tyre.... Ata kanë kërkuar të vijnë këtu, por nuk duan ta lëshojnë Enverin vetëm, por me të dëshiron të vijë edhe Koçi Xoxe, si një kontroll. Ne vazhdimisht e shtyjmë ardhjen e tyre”.¹³⁹ Stalini e kishte pyetur Titon, se a do t’i duhej t’i pranonte udhëheqësit shqiptarë në Moskë, duke sugjeruar qëllimisht dhe plot me dinakëri se më mirë do të ishte që udhëheqja sovjetike t’i ndihmonte përmes jugosllavëve. Megjithatë, gjatë takimit Stalini kishte arritur në përfundimin se diçka nuk është në rregull në Politbyronë Shqiptare.

Aleksandër Rankovici, duke u inkuadruar në bisedën për çështjen e zhvillimit përbrenda PKSh, kishte thënë se “Nuk ka probleme të mëdha, por asaj që shokët nga Politbyroja Shqiptare nuk e mendojnë Enver Hoxhën aktualisht mjaft të zotin, prandaj gjithnjë kërkojnë që së bashku me të të shkojë edhe Koçi Xoxe, si anëtar më i vjetër i Partisë. Takimi i udhëheqjes sovjetike dhe asaj jugosllave, në qershor të vitit 1946, dhe ngritjen e çështjes së Shqipërisë nga ana e Stalinit, Gjelasit e shpjegonte me vlerësimin:

¹³⁴ AQSH, F. 14/AP, MPKJ, viti 1946, D.11, fl.5. *Informim i Nako Spirit nga Beogradi, dërguar në dorëshkrim Enver Hoxhës më 26.4.1946, lidhur me bisedimet me Kardelin.*

¹³⁵ “Shqipëria dhe Kosova në arkivat ruse”, përgatitën për botim Hamit Kaba & Ethem Çeku, Tiranë, Botimet: "Flamuri", 2017, f. 24.

¹³⁶ *Po aty*, f. 25.

¹³⁷ AQSH, F. 14/AP, viti 1947, D.23, fl.7. *Në dokumente nuk ka protokoll për bisedimet me Stalinin. Megjithatë, në mbledhjen e Byrosë Politike më 27 korrik u informua nga E. Hoxha dhe anëtarët e tjerë të delegacionit mbi rezultatet e vizitës.*

¹³⁸ *Po aty*.

¹³⁹ A. Zogaj, *Marrëdhëniet Shqiptaro-Jugosllave...*, f.167

“Ajo bisedë për Shqipërinë nuk ishte aspak e rëndësishme, kurse unë mendoj se në mendjen e Stalinit që atëherë formësohej ideja për nënshkrimin e Jugosllavisë. Pikërisht Shqipëria dhe mosmarrëveshjet e Jugosllavisë me sovjetët do t’i shërbejnë Stalinit, në fillim të vitit 1948, si shkak më i mirë për sulm ndaj Jugosllavisë... Afrimi i Shqipërisë me Jugosllavinë ishte kurth i Stalinit”.¹⁴⁰ Ndërsa, gjatë informimit në Plenumin VII të KQ më 30 gusht 1947, E. Hoxha theksoi: “Shoku Stalin na tha se populli ynë duhet të jetë i lumtur, që në kufijtë e tij të ketë një aleat si Jugosllavia...”¹⁴¹ Traktati parashihej të ishte i vlefshëm për njëzet vjet nga data e nënshkrimit të tij. Me këtë traktat, ishte më se e qartë se Jugosllavia po bënte hapa të fortë hegjemonist në Ballkan, dhe se kjo po tregohej sheshazi në rastin e Shqipërisë. U bënë përpjekje që të hollat shqiptare, lekët, të shndërroheshin në dinarë. Po ashtu, çmimet për mallrat e ndryshme qenë të njëjta për të dyja shtetet dhe malli u përcaktua në të dyja drejtimet njësoj. Planet ekonomike u koordinuan nga një komision i përbashkët, i cili e përjashtoi pothuajse plotësisht ndikimin e qeverisë shqiptare.

Pas vizitës që Enver Hoxha bëri në Beograd, në vitin 1946, “Ministria e Financave e Shqipërisë dhe Banka Kombëtare vendosën shtypjen e frangës shqiptare, që do të përdorej për shkëmbime financiare më të ngushta mes dy vendeve. Po në këtë vit, të dyja vendet do të binin dakord për Traktatin e Miqësisë dhe të Ndihmës së Përbashkët. Përfaqësuesit e Shqipërisë dhe të Jugosllavisë vendosën të konkludojnë një pakt miqësie dhe ndihme reciproke. Një pakt i tillë do të konfirmojë vullnetin e popujve të të dy vendeve, për të mbrojtur së bashku lirinë dhe pavarësinë e tyre”.¹⁴² Përkrahja e madhe që Jugosllavia tregoi ndaj Shqipërisë bëri që marrëdhëniet e tyre të intensifikoheshin edhe më shumë, duke u pasuar me marrëveshje e traktate të njëpasnjëshme. Për Traktatin mbi Miqësinë dhe Ndihmën Reciproke, i cili njihej si një instrument i rëndësishëm për garantimin e sigurisë dhe të kufijve shqiptarë, Radio Moska, në një emision të saj në gjuhën shqipe, më 12 korrik 1946, thotë: “Ky traktat është një kontribut i ri për sigurimin dhe paqen në Ballkan dhe në mbarë botën...”¹⁴³ Nënshkrimi i këtij traktati u ekspozua në shtyp si një ekspansion të Jugosllavisë ndaj Shqipërisë. “Ky shpërthim, në artikujt e fletores “La kapitale”, “Tempo”, “Mesagjero”, në organin monarko-fashist “Elinikon Vima” dhe tek “Observer”, të gjithë thelbin e kishte në frikën e gllabërimit të Shqipërisë nga Jugosllavia, si dhe provokimeve të ngritura kundër Greqisë dhe Organizatës së Kombeve të Bashkuara.”¹⁴⁴

Pas nënshkrimit të këtij Traktati do të hapet rruga edhe për një sërë marrëveshjesh të tjera ekonomike mes dy vendeve. Traktati më i rëndësishëm ishte Traktati Ekonomik i

¹⁴⁰ Milovan Gjilas, *Vlast I Pobuna*, Beograd, 1991, f.91.

¹⁴¹ AQSH, F. 14/AP, OU, viti 1947, D.1, fq.111. *Diskutim i Enver Hoxhës në Plenumin VII të KQ të PKSH, mbajtur më datën 30 gusht të vitit 1947, në të cilin citon thënien e Stalinit gjatë bisedimeve të zhvilluara me të në Moskë*

¹⁴² Kastriot Myftaraj, *Enigmat e sundimit të Enver Hoxhës 1944-1961*, vëll.II, Tiranë, Botimet: PLEJAD, 2009, f.105.

¹⁴³ V. Dedijer, *Marrëdhëniet shqiptaro-jugosllave...*, f.143.

¹⁴⁴ *Po aty*, f.144.

firmosur në vitin 1946. Ky traktat konsistonte në pikat më kyç të një vendi, të cilat ishin: krijimi i një agjencie për koordinimin e planifikimit ekonomik të të dy vendeve, njehsimin e monedhave të lekut dhe dinarit, çdo ndihmë ekonomike për Shqipërinë të kalonte nga Beogradi, në tregjet shqiptare të aplikoheshin çmimet e tregut jugosllav, heqja e zyrave doganore kufitare, duke unifikuar në këtë mënyrë sistemin doganor, si edhe krijimin e një Komisioni të Përbashkët Doganor Shqiptaro-Jugosllav me qendër në Shqipëri, me qëllim mbikëqyrjen e kësaj zone doganore. Morinë e iniciativave të asaj kohe e pasoi Marrëveshja për Bashkëpunimin Ekonomik të 28 nëntorit 1946, e cila parashikonte një periudhë tridhjetëvjeçare të organizimit të kompanive shqiptaro-jugosllave për burimet natyrore të Shqipërisë, për linjën hekurudhore, energjetikën, lundrimin, import-eksportin dhe Bankën Shqiptaro-Jugosllave. Në këtë marrëveshje ishte rënë dakord për përgatitjen në Jugosllavi të specialistëve për bujqësinë dhe industrinë shqiptare, një kredi jugosllave për blerje makinerish dhe pajisjesh, si edhe formimin e ndërmarrjeve të përbashkëta me opsionin që shqiptarët, në fund të tridhjetë viteve të mund t'i blinin aksionet jugosllave.

Të gjitha këto traktate dhe marrëveshje nënkuptonin nënshtrimin total të Shqipërisë nën epërsinë jugosllave. “Nga çdo lloj këndvështrimi që mund të shihen këto marrëveshje, Jugosllavia thjesht do të hante kafshatën e madhe, ndërsa Shqipërisë i mbeti vetëm të kënaqej nga thërrimet që ata do t’i ofronin. Kjo nuk mund të konsideroj si një marrëveshje reciproke, kur Jugosllavia shfrytëzonte pamasë dhe në mënyrë të pamëshirshme resurset e Shqipërisë, dhe në këmbim ofrohej vetëm drithëra të kufizuara, armë e teknologji të vjetra, si dhe artikuj të zhvlerësuar. Titoja diti ta kapte shumë mirë vakumin e krijuar në ekonominë shqiptare mbas tërheqjes së strukturave italiane, gjermane, angleze dhe amerikane.¹⁴⁵ Enver Hoxha nuk e mendoj se bashkëpunimi ekonomik është një strategji kombëtare, dhe se në këtë mes ai që fitoi ishte vetëm Titoja. Siç e vërente edhe studiuesi amerikan Byrnes, kur shkruante: “... për të gjitha arsyet praktike, ekonomia shqiptare u bë pjesë dhe parcelë e ekonomisë jugosllave”.¹⁴⁶ Por për këtë çështje, edhe vetë Enver Hoxha shprehet në librin e tij “Titistët” se “E ashtuquajtura ndihmë ekonomike ishte thjesht sinonimi i përpjekjeve dhe synimeve djallëzore të titistëve për ta kthyer Shqipërinë në një apendiks të ekonomisë jugosllave dhe nën zinxhirët e një skllavërie të re”.¹⁴⁷ Por për t’u mos u mjaftuar vetëm me projektet ekonomike që Jugosllavia kishte ndaj Shqipërisë, ata po zgjerorin edhe strategjinë e kontrollit, përgatitjes dhe nënshtrimit të plotë të burimeve njerëzore, duke dhënë bursa për studentët shqiptarë që të studionin në shkollat jugosllave dhe duke u përpjekur të fusnin për herë të parë gjuhën jugosllave në shkollat shqiptare.

Në vitin 1946, bashkëpunimi intensive i marrëdhënieve shqiptaro-jugosllave ishin shënuar edhe në fushën e sigurisë dhe të punëve të brendshme midis dy shteteve. Lidhur

¹⁴⁵ Lisen Bashkurti, *Diplomacia shqiptare në fillimet e Luftës së ftohtë, 1945-1961*, Tiranë, Botimet: “Geer”, 2003, f.135.

¹⁴⁶ *Po aty*, f.136.

¹⁴⁷ L. Bashkurti, *Diplomacia shqiptare...*, f.136.

me këtë bashkëpunim, i cili mund të kualifikohet edhe si ndërhyrje brutale e Jugosllavisë në çështjet e sigurisë së brendshme dhe të sistemit të sigurisë e fshehtësisë shtetërore të Shqipërisë, janë me interes referimet në komunikim përmes radiogramave midis Koçi Xoxit, ministër i Brendshëm i Shqipërisë, dhe Aleksandër Rankoviçit, ministër i Brendshëm i Jugosllavisë. Aleksandër Rankoviç, në radiogramin e datës 24 janar 1946, dërguar Koçi Xoxes, duke e njoftuar për saktësim informatash agjente konfirmonte: “Sipas njoftimeve... disa ish-bajraktarë të fiseve shqiptare bisedojnë midis njerëzve të tyre për një kryengritje me armë në pranverë në Shqipërinë e Veriut... Na lajmëroni nëse janë të vërteta njoftimet e mësipërme”.¹⁴⁸ Ndërkohë, në radiogramin e datës 12 prill Koçi Xoxe e informonte Rankoviçin për lëvizjet në planin e sigurisë: “Porsa kemi arrestuar një dezertor të ushtrisë sonë që kalonte kufirin duke ardhur nga Greqia... Interesant është se ai deklaroi të ketë lidhje me informatorë në territorin jugosllav...”.¹⁴⁹ Në radiogramet e datave 5, 12 dhe 15 maj 1946, dërguar Rankoviçit, Koçi Xoxe kërkonte mendimin e tij konkret lidhur me mënyrën e organizimit të shërbimit të sigurimit sekret shqiptar, duke iu drejtuar me fjalët: “Ju lutem të më përgjigjeni si mendoni ju të rregullohet kjo çështje, sepse ne kemi problemin e buxhetit të Ministrisë sonë të Brendshme”.¹⁵⁰

Më 30 tetor 1945 vjen në Tiranë Josip Gjergja (me origjinë arbëreshe), me detyrën e ambasadorit të RPF të Jugosllavisë. Pas njohjes jo të plotë ndërkombëtare të qeverisë shqiptare, pra në fund të vitit 1945 dhe në fillim të vitit 1946, Shqipëria ishte orientuar për marrëdhënie sa më të afërta me Jugosllavinë dhe BRSS, duke u larguar kështu nga kursi i politikës së jashtme diplomatike edhe me shtetet e Perëndimit. Me këtë orientim të politikës së jashtme, shteti shqiptar dhe udhëheqja e PKSh-së përfundimisht kishin mbetur në orbitën lindore dhe po i hapnin rrugë izolimit të gjatë nga rrjedhat e shoqërive perëndimore. Megjithatë, përfaqësuesit e PKJ nuk mjaftoheshin me këtë nivel të marrëdhënieve shqiptaro-jugosllave, por të shtyrë nga politika e diktatit mbi palën shqiptare dhe, në radhë të parë në udhëheqjen e PKSh, në fillim të vitit 1946 po i shprehnin pakënaqësitë e tyre ndaj udhëheqësve shqiptarë, të cilëve u bëhej vërejtje se, edhe pse e çmonin ndihmën ekonomike të Jugosllavisë, nuk i kryenin obligimet e tyre ndaj Jugosllavisë. “Udhëheqjes partiake shqiptare iu përshkrua si gabim edhe fakti pse shtypi shqiptar, përveç gazetës “Bashkimi”, organ i Frontit Demokratik të Shqipërisë, nuk shkruante as sa duhej për Jugosllavinë apo pse ndaj ngjarjeve sillej si vëzhgues neutral. Ndër dobësitë radhitej edhe fakti i mos botimit të fjalimeve të Titos në tërësi dhe mos komentimi i fjalimeve të tij.”¹⁵¹ Kritikta jugosllave ndaj palës shqiptare shkonin edhe deri aty sa udhëheqja partiake dhe ajo shtetërore e Shqipërisë kritikohej madje edhe për mos informim të mjaftueshëm të saj për rrethanat në Jugosllavi.

¹⁴⁸ AMB, Dosja.1623/9.

¹⁴⁹ Po aty.

¹⁵⁰ Po aty.

¹⁵¹ Branko Petranoviç, *Balkanska Federacija 1943-1948*, Beograd, 1991, f.149.

Historiani dhe njohësi i mirë i marrëdhënieve shqiptaro-jugosllave, Branko Pribicevic, në trajtimin e kësaj çështjeje vlerëson se “Prej këtyre keqkuptimeve dhe pakënaqësive të fshehura, megjithatë fshihej divergjenca e thellë e shprehur në pakënaqësinë e Enver Hoxhës, në lidhje me statusin e Kosovës, i cili nuk u zgjidh në favor të Shqipërisë ashtu si ishte pritur, si dhe pakënaqësia personale e tij ndaj Velimir Stojnicit, i cili, sipas Hoxhës, e favorizonte Koçi Xoxen në llogari të tij”.¹⁵² Dyshimet e jugosllavëve ndaj palës shqiptare, në lidhje me mungesën e një përcaktimi edhe më të fuqishëm të udhëheqjes shqiptare ndaj modelit jugosllav shkonin deri aty sa pala jugosllave paraqitej e habitur se pse udhëheqja e PKSh-së nuk e pranonte më me entuziazëm ndihmën ekonomike, politike, ushtarake dhe kulturore të jugosllavëve. Ata kishin ngritur shqetësime edhe lidhur me atë pse udhëheqja shqiptare nuk mbështetej më tepër në përvojat e modelit jugosllav të ndërtimit të socializmit, sidomos pse nuk kërkonte vetë mbështetje më të madhe të Jugosllavia. Emisari jugosllav Velimir Stojnicit, diku është shprehur për udhëheqjen shqiptarese, “Pa Jugosllavinë ju nuk mund ta mbani pushtetin... Perspektiva e Jugosllavisë është perspektiva e kreu Ballkanit... Emri i Titos është simbol içlirimit të popujve nga reaksioni i fashizmit”¹⁵³. Edhe në fund të vitit 1945, diplomacia jugosllave, përmes përfaqësuesve të saj në Tiranë, shprehte pakënaqësi për orientimin e tillë të qeverisë shqiptare, duke konstatuar se “Shqipëria, në vend të orientimit nga Perëndimi duhet vendosmërisht dhe pa dilema të orientohet nga Lindja, Jugosllavia, Ballkani demokratik dhe BRSS. Shqiptarët janë lëshuar në spekulimet e rrezikshme dhe jo principale të Perëndimit me parullën ‘çdo gjë për pranimin ndërkombëtar të vendit tonë’.”¹⁵⁴

Me ftesën e Titos, nga 23 qershori deri më 2 korrik 1946, një delegacion i madh qeveritar shqiptar me E. Hoxhën në krye shkoi në Jugosllavi. Sipas E. Hoxhës, në bisedimet me Titon u trajtuan edhe çështjet të brendshme partie, për ndihmën e madhe që kishin dhënë përfaqësuesit jugosllavë pranë KQ të PKSh, si dhe për gabimet e disa prej tyre, sidomos Velimir Stojnić, në Plenumin e Beratit të vitit 1944 dhe pas tij. Sipas E. Hoxhës, për të gjitha mendimet e shfaqura Tito kishte qenë dakord. Duke pranuar edhe gabimet e përfaqësuesve jugosllavë, ai kishte porositur që partia shqiptare të “sigurojë unitetin dhe kompaktësinë” dhe kjo duhet të bëhet nga “sekretari i përgjithshëm i partisë”,¹⁵⁵ domethënë nga vetë Enver Hoxha.

Ndërsa ambasadori jugosllav në Shqipëri, Josep Gjergje, pjesëmarrës në bisedimet Tito – Enver në Beograd, shpreh një opinion tjetër. Në takimin me ambasadorin sovjetik Çuvahin ai nënvizonte se Tito i kishte deklaruar Hoxhës se, “në Konferencën e Beratit (plenumi i Beratit, nëntor 1944) jo gjithçka ishte keq (siç thotë për të E. Hoxha). Kjo konferencë mundi të zbuloi shumë mangësi në punën e partisë shqiptare dhe gabime të

¹⁵² *Po aty*.

¹⁵³ Bashkim Shehu, “*Liri Belishova dhe koha e saj*”, Tiranë, Botimet: UET, 2020, f.44.

¹⁵⁴ A. Zogaj, *Marrëdhëniet shqiptaro-jugosllave...*, f.113.

¹⁵⁵ *Shqipëria në dokumentet e arkivave ruse...*, përgatitën I. Lauka & E. Ymeri, f.126.

udhëheqjes së saj. E meta e Beratit ishte se kjo konferencë, pasi verifikoi gabimet e partisë dhe pasi zbuloi mungesat e punës së saj nuk mundi të përcaktonte rrugët për korrigjimin e tyre. Edhe këtu, sipas mendimit të Titos, përfaqësuesit e Partisë Komuniste Jugosllave u treguan në lartësinë e detyrave të veta. Tito e këshilloi E. Hoxhën të arrinte unitetin në KQ të PKSh, duke theksuar se e gjithë përgjegjësia për gjendjen në vend dhe në parti bie tërësisht mbi sekretarin e parë të partisë”,¹⁵⁶ domethënë mbi vetë Enver Hoxhën.

Gjatë qëndrimit në Beograd, E. Hoxha zhvilloi bisedime të gjata me Titon. Megjithëse në dokumentet arkivore për bisedimet e zhvilluara nuk rezulton ndonjë protokoll, karakteri i tyre evidentohet nga rrëfimi që E. Hoxha i bëri ambasadorit sovjetik Çuvahin më 3 korrik, menjëherë pas vizitës. Sipas tij, me Titon ishin biseduar të gjitha çështjet ushtarake, me interes të përbashkët për të dy vendet dhe për përfundimin e Traktatit të Miqësisë dhe të Ndhmës Reciproke. Tito ishte interesuar për gjendjen, dislokimin, armatimin dhe furnizimin e ushtrisë shqiptare. Ai kishte porositur për “forcimin e kufijve jugorë me Greqinë e të bregdetit”, për forcimin e mbrojtjes “në rajonin e Vlorës, veçanërisht të Sazanit e të Kepit të Karaburunit dhe rajonit të Sarandës”, në mënyrë që kjo mbrojtje të arrijë të pengojë në njëfarë mase desantimin e forcave të armikut. Nga ana tjetër, premtoi ndihmën e Shtabit të Përgjithshëm jugosllav dhe dërgimin e disa specialistëve ushtarakë (jo zyrtarisht) për organizimin dhe ndërtimin e mbrojtjes bregdetare. Gjithashtu, u arrit marrëveshja për “krijimin e delegacioneve të përbashkëta ushtarake: të atij shqiptar pranë Shtabit të Përgjithshëm Jugosllav dhe atij jugosllav pranë Shtabit të Përgjithshëm Shqiptar”¹⁵⁷.

Bisedën e E. Hoxhës me Titon për çështjen e Kosovës e konfirmon edhe ambasadori jugosllav J. Gjergja, në takimim me ambasadorin Çuvahin më 5 korrik 1946. Duke i shfaqur edhe mendimin e tij ambasadorit Çuvahin, ai thekson se “do të ishte fatkeqësi, në qoftë se kjo krahinë do t’i aneksohej Shqipërisë”. Sipas tij, “bashkimi i Kosovës dhe Metohisë me Shqipërinë do të kishte pasoja fatale për çështjen e paqes në Ballkan”.¹⁵⁸ Sipas bisedës së zhvilluar me ambasadorin sovjetik Çuvahin, pas kthimit nga Beogradi, E. Hoxha në takimim me Titon kishte ngritur edhe çështjen e së ardhmes së Kosovës dhe të Metohisë. Tito kishte shfaqur mendimin e tij se “as për qeverinë shqiptare, as për qeverinë jugosllave nuk ishte e volitshme të shtrohet çështja e bashkimit të kësaj krahine me Shqipërinë”. Sipas tij, kjo krahinë “në kohën e vet do të bashkohet me Shqipërinë, por kjo është e mundshme vetëm atëherë kur edhe Shqipëria, edhe Jugosllavia do të jenë shtete socialiste”.¹⁵⁹ Ngritjen e kësaj çështjeje Tito e vlerësoi si dobësim të

¹⁵⁶ *Shqipëria dhe Kosova në arkivat ruse...*, përgatitën H. Kaba & E. Çeku, f.32.

¹⁵⁷ *Shqipëria në dokumentet e arkivave ruse...*, përgatitën I. Lauka & E. Ymeri, f.122.

¹⁵⁸ *Shqipëria dhe Kosova në arkivat ruse...*, përgatitën H. Kaba & E. Çeku, f.32.

¹⁵⁹ *Shqipëria në dokumentet e arkivave ruse...*, përgatitën I. Lauka & E. Ymeri, f.128-129.

pozitive të qeverisë jugosllave, sidomos të Serbisë, ndërkohë që nuk e forconte situatën ndërkombëtare të Shqipërisë.

I gjetur nën trysinë jugosllave, por edhe për t'u imponuar me orientimin pro forcimit të marrëdhënieve me Jugosllavinë, në referatit e Plenumit të 5-të Enver Hoxha ekspozoi pikëpamjet e veta edhe në lidhje me Kosovën. Paraqitja e tij rreth çështjes së Kosovës ishte në frymën e marrëveshjeve bilaterale me udhëheqësit jugosllavë, marrëveshje kjo e konfirmuar në bisedimet me rastin e vizitës së Enver Hoxhës në Jugosllavi, në qershor-korrik 1946. Rreth kësaj teme ai ishte i prerë dhe nuk linte hapësira për diskutim apo dialog: “Disa anëtarë partie që duan të filozofojnë thonë se mos kërkojë populli ç’bëhet me Kosovën. Në rast se një anëtar partie e ka të qartë vijën, ai e ka të qartë edhe çështjen e Kosovës. Jugosllavia demokratike është më e avancuar, më e përparuar se ne. Interesi ynë është që ajo të jetë e fortë, se me një Jugosllavi të fortë do të ketë demokraci në Ballkan. A është në interesin tonë të kërkojmë Kosovën? Kjo nuk është progresiste.”¹⁶⁰

Gjatë qëndrimit në Jugosllavi, përveç Beogradit Enver Hoxha vizitoi edhe Kroacinë e Slloveninë, por për çudi nuk vizitoi Kosovën dhe nuk u takua me asnjë nga udhëheqësit kosovarë të asaj kohe, si Fadil Hoxhën, Ymer Pulën, Xhavit Nimanin etj. “Në përfundim të vizitës u nënshkrua marrëveshja e Bashkëpunimit Ekonomik dhe u ra dakord të përfundohej Traktati i Miqësisë dhe Ndhmës Reciproke në mes të dy vendeve.”¹⁶¹ Me këtë vizitë, e cila aprovohej edhe nga BRSS, qeveria dhe përgjithësisht politika e jashtme jugosllave kishte siguruar realizimin pa pengesa të kursit të ri të politikës së jashtme shqiptare për modelin dhe konceptin jugosllav të ndërtimit të shtetit. Nga ana tjetër, tanimë ishin eliminuar pengesat dhe fraksionet e brendshme partiake dhe shtetërore shqiptare që synonin ngadalësimin e afrimit të Shqipërisë me Jugosllavinë, siç ishte rasti i Sejfulla Malëshovës e më vonë edhe Naku Spiros, rishikimin kritik të bashkëpunimit të njëanshëm dhe jo të barabartë ndërshtetëror midis Shqipërisë dhe Jugosllavisë. Me këtë vizitë po forcohej pozita udhëheqëse e Enver Hoxhës, edhe pse në dëm të interesave të shtetit shqiptar, por gjithashtu po forcohej edhe pozita kyç politike e Koçi Xoxes, të cilin, megjithatë Enver Hoxha nuk e kishte marrë në përbërje të delegacionit gjatë vizitës në Jugosllavi. Nexhmije Hoxha, në kujtimet e saj për vizitën e parë të Enver Hoxhës në Jugosllavi, shkruante: “Pas mbarimit të kësaj vizite dhe nga ato që bënë jugosllavët në drejtim të “unifikimit” ekonomik, mund të themi, edhe ushtarak, Enveri u kthye me përshtypjen më të përforcuar se diçka po ndodhte, diçka më e madhe, sidomos në fushën politike. Jugosllavët po bëheshin gjithnjë e më arrogantë ndaj nesh.”¹⁶²

Politika sovjetike ndaj Shqipërisë, duke e vendosur nën “kujdestarinë” jugosllave dhe porosia e Stalinit dhënë Titos “për ta çuar Shqipërinë sa më afër Jugosllavisë”, u

¹⁶⁰ AQSH. F.14/AP, dosja 4, v.1946.

¹⁶¹ Gazeta *Bashkimi*, Tiranë, 7 gusht 1946.

¹⁶² Nexhmije Hoxha, *Jeta ime me Enver Hoxhën*, Tiranë, 1989, f.195.

konkretizua me institucionalizimin e marrëdhënieve shqiptaro-jugosllave, duke nënshkruar mbi 33 traktate, marrëveshje dhe protokolle ekonomike, politike, sociale, ushtarake etj., të cilat e forcuan dhe e bënë të gjithanshëm bashkëpunimin. Mjafton njohja me një pjesë të këtyre akteve, për të kuptuar nivelin dhe thellësinë e marrëdhënieve shqiptaro-jugosllave.

Traktati i Miqësisë dhe Ndihmës Reciproke ndërmjet Shqipërisë dhe Jugosllavisë u nënshkrua në Tiranë, më 9 korrik 1946, duke hapur rrugën për nënshkrimin e një varg marrëveshjesh të tjera ndërmjet të dy vendeve. Ky traktat kishte si objekt forcimin më tej të marrëdhënieve në mes dy vendeve, masa të përbashkëta për sigurimin e pavarësisë, si dhe lidhje ekonomike e kulturore reciproke sipas marrëveshjeve përkatëse. Ashtu siç porosiste Stalini, thelbi i bisedimeve ishte arritja e një marrëveshjeje të gjithanshme, për sa i përket bashkëpunimit ekonomik midis të dy vendeve dhe forcimin e këtyre lidhjeve në të gjitha fushat. Përmbajtja e bisedimeve u pasqyrua në këtë traktat, i cili u bë bazë bashkëpunimi, burim e referim për të gjitha traktatet, marrëveshjet e protokollet e nënshkruara më vonë ndërmjet Shqipërisë dhe Jugosllavisë.

Marrëveshja mbi Bashkëpunimin Ekonomik, e nënshkruar në qershor të vitit 1946, “ishte marrëveshja më e rëndësishme në fushën ekonomike, thelbi i së cilës ishte forcimi i bashkëpunimit nëpërmjet organizimit e funksionimit të shoqërive të përbashkëta shqiptaro-jugosllave”.¹⁶³ Në bazë të kësaj marrëveshjeje, u organizuan shoqëritë e përbashkëta, të cilat përfshinin të gjitha fushat dhe sektorët e ekonomisë shqiptare. Marrëveshja përfshinte akordin mbi formimin e një shoqërie shqiptaro-jugosllave për ndërtimin dhe shfrytëzimin e udhëve të hekurta; akord për formimin e shoqërisë shqiptaro-jugosllave për kërkimin dhe shfrytëzimin e minierave; akord mbi formimin e një shoqërie shqiptaro-jugosllave të elektrikut; akord mbi themelimin Bankës Shqiptaro-Jugosllave, i cili ishte edhe një ndër akordet më të rëndësishme.

Krahas marrëveshjes tregtare, me propozim të Boris Kidriçit, Kuvendi Popullor i Jugosllavisë i dha Republikës Popullore të Shqipërisë kredi në një lartësi prej dy miliardë dinarësh pa kamatë dhe pa afat të caktuar të kthimit. Sipas fjalëve të Kidriçit, kjo kredi me kushte aq të volitshme iu dha Shqipërisë edhe me qëllim që të kompensohen humbjet e saj, të cilat si vend më pak i zhvilluar do të mund t’i kishte në marrëdhëniet ekonomike me Jugosllavinë, si vend më të zhvilluar. Këtë propozim dhe arsyetim e aprovoi unanimisht Kuvendi Popullor i Jugosllavisë, megjithëse marrëdhëniet ekonomike ndërmjet Shqipërisë dhe Jugosllavisë nuk ishin të tipit të vjetër për nga forma, përmbajtja dhe esenca, sepse shkëmbimi reciprok i mallrave nuk bëhej në bazë të “çmimeve botërore”, por në bazë të shpenzimeve reale të prodhimit”.¹⁶⁴ Marrëveshja u nënshkrua në Beograd më 12 qershor 1947 dhe “kredia do të përdorej nga qeveria shqiptare për interesat ekonomiko-financiare

¹⁶³ V. Dedijer, *Marrëdhëniet Shqiptaro-Jugosllave...*, f.39.

¹⁶⁴ Panajot Plaku, *Dhuna ndaj revolucionit në Shqipëri*, Prishtinë, 1985, f.68.

të vendit, por do të paguhej me mallra tregtie të konsumit të gjerë, si dhe materiale shërbimi për investime, të akorduara nga pala jugosllave”.¹⁶⁵

Konventa Ekonomike, e nënshkruar më 27 nëntor 1946, shënoi një stad të ri më të lartë bashkëpunimi ndërmjet të dy vendeve, me tendencë shtimin e varësisë së Shqipërisë nga Jugosllavia. Në nënshkrimin e marrëveshjes së kësaj konvente mes Shqipërisë dhe Jugosllavisë, ndër të tjera ritheksohej: “Me këtë konventë, RFD e Jugosllavisë merr barrën për t’i ofruar një përkrahje të gjerë dhe një ndihmë të konsiderueshme në fushën e mjeteve të prodhimit dhe të tjera RP të Shqipërisë, me qëllim ngritjen ekonomike të saj më të shpejtë e me efikase”.¹⁶⁶ Nënshkrimi i Konventës Ekonomike synonte koordinimin e planeve, bashkëpunimin doganor dhe barazimin e monedhave.

Objekti i Konventës Ekonomike ishte “koordinimi i planeve ekonomike, nëpërmjet krijimit të organeve të përbashkëta të koordinimit; njësimi të lekut shqiptar me dinarin jugosllav; furnizimit të Shqipërisë me mallra e material për realizimin e planit ekonomik; vendosjes së sistemit të çmimeve me bazë çmimet jugosllave, si dhe heqjes së kufijve doganorë dhe doganës, duke krijuar një territor doganor të përbashkët”.¹⁶⁷

Qëllimi i Konventës Ekonomike ishte planifikimi i përbashkët i ekonomisë dhe integrimi i planeve ekonomike të Shqipërisë në planet jugosllave. Zbatimi i kërkesave të kësaj marrëveshjeje filloi të konkretizohet në hartimin e planit ekonomik të vitit 1947 dhe projektplanin pesëvjeçar 1947-1951. Plani i vitit 1947 u hartua të investohej 70 për qind nga Shqipëria dhe 30 për qind nga Jugosllavia, ashtu siç veprohej me çdo republikë jugosllave. Si për planin njëvjeçar, ashtu edhe për projektplanin pesëvjeçar, drejtimet kryesore u dhanë nga Komisioni i Planit të Shtetit Jugosllav. Një drejtim tjetër shumë i rëndësishëm i bashkëpunimit dypalësh ishte edhe ai në fushën ushtarake. Në vitet e para pas çlirimit, si në të gjitha fushat e tjera edhe në fushën ushtarake partneri kryesor i Shqipërisë ishte Jugosllavia dhe ushtria jugosllave. Ajo luante rolin parësor në mbështetjen e Ushtrisë Kombëtare të Shqipërisë. Jugosllavia kishte specialistët e vet ushtarakë pranë Ministrisë së Mbrojtjes, kryesisht në Drejtorinë Politike, por edhe në njësi e reparte. Ndikimi dhe bashkëpunimi me ushtrinë jugosllave ishte më i konkretizuar në sferën politike, atë të agjitacionit e të propagandës. Siç pohonte ambasadori sovjetik në Shqipëri, Çuvahin, “e gjithë puna politike në ushtrinë shqiptare konsistonte në faktin që mbi 75 për qind e gjithë kohës së punës politike iu kushtohej temave jugosllave, ushtria shqiptare edukohej kryesisht me materiale jugosllave, me artikujt e Titos, Kardelit etj.”¹⁶⁸ Ndërsa

¹⁶⁵ *AQSH*, F. 14/AP, MPKJ, viti 1947, D.7, fl.22. Marrëveshja mbi kredin prej dy miliard dinar për rimbëkëmbjen ekonomike të RPSH.

¹⁶⁶ *Gazeta Borba*, 11 dhjetor 1946.

¹⁶⁷ *AQSH*, F. 14/AP, OU, viti 1946, D.4/1, fl.9-40. *Mbledhje e jashtëzakonshme e plenumit të KQ të PPSH, më 18-20 dhjetor të vitit 1946, pët të shqyrtuar marrëveshjen mbi Konventën Ekonomike midis Shqipërisë dhe Jugosllavisë.*

¹⁶⁸ *Shqipëria dhe Kosova në arkivat ruse...*, përgatitën H. Kaba & E. Çeku, f.77.

ndikimi jugosllav më pak i ndjeshëm ishte në Shtatmadhori dhe në strukturat ushtarake, pasi në këto struktura ndodheshin edhe disa këshilltarë sovjetikë. Siç shihet nga kërkesa dhe procedurat e zbatimit të Konventës Ekonomike dhe marrëveshjeve e protokolleve të tjera, Jugosllavia synonte përfshirjen e Shqipërisë në Federatën Jugosllave, si një nga republikat e saj. Nëpërmjet institucionalizimit të marrëdhënieve shqiptaro-jugosllave me traktate, marrëveshje e protokolle të shumta, Jugosllavia ia arriti që Shqipëria të lidhej e të kishte bashkëpunim me botën vetëm nëpërmjet këtij vendi.

Në lidhje me marrëveshjet ekonomike që u bënë midis dy vendeve, në mbledhjen e Presidiumit të Kuvendit Popullor E. Hoxha u shpreh se “Gjithë ky bashkëpunim midis dy vendeve theksohet se ka ndodhur për shkak të luftës se tyre të përbashkët kundrejt nazi-fashizmit. Por ne kemi luftuar edhe përkrah vendeve të tjera, por me ato nuk kemi traktate të ngjashme”.¹⁶⁹ Në diskutimin e tij në Plenumin e 5-të të KQ të PKSh, më 22 shkurt 1946, Dali Ndreut shprehet se “Ne bëjmë një politikë që frymëzohet nga Jugosllavia dhe Bashkimi Sovjetik, por ne duhet të bëjmë një politikë nacionale të adoptuar nevojave dhe konditave të vendit”.¹⁷⁰

Edhe vetë Titoja ndoqi në mënyrë rigorozë politikat staliniste brenda vendit. Por, për sa i përket politikës të jashtme të Titos, ai ishte shumë i pavarur për shijen e Stalinit.¹⁷¹ Titoja e dinte që për Ballkanin “strategjitë e trashëguara të Jugosllavisë bazoheshin në doktrinat e vjetra të Rusisë Cariste, që prej fundit të shekullit të 18-të dhe gjatë shekullit të 19-të”.¹⁷² Në këtë formë ai vendosi të ndjekë po këtë strategji, duke u munduar të krijonte struktura gjithëpërfshirëse në Ballkan. Studiuesi Dusko Doder për këtë strategji shprehet se: “Jugosllavët punuan për të krijuar Federatën Komuniste Ballkanike nën udhëheqjen e Titos, e cila synonte të përfshinte Jugosllavinë, Bullgarinë, Shqipërinë dhe mundësisht Greqinë. Vukmanovic – Tempo, njëri prej bashkëpunëtorëve të Titos, i cili përfaqësoi Partinë Komuniste Jugosllave në Shqipëri, deklaroi botërisht në televizionin e Beogradit se “Manifesti për krijimin e Konfederatës Ballkanike që shkruar nga dora e Hoxhës, dhe se origjinali i këtij dokumenti ruhej në arkivin e Komitetit Qendror të Partisë Komuniste Jugosllave”.¹⁷³ Disa prej udhëheqësve kryesorë të Bullgarisë dhe Shqipërisë “e patën marrë në dorë këtë plan të Titos”.¹⁷⁴ Por Stalini ishte kundër krijimit të një Federate të tillë, jo sepse ai ishte kundër shtrirjes së komunizmit, por, siç edhe ai vetë shprehet, “në

¹⁶⁹ V. Dedijer, *Marrëdhëniet shqiptaro-jugosllave...*, f.177.

¹⁷⁰ *Marrëdhëniet shqiptaro-jugosllave...*, përgatitën N. Plasari, L. Malltezi, f.28.

¹⁷¹ L. Bashkurti, *Diplomacia shqiptare në fillimet e Luftës së Ftohtë...*, f.137.

¹⁷² *Po aty*.

¹⁷³ Amik Kasoruh, *Një ankth gjysmëshekullor, Shqipëria e Enver Hoxhës*, Tiranë, Botimet: Çabej, 1996, f.29.

¹⁷⁴ Lisen Bashkurti, *Diplomacia shqiptare në fillimet e Luftës së Ftohtë...*, f.137.

hegemonizmin ndërkombëtar hapësirat e mëdha sigurohen përmes garantimit të hapësirave të vogla”.¹⁷⁵

Koncepti mbi politikën rajonale u bë në këtë mënyrë edhe shkaku i përplasjes së interesave të Stalinit dhe Titos. Pavarësia e Titos dhe synimit që ai kishte filluan të bëheshin shqetësuese për Bashkimin Sovjetik. Studiuesi Doder shprehet se “Jugosllavët ishin të bindur se politika e tyre ishte në të mirën e komunizmit botëror, por rusët ishin duke depërtuar në të gjitha organizatat kyç dhe kishin si synim ta zëvendësonin Titon dhe përkrahësit e tij me njerëz më të nënshtruar”.¹⁷⁶ Ndërsa Kissinger, në librin e tij “Diplomacia” shprehet për Stalinin se “atij asnjëherë nuk i pëlqente të zbatonte një politikë të re me njerëz që i kishte përdorur më parë për të ndjekur një kurs tjetër, edhe nëse ata i kishin ndjekur në mënyrë të verbër direktivat e tij, bile aq më tepër në një rast të tillë”.¹⁷⁷ Tërheqja e këshilltarëve rusë nga Jugosllavia në vitin 1948 ishte një shenjë kërcënuese për prishjen e marrëdhënieve dypalëshe Beograd-Moskë. Në letrat e Stalinit kundër Titos përmenden shumë çështje, prej të cilave Bashkimi Sovjetik ishte i pakënaqur, për të mos thënë i zhgënjyer nga Tito. Akuzat ndaj tij si trockist, pikëpamjet nacionaliste, injorimi i rolit të komunistëve rusë dhe ushtrisë sovjetike në çlirimin e Jugosllavisë, si dhe babëzia e tij për të gllabëruar të gjitha vendet komuniste të Ballkanit dukeshin se vinin më shumë prej “frikës” se mos Moskës e humbte mundësinë për nënshtrimin e lëvizjen komuniste në mbarë Europën Lindore.

Etapa e tretë nis pikërisht me fillimin e konfliktit dhe prishjen e marrëdhënieve dypalëshe Shqipëri-Jugosllavi. Me hyrjen e vitit 1947, Tirana filloi gradualisht të krijonte një mendim më të pavarur për planet e zhvillimit ekonomik midis dy vendeve. Por kjo përpjekje e tyre u pasua me një akuzë me shkrim nga Tito, i cili i akuzoi ata për krijimin e një vije anti-jugosllave në radhët e saj. Mospranimi i projektplanit pesëvjeçar të propozuar nga Beogradi shënoi edhe një hap tjetër drejt këtij konflikti.

Udhëheqja komuniste shqiptare i mbikëqyri me kujdes problematikat dhe divergjencat midis Beogradit dhe Moskës dhe, sipas disa dokumenteve të botuara të PKSh-së, Enver Hoxha e informoi Stalinin për vështirësitë dhe për nënshtrimin total të Shqipërisë ndaj Jugosllavisë. Por kur Shqipëria po ‘falej’ te Bashkimi Sovjetik, është për t’u çuditur fakti se “Beogradi kishte të njëjtat qëllime dhe përdorte të njëjtat metoda për nënshtrimin e Tiranës, sikundër Moskës për nënshtrimin e Beogradit”.¹⁷⁸ Kjo ngjashmëri nuk mund ta bënte më të lehtë mbijetesën tonë nga shiu në breshër. Gjatë një delegacioni në Moskë, ku shkoi personalisht për t’u takuar me Stalinin edhe vetë Enver Hoxha, ata morën iniciativën për bashkëpunime ekonomike shqiptare të pavarura me Bashkimin Sovjetik, porsa ky fakt

¹⁷⁵ *Po aty*, f.139.

¹⁷⁶ *Po aty*, f.140.

¹⁷⁷ *Po aty*, f.141.

¹⁷⁸ L. Bashkurti, *Diplomacia shqiptare në fillimet e Luftës së Ftohtë...*, f.142.

i acaroi edhe me tej marrëdhëniet shqiptaro-jugosllave. Por diplomacia jugosllave ishte mësuar me një Shqipëri të nënshtruar dhe kokulur dhe, në këtë formë nuk mund të lejonte që rruga e shqiptarëve në Moskë të mos kalonte përmes Beogradit, që Shqipëria të merrte iniciativa ndërkombëtare të pavarura nga Beogradi. Këtë faktor e vë në dukje edhe ambasadori i Jugosllavisë në Moskë, përgjatë një proteste në vitin 1947, ku ai shprehet se “Ne nuk e kuptojmë se si në një kohë kur ne jemi të lidhur ekonomikisht, ju kërkoni të bëni marrëveshje të tjera ekonomike dhe tregtare? Si mund të bëni veprime të tilla, pa u konsultuar më parë me ne”.¹⁷⁹

Teoria e konspiracionit që Tito ia kishte paraqitur në terma evazive ambasadorit sovjetik në Jugosllavi, në gusht 1947, në lidhje me qëndrimet anti-jugosllave në udhëheqjen shqiptare, në fillim të nëntorit 1947 u artikulua në një qëndrim zyrtar të Komitetit Qendror të Partisë Komuniste të Jugosllavisë adresuar homologut shqiptar. Më 6 nëntor 1947, i dërguari i Komitetit Qendror të PKJ në Shqipëri, Savo Zllatic, në një bisedë me Hoxhën dhe Xoxen iu komunikoi këtyre se “Komiteti Central Jugosllav, duke e çmuar këtë situatë ndërkombëtare dhe situatën e krijuar në mes nesh, duhet të jetë vigjilent për të gjitha këto, sidomos në marrëdhëniet me Jugosllavinë, se mos ka gisht armiku.”¹⁸⁰

Në nëntor të vitit 1947, pasi Enver Hoxha u kthye nga vizita e tij në Moskë, udhëheqja jugosllave e akuzoi atë se po ndiqte haptazi një politikë anti-jugosllave, dhe se po dilte kundra vullnetit të popullit, duke të lënë të mendosh se deri në këto momente nuk ishin vetë jugosllavët ata që po shfrytëzonin në çdo lloj forme burimet njerëzore dhe ato natyrore të Shqipërisë. Pika më e nxehtë në marrëdhëniet Shqipëri-Jugosllavi ka qenë Plenumi VIII i KQ të PKSh, në shkurt-mars të vitit 1948. Në këtë plenum, i dërguari jugosllav Savo Zlatic bëri akuza dhe presion kundër udhëheqjes shqiptare, dhe mbështetësit e tij në këtë çështje ishin Koçi Xoxe dhe Pandi Kristo. Por periudha pas Plenumit VIII të KQ të PKSh ishte një periudhë akoma edhe më e errët në marrëdhëniet dypalëshe shqiptaro-jugosllave. “Titoja, i cili ishte në dijeni të marrëdhënieve të tensionuara midis Shqipërisë dhe Greqisë për çështjen e Vorio-Epirit dhe të Çamërisë, paralajmëroi për rrezikun ushtarak që i vinte nga Jugu.”¹⁸¹ Kjo vinte jo prej dashamirësisë dhe zemërgjerësisë së jugosllavëve, por sepse këta të fundit synonin që në këtë formë të dërgonin në Shqipëri dy prej divizioneve më të mëdha ushtarake jugosllave. “Në këtë formë, pushtimi ushtarak i Shqipërisë nga Jugosllavia do të bëhej fakt i kryer.”¹⁸²

Tri figurat kryesore, Hoxha–Stalin–Tito, ishin të ndryshëm, sepse secili kishte interesat vetjake, por ishin edhe të ngjashëm, sepse që të tre kishin aftësinë për ta mbrojtur me çdo mjet pushtetin e tyre nga rreziqe të brendshme apo të jashtme qofshin ato. Porse në

¹⁷⁹ *Po aty*, f.143.

¹⁸⁰ Kastriot Myftaraj, *Enigmat e sundimit të Enver Hoxhës 1944-1961*, vëll.II, Tiranë, Botimet: PLEJAD, 2009, f.148.

¹⁸¹ L. Bashkurti, *Diplomacia shqiptare në fillimet e Luftës së Ftohtë...*, f.144.

¹⁸² *Po aty*.

këtë rivalitet të krijuar, Moska ishte më e fuqishme, sepse nuk përdori vetëm autoritetin dypalësh, por edhe udhëheqjen e Informbyrosë kundër Jugosllavisë dhe Titos. Në këtë formë konflikti mori përmasa ndërkombëtare. Më 28 qershor 1948, PKJ u përjashtua nga Informbyroja, duke i shndërruar konfliktet e deriatëhershme nga të brendshme në publike. Këtë fakt Enver Hoxha e shfrytëzoi për t'i forcuar më tej marrëdhëniet me Bashkimin Sovjetik, si dhe të spastronte nga radhët e partisë kundërshtarët e tij “pro-jugosllavë”, ku midis tyre ishte edhe Koçi Xoxe. Politika e tij, siç thuhet edhe në librin e Miranda Vickers dhe James Pettifer, “kishte nisur ta integronte ekonominë e Shqipërisë dhe sistemin politik me atë të Jugosllavisë”.¹⁸³ Plenumi IX KQ që Enver Hoxha organizoi në vitin 1948 “ishte edhe kthesa ku politika e jashtme e regjimit komunist të Tiranës mori, duke u shkëputur nga vasale e Jugosllavisë në satelit të Moskës”.¹⁸⁴

1.3 Koçi Xoxe në politikën shqiptare

Koçi Xoxe lindi në vitin 1911, në fshatin Negovan afër Florinës në Greqi. Në atë kohë, vendlindja e tij ishte pjesë e vilajetit të Manastirit të Perandorisë Osmane. Disa burime tregojnë se Xoxe kishte etni maqedonase apo bullgare nga Maqedonia e Egjeut. “Kështu, ai fliste gjuhën sllave të Maqedonisë”.¹⁸⁵ Duke qenë se fshati ku kishte lindur Koçi Xoxe gjendej në atë pjesë të territorit të Greqisë, që jugosllavët pretendonin t’ia bashkonin Republikës Jugosllave të Maqedonisë pas lufte, kjo ishte një prej arsyeve që përfaqësues të udhëheqjes jugosllave, si Tempo dhe Stoiniç, mbështetën Koçi Xoxen. “Ai u shfaq në skenën e politikës shqiptare rreth vitit 1937, së bashku me Enver Hoxhën, Koço Tashkon, si liderë të komunizmit në Shqipëri. Në atë kohë, ai ishte ndër të zgjedhurit në Kuvendin e Bashkisë së Korçës. Si përkrahës i komunizmit, Xoxe u internua në fund të vitit 1938 dhe u burgos nga regjimi fashist në vitet 1941-1943.”¹⁸⁶ “Ai përdori një tunel për t’u arratisur nga burgu.”¹⁸⁷

Në fundin e Luftës së Dytë Botërore, për sa iu përket marrëdhënieve të saj të jashtme, udhëheqja shqiptare ishte e ndarë në dy kampe. “Njëri kamp përfaqësohej nga Enver Hoxha dhe Koçi Xoxe, të cilët preferonin një marrëdhënie sa më të ngushtë me Bashkimin Sovjetik dhe Jugosllavinë, ndërsa kampi tjetër përfaqësohej prej Sejfulla

¹⁸³ Miranda Vickers, James Pettifer, *Shqipëria nga anarkia në një identitet ballkanik*, Tiranë, Botimet: Toena, 1998, f.168.

¹⁸⁴ L. Bashkurti, *Diplomacia shqiptare në fillimet e Luftës së Ftohtë...*, f.147

¹⁸⁵ K. Myftaraj, *Jeta e Fshehur e Enver Hoxhës...*, f. 438.

¹⁸⁶ Kastriot Dervishi, *Sigurimi i Shtetit 1944-1991: Historia e policisë politike të regjimit komunist*, Tiranë, Botimet : "55", 2012, f. 142.

¹⁸⁷ Franko Benanti, *Lufta më e gjatë*, përktheu Luan Malaj, Tiranë, Botimet : Naimi, 2012, f. 22.

Malëshovës, i cili ishte për një politikë të jashtme të lëkundur mes Lindjes dhe Perëndimit.”¹⁸⁸

Kështu, Koçi Xoxe themeloi dhe kryesoi grupin e parë komunist të Korçës. Ai mori pjesë në mbledhjen e themelimit të Partisë Komuniste Shqiptare, duke marrë pozicionin e anëtarit të Byrosë Politike dhe Komitetit Qendror të saj. Në mars të vitit 1943, u zgjodh në mungesë sekretar organizativ i Partisë Komuniste Shqiptare. Më 10 korrik të po atij viti ai u zgjodh anëtar i Shtabit të Përgjithshëm. Në Kongresin të Përmetit, si pjesë e 188 delegatëve, Koçi Xoxe u gradua gjenerallejtënant dhe u caktua zëvendës-president i KANÇ-it.

Në Plenumin e Beratit, nëntor 1944, Koçi Xoxe luajti një rol të rëndësishëm. Në këtë plenum u përpunuan drejtimet themelore të ndërtimit socialist. “Koçi Xoxe kishte kritikuar Enver Hoxhën, Ymer Dishnicën dhe Sejfulla Malëshovën, si shumë intelektualë dhe kundër klasës proletare, dhe se Enver Hoxha, sipas tij kishte një qëllim pajtues ndaj Ballit Kombëtar.”¹⁸⁹ Gjatë Plenumit të 5-të, Xherxha, një përfaqësues i udhëheqjes jugosllave, kishte takuar Enver Hoxhën dhe Koçi Xoxen, të cilët, sipas tij i kishin shprehur dëshirën për të pasur marrëdhënie sa më të thella me Jugosllavinë. Për këtë qëllim, midis të tjerash Xherxha thotë se udhëheqja shqiptare po përgatit një grup të gjerë që do të dërgohet në Beograd. “Duket se atyre po iu bëhet gjithmonë e më e qartë se çështja e qëndrimit dhe marrëdhëniet e tyre me ne janë një ndër themelet e politikës së tyre të përgjithshme”, shkruan Xherxha.¹⁹⁰

Udhëheqësit jugosllavë, me anë të agjentëve të tyre në Partinë Komuniste Shqiptare, përfshi Koçi Xoxen, “synonin ta mënjanonin Enver Hoxhën nga drejtimi i punëve të partisë, në atë kohë Sekretar i Përgjithshëm, duke u justifikuar me ngarkesën e madhe e tij në punët shtetërore edhe si Kryetar i Këshillit të Ministrave”.¹⁹¹ Si sekretar organizativ i Komitetit Qendror të asaj kohe, “Koçi Xoxe e kishte përqendruar udhëheqjen e partisë në duart e tij, pasi të gjitha udhëzimet, në lidhje me dekretet dhe ligjet mund të zbatoheshin vetëm pasi të jepeshin udhëzime të veçanta të aparatit të Komitetit Qendror që nënshkruheshin nga ai”.¹⁹² Në këtë mënyrë, ai synonte të përdorte autoritetin e partisë për të marrë në dorë edhe drejtimin e pushtetit. Burokracia e mësipërme e pengonte zgjidhjen e shpejtë dhe të drejtë të problematikave, si dhe mbrojtjen e lirisë dhe pavarësisë kombëtare.

¹⁸⁸ Ledion Krisafi, “Marrëdhëniet shqiptaro-jugosllave 1945-1948, Mitet, Faktet dhe Dyshimet”, Shtëpia botuese “Naimi”, Tiranë 2017, faqe 47. Marrë nga: https://uet.edu.al/images/doktoratura/Ledjon_Krisafi.pdf

¹⁸⁹ *Po aty*, f. 49.

¹⁹⁰ *Po aty*, f. 55.

¹⁹¹ Marxists Internet Archive, “Partia Komuniste e Shqipërisë në luftë për rindërtimin e vendit dhe për zhvillimin e revolucionit socialist”, faqe 211. Marrë nga: <https://www.marxists.org/shqip/subjekt/dokumente-shqiptare/ppsh/historia/iii/1-5.pdf>

¹⁹² *Po aty*.

Mbledhja e Byrosë Politike të Partisë Komuniste Shqiptare më 11 dhjetor 1945 doli në konkluzionin se drejtimi i ardhshëm i politikës së jashtme të Shqipërisë do të ishte ajo e afrimit me Jugosllavinë. “Këtij mendimi i mëshuan fort Enver Hoxha, Koçi Xoxe, Bedri Spahiu, Tuk Jakova dhe Pandi Kristo. Vetëm Sejfulla Malëshova shprehu një orientim të kundërt pro-perëndimor”.¹⁹³

Siç e shohim, pas Luftës së Dytë Botërore, Koçi Xoxe ishte figura numër dy e Partisë Komuniste Shqiptare, pas Enver Hoxhës, për shkak të posteve të rëndësishme në jetën politike të vendit. Kështu, në fund të nëntorit 1944, në kohën kur Partia Komuniste Shqiptare mori pushtetin, organi i saj drejtues, Byroja Politike, përbëhej nga shtatë anëtarë: Enver Hoxha, Koçi Xoxe, Nako Spiro, Sejfulla Malëshova, Pandi Kristo, Tuk Jakova dhe Bedri Spahiu. Me vendosjen e Pushtetit Popullor, në postet kyçe të drejtimit të vendit u vendosën pikërisht ata që kishin drejtuar luftën, sidomos ata që kishin vepruar nën diktatin e egër dhe mizor të direktivave të partisë dhe të dënimeve të kundërshtarëve politikë apo të partizanëve vetëm me “gjqin partizan”. Njëri prej tyre ishte edhe Koçi Xoxe, i cili, në periudhën mars-prill të vitit 1945, u caktua në krye të grupit të Gjyqit Special që do të gjykonin të gjithë ata që ishin kundërshtarë të pushtetit të sapokrijuar popullor. Në vitet 1945-1948, si kryetar i këtij Grupi Special dhe mbikëqyrës i të gjitha seancave gjyqësore, bashkë me Prokurorin e Përgjithshëm, Bedri Spahiu, për shumë persona ata dhanë dënime tepër të rënda, duke i cilësuar kriminelë të Luftës. Nga dëshmitarë të shumtë të asaj kohe, dënimet që jepeshin nga ky grup ishin të gjitha të paramenduara. Edhe pse marrja e vendimit në këto lloj gjyqesh jepej nga Koçi Xoxe dhe Bedri Spahiu, ishin posaçërisht porositë e Enver Hoxhës ato që ua vinin vulën përfundimisht. Midis shumë viktimitave të dënuara me vdekje nga ky Gjyq Special, do të gjykoreshin dhe dënoreshin edhe vetë njerëzit e tyre. Përsa u përket ekzekutimeve pa gjyq, i akuzuarnë gjyqin e tij nga prokurori special Bedri Spahiu, Koçi Xoxes i përgjigjet atij se “Edhe për vrasjet pa gjyq, kam pas qenë këshilluar dhe janë bërë me urdhër të Komandantit, dhe për këtë ka pasur vendim të Byrosë, kurse vetëm në një rast është vepruar duke qenë këshilluar vetëm me Enver Hoxhën.”¹⁹⁴

Në periudhën dhjetor 1944 – mars 1946, Koçi Xoxe mbajti postin e drejtorit të Drejtorisë së Mbrojtjes së Popullit, me funksion shtypjen e kundërshtarëve të regjimit. Në vitet 1946-1948 ai ishte deputet i Korçës. Gjithashtu, në vitet 1946-1948 ai mbante pozicionin e zëvendëskryeministrit, kryetarit të Komisionit të Kontrollit të Shtetit dhe zëvendëspresidentit të Presidiumit të Kuvendit Popullor. Përveç postit të zëvendëskryeministrit, Xoxe u emërua edhe ministër i Brendshëm, si dhe ishte në funksionin e Sekretarit Organizativ të PKSh-së, pas Enver Hoxhës, i cili mbante detyrën e Sekretarit të Përgjithshëm. Kështu, qartas arrihet në përfundimin se, duke parë raportet

¹⁹³Ledion Krisafi, “Marrëdhëniet shqiptaro-jugosllave 1945-1948, Mitet, Faktet dhe Dyshimet”, Shtëpia botuese “Naimi”, Tiranë 2017, faqe 48. Marrë nga: https://uet.edu.al/images/doktoratura/Ledjon_Krisafi.pdf

¹⁹⁴Bashkim Shehu, “Liri Belishova dhe koha e saj”, Tiranë, Botimet: UET, 2020, f.87

midis Koçi Xoxes dhe Enver Hoxhës, të gjitha veprimet dhe vendimet që ai ndërmernte nuk mund të bëheshin pa miratimin e Enverit, gjithnjë në fshehtësi dhe konspiracion midis tyre. Ndaj edhe prishja e marrëdhënieve me jugosllavët pati efekt negativ deri në armiqësi edhe te marrëdhëniet e Enver Hoxhës me Koçi Xoxen. Vetëm në periudhën e tij të fundit, në tetor të vitit 1948, pasi u shkarkua nga posti i ministrit të Brendshëm, Koçi Xoxe u emërua ministër i Industrisë.

Deri në vitin 1948 dukej sikur midis Enver Hoxhës dhe Koçi Xoxes kishte nisur një luftë për pushtet. Ky i fundit, si “Sekretar Organizativ i Partisë, që vendoste për çështjen e kadrove, pra emërimet në të gjithë hierarkinë shtetërore, dhe drejtor i Drejtorisë së Mbrojtjes së Popullit, pra shërbimit sekret, kishte në dorë kombinacionin pushtetar që e bënte të plotfuqishëm”.¹⁹⁵ Ai u bë numri dy në hierarkinë e regjimit, “duke lënë në hije ministrin e Brendshëm Haxhi Lleshi, të cilit më pas do t’ia merrte edhe portofolin ministror. Në këto rrethana, dukej vetëm si çështje kohe që Koçi Xoxe të zinte vendin e Enver Hoxhës”.¹⁹⁶

Në qershor të 1946-s, Enver Hoxha paraqiti në një takim të Byrosë Politike një raport për rishikimin e Plenumit të 2-të të Komitetit Qendror, ku cilësohej se përgatitja e punimeve të këtij plenumi cenonte pavarësinë e Partisë Komuniste Shqiptare dhe i ngjante më shumë një grushti shteti. Megjithatë, në këtë drejtim ai nuk e cilësoi drejtpërdrejt përgjegjës Koçi Xoxen, por së bashku me Pandi Kriston dhe Nako Spiron u konsideruan si mbështetës të Velimir Stojnićit dhe Sejfulla Malëshovës, të cilët “e kishin sulmuar drejtpërdrejt partinë në Plenumin II të Komitetit Qendror”.¹⁹⁷ Tezat e Enver Hoxhës, se në Plenumin e Beratit ishte sulmuar padrejtësisht vija ideologjike marksiste-leniniste e partisë dhe se nevojiteshin anëtarë të rinj të sprovuar në Byronë Politike nuk u pranuan nga Koçi Xoxe, Pandi Kristo dhe Nako Spiro, për shkak se mund të dilnin qartësisht në pah synimet e ndërhyrjes së Partisë Komuniste Jugosllave në punët e Partisë Komuniste Shqiptare.

Në fillim të vitit 1947, Komiteti Qendror i Partisë Komuniste Shqiptare propozoi hartimin e një plani dyvjeçar të zhvillimit ekonomik, plan të cilin udhëheqja e Partisë Komuniste Jugosllave këmbënguli ta çonte deri në pesë vjet, me qëllim që ekonomia e Republikës Popullore të Shqipërisë të shkrihej me ekonominë e Jugosllavisë. Sipas Jugosllavisë, nuk ishte e nevojshme që Shqipëria të krijonte industrinë e vet kombëtare, por mund të prodhonte vetëm lëndë të para bujqësore dhe minerale, të cilat do të përpunoheshin më tej në Jugosllavi.

¹⁹⁵ K. Myftaraj, *Jeta e Fshehur e Enver Hoxhës...*, f. 451.

¹⁹⁶ *Po aty*, f. 452.

¹⁹⁷ Marxists Internet Archive, “*Partia Komuniste e Shqipërisë në luftë për rindërtimin e vendit dhe për zhvillimin e revolucionit socialist*”, faqe 213. Marrë nga: <https://www.marxists.org/shqip/subjekt/dokumente-shqiptare/ppsh/historia/iii/1-5.pdf>

Sërish në nëntor të vitit 1947, Titoja ngriti një akuzë ndaj Partisë Komuniste Shqiptare, se plani pesëvjeçar i hartuar nga Shqipëria ishte një shkoputje e ekonomisë së vendit nga Jugosllavia. Po ashtu, vizita e Enver Hoxhës në Moskë, në korrik 1947, bëri që Titoja ta padiste Enver Hoxhën se, “pas kthimit të tij nga Moska e kishte ndryshuar politikën kundrejt Jugosllavisë”.¹⁹⁸ Ishte kjo periudha kur akuzat për krijimin në Shqipëri të një frontit anti-jugosllav ranë mbi Partinë Komuniste Shqiptare. Koçi Xoxe, Pandi Kristo dhe Kristo Themelko u pozicionuan në mbrojtjen e tezave jugosllave. Nako Spiro u padit si bashkëpunëtor me armikun, dhe kjo solli më pas edhe vetëvrasjen e tij. Një tjetër moment, në të cilin Koçi Xoxe shfaq qëndrimin e tij pro-jugosllav ishte në dhjetor të 1947-s, kur si pjesë e një delegacioni qeveritar të kryesuar nga Enver Hoxha shkoi në Sofje për të nënshkruar Traktatin e Miqësisë, Bashkëpunimit dhe Ndhmës Reciproke mes Republikës Popullore të Shqipërisë dhe Republikës Popullore të Bullgarisë. Ai u përpoq të ndikonte në dispozitat e traktatit, me qëllim që pëlqimi paraprak i Jugosllavisë të merrej për çdo veprim të përbashkët të Shqipërisë me Bullgarinë, gjë që u hodh poshtë.

Pas vetëvrasjes së Nako Spiros, në udhëheqjen e partisë u krijua një gjendje e nderë. Për këtë arsye, përgatitjet e Plenumit të 8-të të Komitetit Qendror të Partisë Komuniste Shqiptare, që u mbledh në shkurt 1948, u bazuan në tezën e Savo Zllatiçit “për bashkimin e Shqipërisë me Jugosllavinë mbi baza federative, e cila synonte shkrirjen e ekonomike kombëtare përmes planeve të përbashkëta, shkrirjen e ushtrive etj.”.¹⁹⁹ Koçi Xoxja së bashku me Pandi Kriston ishin propagandues të kësaj teze. Si rezultat, presioni i udhëheqjes jugosllave bëri që paditë e Titos të pranoheshin, “duke cenuar pavarësinë dhe sovranitetin kombëtar”.²⁰⁰

Pas Plenumit të 8-të, Koçi Xoxe kryesoi luftën ndaj atyre anëtarëve të partisë që kundërshtonin marrëdhëniet shqiptaro-jugosllave. Kjo luftë përfshinte diskreditimin, por edhe zhdukjen fizike të kundërshtarëve partiakë. Kjo tregon se Partia Komuniste Shqiptare me në krye Enver Hoxhën varej plotësisht nga Partia Komuniste Jugosllave, e kryesuar prej Titos. “Synimi ishte pa mëdyshje bashkimi sa më i shpejtë i Shqipërisë me Jugosllavinë ose, më saktë, aneksimi i saj, plan i cili kishte filluar të përgatitej që në kohën e luftës.”²⁰¹ Megjithatë, fërkimet e karakterit politik dhe ideologjik midis Stalinit dhe Titos kishin filluar qysh në vitin 1947. “Ekzistonte rreziku se dalja në pah e fërkimeve mund të sillte dështimin e planit të aneksimit të Shqipërisë nga Jugosllavia.”²⁰² Kështu, ndërhyrja jugosllave në punët e brendshme të Partisë Komuniste Shqiptare vazhdoi përmes Komisionit për Bashkërendimin e Planeve Ekonomike mes Shqipërisë dhe Jugosllavisë, i

¹⁹⁸ Marxists Internet Archive, “Partia Komuniste e Shqipërisë në luftë për rindërtimin e vendit dhe për zhvillimin e revolucionit socialist”, faqe 228. Marrë nga:

<https://www.marxists.org/shqip/subjekt/dokumente-shqiptare/ppsh/historia/iii/1-5.pdf>

¹⁹⁹ **Shënim:** Kjo tezë ju paraqit Komitetit Qendror të Partisë Komuniste Shqiptare në 5 dhjetor 1947.

²⁰⁰ *Po aty*, f. 232.

²⁰¹ *Marrëdhëniet Shqiptaro Jugosllave 1945- 1948...*, f. 7-8.

²⁰² *Po aty*.

cili u shndërrua gati në një qeveri të dytë nën emrin e “bashkimit dhe vëllazërimit me Jugosllavinë”.²⁰³ Gjithashtu, udhëheqja jugosllave, në bashkëpunim me Koçi Xoxen dhe mbështetës të tjerë kërkuan largimin e këshilltarëve ushtarakë sovjetikë, me qëllim njehsimin e komandës së përgjithshme të ushtrisë shqiptare dhe jugosllave me Titon në krye, dhe më tej bashkimin politik të dy vendeve, kërkesa të cilat nuk u pranuan nga Enver Hoxha.

Një tjetër mënyrë e zgjedhur nga udhëheqja jugosllave, me qëllim aneksimin e Shqipërisë, ishte ajo e frikësimit nga një sulm i mundshëm i Greqisë në Shqipëri, gjë që duhet të lejonte, sipas tyre, që të dërgoheshin në Shqipëri disa divizione të ushtrisë jugosllave për të realizuar më tej qëllimet e pushtimit ushtarak të vendit. Koçi Xoxe e përkrahu këtë kërkesë, e cila do të mbështetej në Traktatin e Miqësisë, të Bashkëpunimit dhe Ndhmës Reciproke, gjë që nuk u përmbush. Në kushtet e ndërhyrjes së Titos dhe funksionarëve të tjerë jugosllavë në punët e brendshme të Partisë Komuniste të Shqipërisë, Enver Hoxha iu drejtua Stalinit. Në këtë periudhë, udhëheqja jugosllave ishte kritikuar nga Bashkimi Sovjetik për qëndrimin e saj antisovjetik, e dukshme kjo në rezolutën e Byrosë Informative “Mbi gjendjen në Partinë Komuniste Jugosllave”,²⁰⁴ e cila u përkrah nga Partia Komuniste Shqiptare.

Në shtator 1948, u mbajt mbledhja e Plenumit të 11-të të Komitetit Qendror të Partisë Komuniste Shqiptare, sipas së cilës u dënuan qëllimet jugosllave kundrejt Republikës Popullore të Shqipërisë, nën dritën e rrethanave të reja historike. Vendimet e plenumeve të mëparshme, atij të dytë dhe të tetë, u zhvlerësuan. Veprimtaria e Koçi Xoxes u cilësua si trockiste. Ai zbatoi metoda të drejtimit policor në parti, për ta vënë këtë të fundit nën kontrollin e organeve të Sigurimit të Shtetit, duke shfrytëzuar funksionin e sekretarit organizativ të Partisë dhe atë të ministrit të Punëve të Brendshme. Gjithashtu, sipas përfundimeve të plenumit, “Koçi Xoxe jepte urdhra dhe udhëzime individuale, ndërkohë që në udhëheqjen e Partisë duhet të mbizotëronte kolegialiteti”.²⁰⁵ Koçi Xoxe u dallua për ashpërsinë ndaj kundërshtarëve politikë dhe “e shndërroi Sigurimin në një armë të profilizuar kriminale, sektare, krahinore, madje deri diku edhe fetare”.²⁰⁶ Kështu, u vendos marrja e masave ndëshkimore ndaj tij. Po ashtu, politika e asaj kohe do të orientohej ndaj miqësisë dhe bashkëpunimit me Bashkimin Sovjetik, duke e cilësuar udhëheqjen jugosllave me në krye Titon një kërcënim ndaj veprimtarisë së Partisë Komuniste Shqiptare. “Shqipëria në këtë mënyrë po kalonte nga varësia jugosllave në varësinë

²⁰³ Marxists Internet Archive, “Partia Komuniste e Shqipërisë në luftë për rindërtimin e vendit dhe për zhvillimin e revolucionit socialist”, faqe 232. Marrë nga:

<https://www.marxists.org/shqip/subjekt/dokumente-shqiptare/ppsh/historia/iii/1-5.pdf>.

²⁰⁴ Marxists Internet Archive, “Partia Komuniste e Shqipërisë në luftë për rindërtimin e vendit dhe për zhvillimin e revolucionit socialist”, faqe 234. Marrë nga:

<https://www.marxists.org/shqip/subjekt/dokumente-shqiptare/ppsh/historia/iii/1-5.pdf>.

²⁰⁵ *Po aty*, f. 236.

²⁰⁶ K. Dervishi, *Sigurimi i Shtetit 1944-1991: Historia e policisë politike të regjimit komunist...*, f. 142.

sovjetike, gjë që në planin e rrezikimit të integritetit dhe sovranitetit territorial të Shqipërisë dukej se kishte më pak rreziqe.”²⁰⁷ Në këtë situatë, Enver Hoxha i dha vetes pozicionin e liderit të Shqipërisë, ndërsa të gjithë ata që u dënuan për politikë anti-jugosllave u shpallën heronj që e shpëtuan Shqipërinë nga aneksimi jugosllav.

Pas ndërrimit të kursit të marrëdhënieve midis Bashkimit Sovjetik dhe Jugosllavisë, edhe Koçi Xoxe mbajti një qëndrim pro-partiak, në dënim të politikës antishqiptare jugosllave. Ishte Koçi Xoxe, “titisti” shqiptar që mori drejtimin në korrik dhe gusht në denoncimin e regjimit të Titos dhe për të lavdëruar Bashkimin e Republikave Socialiste Sovjetike, ndërsa Enver Hoxha ishte kryesisht joaktiv gjatë kësaj periudhe. Në 24 qershor 1948, ai “nënshkroi urdhrin e dëbimit të Komisarit Politik Jugosllav, bashkangjitur ushtrisë shqiptare.”²⁰⁸ Udhëheqja komuniste shqiptare kishte marrë tashmë vendimin për të hedhur poshtë zgjedhën jugosllave para shpalljes së rezolutës së Kominformës të 28 qershorit. Brenda një jave, shqiptarët i kishin ndërprerë plotësisht të gjitha lidhjet me Jugosllavinë, përveç Traktatit të Miqësisë dhe Ndihmës së Ndërsjellë. (Kjo nuk u anulua, derisa jugosllavët e bënë këtë më 1949-n).

Enver Hoxha ishte i pranishëm gjatë vizitës së një delegacioni ushtarak sovjetik, midis 9–14 korrikut 1948. Përveç dekorimit të delegacionit më 10 korrik, më 12 korrik ai e nderoi delegacionin me një darkë, si dhe e shoqëroi në largim, më 14. Njëherësh, nisën të shkëmbehen edhe delegacione të ndryshme me Bashkimin e Republikave Socialiste Sovjetike, ndërsa Enver Hoxha nuk u shfaq përsëri deri në mes të shtatorit. Në të kundërt, Xoxe ishte aktiv gjatë gjithë periudhës. Ishte ai që nënshkroi urdhrat për ndërprerjen e marrëveshjeve me Jugosllavinë, si dhe komunikimin e partisë të 16 korrikut, duke e refuzuar ftesën për kongresin e ardhshëm të Partisë Jugosllave. Gjithashtu Xoxe, më 2 shtator kryesoi Shoqërinë Kulturore Shqiptare, në të cilën ai u zgjodh President, në një ceremoni solemne të organizuar në Tiranë, me rastin e vdekjes së Zhdanov. Kështu, të gjitha shenjat treguan se “Xoxe ishte duke forcuar pozicionin e tij, dhe ndoshta duke u përgatitur të merrte pozitën numër një të Hoxhës”.²⁰⁹

Në Plenumin IX të Komitetit Qendror të Partisë Komuniste të Shqipërisë, që u mbajt në shtator të vitit 1948, Enver Hoxha, pasi akuzoi Titon si trockist dhe nacionalist borgjez, i cili kishte ndërhyrë në punët e brendshme të Shqipërisë, iu kthye grupit pro-jugosllav brenda Partisë Komuniste Shqiptare, i cili kryesohej nga Koçi Xoxe dhe Pandi Kristo. “Me akuzën si pro-jugosllav apo agent i jugosllavëve në Shqipëri, Koçi Xoxe mbeti anëtar i Byrosë Politike, por u zhvesh nga të gjitha detyrat shtetërore”.²¹⁰ Pas arrestimit të tij, më 11 qershor 1949 u ekzekutua edhe vendimi i gjykatës për dënimin e tij me vdekje.

²⁰⁷ A. Zogaj, *Marrëdhëniet Shqiptaro- Jugosllave...*, f.89.

²⁰⁸ *AMPJ*, Dosja Nr.B/1-8, viti 1948.

²⁰⁹ Central Intelligence Agency, “*Current Intelligence Staff Study, Soviet-Albanian Relations, 1940-1960*”, ESAU XIX-62, 2007. Marrë nga: <https://www.cia.gov/library/readingroom/docs/esau-19.pdf>.

²¹⁰ V. Duka, *Histori e Shqipërisë...*, f. 237.

Megjithatë, gjatë periudhës së angazhimit të tij politik jugosllavët nuk ngurrnin të flisnin me vlerësime të larta për Koçi Xoxen, dhe kjo gjë vihet re edhe në takimin e jugosllavëve me Stalinin, në maj të vitit 1946, ku, sipas dokumentit jugosllav, thuhet se “shokët e Byrosë Politike nuk e konsiderojnë Enver Hoxhën njeri me partishmëri fort të mjaftueshme, dhe prandaj gjithnjë ngulin këmbë që, me atë të vijë Koçi Xoxe, si anëtari më i vjetër i partisë në Byronë Politike”.²¹¹ Koçi Xoxe ishte njeriu që i qetësonte dhe që shfaqej si më racional dhe më i besueshmi në sytë e jugosllavëve. Në prill të vitit 1947, ndërsa priste zyrtarin dhe kreun jozyrtar të diplomacisë jugosllave, S. Simic dhe E. Kardel, së bashku me ambasadorin jugosllav në Moskë, V. Popoviç, Stalini kërkoi përsëri detaje për marrëdhëniet jugosllave-shqiptare dhe, në veçanti për Hoxhën. Ai e befasoï Kardelin me pretendimin se Hoxha “po bënte gjyqe për këshilltarët politikë jugosllavë në ushtrinë shqiptare, të cilat po dobësojnë disiplinën”. Kardeli iu përgjigj: “Për ne kjo është e re”.²¹² Stalini pyeti për Hoxhën; ai ishte i interesuar për besueshmërinë dhe qëndrueshmërinë e tij, i shqetësuar nëse ai do të ishte me ta deri në fund. Kardeli iu përgjigj se Hoxha është i besueshëm dhe i dashur nga njerëzit, por atij i mungon arsimi marksist-leninist. Kardeli veçoi Koçi Xoxe, si më të mirën brenda udhëheqjes shqiptare, megjithëse gjithashtu nuk kishte arsimim. Molotov u pajtua”.²¹³

Po ashtu, vlerësimin për figurën e Koçi Xoxes e konfirmojnë edhe përfaqësues të udhëheqjes jugosllave, si Miladini dhe Dushani. Sipas tyre, komunisti më i mirë në Partinë Komuniste Shqiptare ishte Koçi Xoxe, por që në atë kohë ishte në burg i akuzuar për vrasje. Edhe në kohën kur u prishën marrëdhëniet midis Shqipërisë dhe Jugosllavisë, në një takim me Hrushovin, Tempo do të përsëriste mendimin e tij pozitiv për Koçi Xoxen, duke iu drejtuar Hrushovit me fjalët: “Komunistin më të mirë të Shqipërisë, Koçi Xoxen, ju e vratë... Ishte punëtor dhe revolucionar i madh”.²¹⁴

Është e vërtetë se presioni i udhëheqjes jugosllave me Titon në krye, edhe drejtpërdrejt, edhe me anë të emisarëve të saj ishte i madh dhe i vazhdueshëm. Por pa gatishmërinë dhe mbështetjen e udhëheqjes së Partisë Komuniste Shqiptare e të vetë Enver Hoxhës, asgjë nuk mund të kryhej. “Enver Hoxha ka bërë fajtor për politikën pro-jugosllave antishqiptare të Partisë Komuniste Shqiptare, Koçi Xoxen, Pandi Kriston, Kristo Themelkon e ndonjë tjetër. Por Koçi Xoxe nuk mund të bënte ligjin në të gjithë Plenumin

²¹¹*Shqipëria dhe Kosova në arkivat ruse...*, përgatitën H. Kaba dhe E. Çeku, f. 27.

²¹²Momcilo Pavlovic, “Albania between Tito and Stalin”; Në “*The Balkans in the Cold War*”, edituar nga Vojislav G. Pavlovic, Institute des Etudes Balkaniques, Beograd, 2011, f.161. Marrë nga: <https://books.google.al/books>

²¹³Momcilo Pavlovic, “Albania between Tito and Stalin”; Në “*The Balkans in the Cold War*”, edituar nga Vojislav G. Pavlovic, Institute des Etudes Balkaniques, Beograd, 2011, f.161. Marrë nga: <https://books.google.al/books>

²¹⁴Svetozar Vukamanovic Tempo, *Revolucija koja teče, Memoari*, knjiga 1, Beograd 1971, f. 357.

e Komitetit Qendror e në të gjithë Partinë pa Enver Hoxhën, që ka qenë vazhdimisht lideri numër një i kësaj partie, pra komandanti i saj”.²¹⁵

²¹⁵*Marrëdhëniet Shqiptaro Jugosllave...*, f. 6.

KREU II

ROLI I KOÇI XOXES NË MARRËDHËNIET SHQIPTARO-JUGOSLLAVE

2.1 Intensifikimi i marrëdhënieve politike

Marrëdhëniet politike mes Shqipërisë dhe Jugosllavisë lidhen me të kaluarën e tyre të përbashkët, si pjesë e agresionit të Italisë fashiste dhe Gjermanisë naziste. “Si Partia Komuniste Jugosllave (PKJ), ashtu edhe Partia Komuniste Shqiptare (PKSh) ishin pjesë e rezistencës antifashiste. Kjo e fundit u krijua nën ndikimin jugosllav, pasi Jugosllavia dhe Bashkimi Sovjetik, të cilët kishin mbështetur LANÇ”²¹⁶, synonin përfshirjen e Shqipërisë në Bllokun Socialist Lindor. Gjithashtu, kushtet e reja gjeopolitike të krijuara pas luftës shënuan rënien e Italisë, si konkurrenca e interesave jugosllave në Shqipëri. Ndikimi jugosllav filloi të ishte i dukshëm edhe në këshillimin e qeverisë shqiptare kundër pranimit të kërkesave të Shteteve të Bashkuara të Amerikës për njohjen e marrëveshjeve të tyre me Shqipërinë, në prill të vitit 1939, si kusht kryesor për njohjen e vetë shtetit shqiptar, çka orientoi në vazhdimësi edhe marrëdhëniet politike të vendit në arenën ndërkombëtare. Në këtë mënyrë, “përmbusheshin interesat e Jugosllavisë për koordinimin e lidhjeve diplomatike të vendeve të Ballkanit, për përfshirjen e Shqipërisë në Federatën Jugosllave”.²¹⁷ Po ashtu, “përmbushej edhe interesi i Bashkimit Sovjetik për shtrirjen në Ballkan dhe daljen në ujërat e Detit Mesdhe”.²¹⁸ Megjithatë, duhet theksuar se partneriteti i ngushtë me Jugosllavinë asokohe u nxit edhe nga gjendja e vështirë e Shqipërisë pas Luftës së Dytë Botërore, si dhe nga mungesa e traditës së mirëfilltë politikëbërëse. “Miladin Popoviç dhe Dushan Mugosha, si të emëruarit jugosllavë që e kishin ndihmuar Enver Hoxhën qysh në organizimin e partisë, përpunuan edhe rregulloret e partisë komuniste, të ashtuquajtura të tipit leninist, ku parashikonin bindjen ndaj centralizmit demokratik, pra zgjedhjen e organeve drejtuese nga poshtë lart, dhënien llogari në mënyrë periodike, nënshtrimin e pakicës ndaj shumicës etj.”²¹⁹

PKSh, në fakt e shihte bashkëpunimin me partinë dhe shtetin jugosllav si një mundësi për rindërtimin dhe zhvillimin e ekonomisë së vendit të sapo dalë nga lufta. Për më tepër, qeveria e përkohshme e Hoxhës kërkonte njohjen e saj dhe të shtetit të pavarur shqiptar në arenën ndërkombëtare. Këtë mision e mori përsipër sërish Jugosllavia. Fillimisht, gjatë vitit 1945 marrëdhëniet mes Shqipërisë dhe Jugosllavisë u përqendruan kryesisht në fushën politike dhe diplomatike dhe më pak në atë ekonomike. “Përfaqësuesit

²¹⁶ *Shënim*: LANÇ është shkurtim për: Luftën Antifashiste Nacionalçlirimtare.

²¹⁷ Bogumijl Hrabak, *Arbanske Studije*, knj, I-V, Beograd 2005, f. 269.

²¹⁸ Hajdi Xhixha, ‘Marrëdhëniet shqiptaro-jugosllave’, Disertacion, Universiteti i Tiranës, 2018, f. 35. Marrë nga: <https://unitir.edu.al/marredheniet-shqiptaro-sovjetike-1949-1960/>.

²¹⁹ Nina Smirnova, *Historia e Shqipërisë përgjatë shekullit XX*, Tiranë, Botimet: Ideart, 2004, f. 225.

e misionit shqiptar në Beograd e cilësuan Jugosllavinë si një garant të paqes në Ballkan.”²²⁰ Megjithatë, në vitet e pasluftës, përfaqësuesit shtetërorë në Shqipëri nuk e kishin përvojën e duhur politike për të udhëhequr vendin. Ky fakt u shfrytëzua nga jugosllavët me qëllim lehtësimin e orientimit politik të qeverisë së përkohshme shqiptare drejt Jugosllavisë dhe Bashkimit Sovjetik. Në shkurt të vitit 1945, delegacioni shqiptar që u nis drejt Jugosllavisë u prit me fjalët “mbetet për më vonë bisedimi”.²²¹ Kjo tregonte ngurrim nga ana e jugosllavëve për të siguruar ndihmë për Shqipërinë e shkatërruar nga lufta. Megjithatë, një raport i Ministrisë së Ekonomisë mbi bisedimet e zhvilluara në Jugosllavi tregon premtimin e udhëheqjes jugosllave për ta ndihmuar Shqipërinë me çfarë t’u ndodhej, pasi ajo ishte “shumë e dëmtuar nga lufta heroike përkrah Bllokut Antifashist”.²²²

Duhet theksuar se “partneriteti dhe marrëdhëniet Jugosllavi-Shqipëri kishin interesa dypalëshe, edhe pse veprimet treguan se interesi kombëtar shqiptar nuk u përfill fare”.²²³ Në rastin e kërkesave për njohjen ndërkombëtare të qeverisë së përkohshme të Hoxhës, në rastin e incidentit të Kanalit të Korfuzit e shumë momente të tjera të rëndësishme të politikës së jashtme të Shqipërisë, “Jugosllavia shërbeu jo vetëm si këshilltare e Shqipërisë, por edhe si vendimmarrëse, me përjashtim të veprimeve formale-diplomatike të Shqipërisë me vendet e tjera”.²²⁴ Në këtë kontekst, Jugosllavia ishte kanali kryesor i marrëdhënieve të Shqipërisë me Bashkimin Sovjetik dhe vende të tjera të Ballkanit. Ajo synonte krijimin e Federatës Ballkanike, dhe kështu rritja e ndërhyrjes së saj në politikën e brendshme në Shqipëri i shërbente këtij qëllimi.

Në të njëjtën kohë, “Jugosllavia synonte të mënjanonte ndikimin sovjetik në Shqipëri dhe të forconte pozitat e veta”.²²⁵ Kështu, në Shqipëri u zhvillua një propagandë e fuqishme e miqësisë, të cilat shprehnin qartë intensifikimin e marrëdhënieve të asokohe me Jugosllavinë. Në Plenumin V të Komitetit Qendror të PKSh, Enver Hoxha u shpreh për ekzistencën e “dashurisë” dhe “vëllazërisë” mes Shqipërisë dhe Jugosllavisë, që i kishte rrënjët gjatë rezistencës së përbashkët antifashiste në Luftën e Dytë Botërore. “Populli duhet ta kuptonte se kjo vëllazëri ishte kusht për ekzistencën e tyre.”²²⁶ Të dy vendet duhet “t’i shërbenin forcimit të demokracisë dhe ta mbështesnin Bashkimin Sovjetik në këtë drejtim”.²²⁷ Intensifikimi i marrëdhënieve të Shqipërisë me Jugosllavinë po ashtu u bazua në pasigurinë e qeverisë së Hoxhës, për sa i takon ruajtjes së tërësisë dhe pavarësisë territoriale të Shqipërisë. Kjo lidhej me rrezikun e misionëve ushtarake dhe

²²⁰ *Gazeta Bashkimi*, Tiranë, 17 korrik 1945.

²²¹ *AQSH*, Fondi 494, dosja nr. 263, viti 1945, fl.1-3.

²²² *Po aty*.

²²³ Hajdi Xhixha, *Marrëdhëniet shqiptaro-jugosllave*, Disertacion, Universiteti i Tiranës, 2018, f. 27. Marrë nga: <https://unitir.edu.al/marredheniet-shqiptaro-sovjetike-1949-1960/>.

²²⁴ Agustin Gjinaj dhe Fejzi Lila, *Lidershipi shqiptar përmes historisë së Ushtrisë*, Tiranë, Botimet: Geer, 2012, f. 143.

²²⁵ Branko Petranoviç, *Balkanska Federacija: 1943-1948*, Beograd, 1991, f. 136-138.

²²⁶ *Shqipëria në dokumentet e arkivave ruse...*, përgatitën I. Lauka dhe E. Ymeri, f. 113.

²²⁷ *AQSH*, Fondi 14, dosja nr. 1, viti 1946.

civile të aleatëve perëndimore, si dhe mbështetjen e tyre ndaj shtetit grek. Planet jugosllave për kthimin e Shqipërisë në Republikë të Shtatë jugosllave janë dokumentuar nga Vladimir Dedijer. Aneksimi i Shqipërisë, ashtu siç u sugjerua nga Bashkimi Sovjetik duhet të ndodhte jo me luftë, pasi shkaktonte debate në arenën ndërkombëtare, por me anë të “vullnetit”²²⁸ të ligjshëm të qeverisë shqiptare. Megjithatë, Jugosllavia duhet të merrte miratimin e Bashkimit Sovjetik për lëvizje të tilla, duke mos e tërhequr vëmendjen e aleatëve perëndimorë.

Në vitin 1946, marrëdhëniet shqiptaro-jugosllave arritën kulmin e tyre. Qëndrimi i Shqipërisë ndaj Jugosllavisë ishte mjaft miqësor. Bedri Spahiu, përfaqësues i delegacionit shqiptar në Beograd, u shpreh se Shqipëria nuk do ta harronte kurrë ndihmën ushtarake, ekonomike dhe politike që Jugosllavia i kishin ofruar Shqipërisë, e cila e shihte rolin paqedashës të Jugosllavisë si “një garant të vendosur të pavarësisë së saj”.²²⁹ Rëndësia e marrëdhënieve me Jugosllavinë bëhej e dukshme edhe në komunikimet e Komitetit Qendror të Partisë Komuniste me Komitetet Qarkore. Në një komunikim të bërë me Komitetin e Qarkut, ku evidentoheshin më tej përparimet në aspektin politik, katër prej tyreve iu dha më tepër rëndësi dhe u vlerësuan si ndryshime mjaft të rëndësishme në aspektin politik të vendit në atë kohë:

- rritjen e besimit të popullit dhe sigurinë, lidhur me pavarësinë e vendit;
- rritjen e dashurisë dhe besimit për Jugosllavinë Federative dhe zhdukjen e mendimeve reaksionare, lidhur me qëllimet e Jugosllavisë, të cilat më parë shfaqeshin nëpërmjet parullave. “Pse Jugosllavia nuk e tregon miqësinë me vendin tonë nëpërmjet nënshkrimit të ndonjë pakti”²³⁰;
- rritjen e urrejtjes ndaj armiqve, si Greqia, dhe në këtë aspekt ka ndikuar lëvizja reaksionare në momentin e duhur;
- rritjen e bindjes me sigurinë ekonomike, falë ndihmave të marra nga Jugosllavia.²³¹

Më tej, më 6 gusht 1946, u aprovua Ligji mbi Traktatin e Miqësisë dhe të Ndihmës reciproke mes Shqipërisë dhe Jugosllavisë, lidhur në Tiranë më 9 korrik 1946. Në këtë traktat theksohej se të dyja qeveritë duhet të përpiqeshin që t’i forconin edhe më tepër marrëdhëniet ndërmjet tyre, si dhe në mënyrë më të gjithanshme. Traktati po ashtu kërkon që të dyja palët kontraktuese të ndërmarrin të gjitha masat e nevojshme, për të siguruar pavarësinë dhe integritetin e vendeve të tyre, si dhe për të ndaluar në të ardhmen çdo përsëritje agresioni të njëjlojtë me atë të Gjermanisë hitleriane dhe Italisë fashiste të Musolinit. Për këtë qëllim, sipas traktatit, të dyja palët duhet të bashkëpunonin sa më

²²⁸ Enver Hoxha, *Vepra*, Vëll. IV, Tiranë: “Naim Frashëri”, 1969, f. 212.

²²⁹ James S. O’Donnel, *A coming of Age. Albania Under Enver Hoxha*, East European Monographs, 1999, f. 18.

²³⁰ *AQSH*, AKQ/PKSH, Fondi 14, dosja nr. 170, viti 1946, fl. 1.

²³¹ *Po aty*.

ngushtë në të gjitha çështjet ndërkombëtare për interes të ruajtjes së paqes, dhe ta ndihmojnë njëra-tjetrën në rast sulmi prej ndonjë fuqie tjetër. “Traktati e materializonte më tej bashkëpunimin, duke thënë se kjo ndihmë do të jetë ndihmë ushtarake si dhe çdo ndihmë tjetër, sipas mjeteve që disponoheshin.”²³² Po ashtu, në traktat theksohej se “të dyja palët kontraktuese ishin të detyruara me firmosje të traktatit, që të mos hynin në asnjë aleancë tjetër, as të bëheshin pjesë në ndonjë koalicion që drejtohet kundër palës tjetër kontraktuese. Ndërsa, sa i takon lidhjeve ekonomike, kulturore etj., traktati parashikonte se ato do të trajtoheshin me marrëveshje të veçanta”.²³³

Ky traktat u mirëprit nga të dy vendet. Në ekspozenë e ministrit të Punëve të Jashtme të Jugosllavisë, Stanoje Simić, paraqitur më 20 korrik para deputetëve të Kuvendit të Republikës Federative Popullore të Jugosllavisë, me rastin e ratifikimit të Traktatit e Miqësisë në mes Shqipërisë dhe Jugosllavisë, vlerësohej se “... *Është prekëse të shohësh në çdo hap atë dashuri dhe respekt, të cilin e ndjejnë masat e gjëra të popullit shqiptar për mareshalin Tito dhe Jugosllavinë e re. Atje Jugosllavia ndihet si ndër mysafirë te të afërmit e gjakut*”.²³⁴

Intensifikimin e marrëdhënieve e tregoi qartë edhe vija e “bashkimit e vëllazërimit” me Jugosllavinë, një frazë e përdorur shpesh midis palëve, nëpërmjet Plenumit të Jashtëzakonshëm të KQ të dhjetorit 1946, me vendimet e direktivat e tij “për zhvillimin e Shqipërisë e të Jugosllavisë në të njëjtën rrugë të socializmit, për bashkimin e ekonomive të tyre nëpërmjet koordinimit të planeve ekonomike, krijimit të shoqërive të përbashkëta shqiptaro-jugosllave, bashkimit doganor, njësimin të monedhës, barazimit të çmimeve, krijimit të Komisionit të Përbashkët të Koordinimit, unifikimit të ushtrive e mbrojtjes së përbashkët dhe nëpërmjet bashkimit mbi baza federale të partive komuniste dhe bashkimit politik të Shqipërisë me Jugosllavinë”.²³⁵ Po ashtu, interesi i Bashkimit Sovjetik në këtë drejtim u përforcua. Bashkimi Sovjetik në atë kohë tregoi interes mbi mendimin e udhëheqjes shqiptare, në lidhje me “planet e përbashkëta të mbrojtjes, bashkëpunimit ekonomik dhe krijimit të Federatës me Jugosllavinë, por mbi të gjitha për çdo lëvizje të mundshme të Jugosllavëve në Shqipëri”.²³⁶

Përforcimi i “kontrollit të Jugosllavisë dhe Bashkimit Sovjetik në Shqipëri”²³⁷ u bë i dukshëm kur Shqipëria u përfshi në incidentin e Kanalit të Korfuzit, në tetor të vitit 1946, gjë që nuk e favorizoi njohjen e qeverisë shqiptare të asaj kohe në arenën ndërkombëtare. Britania u kundërpërgjigj për mospranimin e kushteve të kalimit në Kanalin e Korfuzit,

²³²AMPJ, dosja nr. 167, viti 1946, f. 27. **Shënim:** ‘Relacion mbi marrëdhëniet midis dy vendeve.’

²³³Po aty, f. 28.

²³⁴ Gazeta Borba, 21 korrik 1946.

²³⁵Marrëdhëniet Shqiptaro Jugosllave..., f. 6.

²³⁶ Enver Hoxha, *Vepra*, Vëll. III, Tiranë, Botimet: “8 Nëntori”, 1969, f. 4-5.

²³⁷A. Zogaj, *Marrëdhëniet shqiptaro-jugosllave...*, f. 73.

mbështetur në ligjin ndërkombëtar.²³⁸ Ndërkohë, “shtypi britanik kërkonte marrjen e masave drastike luftarake ndaj Shqipërisë”. Për më tepër, kishte mungesë informacioni nga ana e aleatëve për “ekzistencën e minave në kanalin e pastruar”.²³⁹ Jugosllavia e këshilloi Shqipërinë për çdo hap që duhet të ndiqte në lidhje me incidentin në fjalë. “Kishte raste kur diplomacia jugosllave i iniconte vetë lidhjet e Shqipërisë me botën.”²⁴⁰ Gjykata e Hagës e shpalli Shqipërinë fajtoreshë për mos-vëmendje mbi ngjarjen e ndodhur në ujërat e saj territoriale, “duke e dënuar me pagesën e një dëmshpërblimi ndaj qeverisë britanike”²⁴¹ Ndërkohë, “dysshohej se minat në Kanalin e Korfuzit ishin vendosur nga Jugosllavia”.²⁴² Kontrolli i fortë që ushtri qeveria jugosllave në vendimmarrjen shqiptare, lidhur me këtë incident, shkaktoi ftohjen e marrëdhënies me Perëndimin dhe orientimin e plotë drejt vijës politike jugosllave dhe më tej drejt asaj të Bashkimit Sovjetik.

Premtimet e Jugosllavisë për ndihmë, si në politikën e brendshme ashtu edhe në atë të jashtme të vendit ishin të shumta. Ajo ishte ndërmjetëse e kërkesave të qeverisë shqiptare ndaj aleatëve perëndimorë për pranimin e Shqipërisë në Organizatën e Kombeve të Bashkuara. Shtypi jugosllav propagandonte dyshime mbi cilësinë e marrëdhënies mes qeverisë shqiptare dhe aleatëve perëndimorë. Sipas gazetës “Politika”, në janar të vitit 1946, në lidhje me vonesën e pranimit të Shqipërisë në Organizatën e Kombeve të Bashkuara shkruhej se “*po harrohej fakti se Shqipëria ishte viktima e parë e agresionit fashist*”.²⁴³ Gjithashtu, në shkurt të vitit 1946, në të njëjtën gazetë shkruhej se “*po përkraheshin qarqet reaksionare të Greqisë... kundër Shqipërisë së vogël*”.²⁴⁴

Çdo vendim i marrë nga vendet e tjera të Europës “për njohjen e shtetit shqiptar kalonte te përfaqësuesit jugosllavë, dhe jo te qeveria shqiptare, siç ndodhi në rastin e Çekosllovakisë dhe Polonisë”.²⁴⁵ Po ashtu, në një kërkesë drejtuar Turqisë dhe Egjiptit, “qeveria shqiptare pranonte që Jugosllavia ta përfaqësonte në këto vende”.²⁴⁶ Gjithashtu, kjo e fundit propozoi edhe “mbrojtjen e interesave shqiptare në ShBA”.²⁴⁷ E ndodhur nën ndikimin jugosllav dhe më gjerë, atë të vijës ideologjike marksiste, udhëheqja shqiptare i shihte me dyshim marrëdhëniet me aleatët perëndimorë. Për shembull, ndihma e dhënë Shqipërisë së pasluftës nga një organizatë ndërkombëtare UNRRA, pjesë e së cilës ishin edhe aleatët perëndimorë, “solli një frymë mosbesimi tek udhëheqja shqiptare lidhur me

²³⁸ Leslie Gardiner, *The eagle spreads his claws*, London, 1966, f. 68.

²³⁹ A. Zogaj, *Marrëdhëniet shqiptaro-jugosllave...*, f. 82.

²⁴⁰ Bogumilj Hrabak, *MedjunarodnipolozajAlbanije1945-1947i Jugoslavija*, Izdrzhivanjabr.13, Novi Sad 1990, f. 258.

²⁴¹ A. Zogaj, *Marrëdhëniet shqiptaro-jugosllave...*, f. 88.

²⁴² Bogumilj Hrabak, *Arbanske Studije*, knj, I-V, Beograd, 2005, f. 293. (përkthimi: Studime shqiptare, vëllimi I).

²⁴³ *Gazeta Politika*, 31 janar, 1946.

²⁴⁴ *Po aty*, 15 shkurt, 1946.

²⁴⁵ A. Zogaj, *Marrëdhëniet shqiptaro-jugosllave...*, f. 78.

²⁴⁶ *Po aty*, f. 79.

²⁴⁷ *Po aty*.

motivet e ofrimit të kësaj ndihme”.²⁴⁸ Madje, as propozimi i përfaqësuesit të Komisionit Ndërministror të UNRAA, për shtimin e ndihmave ofruar Shqipërisë, “u pa me dyshim nga qeveria shqiptare”.²⁴⁹ Kështu, misioni UNRAA njoftoi ndërprerjen e veprimtarisë së tij në Shqipëri, në qershor të vitit 1947. Kjo tregoi edhe njëherë influencën dhe llojin e marrëdhënieve të Shqipërisë dhe Jugosllavisë në arenën ndërkombëtare. Krahas përmbushjes së interesave sovjetike në arenën ndërkombëtare, Jugosllavia ushtroi një ndikim të dukshëm edhe në aspektin e politikës së brendshme të vendit, duke u kujdesur që, përmes elementëve pro-jugosllavë ta dobësonte nga brenda shtetin shqiptar, gjë që do të lehtësonte përfshirjen e Shqipërisë në Federatën Jugosllave.

Në vitet e mëvonshme, pas publikimit të rezolutës së byrosë mbi gjendjen në PKJ (1948) dhe fillimit të polemikës me “revizionistët” titistë, në shtypin jugosllav dolën materiale e dokumente që synonin të vërtetonin se edhe “krijimi i PKSh, edhe organizimi i qëndresës antifashiste të shqiptarëve qenë vepër e PKJ dhe përfaqësuesve të saj në Shqipëri, Miladin Popoviç e Dushan Mugoshës, që kishin përmbushur detyrën e ngarkuar nga Titoja, sipas udhëzimit të dhënë nga Kominterni”.²⁵⁰

2.2 Bashkëpunimi në fushën ekonomike

Pesë vitet e pushtimit italo-gjerman patën ndikim në thellë në shtetin shqiptar. Qeverisë së re të RPSH-së i duhej të zgjidhte detyrën tepër të vështirë, jo vetëm të rimëkëmbjes së ekonomisë, por edhe të ndërtimit të ekonomisë. Në këtë kontekst, Shqipëria zhvilloi një bashkëpunim të ngushtë me Jugosllavinë në fushën e zhvillimit ekonomik. “Udhëheqja shqiptare ndërkohë i kishte nisur disa kërkesa Beogradit, për t’i theksuar nevojën urgjente për bukë që kishte Shqipëria e asaj kohe”²⁵¹, edhe pse fillimisht pala jugosllave nuk kishte pranuar të ofronte ndihmë në këtë drejtim me shprehjen “*Miellin nuk jua japim*”²⁵². Megjithatë, pala shqiptare ishte këmbëngulëse, për shkak të situatës së rënduar ekonomike dhe sociale, në të cilën gjendej vendi i sapodalë nga Lufta e Dytë Botërore. Pala jugosllave nisi dërgesën e sasive të pakta të misrit dhe grurit në Shqipëri, të cilat, sipas një procesverbalit mbajtur në korrik 1945 kishin rezultuar të papërshtatshme për konsum dhe të përdorshme “*vetëm për alkool*”.²⁵³

Jugosllavia nuk ishte i vetmi opsion që qeveria shqiptare shfrytëzoi për të plotësuar nevojat ushqimore të popullatës së asaj kohe. Bullgaria, Çekosllovakia dhe Rumania u vizituan nga delegacioni shqiptar, me synim shkëmbimin e mallrave dhe rimëkëmbjen

²⁴⁸ Hamit Kaba, *Shqipëria në rrjedhën e luftës së Ftohtë, studime e dokumenta*, Tiranë: “Botimpex”, 2007, f. 40.

²⁴⁹ *AQSH*, Fondi 164, dosja nr. 54, viti 1946, fl.14.

²⁵⁰ N. Smirnova, *Historia e Shqipërisë...*, f. 223.

²⁵¹ *AQSH*, Fondi 494, dosja nr. 268, viti 1945, fl.47.

²⁵² *Po aty*, fl.30.

²⁵³ *Po aty*, fl.66.

ekonomike të vendit. Lufta e Dytë Botërore e kishte çekuilibruar situatën politike dhe ekonomike të këtyre vendeve. Për këtë arsye, Bullgaria dhe Rumania refuzuan dërgimin e drithërave në Shqipëri. Pala rumune refuzoi edhe kërkesat për pjesë këmbimi apo pajisje për industrinë e naftës. Duke pasur marrëdhënie më të ngushta me Jugosllavinë, pala shqiptare kishte kontaktuar qeverinë jugosllave në gusht të vitit 1945, me qëllim aktivizimin e rolit të saj ndërmjetësues që Shqipëria të vendoste marrëdhënie diplomatike me vendet e mësipërme. Në ndryshim nga Bullgaria dhe Rumania, “pala çekosllovake shprehu interes pothuajse në të gjithë gamën e produkteve të eksportit shqiptar, duke u zotuar se do siguronte në këmbim makineri të ndryshme, pjesë këmbimi, sheqer etj”.²⁵⁴ Ndërkohë, orientimi i Shqipërisë drejt ideologjisë marksiste e kishte vështirësuar bashkëpunimin me misionin britanik dhe amerikan në këtë drejtim. Udhëheqja shqiptare vlerësoi më tepër bashkëpunimin ekonomik me Jugosllavinë edhe për shkak të afrisë gjeografike që e lehtësonte punën. Pritej po ashtu që këmbimet tregtare të sillnin përfitime reciproke për të dy vendet fqinje. Qëllimi kryesor i politikës jugosllave, duke filluar nga viti 1945, ishte kthimi i shtetit të pavarur shqiptar në Republikë të Shtatë të Jugosllavisë, çka shpjegonte se pse Jugosllavisë nuk i interesonte fuqizimi ekonomik i saj. Kështu, ajo krijonte në ekonominë shqiptare shumë vështirësi dhe sfida, duke e dëmtuar në mënyra të ndryshme. Në thelb, vendosja e bashkëpunimit ekonomik me Shqipërinë nuk ishte në funksion të zhvillimit ekonomik të vendit, por në funksion të qëllimeve kolonialiste të Jugosllavisë. Nëse i referohemi historiografisë së periudhës komuniste, politika jugosllave ka zhvilluar një ndërhyrje armiqësore në punët e brendshme të Shqipërisë. “Një prej faktorëve që e lejuan Jugosllavinë të ushtronte presionin e saj politik, sidomos atë ekonomik, ishte mbështetja e ofruar nga udhëheqja shqiptare e asaj kohe.”²⁵⁵ Orientimi pro-jugosllav u nxit edhe nga nevoja e madhe për rimëkëmbjen ekonomike të vendit të sapo dalë nga lufta. Orientimi ekonomik i Shqipërisë drejt lindjes komuniste rriti paragjykimet dhe pengoi marrjen e ndihmave nga aleatët perëndimorë. Në prill 1946, u njoftua se “*dogana jugosllave nuk lejon në asnjë mënyrë kalimin e mallit në Shqipëri*”,²⁵⁶ i cili vinte nga Kryqi i Kuq posaçërisht për Shqipërinë. Në këtë kontekst, udhëheqjes jugosllave i interesonte izolimi i Shqipërisë, në mënyrë që marrëdhëniet ekonomike dhe tregtare të ishin tërësisht të kontrolluara nga Jugosllavia dhe që kjo të ndikonte sipas interesave të veta në këtë drejtim. Në periudhën 1944-1946 u vunë re po ashtu praktika të disfavorshme dhe raporte jo të ndërsjella ekonomike dhe tregtare të vendosura në dëm të Shqipërisë. Një tregues i këtyre praktikave është “manipulimi i çmimeve të mallrave që importoheshin dhe eksportoheshin nga Jugosllavia në Shqipëri. Aplikimi i çmimeve të tregut botëror”²⁵⁷ në shkëmbimet e ndërsjella mes Jugosllavisë dhe Shqipërisë e kushtëzuan këtë të fundit, duke lejuar manovrimet në favor të palës jugosllave.

²⁵⁴ Iljaz Fishta dhe Mihal Ziu, *Historia e Ekonomisë së Shqipërisë 1944-1960*, Tiranë, Botimet “Dita”, 2004, f.266.

²⁵⁵ “*Marrëdhëniet shqiptaro-jugosllave...*, Dokumente, përgatitën N. Plasari dhe. Malltezi, f.4.

²⁵⁶ *AQSH*, Fondi 494, dosja nr. 553, viti 1946, fl.250.

²⁵⁷ *AQSH*, Fondi 494, dosja nr. 548, fl. 98.

Formalizimi i marrëdhënieve ekonomike mes Shqipërisë dhe Jugosllavisë ndodhi pas vizitës së Enver Hoxhës në Jugosllavi në periudhën 23 qershor–2 korrik 1946. Rezultat i kësaj vizite ishte nënshkrimi i Marrëveshjes për Bashkëpunim Ekonomik mes dy vendeve. Ministri i Ekonomisë, Nako Spiro, nënshkroi në emër të qeverisë shqiptare dhe ministri i Tregtisë dhe Burimeve, Nikolla Petrovic, nënshkroi në emër të qeverisë jugosllave. Kjo marrëveshje parashikonte krijimin e shoqërive ekonomike shqiptaro-jugosllave me kohëzgjatje 30-vjeçare, të cilat “do ta ushtronin veprimtarinë e tyre në fushën e elektrifikimit, nxjerrjes dhe përpunimit të naftës, zbulimit të mineraleve dhe shfrytëzimit të metaleve, ndërtimit dhe shfrytëzimit të hekurudhave, në tregtinë e import-eksportit dhe në krijimin e bankave shqiptaro-jugosllave”.²⁵⁸

Komiteti Qendror i Partisë e argumentoi marrëveshjen ekonomike me Jugosllavinë si një hap themelor për sigurinë ekonomike të vendit pasi, sipas tyre, krijonte kushtet “për krijimin e një ekonomie të organizuar dhe përparuar, për të zhdukur disnivele midis regjimit politik dhe prapambetjes ekonomike, për forcimin dhe konsolidimin e pushtetit, lidhjen e proletariatit me pushtetin, forcimin e fuqive demokratike etj”.²⁵⁹ Ata e konsideronin këtë marrëveshje jo të rastësishme, por si “një shtysë për zhvillimin e vendit në rrugën e drejtë dhe si një vepër largpamëse”.²⁶⁰

Në nëntor 1948, gazeta “Luftëtari” shkruante se “Në krijimin e këtyre shoqërive të përbashkëta Jugosllavia do të ndihmonte duke bërë investime në drejtim të shtimit të prodhimit, i cili ishte në interesin tonë, të Jugosllavisë dhe të të gjithë kampit unik të socializmit. Por udhëheqja nacionaliste jugosllave kishte qëllime shfrytëzimi dhe kolonizimi. Ajo ishte kundra Bashkimit Sovjetik, kundra kampit unik të socializmit, vetvetiu edhe kundra nesh.”²⁶¹ Komisioni i Koordinimit luajti një rol të rëndësishëm, i cili do të funksiononte thujse si një qeveri e përbashkët ekonomike shqiptaro-jugosllave. Sipas gazetës “Luftëtari”, “Komisioni i Koordinimit të planeve ekonomike kishte si synim të hidhte në dorë de facto dhe de jure ekonominë tonë dhe të zhdukte independencën ekonomike të Shqipërisë, pra të merrte në dorë drejtimin ekonomik të shtetit”.²⁶² Jugosllavia përfitoi nga zhvillimi i një raporti të padrejtë të import-eksporteve me Shqipërinë. Ajo parashikonte që Shqipëria të hiqte dorë nga monopoli mbi tregtinë e jashtme, sepse “të gjitha operacionet e import-eksportit do të realizoheshin ekskluzivisht nga organizmat jugosllave”.²⁶³ Traktati i Miqësisë dhe Ndihmës Reciproke midis RP të Shqipërisë dhe RPF të Jugosllavisë, i nënshkruar në korrik të vitit 1946, me qëllim

²⁵⁸ Çelo Hoxha, *Fillimet e Diktaturës Komuniste në Shqipëri 1944-1948*, Tiranë, Botimet: West Print, 2013, f. 106.

²⁵⁹ *AQSH*, AKQ/PKSH, Fondi 14, dosja nr. 170, viti 1946, fl. 2. *Shënim*: radiogram i shkruar nga Koçi Xoxe për Komitetin Qarkor të Kukësit.

²⁶⁰ *Po aty*, fl.3.

²⁶¹ Gazeta “Luftëtari”, 17 nëntor 1948.

²⁶² *Po aty*.

²⁶³ N. Smirnova, *Historia e Shqipërisë...*, f. 328.

përforcimin e mëtejshëm të bashkëpunimit mes dy vendeve u mbështet nga Bashkimi Sovjetik, pasi Jugosllavia kishte vepruar sipas direktivave të tyre. E përditshme jugosllave “Borba” shkruan më 13 korrik 1946 se “*Padyshim traktati shqiptaro-jugosllav përfaqëson një kontribut me rëndësi të madhe për sigurimin e integritetit dhe të pavarësisë së Shqipërisë... Popujt tanë sot e dinë mirë se me përkrahjen e tyre ndaj Shqipërisë forcojnë një vend aleat... përforcon edhe paqen në Ballkan*”.²⁶⁴ Lidhur me marrëdhëniet e popullit shqiptar kundrejt popujve të Jugosllavisë, mund të themi se me traktatin u realizua *de jure* ajo çka popujt e këtyre vendeve kishin bërë *de facto* gjatë Luftës Nacionalçlirimtare dhe pas çlirimit. Por vende të tjera europiane, si Turqia, Italia etj., nuk e mbështetën këtë traktat, e konsideruan, ashtu siç edhe ishte në të vërtetë, si zaptim të Shqipërisë nga Jugosllavia. Para nënshkrimit të traktatit, në qershor 1946, gazeta turke “Vakit” shprehej se “Jugosllavia po ndiqte politikën e Musolinit për zgjerim në detin Adriatik dhe më tej në të gjithë Detin Mesdhe”.²⁶⁵ Në titujt e gazetave italiane lexoje “*Jugosllavia ka kapërdirë Shqipërinë*”, “*Titoja do të dominojë në Ballkan, Shqipëria është zhdukur si shtet kombëtar*”, “*Shqipëria në gjirin e federatës jugosllave*” etj.²⁶⁶ “Elinikon Vima”, më 14 korrik 1946 shkruante se “*Traktati Shqiptaro-Jugosllav përfaqëson provokimin e ngritur kundër Greqisë dhe Organizatës së Kombeve të Bashkuara (OKB), ky traktat mund të bëhet shkak i zjarrit të tmerrshëm në Ballkan*”.²⁶⁷ “Observër”, më 8 gusht 1946 shkruante se “*mbi miqësinë e Jugosllavisë dhe Shqipërisë duhet parë paramanovra për krijimin e Federatës Jugosllave, e cila do të përfshinte Shqipërinë dhe do të mundësonte propagandën e Beogradit të parashikojë bashkimin e Tiranës si shpërblim për humbjen e Triestes*”.²⁶⁸ Të gjitha këto tregojnë se vendet europiane e perceptuan rrezikun e mundshëm që i kanosej Shqipërisë dhe Ballkanit nga interesat jugosllave. E kundërta ndodhte me shtypin vendas. Në kryeartikullin e gazetës “Bashkimi”, më 14 korrik 1946 shkruhej se “*Traktati i Miqësisë dhe i Ndhmës Reciproke, siguri për të ardhmen tonë*”.²⁶⁹

Mbështetja pro-jugosllave e udhëheqjes shqiptare, kushtet e vështira ekonomike dhe politike të vendit bënë që Shqipëria të miratonte çdo sipërmarrje jugosllave. Më 3 tetor 1946 u nënshkrua në Beograd një protokoll midis përfaqësuesve shqiptarë dhe jugosllavë, ku shkruhej se “*Banka e Shtetit Shqiptar vinte në dispozicion të Bankës Kombëtare Jugosllave një kredi në dollarë amerikanë në shumën 1.390.000*”.²⁷⁰ Kjo kredi do të shërbente si garanci për eksportimet jugosllave në Shqipëri, por në të vërtetë ishte tregues i interesave anti-shqiptare të udhëheqjes jugosllave. Kjo e fundit “kërkonte të godiste rëndë zhvillimin ekonomik dhe të pengonte ndërtimin e socializmit në

²⁶⁴ V. Dedijer, *Marrëdhëniet Shqiptaro-Jugosllave...*, f.140.

²⁶⁵ *Po aty*, f. 141.

²⁶⁶ Ç. Hoxha, *Fillimet e Diktaturës Komuniste në Shqipëri...*, f.102.

²⁶⁷ V. Dedijer, *Marrëdhëniet Shqiptaro-Jugosllave...*, f.143.

²⁶⁸ *Po aty*, f.144.

²⁶⁹ *Marrëdhëniet shqiptaro-jugosllave... Dokumente*, përgatitën N. Plasari dhe L. Malltezi, f.49.

²⁷⁰ Bashkim Trenova, ‘*Studime Historike*’, vëll. III, 1990, fq.58.

Shqipëri”.²⁷¹ Më 27 nëntor 1946 u nënshkrua Konventa Ekonomike mes Shqipërisë dhe Jugosllavisë me përfaqësues Naku Spiron, si ministër i Ekonomisë në Shqipëri dhe Boris Kidriçi, si Presidenti i Këshillit Ekonomik dhe ministër i Industrisë. Kjo konventë u quajt “Marrëveshja e Madhe Ekonomike, që parashikonte koordinimin e planeve ekonomike, barazimin e monedhës dhe bashkimin doganor”. Nevoja e Shqipërisë për ndihma ishte e lartë, për shkak të mungesës së kapaciteteve të nevojshme për të rindërtuar vendin dhe refuzimit të ndihmave që mund të vinin nga Plani Marshall. Në kushte të tilla, fqinji i saj Jugosllavia shihej si mundësia më e mirë për të siguruar ndihmat e nevojshme për vendin. I quajtur ndryshe Traktati i Koordinimit të Planeve Ekonomike, Bashkimit Doganor dhe Barazimit të Monedhave, ai ishte i vlefshëm për 20 vjet dhe zgjaste çdo vit, “nëse njëra nga palët kontraktuese nuk lajmëronte qëllimin e saj për denoncimin e këtij traktati, 12 muaj para skadimit të periudhës pesëvjeçare në vijim”.²⁷² Zbatimi i këtyre marrëveshjeve nuk rezultoi aq i thjeshtë sa nënshkrimi i tyre, pasi qeveria jugosllave kërkonte ta vinte ekonominë shqiptare nën funksion të ekonomisë jugosllave dhe “synimi përfundimtar i kësaj të fundit ishte afrimi dhe përfshirja e Shqipërisë brenda Federatës Jugosllave”.²⁷³

Megjithatë, kryeministri i Serbisë, Bllagoje Neskovic, u shpreh se “marrëveshja nuk është drejtuar kundra askujt, por mbron vendin tonë dhe Shqipërinë nga ata që kanë tendenca imperialiste... kjo marrëveshje është një ndihmë e madhe për përforcimin e paqes në Ballkan dhe Europë”.²⁷⁴ Në fjalën përshëndetëse të Enver Hoxhës, mbajtur për këtë qëllim, ai u shpreh: “Traktati me Jugosllavinë është akti më i rëndësishëm që bën qeveria jonë në lëmin ndërkombëtar... Është një grusht i fortë që iu jepet imperialistëve... do të shërbejë si një bazë për bashkëpunim sa më të gjerë ekonomik e kulturor ndërmjet dy vendeve.”²⁷⁵

Kjo marrëveshje u diskutua edhe në plenumin e mbajtur më 22 dhjetor 1946. Sipas argumenteve të paraqitura në plenum, kjo marrëveshje do të thoshte hyrje në një fazë të zhvillimit dhe përparimit; do të forconte marrëdhëniet vëllazërore ndërmjet dy popujve.²⁷⁶ Udhëheqja shqiptare në këtë plenum e cilësoi nënshkrimin e konventës ekonomike ndërmjet Jugosllavisë dhe Shqipërisë si “çimentimin e bashkëpunimit dhe vëllazërimit me popujt e Jugosllavisë”.²⁷⁷ Më tej, në të njëjtën kohë me nënshkrimin e konventës ekonomike me Jugosllavinë, qeveria shqiptare hartoi edhe planin pesëvjeçar të ekonomisë shqiptare në vitin 1947, sipas modelit të adoptuar nga vendet e bllokut komunist. Ajo synonte “rritjen e nivelit të jetesës të masave punonjëse, si dhe zhvillimin e nivelit

²⁷¹ Enver Hoxha, *Vepra*, Vëll.V, Tiranë, f.515.

²⁷² AMPJ, dosja nr. 167, viti 1946, f. 29.

²⁷³ *Historia e Popullit Shqiptar...*, vëll.4, f. 238.

²⁷⁴ Gazeta Bashkimi, ‘Presidiumi i asamblesë popullore të Jugosllavisë ratifikoi Traktatin mbi Kordinimin e Planeve Ekonomike, Bashkimit Doganor dhe Barazimin Monetar’, Tiranë, 29 dhjetor 1946.

²⁷⁵ *Po aty*.

²⁷⁶ *AQSH*, AKQ/PKSH, Fondi 14, dosja nr. 170, viti 1946, fl. 5.

²⁷⁷ *Po aty*, fl. 11.

ekonomik në vend”.²⁷⁸ Pala jugosllave ushtroi shumë presion, në lidhje me barazimin/parifikimin e monedhave, për të cilën, pala shqiptare nuk ra dakord në parim. Kjo e fundit “argumentoi se kjo praktikë do të haste shumë pengesa dhe do të rezultonte jo reale”.²⁷⁹ Sipas një komunikimi mes Koçi Xoxes dhe Nako Spiros, ky i fundit shprehet se parifikimi, domethënë “barazimi i vlerës së lekut me dinarin do të ishte i vështirë, pasi një gjë e tillë duhet të ndodhte vetëm nëse ose kur të rimëkëmbej plotësisht ekonomia shqiptare”.²⁸⁰ Në gazetën “Luftëtari” të asaj kohe shkruhej se “*Ne, të këshilluar dhe të ndihmuar konkretisht edhe nga shokët sovjetikë, kemi qenë kundër kësaj reformë monetare edhe pasi është firmosur Konventa*”.²⁸¹ Më tej ata argumentuan se kjo reformë monetare do të shkaktonte edhe shumë probleme të tjera ekonomike dhe sociale në vend. Raporti i këmbimit ndërmjet monedhës shqiptare dhe asaj jugosllave u bë mbi baza krejtësisht arbitrare. “Raporti real ekzistues në atë kohë ishte 1 frang shqiptare baras me 12.5 dinarë, ndërsa në këtë marrëveshje u caktua 1 frang shqiptare baras me 9 dinarë”.²⁸² Për këtë çështje, Gogo Nushi, anëtar i Byrosë Politike, u shpreh se Shqipëria në këtë formë do të dëmtohej 12.5 herë më shumë. Konventa parashikonte “zhvlerësimin e lekut shqiptar në nivelin e dinarit jugosllav, përshtatjen e çmimeve të mallrave sipas sistemit jugosllav të çmimeve, eliminimin e doganës në kufirin mes Shqipërisë dhe Jugosllavisë duke përdorur tarifat doganore jugosllave”.²⁸³ Dëmet që iu shkaktuan Shqipërisë nga barazimi fiktiv i dy monedhave qenë të mëdha.

“Gjatë viteve 1947-1948, ekonomia shqiptare humbi rreth 882 milionë lekë, si pasojë e përpjesëtimit të lekut me dinarin në dëm të monedhës vendase.”²⁸⁴ Njësimi i çmimeve në të dyja vendet përbente një problem tjetër të marrëveshjeve ekonomike mes tyre. U ra dakord që mallrat të shkëmbeheshin me çmimet e brendshme, dhe jo me ato të tregut ndërkombëtar. Për vitin 1947 u vendos të aplikoheshin çmimet në dinarë për shkëmbimin e mallrave, pra çmimet e unifikuara të brendshme të Shqipërisë dhe Jugosllavisë. Sipas tyre, “*për mallrat e prodhuara në Shqipëri dhe që përdoren në Jugosllavi si lëndë e parë ose konsumi dhe paralelisht edhe për ato mallra që do të prodhohen në Jugosllavi dhe do të eksportohen në Shqipëri, do të zbatohen çmimet e brendshme jugosllave*.”²⁸⁵ Kjo iu mundësoi jugosllavëve të kishin dorë të lirë për t’i imponuar Shqipërisë çmime sa më të ulëta për prodhimet e tyre, në mënyrë që Jugosllavia t’i përfitonte ato sa më lirë. Shqipëria nuk mund t’i diskutonte çmimet e prodhimeve që vinin nga Jugosllavia, që rezultonin shumë të larta për t’u përballuar nga vendi në atë

²⁷⁸ Po aty, Fondi 14, dosja nr. 308/5, viti 1947, fl.8. **Shënim:** marrë nga *Gazeta Zyrtare*, Nr. 78, Viti 1947, f. 4.

²⁷⁹ Gogo Nushi, *Vepra të zgjedhura*, vëll.I, Tiranë, Botimet: ‘8 Nëntori’, 1980, f.309.

²⁸⁰ *AQSH*, AKQ/PKSH, Fondi 14, dosja nr. 12, viti 1946, fl. 12.

²⁸¹ Gazeta “Luftëtari”, 17 nëntor 1948.

²⁸² *AQSH*, Fondi 495, dosja nr. 72, viti 1948, fl.3.

²⁸³ V. Dedijer, *Marrëdhëniet Jugosllavo-Shqiptare...* f. 62-64.

²⁸⁴ *AQSH*, Fondi. 505, viti 1949. **Shënim:** Relacion mbi marrëdhëniet ekonomike midis Shqipërisë dhe Jugosllavisë (1945-1948), Tiranë, qershor, 1949, f.72-73.

²⁸⁵ *AQSH*, Fondi 503, dosja nr. 85, viti 1947, fl.3.

kohë. Konventa Ekonomike parashikoi edhe bashkimin doganor të Shqipërisë me Jugosllavinë, proces që shihej nga këndvështrime të ndryshme nga qeveritë e dy vendeve. Mendimi i jugosllavëve për unionin doganor ishte që të hapeshin kufijtë dhe ndërmarrjet tregtare “*të ndershme*”²⁸⁶, siç i cilësonin ata, mund të vinin nëpër qytete të Shqipërisë dhe të blinin prodhime që ishin në treg të lirë për t’i çuar në Jugosllavi. Politika e unifikimit në sferën e ekonomisë së dy sistemeve, në të vërtetë nënkuptonte përsheptimin e krijimit të federatës jugosllave, me bindjen se për këtë “*ka ardhur koha dhe janë pjekur kushtet*”.²⁸⁷ Interesat e Jugosllavisë në Konventën Ekonomike ishin të qarta, ata donin të shfrytëzonin sa të mundnin tregun dhe pasuritë e Shqipërisë dhe në këmbim të jepnin gjëra minimale e të pallogaritshme. Varësia ekonomike ndaj shtetit jugosllav do ta çonte Shqipërinë në varësi jo vetëm politike, por edhe ekonomike, gjë që do e çonte edhe drejt humbjes së sovranitetit të saj, për të cilin kishte luftuar aq shumë. Kjo shihet qartë dhe nga marrëveshja doganore, në të cilën pala jugosllave cilësonte se “*Mbi territorin doganor unik do të jenë në fuqi tarifat dhe sistemet doganore që ekzistojnë në Republikën Federative Popullore të Jugosllavisë.*”²⁸⁸ Shkrimi e kufijve doganorë midis dy vendeve ishte një hap serioz paraprak për shuarjen më vonë edhe të kufijve politikë dhe shtetërorë midis tyre. Për këtë çështje, në gazetën “Luftëtari” në atë kohë shkruhej se, “*Pa i ditur akoma qëllimet e errëta të PKJ-së, qeveria jonë e quajti të padrejtë çështjen e parifikimit të monedhës dhe të unifikimit të çmimeve; çështje të rëndësishme dhe principale që më vonë koha e tregoi se sa të drejta ishin propozimet tona dhe cilat ishin qëllimet e udhëheqjes trockiste jugosllave*”²⁸⁹

Me këtë marrëveshje Jugosllavia po merr mbi vete detyrime të mëdha serioze ndaj Shqipërisë. Milovan Gjilasi, ministër në qeverinë jugosllave, kishte thënë se “*Bashkimi doganor ndërmjet Jugosllavisë dhe Shqipërisë në të vërtetë do të thotë forcim i pavarësisë së Shqipërisë, forcim i barazisë së saj me Jugosllavinë dhe me vendet e tjera*”.²⁹⁰ Teksti i Konventës Ekonomike nuk u publikua në kohën e nënshkrimit, por “u bë i njohur pas prishjes së marrëdhënieve me Jugosllavinë”.²⁹¹ Nako Spiro, duke qenë pjesëmarrës në punën për realizimin e marrëveshjeve, e shikonte nga afër efektin e “*litarit që ajo do të kishte në fytyrën e Shqipërisë*”²⁹² dhe, përveç kësaj, si nënshkrues i marrëveshjes, ai ishte personi direkt përgjegjës përballë historisë për dorëzimin e pavarësisë së vendit me vullnet të lirë. Më tej, me intensifikimin e marrëdhënieve ekonomike të të dy vendeve, “në Shqipëri u krijuan 6 shoqëri të përbashkëta jo me kapitale të përbashkëta, por mbi bazën e kapitaleve shqiptare”.²⁹³ Në këto marrëveshje u vendos krijimi i shoqërive për ndërtimin e

²⁸⁶ Gazeta “Luftëtari”, 17 nëntor 1948.

²⁸⁷ B. Petranoviç, *Balkanska Federacija...*, f.160.

²⁸⁸ *AQSH*, Fondi 505, dosja 1, viti 1947, f.4.

²⁸⁹ Gazeta “Luftëtari”, 17 nëntor 1948.

²⁹⁰ A. Zogaj, *Marrëdhëniet shqiptaro-jugosllave...*, f.130.

²⁹¹ Tajar Zavalani, *Historia e Shqipërisë*, Tiranë: Phoenix & Shtëpia e Librit, 1998, f. 339.

²⁹² Ç. Hoxha, *Fillimet e Diktaturës Komuniste në Shqipëri...*, f. 111.

²⁹³ *Po aty*.

hekurudhave, për nxjerrjen dhe prodhimin e naftës, për zbulimin dhe shfrytëzimin e mineraleve dhe përdorimin e metaleve, për elektrifikimin dhe shfrytëzimin e energjisë elektrike, krijimi i shoqërive tregtare të import-eksportit dhe të Bankës Shqiptaro-Jugosllave. Zbatimi i kësaj marrëveshjeje duhet thënë se ndeshi në vështirësi të mëdha. Enver Hoxha do të shprehej se realizimi i traktateve dhe marrëveshjeve po ecte shumë ngadalë, për faj të palës jugosllave. “*Të krijohet përshtypja sikur të gjitha traktatet dhe marrëveshjet ekonomike shqiptaro-jugosllave janë përfunduar pa një studim mjaft të thellë të çështjeve. Prandaj realizimi i tyre ndesh në një sërë vështirësish.*”²⁹⁴

Qeveria jugosllave u përpoq ta orientonte ekonominë shqiptare në funksion të tregut jugosllav dhe të zhvillimit ekonomik të Jugosllavisë. Kjo pasqyrohet edhe në pretendimin e jugosllavëve që, me anë të Shoqërisë së Përbashkët të Import-Eksportit, pala shqiptare t’iu linte në dorë jugosllavëve jo vetëm tregtinë e jashtme të Shqipërisë me Jugosllavinë, por edhe tregtinë e jashtme të Shqipërisë me vendet e tjera. Në këtë kuadër, Shqipëria duhej të caktonte vetëm kontingjentin e mallrave që do të eksportohehin. Për sa i takon eksportit, çmimet e shitjes në vendet e tjera do të vendoseshin nga jugosllavët. “Jugosllavia u mundua që të shkëpuste lidhjet ekonomiko-tregtare të Shqipërisë me vendet e tjera, duke e izoluar atë rrjedhimisht nga bota e jashtme.”²⁹⁵ Nga ana tjetër, edhe jugosllavët huazuan modelin sovjetik të organizimit të ekonomisë, të cilin ia imponuan në mënyrë identike edhe qeverisë komuniste shqiptare.

Zbatimi i marrëveshjeve dypalëshe të nënshkruara po ndeshte gjithnjë e më shumë në pengesa. Jugosllavia duhej të investonte në vitin 1947 për shoqëritë e përbashkëta një shumë prej 600 milionë lekësh, kryesisht për makineri dhe pajisje. Këto investime nuk u realizuan asnjëherë. “Pala jugosllave duhej të merrte pjesë në shoqërinë e naftës me mjete dhe me ndihmë teknike për të shtuar prodhimin e naftës, por fondet që ajo derdhi nuk përfaqësonin veçse 0.81% të fondeve të përgjithshme të kësaj shoqërie”.²⁹⁶ Përveç mungesës së kontributit në këtë shoqëri, pala jugosllave po mendohej madje të pengonte edhe në zhvillimin e distilerve të naftës, “duke pretenduar që përpunimi i naftës të bëhej në Jugosllavi dhe po kjo naftë t’i shitej Shqipërisë me çmime shumë herë më të larta. Dukuri të tilla u vunë re edhe në Shoqërinë e Kërkimit dhe Shfrytëzimit të Mineraleve, ku pala jugosllave me spekulime dhe përgënjeshtime iu shmangej gjithmonë detyrimeve të saj”.²⁹⁷ Kulmi arriti në maj të 1947-s, kur Beogradi i kërkonte Tiranës zotërimin e pronave të shqiptarëve të dënuar në Jugosllavi si “kriminelë luftime”. Këta të dënuar kryesisht “ishin

²⁹⁴ *Shqipëria në dokumentet e arkivave ruse...*, përgatitën I. Lauka dhe E. Ymeri, f. 150.

²⁹⁵ I. Fishta dhe M. Ziu, *Historia e Ekonomisë së Shqipërisë 1944-1960...*, f.270.

²⁹⁶ *AQSH*, Fondi 505, viti 1949, fl.8. *Shënim:Relacion mbi marrëdhëniet ekonomike ndërmjet Shqipërisë dhe Jugosllavisë (1945-1948)*.

²⁹⁷ I. Fishta dhe M. Ziu, *Historia e Ekonomisë së Shqipërisë...*, f.217.

shqiptarë, ish-shtetas jugosllavë që kishin pasur detyra të ndryshme shtetërore në Shqipëri gjatë kohës së luftës”.²⁹⁸

Një marrëveshje tjetër e një rëndësie të lartë ishte edhe ajo e nënshkruar më 12 qershor 1947, ku qeveria jugosllave i jepte Shqipërisë një kredi pre 2 miliardë lekësh. Kjo kredi u realizua pjesërisht. Kjo gjë “pohohet edhe në një procesverbal të mbajtur në Beograd në maj të vitit 1948, ku ishte kryer një llogaritje mbi bazën e shqyrtimit të pjesshëm të dokumenteve”.²⁹⁹ Mosdhënia e kësaj kredie, kur vendi ishte në një gjendje shumë të rëndë ekonomike, e detyroi qeverinë shqiptare të shfrytëzonte rezervat e fundit të lëndëve të para, materialet e ndërtimit dhe mallrat e konsumit të gjerë.

Në fakt, gjendja e rëndë ekonomike në Shqipëri ishte rrjedhojë e reformave ekonomike të qeverisë, të cilat konsistonin në prishjen e strukturave ekzistuese ekonomike. Deri në vitin 1947, furnizimi i tregut me mallrat e nevojshme ushqimore ishte më tepër pasojë e stoqeve të mëdha që u gjenden nga lufta në Shqipëri, sesa rezultat i prodhimit të brendshëm të asaj periudhe. “Pala jugosllave nuk e furnizonte Shqipërinë me materialet dhe makineritë e nevojshme. Edhe kur ajo e bënte një gjë të tillë, sasitë minimale që dërgoheshin nuk realizoheshin brenda afateve të përcaktuara.”³⁰⁰“Qeveria jugosllave u orvat të merrte në dorë edhe industrinë shqiptare të elektrikut, duke çimentuar në këtë formë varësinë totale të Shqipërisë. Por kjo nuk u lejua nga qeveria shqiptare.”³⁰¹

Në rrethana të tilla, Nako Spiro, ministër i Ekonomisë, pasi u konsultua dhe me Enver Hoxhën i kërkoi qeverisë jugosllave që t’i respektonte marrëveshjet e nënshkruara, të paktën ashtu siç ishin. Mirëpo kërkesat e Nakos krijonin bezdi në udhëheqjen jugosllave, pasi ato binin ndesh me planet e saj për bashkimin sa më të shpejtë të Shqipërisë me Jugosllavinë. Në këtë situatë udhëheqja e Beogradit po vërente se planet e saj për aneksimin sa më shpejt ekonomik dhe politik të Shqipërisë nuk po ecnin sipas parashikimeve të saj. Me qëllim që të ushtronte trysni mbi udhëheqjen e PKSh, për të hequr dorë nga rezistenca anti-jugosllave, në korrik 1947 udhëheqja e Beogradit e akuzoi Nako Spiron, nëpërmjet të dërguarit të saj në Tiranë, Savo Zllatic, se marrëdhëniet shqiptaro-jugosllave ishin tronditur dhe se përgjegjëse ishte udhëheqja e partisë dhe e shtetit shqiptar. Kjo e fundit, në politikën e marrëdhënieve shqiptaro- jugosllave, veçanërisht në fushën ekonomike, kishte bërë që “të kristalizoheshin dy vija: vija teorike, e cila ishte e drejtë, dhe vija praktike, e cila sipas jugosllaveve ishte ‘anti-jugosllave’, në kundërshtim me atë të KQ-së dhe të PKSh-së”.³⁰²Koçi Xoxe u bashkua me pikëpamjen jugosllave dhe këmbënguli që Nako Spiro, si ministër i Ekonomisë dhe përgjegjës i saj të jepte shpjegime në Byronë Politike. Akuza e

²⁹⁸ AQSH, Fondi 588, Dosja nr. 7, viti 1947, fl. 1-3.

²⁹⁹ AQSH, Fondi 506, *Procesverbali mbi përdorimin e kredisë prej 2 miliardë lekësh, nënshkruar në Beograd më 12 qershor 1947.*

³⁰⁰ AQSH, Fondi 505, *Relacion mbi marrëdhëniet ekonomike ndërmjet Shqipërisë dhe Jugosllavisë...*, fl.166.

³⁰¹ AQSH, Fondi 495, dosja nr. 55, viti 1947. **Shënim:** Dokument me lëndë ‘Shoqëria shqiptaro-jugosllave e Elektrikut’.

³⁰² Enver Hoxha, *Titistët*, Tiranë, Botimet: 8 Nëntori, 1982, f. 304.

Beogradit ishte e rëndë. Savo Zalltic u pozicionua duke u shprehur se “Në të gjithë këtë situatë ka luajtur rol shkatërrimtar Nako Spiro me qëndrimet e tij të anti-jugosllavizmit në Shqipëri, si agjent i imperializmit, prandaj çështja e tij duhej të shihej më mirë”.³⁰³

Enver Hoxha, për të shmangur trysninë e jugosllaveve që synonin, në radhë të parë largimin e tij nga udhëheqja e vendit, ia arriti më së fundi që, në korrik 1947 të bënte vizitën zyrtare të kërkuar me insistim në Moskë dhe të takohej me Stalinin. Ai shkoi në Moskë për të siguruar mbështetje dhe ndihmë ekonomike, por edhe për të forcuar pozitat e tij. Në përfundimin e këtyre bisedimeve u ra dakord që BRSS t’i jepte RPSH një kredi për pajisjen e bujqësisë me traktorë dhe për ndërtimin e veprave industriale. Nga ana tjetër, udhëheqja jugosllave u përpoq ta pengonte këtë marrëveshje. Madje, ajo shkoi aq larg sa “përfaqësuesi i Jugosllavisë në Moskë i kërkoi përfaqësisë shqiptare t’i dorëzoheshin kopjet e marrëveshjes, duke u shprehur në mënyrë kërcënuese se asgjë nuk duhej përfunduar pa pëlqimin e qeverisë jugosllave”.³⁰⁴

Në fillim të nëntorit 1947, Komiteti Qendror i PKJ i përcolli udhëheqjes së PKSh akuzën e dytë ku, ndër të tjera theksohej se në Shqipëri po kristalizohej një qëndrim e një orientim anti-jugosllav. Sipas tyre, duheshin parë shkaqet që marrëdhëniet midis Shqipërisë dhe Jugosllavisë nuk ishin të kënaqshme. Në letrën e Beogradit, Nako Spiro bëhej përgjegjës për vështirësitë e krijuara në këtë drejtim. Në fund jugosllavët kërkuan që të plotësoheshin kërkesat e tyre, në rast të kundërt do të detyroheshin që të rishikonin marrëveshjet ekonomike me Shqipërinë. I ndodhur përballë akuzave të rënda dhe pa mbështetjen e Byrosë Politike, i braktisur dhe nga sovjetikët, më 20 nëntor 1947, në prag të një mbledhjeje të Byrosë, Nako Spiro vrau veten. Edhe në muajin dhjetor të 1947, kur delegacioni shqiptar shkoi në Sofje për nënshkrimin e Traktatit të Miqësisë me Bullgarinë, udhëheqja e PKJ-së u përpoq ta pengonte lidhjen e këtij traktati dhe, kur nuk e arriti një gjë të tillë, u mundua që në hartimin e traktatit të përmendej se veprimet e përbashkëta të Shqipërisë dhe Bullgarisë duhet të merrnin pëlqimin paraprak të Jugosllavisë. Kjo kërkesë e udhëheqjes jugosllave, që u përkrah me këmbëngulje nga Koçi Xoxe, u hodh poshtë nga Enver Hoxha. “Në pamundësi për ta ndaluar lidhjen e këtij traktati, udhëheqja jugosllave u mundua ndërkohë ta ulte rëndësinë e tij.”³⁰⁵

Në fillim të dhjetorit mbërritën në Tiranë tezat e Komitetit Qendror të PKJ për bashkimin ekonomik midis dy vendeve që do të çonte më pas në krijimin e Federatës Ballkanike. Byroja Politike e PKSh i miratoi propozimet jugosllave, të cilat përbënin një rrezik për pavarësinë e Shqipërisë. Në qershor të 1948, qeveria shqiptare kërkoi rishikimin e të gjitha marrëveshjeve të nënshkruara me Jugosllavinë, me përjashtim të Traktatit të Miqësisë dhe Ndihmës Reciproke. Meqenëse qeveria jugosllave e kundërshtoi këtë

³⁰³ Bernard Lory, *Europa Ballkanike nga 1945 në ditët e sotme*, Tiranë, Botimet: Dituria, 2007, f.57.

³⁰⁴ *Historia e Partisë së Punës së Shqipërisë*, Vëll. II, Instituti i Studimeve Marksiste-Leniniste pranë KQ-së së PPSH-së, Tiranë, Botimet: 8 Nëntori, 1981, f.228.

³⁰⁵ *Po aty*, f.229.

kërkesë, qeveria shqiptare i shfuqizoi këto marrëveshje. “Enver Hoxha kishte arritur t’i kuptonte qëllimet e vërteta të Titos dhe PKJ, dhe u shpreh hapur që jugosllavët synonin ta nënshtronin Shqipërinë ekonomikisht”.³⁰⁶ Nga fundi i vitit 1948 marrëdhëniet midis dy vendeve ishin në nivelin më të ulët të tyre.

Siç është thënë edhe më sipër, ndërhyrja jugosllave në Shqipëri i përfshiu të gjitha fushat, atë politike, ekonomike dhe ushtarake. Megjithatë, peshën më të madhe e pati mbi fushën ekonomike, e cila në thelbin e saj synonte t’i jepte edhe frytet më të mëdha palës jugosllave. “Jugosllavët ishin të ndërgjegjshëm se, duke e ‘privatizuar’ këtë sektor, pjesa tjetër do të ishte më e lehtë për t’u bërë. Në vitin 1947 u nënshkruan mbi 27 marrëveshje të tilla, qëllimi i të cilave ishte që të përgatitej terreni për futjen e Shqipërisë në Federatën Jugosllave.”³⁰⁷ Në bisedën me Enver Hoxhën, Stalini kishte shpjeguar arsyet pse ndihma sovjetike duhej të shkonte në Shqipëri përmes Jugosllavisë: “*Ne nuk mund t’ju ndihmojmë dot drejtpërdrejt. Ndihamat tona ne do t’ju japim nëpërmjet Jugosllavisë, sepse po t’ju japim drejtpërdrejt dhe po të marrin vesh për këtë anglo-amerikanët, atëherë ata do të përpiqen të bëjnë pengesa. Por ndihamat do të vijnë nëpërmjet Jugosllavisë*”.³⁰⁸ Në fakt, jugosllavët dëshironin të kishin një kontroll mbizotërues mbi Shqipërinë dhe nënëmbledhje Stalini i tha Titos se “ne vazhdimisht e shtyjmëardhjen e tyre në Moskë... Mëmirëne i ndihmojmë ata nëpërmjet jush”, ndërsa Tito iu përgjigj se “ne mund të realizojmë gjithçka me ata”.³⁰⁹

Pas vizitës në BRSS, Enver Hoxha ishte më i qetë nga takimet që kishte pasur me udhëheqjen sovjetike, sepse kësaj radhe ai kishte arritur që të krijonte afërsi politike me Stalinin, që në ato vitet e stuhishme Enver Hoxhës i garantonte mbrojtje nga kritikët dhe presionet jugosllave. Nga ana tjetër, Tito po bëhej gjithnjë e më nervoz dhe kërkonte që Koçi Xoxe të ishte më aktiv në realizimin e planeve për realizimin e marrëveshjeve të nënshkruara ekonomike midis Shqipërisë dhe Jugosllavisë, që shënonin edhe një hap drejt bashkimit të dy vendeve. Tito, po ashtu ndihej i shqetësuar për rolin gjithnjë e më aktiv të Stalinit, në lidhje me zhvillimet në Shqipëri dhe përpjekjet e shtuara për t’i kontrolluar, sa të ishte e mundur, marrëdhëniet shqiptaro-jugosllave. Koçi Xoxe, i cili kishte pasur rolin kryesor në eliminimin e vijës së moderuar partiake me në krye Sejfulla Malëshovën, e parandiente se po vinte çasti i tij për veprim. Enver Hoxha, ndonëse edhe vetë me orientim pro-jugosllav, e hetonte trimërimin e Koçi Xoxes dhe dalja hapur e jugosllavëve në anën e Xoxes, më në fund i krijoi Hoxhës bindjen se Titoja e kishte nisur betejën vendimtare për të shtënë nën kontroll të plotë udhëheqjen e PKSh. I gjendur në pozita të pafavorshme, për arsye të krijimit të lidhjeve të drejtpërdrejta të Enver Hoxhës me Stalinin, Tito u

³⁰⁶ N. Smirnova, *Historia e Shqipërisë...*, f. 336.

³⁰⁷ Tonnes. Bernhard, ‘*Sonderfall Albanien: “Enver Hoxhas "eigener Weg" und die historischen Ursprünge seiner Ideologie”*’, 1980, f.487.

³⁰⁸ A. Zogaj, *Marrëdhëniet shqiptaro-jugosllave...*, f.169.

³⁰⁹ Kaba.H & Ceku.E, *Shqipëria dhe Kosova në arkivat ruse 1946-1962*, Tiranë, Qendra e Studimeve Albanologjike, 2011, f.24

detyrua të kalojë në ofensivë politike, duke i shpeshtuar presionet mbi udhëheqjen e PKSh, dhe kështu i bëri padi të reja drejtpërdrejt Enver Hoxhës për vonesa të qëllimshme në realizimin e marrëveshjeve të nënshkruara midis Shqipërisë dhe Jugosllavisë. Tito e ndjente se po i rrezikohej privilegji i kontrollit mbi Shqipërinë. Prandaj, në nëntor të vitit 1947 Tito e bëri padinë e dytë brenda vitit kundër udhëheqjes së PKSh, duke e hedhur fajësinë mbi palën shqiptare për moszbatimin e marrëveshjeve ndërshtetërore. Vërejtjet e Titos ndaj KQ të PKSh dhe personalisht ndaj Enver Hoxhës, këtij të fundit ia kishte transmetuar gojarisht Savo Zllatic, në bisedën më 6, 7, 8 dhe deri më 18 nëntor 1947. Në bisedime, herë pas here kishte marrë pjesë edhe Koçi Xoxe, i cili kishte përkthyer bisedimet. Nga shënimet e datës 8 nëntor 1947, prej bisedës me Savo Zllaticin, del se kritikata jugosllave konsistonin në një varg pikash rreth çështjeve të marrëdhënieve shqiptaro-jugosllave të atyre viteve. Zllatic kishte konstatuar se ato marrëdhënie, sipas jugosllavëve *“Nuk janë të qarta, në vend që të jenë të ngushta. Konstatohet një rënie e dobët në lidhjet tona sidomos në ekonomi... Duhet të themi se njerëzit shqiptarë nuk përfitojnë dhe nuk e marrin ndihmën e jugosllavëve dhe ka njerëz që kanë frikë nga ky bashkëpunim. Kemi përshtypjen që, në vend të përpjekjeve të përbashkëta për të kapërcyer pengesa, te disa shokë shqiptarë ka një qëndrim jo konstruktiv.”*³¹⁰ Zllatic kishte kritikuar edhe nivelin e dobët të bashkëpunimit shqiptaro-jugosllav në sferën e kulturës, duke cilësuar: *“Ne s’jemi të kënaqur me këto marrëdhënie, të cilat janë shumë të këqija, dhe ne ngremë pyetje se armiku këtë do dhe ai është i kënaqur.”*³¹¹

Gjatë Kongresit I të PKSh-së dukej qartë se tashmë marrëdhëniet ishin prishur. *“Enver Hoxha i akuzoi jugosllavët së më Konventën Ekonomike ata kishin dashur ta nënshtronin Shqipërinë dhe ta kthenin atë në një koloni të Jugosllavisë, të godisnin ekonominë shqiptare dhe të pengonin ndërtimin e socializmit në Shqipëri, të plaçkitnin Shqipërinë dhe ta izolonin atë nga Bashkimi Sovjetik.”*³¹² Ndërsa për Komisionin e Koordinimit, Enver Hoxha deklaroi se ai *“do të zhdukte de facto dhe de juro pavarësinë ekonomike të Shqipërisë, Jugosllavia do të merrte në dorë planifikimin e ekonomisë shqiptare, do të shkëputte nga drejtimi i qeverisë shqiptare shoqëritë e përbashkëta dhe do të merrte nën kontroll edhe ministritë shqiptare”.*³¹³ Prishja e marrëdhënieve me Jugosllavinë e shpëtoi Shqipërinë e vogël nga ‘gllabërimi’ ekonomik dhe më pas politik i Beogradit zyrtar.

³¹⁰ A. Zogaj, *Marrëdhëniet shqiptaro-jugosllave...*, f. 170.

³¹¹ *Po aty*, f. 170-171.

³¹² Ç. Hoxha, *Fillimet e Diktaturës Komuniste në Shqipëri...*, f. 105.

³¹³ *Po aty*, f. 107.

2.3 Qëndrimet pro dhe kundër vijës jugosllave

Qëndrimet “pro” dhe “kundër” u vunë re nga pala jugosllave që në vitin 1943, kur njëri prej udhëheqësve të PKJ, Vukmanoviç Tempo, akuzoi KQ të PKSh se po mbante një qëndrim oportunist ndaj bllokut komunist, akuzë që nuk u pranua nga Enver Hoxha. Më tej, vihet re se në vitin 1944 ndodhën plasaritjet e para dhe mosmarrëveshje lidhur me orientimin politik të Enver Hoxhës, Sejfulla Malëshovës, Ymer Dishnicës dhe Koçi Xoxes, për shkak se tre të parët u akuzuan si jo përkrahës të klasës proletare. Nga ana tjetër, Jugosllavia ndikoi përmes Dushan Mugoshës në zgjidhjen e këtij konflikti, duke e përjashtuar Ymer Dishnicën nga Komiteti Qendror i Partisë Komuniste të Shqipërisë. Në ndryshim nga Enver Hoxha, Koçi Xoxe dhe Sejfulla Malëshova mbështetën qëndrimin e Tempos dhe ishin të gatshëm për të zhvilluar një politikë të brendshme e të jashtme sipas direktivave të udhëheqjes jugosllave. Në këto momente, Hoxha mund të ketë menduar se udhëheqja jugosllave kërkonte që qeverinë shqiptare ta udhëhiqte një “pro” jugosllav si Koçi Xoxe, pasi kjo lëvizje iu shkonte për shtat interesave të tyre. Kështu, me ndihmën e Velimir Stoiniçit ata shfrytëzuan Plenumin e Beratit për të goditur figurën e Enver Hoxhës dhe për të ngritur lart atë të Koçi Xoxes. Edhe pse Enver Hoxha e hodhi poshtë kërkesën e Velimir Stoiniçit për të marrë pjesë në mbledhjen e Byrosë, Koçi Xoxe propozonte të kundërtën. Kjo mospërputhje vlerësimesh dhe këndvështrimesh midis Xoxes dhe Hoxhës shënon fillimin e procesit të përçarjes së Byrosë. Madje edhe vija organizative, sipas Koçi Xoxes, ishte e gabuar, sepse ishin mënjeluar shokë të nevojshëm nga funksionet drejtuese. Enver Hoxha dhe përkrahësit e tij ishin mbështetës të të dërguarve të parë në Jugosllavi, si Miladin Popoviçit dhe Dushan Mugosha. Këta të fundit u tërhoqën nga Shqipëria, duke qenë se mbanin një qëndrim të kundërt me atë të Titos, i cili synonte ta kthente Shqipërinë në Republikën e Shtatë të Jugosllavisë. “Këtë detyrë po e kryente më së miri Velimir Stojniçi, i cili së bashku me Nijaz Dizdareviçin drejtuan Plenumin II të Beratit, në nëntor të vitit 1944.”³¹⁴ Në këtë plenum u propozua përjashtimi i Enver Hoxhës nga drejtimi i Shtabit të Përgjithshëm dhe PKSh, pavarësisht se ai do të kthehej më vonë në sovranin e padiskutueshëm të shtetit. Ai e shihte këtë si skenar të iniciuar nga agjentët e huaj.

Drejtimi i politikës së jashtme të Shqipërisë u vendos përfundimisht në dhjetor të vitit 1945, në takimin e Byrosë Politike të Komitetit Qendror të Partisë Komuniste, ku qëndrimi i Sejfulla Malëshovës u konsiderua si oportunist dhe kundër një “*vëllazërie të shëndoshë me Jugosllavinë*”.³¹⁵ Po ashtu, Komiteti Qendror i PK Sovjetike do e quante Malëshovën si “*trockist*” dhe “*ideolog të restaurimit të kapitalizimit në Shqipëri*.”³¹⁶ Më tej, në vitin 1947, Komiteti Qendror i PK Sovjetike shkruante se në vitet e para të

³¹⁴Gazeta Dita, ‘EnverHoxha u planifikua të vritej para Plenumit të Beratit’, 25 shtator, 2015.

³¹⁵Marrëdhëniet shqiptaro-jugosllave..., Dokumente, përgatiti N. Plasari dhe L. Malltezi, f. 23-24.

³¹⁶Kaba.H & Ceku.E, Shqipëria dhe Kosova nëarkivat ruse 1946-1962, Tiranë, Qendra e Studimeve Albanologjike2011, f.38.

ekzistencës së PKSh, Sejfulla Malëshova, nën cilësinë e një intelektual, ishte orientuar drejt nxitjes së iniciativës private, dhe se Komiteti Qendror i PKSh e cilësonte BRSS nën cilësinë e një aleati krahas ShBA dhe Anglisë.³¹⁷

“Komiteti Qendror i PKJ shihte me shqetësim një klasë të mirarsimuar, e cila ishte e orientuar drejt Perëndimit.”³¹⁸ Për më tepër, garancia për pavarësinë dhe tërësinë territoriale e udhëheqjes shqiptare kërkohet sërish nga Perëndimi. Gjithsesi, shumica e përfaqësuesve në takimin e dhjetorit 1945 e vlerësonin partneritetin me Jugosllavinë si një kusht të domosdoshëm për ekzistencën e një “Shqipërie demokratike popullore”. Pro këtij qëndrimi ishin Nako Spiro, Enver Hoxha, Bedri Spahiu, Koçi Xoxe, Pandi Kristo dhe Tuk Jakova. Diplomacia jugosllave, e cila kishte ndihmuar në krijimin e Partisë Komuniste të Shqipërisë nuk kishte në plan që politika e jashtme e Shqipërisë të orientohej drejt vendeve si Italia. Kështu, ajo e kundërshtoi propozimin e Sejfulla Malëshovës, pasi Italia ishte jo vetëm një vend ish-okupator, por edhe një vend perëndimor, orientimi politik i së cilës binte ndesh me interesat e Jugosllavisë dhe Bashkimit Sovjetik. Megjithatë, “udhëheqja komuniste e asaj kohe kishte përkrahur një qëndrim oportunist ndaj anglo-amerikanëve, nxitur nga interesat për njohjen e qeverisë shqiptare nga aleatët perëndimorë, qëndrim që ishte vlerësuar si i domosdoshëm për vetë ekzistencën e kësaj qeverie”.³¹⁹ Po ashtu, sipas dëshmisë së jugosllavëve dhe Koçi Xoxes, “Enver Hoxha kishte një qëndrim miqësor ndaj Francës, si dhe kishte filluar marrëdhëniet diplomatike me Italinë”.³²⁰

Megjithatë, në maj të vitit 1946, Josip Xherxha, si përfaqësues jugosllav në Shqipëri, shkruan se “pas njohjes ndërkombëtare të shtetit dhe qeverisë shqiptare lëkundjet e udhëheqjes së vendit mes Lindjes dhe Perëndimit ndaluan dhe Shqipëria u pozicionua drejt Jugosllavisë dhe Bashkimit Sovjetik”.³²¹ Ky fakt u cilësua nga Komiteti Qendror i PKSh “si një faktor për përforcimin e pozitave demokratike në Ballkan”.³²² Të njëjtin qëndrim kritik që mbajtën jugosllavët lidhur me orientimin e Shqipërisë në politikën e jashtme, mbajti edhe Enver Hoxha në Plenumin V të Komitetit Qendror të PK të Shqipërisë në shkurt 1946. Sipas tij, “oportunizmi i Sejfulla Malëshovës kishte cenuar vëllazërinë me Jugosllavinë, partneriteti me të cilën shihej si kusht i ekzistencës së vendit”.³²³ Megjithatë, për Enver Hoxhën kishte rëndësi siguria jo vetëm e Lindjes por edhe e Perëndimit, në lidhje me njohjen e pavarësisë së Shqipërisë dhe mbrojtjen e kufijve territorialë të saj. Por qëllimi i ruajtjes së pushtetit nuk e lejoi Hoxhën që të zhvillonte një partneritet me Perëndimin dhe, si pasojë, të fitonte mbështetjen e këtyre të fundit. Sigurisht

³¹⁷Po aty.

³¹⁸ Aleksandar Zivotic, *Jugosllavija, Albanijai Velike Sile*, Beograd: Arhipelag, 2011, f. 88.

³¹⁹ *Marrëdhëniet shqiptaro-jugosllave...*, *Dokumente*, përgatitën N. Plasari dhe L. Malltezi, f. 23.

³²⁰ Ledion Krisafi, *Marrëdhëniet e Shqipërisë me Jugosllavinë 1945-1948*, Disertacion, Universiteti Evropian i Tiranës, 2016, fq. 31. Marrë nga: https://uet.edu.al/images/doktoratura/Ledjon_Krisafi.pdf.

³²¹ A. Zivotic, *Jugosllavija, Albanijai Velike Sile...*, f. 88.

³²² *AQSH*, AKQ/PKSH, Fondi 14, dosja nr. 9, viti 1945, fl. 24.

³²³ *AQSH*, Fondi 14/AP, dosja 1, viti 1946.

që Jugosllavia dhe Bashkimi Sovjetik nuk kishin kushte në lidhje me pluralizmin politik dhe garantimin e lirive dhe të drejtave të njeriut, kështu që ishte alternativa më e mirë në raport me Perëndimin.

Në Plenumin V, propaganda për dashuri dhe vëllazërim me Jugosllavinë, si përkrahësja kryesore në Luftën Nacionalçlirimtare ishte mjaft aktive. “Jo vetëm nuk duhet të kishte armiqësi mes vendeve, por duhej të fuqizohej bashkëpunimi në fushën politike, ekonomike, kulturore, atë të arsimit etj.”³²⁴ Jugosllavia përdorej nga Bashkimi Sovjetik si ndërmjetëse e marrëdhënieve të tij me Shqipërinë. Megjithatë, qëndrimet e udhëheqësve shqiptarë, si Enver Hoxha ndaj Jugosllavisë, perceptoheshin si të pasigurta, ashtu siç shkruan edhe Savo Zllatiç në korrik të vitit 1947. Pasiguria qëndronte në frikën për qëllimet e Jugosllavëve ndaj Shqipërisë. Ai thekson “dëshirën e udhëheqjes shqiptare për t’u lidhur drejtpërdrejt me Bashkimin Sovjetik, duke mos e rrezikuar sovranitetin shtetëror për shkak të marrëdhënieve të ngushta me Jugosllavinë. Bashkimi Sovjetik nuk e konsideronte të nevojshme diçka të tillë, duke qenë se mund ta realizonin gjithçka me shqiptarët përmes Jugosllavisë”.³²⁵

2.4 Koçi Xoxe në vijën e parë të frontit pro-jugosllav

Në fund të nëntorit 1944, kohë kur PKSh mori pushtetin, Koçi Xoxe ishte numri dy i kësaj partie, mes emrave si Enver Hoxha, Nako Spiro, Sejfulla Malëshova, Pandi Kristo, Tuk Jakova dhe Bedri Spahiu. Ai kishte poste të rëndësishme në qeverinë shqiptare pasi ishte njëkohësisht sekretari organizativ i partisë dhe drejtor i Drejtorisë së Mbrojtjes së Popullit. Kështu, “Koçi Xoxe kishte në dorë si emërimin e personave në poste partiako-shtetërore, ashtu edhe kontrollin e partisë dhe vendit me metoda policore, çka e bënte atë të plotfuqishëm”.³²⁶ Pozicionimi i një njeriu të vetëm në dy poste të tilla shtetërore ishte karakteristike e modelit partiako-shtetëror jugosllav. Sipas këtij modeli, ministri i Sigurimit të Shtetit kishte mundësi të kontrollonte kuadrot e Partisë.

Qysh në fillim të krijimit të PKSh, Koçi Xoxe ishte një politikan i veçuar nga Svetozar Vukmanoviç Tempo, përfaqësuesi personal i Josip Broz Titos në Republikën Socialiste të Maqedonisë. Tempo e bindi Titon se politika jugosllave në Shqipëri duhet të vihej në funksion të realizimit të projektit maqedonas. Koçi Xoxe u targetua nga Tempo, pasi vendlindja e tij, fshati Negovan, gjendej në atë pjesë të territorit të Greqisë që jugosllavët pretendonin t’ia bashkonin Republikës Jugosllave të Maqedonisë pas lufte. Kështu që, i dërguari jugosllav në Shqipëri, “Velimir Stoinic u instruktua të mbështeste

³²⁴ *Po aty.*

³²⁵ *Po aty.*

³²⁶ K.Myftaraj, *Jeta e Fshehur e Enver Hoxhës...*, f. 451.

klanin e Koçi Xoxes”,³²⁷ për të realizuar interesat jugosllave në Shqipëri. Stoiniçi theksoi se qëllimi i ardhjes së tij në Shqipëri ishte që t’i transmetonte shtabit tonë përvojën e shtabit jugosllav, të vendoste lidhje ‘të rregullta’ midis shtabeve dhe ushtrive të të dy vendeve, të ndihmonte në organizimin e mëtejshëm të ushtrisë sonë. Megjithatë, qëllimi i pranisë së tij në Shqipëri ishte që ta nënshtrohte PK Shqiptare dhe ta kthente atë në vegël të PKJ.

Ndërkohë që “Enver Hoxha hodhi poshtë kërkesën e Velimir Stoiniçit për të dëgjuar “*direktivat*” e tij”³²⁸ në një mbledhje të Byrosë Politike Shqiptare, duke e konsideruar këtë si një kërkesë në kundërshtim me normat e një partie më vete, Koçi Xoxe propozonte që delegati jugosllav të merrte pjesë në mbledhje. Në këtë mënyrë nisi edhe procesi i përçarjes së Byrosë, një situatë e njohur prej kohësh nga jugosllavët. “Për të mos mbajtur asnjë përgjegjësi për vijën “sektare” të partisë, ata e tërhoqën menjëherë edhe Dushan Mugoshën nga Shqipëria, në shtator-tetor të vitit 1944”.³²⁹

Koçi Xoxe, së bashku me Nako Spiron, ishin përkrahësit kryesorë të qëndrimit të mbajtur nga Velimir Stojniçi për ndryshimin e vijës së përgjithshme të PK të Shqipërisë, pasi, sipas tij, ajo ishte e gabuar. Në këtë mënyrë, kërkoheshin ndryshime rrënjësore të vijës ideologjike dhe udhëheqjes së PKSh. Velimi Stojniç ishte kreu i misionit ushtarak jugosllav në Shqipëri, i cili me mbështetjen e Koçi Xoxes në gjirin e KQ të PKSh përpunoi platformën e paraqitur në plenum kundër vijës marksiste-leniniste të kësaj partie. Ndërkohë, palët kundërshtarë të rritjes së ndikimit jugosllav në Shqipëri hodhën akuza se Jugosllavia po shkelte rregullat e marrëdhënieve të vendosura midis dy vendeve, duke ndërhyrë në punët e brendshme të Shqipërisë. “Sipas Enver Hoxhës, trockistët, pjesë e të cilëve ishte edhe Koçi Xoxe, kishin tre qëllime kryesore: vënien nën kontroll të partisë, sigurimit dhe ushtrisë.”³³⁰

Në diskutimet e zhvilluara në Plenumin e 23-24 nëntor 1944, Koçi Xoxe këmbënguli që në referat të pasqyrohej ndihmesa e Titos, “*për ecjen përpara të partisë sonë... ndihma shpëtimtare e shokëve jugosllavë, që nga themeli i partisë e deri më sot... që të dallojmë gabimet e mëdha të mëparshme e aktuale*”.³³¹ Në kushtet e pranimit të vijës së re të partisë, në këtë plenum Koçi Xoxe zhvilloi referatin e tretë mbi organizimin e punës. Ndërkohë, Enver Hoxha do të gjente shkaktarët dhe përgjegjësit e kësaj vije. Sipas tij, përgjegjësia binte mbi Komitetin Qendror, por në kushtet kur ky ishte pa përvojë, gabimet e konstatuara ishin të lidhura drejtpërdrejt me shokët jugosllavë, Miladinin dhe

³²⁷Po aty, f. 439.

³²⁸ Demir Dyrmishi, ‘*Studime Historike*’, Instituti i Historisë, Akademia e Shkencave e Republikës së Shqipërisë. Tiranë, 2003, fq. 80.

³²⁹Po aty, f. 81.

³³⁰ Enver Hoxha, *Raport në Kongresin e Parë të Partisë Komuniste të Shqipërisë mbi punën e Komitetit Qendror dhe detyrat e reja të partisë*, Botim i Komitetit Qendror të Partisë së Punës së Shqipërisë. Tiranë, 1948, f. 252.

³³¹ Demir Dyrmishi, ‘*Studime Historike*’, Instituti i Historisë, Akademia e Shkencave e Republikës së Shqipërisë. Tiranë, 2003, f. 82.

Dushanin, sepse kishin adaptuar prej tyre “*jo vetëm mënyrën e punës, por edhe mënyrën e mendimit*”.³³²

Koçi Xoxe takohej shpesh me palën jugosllave dhe ishte mjaft i angazhuar në politikën e jashtme. Nëse iu referohemi korrespondencave që përfaqësues të Jugosllavisë kanë pasur me qeverinë shqiptare dhe PKSh, “emri më i përmendur, për të mos thënë i vetmi, është ai i Xoxes. Një gjë e tillë mund të konfirmohet edhe në korrespondencat që Xoxe pati me përfaqësuesit e Ministrisë së Jashtme të Jugosllavisë gjatë vitit 1947, Rankoviç, Markos etj”.³³³ Të pasurit e një kontrolli të tillë mbi të gjitha çështjet e marrëdhënieve dhe politikës së jashtme i lejoi Xoxes edhe mundësinë e krijimit të marrëdhënieve të fshehura ose, thënë në një mënyrë më të qartë e të drejtpërdrejtë, i lejoi mundësinë të krijonte kontakte personale dhe t’i zhvillonte ato edhe për qëllime që ishin në kundërshtim me parimet e PKSh dhe udhëheqësve të saj. Ndër korrespondencat me persona të shumtë nga përfaqësuesit jugosllavë, spikat emri i Rankoviç, me të cilin Xoxe ka pasur një komunikim dhe bashkëpunim të vazhdueshëm gjatë vitit 1946. Njëpërmjet këtyre letërkëmbimeve, “Rankoviç e mban Xoxen të informuar mbi zhvillimet në Jugosllavi, mbi ligjet, gjendjen dhe trajtimin e gjeneralëve, oficerëve, admiralëve, të armatës jugosllave etj”.³³⁴ Në një letër, Rankoviç e këshillon Xoxen mbi qëndrimin dhe mënyrën e veprimit që duhet të mbajnë kundrejt “*miqve*” të tyre në Jugosllavi. Në po të njëjtën letër, “Rankoviç e informon Xoxen mbi vizitën e Filipoviç dhe kolonel Vojer Biljanoviç, duke theksuar që kjo ishte mundësia më e mirë për krijimin e një aparati të fshehtë, i cili do të ndiqte më pas çështjen e komunikimit dhe mbështetjes së “*miqve*” të tyre në Jugosllavi. Rankoviç nuk e anashkalon as faktin që ky është një hap shumë i rëndësishëm, i vështirë, dhe që kërkon një kujdes të jashtëzakonshëm. Përndryshe, pasojat do të ishin të mëdha për të dyja palët”.³³⁵

Interesi i palës jugosllave për të bashkëpunuar me Koçi Xoxen është i dukshëm edhe në një raport të Enver Hoxhës, sipas së cilit “Titoja kishte shprehur dëshirën për volinë e vizitës së Koçi Xoxes në Beograd, për t’u njohur me metodat e punës së Sekretarit Organizativ të PKJ”.³³⁶ Sigurisht që këto ishin disa prej momenteve të duhura që udhëheqja jugosllave të mund të ndikonte në mendimet dhe praktikat e asaj shqiptare. Në vitet e mëvonshme, Enver Hoxha do të deklaronte se “Koçi Xoxe, së bashku me Pandi Kriston, Kristo Themelkon etj., ishin fajtorë për politikën pro-jugosllave antishqiptare, edhe pse ai ishte lideri numër një i PKSh dhe pa lejen e tij Koçi Xoxe nuk mund të bënte asgjë”.³³⁷

³³²*Po aty*, f. 85.

³³³*AQSH, AKQ/PKSH, Fondi 14, dosja nr. 1, viti 1947.*

³³⁴*Po aty*, Fondi 14, dosja nr. 7, viti 1946, fl. 8.

³³⁵*Po aty*, fl.11.

³³⁶*Shqipëria në dokumentet e arkivave ruse...*, përgatitën I. Lauka dhe E. Ymeri, f. 126.

³³⁷*Marrëdhëniet Shqiptaro Jugosllave...*, f. 6.

Qëndrimi fillestar i Koçi Xoxes ishte ai ‘pro’ jugosllav, ndërkohë që në vitet në vijim, me prishjen e marrëdhënieve Shqipëri-Jugosllavi dhe më tej Jugosllavi-Bashkim Sovjetik, ai mbajti një qëndrim të kundërt ndaj PKJ, të cilën e cilëson si tradhtarë, pasi kishte *“dalë nga rruga socialiste me në krye Titon dhe ishte hedhur kundër Bashkimit Sovjetik”*.³³⁸ Pavarësisht këtij qëndrimi kontradiktor të mëvonshëm të vitit 1948, kur Koçi Xoxe u akuzua nga Komiteti Qendror si komplotist, armik i popullit dhe agjent i drejtpërdrejtë i Titos, ai zbuloi në Kongresin e Partisë lidhjet e veta me udhëheqësit trockistë të PKJ, si gjatë kohës së punimeve të Plenumit të Beratit të KQ PKSh, të zhvilluar në tetor të vitit 1944, ashtu edhe në periudhën para atij plenumi. Këtu Koçi Xoxe nuk harroi të pohonte se me Vukmanoviç Tempo ai qe lidhur që në vitin 1943, dhe se ia pati vënë veshin me shumë kujdes gjithçkaje që ai thoshte. Po ashtu, ai pohoi se i kishte treguar shumë gjëra Vukmanoviç Tempos për situatën në PKSh, për veprimet e udhëheqësve të veçantë shqiptarë, për punën e gabuar, sipas fjalëve të tij, të përfaqësuesit të KQ PKJ Miladin Popoviç. Sipas tij, që prej asaj kohe përfaqësuesit jugosllavë në Shqipëri ishin duke kryer një veprimtari antimarksiste në Shqipëri. Sipas deklaratës së tij të mëvonshme, *“jugosllavët, të nxitur nga qëllime kolonizuese, mundoheshin të mbillnin në mesin e shqiptarëve një ndjenjë inferioriteti dhe një gjë e tillë është bërë nga të gjithë, duke filluar nga udhëheqësi i tyre Tito e deri tek anëtarit më i thjeshtë i legatës”*³³⁹. Për më tepër, ai pohoi se ata ishin përpjekur të ngulisin në mendjen e shqiptarëve idenë se Shqipëria nuk mund të mbijetojë pa mbështetjen e Jugosllavisë, dhe se nëpërmjet përdorimit të frazave marksiste kërkonte ta nënshtronte dhe shfrytëzonte Shqipërinë. Megjithatë, ai thoshte: *“Jo vetëm Shqipëria, por edhe popuj të tjerë të Ballkanit u mashtruan nga përdorimi i marksizëm-leninizmit nga ana e Jugosllavisë, duke menduar që ajo ishte mbështetja më e madhe e Bashkimit Sovjetik”*.³⁴⁰

Sipas deklaratës së Xoxes, në Plenumin e Beratit, *“Velimir Stojnić dhe Josif Gjergjia kishin ndikuar në nxitjen e konflikteve brenda udhëheqjes komuniste në vend. Megjithatë, Xoxja e identifikonte veten në çdo rast si besnik të Bashkimit Sovjetik dhe partisë bolshevike. Ai gjithashtu e pranonte se kishte qenë i mendimit se udhëheqja shqiptare duhet të mësonte nga eksperiencia jugosllave, e cila kishte mbështetur po ashtu Bashkimin Sovjetik dhe nuk përbënte rrezik për pavarësinë e vendit. Ai pranoi se kishte qenë në anën e politikës së jugosllavëve, pasi këta të fundit ishin shfaqur të gatshëm të ndihmonin në ndërtimin e vendit”*.³⁴¹

³³⁸ AQSH, AKQ/PKSH, Fondi 14, dosja nr. 70, viti 1948, fl. 76.

³³⁹ Shqipëria në dokumentet e arkivave ruse..., përgatitën I. Lauka dhe E. Ymeri, f. 181.

³⁴⁰ AQSH, Fondi i Organeve Udhëheqëse, Fondi 14, dosja nr. 9.1, viti 1948, fl. 17.

³⁴¹ Po aty, f. 23.

2.5 Rikthimi i projekteve spekulative të Beogradit, për ta bërë Shqipërinë një Republikë të Shtatë të saj, dhe presionet ndaj udhëheqjes shqiptare

Synimi i Jugosllavisë për përfshirjen e Shqipërisë në Konfederatën Ballkanike, pra bashkimi i vendit tonë me Jugosllavinë, ishte nxitja kryesore për vendosjen e marrëdhënieve të Jugosllavisë me Shqipërinë. Ashtu siç u përmend edhe më lart, bashkëpunimi mes partive komuniste të dy vendeve ishte i madh. Jugosllavia ishte vendi i parë që e njohu qeverinë shqiptare dhe vendosi marrëdhënie diplomatike me të. Duke qenë se Shqipëria ishte ftohur me Perëndimin dhe Moska nuk shfaqte ndonjë interes të veçantë për Shqipërinë, ajo u detyrua të lidhte marrëdhënie të ngushta me Jugosllavinë fqinje. Shumë jugosllavë ofruan ekspertizën e tyre në institucionet shqiptare, pra ndikimi i tyre jo vetëm në politikën e jashtme, por edhe në atë të brendshme ishte i lartë. Udhëheqësit shqiptarë, fillimisht e konceptuan ndihmën jugosllave si ‘vëllazërore’, për shkak të pjesëmarrjes së përbashkët në Bllokun Lindor Komunist, ndërkohë që më pas kërkuan distancim nga Jugosllavia.

Shpejtimi i procesit të varësisë totale nga Jugosllavia u krye me vullnetin e udhëheqësve shtetërorë dhe partiakë të Jugosllavisë, po ashtu edhe me kërkesë dhe sugjerime të përfaqësuesve të tyre diplomatikë dhe ushtarakë në Tiranë. Për këtë qëllim, ishte vendosur që sa më parë të emërohej atasheu ushtarak jugosllav në Tiranë, atasheu për ekonomi, tregti dhe kulturë dhe bashkëpunim kulturor, si dhe të caktoheshin personat zyrtarë për rregullimin e kalimit kufitar. Edhe çështjet e bashkëpunimit kulturor dhe sportiv ishin në plan të parë. Ishte planifikuar që nga Shqipëria, për mungesë të shkollave të mesme dhe fakulteteve, të shkonin në Jugosllavi për mësim dhe studime të rinjtë shqiptarë. Ishte parashikuar edhe dhënia e bursave dhe kredive për nxënësit dhe studentët shqiptarë që do të studionin në Jugosllavi.

Pas Luftës së Dytë Botërore, disa udhëheqës të tjerë të Europës Lindore me në krye Titon, hodhën tezën e bashkimit të shteteve të gadishullit të Ballkanit. Ky synim dukej mjaft i mundshëm, në kushtet e ndikimit të Jugosllavisë në politikën e brendshme dhe të jashtme të Shqipërisë. “Në vitin 1945, një ndër bashkëpunëtorët më të afërt të Titos, Moshe Pijade³⁴², kërkoi që “*kancelaria e re e Republikës Federative të Jugosllavisë në Beograd të mos kishte 6, por 7 kabinete. Kabineti i shtatë, sipas titistëve, i përkiste Republikës Jugosllave të Shqipërisë.*”³⁴³

Për bisedën midis Caladarisit (ministër grek) dhe Moshe Pijades, Hoxha u shpreh se midis tyre diskutoheshin trojet shqiptare si të ishin një vend i pazotë. Caldarisi i kishte propozuar Moshe Pijades që Shqipëria të mos mbetej një mollë shërr midis Jugosllavisë dhe Greqisë, por “*të ishte një mollë e ëmbël, e ndarë përgjysmë me mirëkuptim*”.³⁴⁴ Ky

³⁴² E. Hoxha, *Një jetë për kombin...*, f.276.

³⁴³ *Po aty*.

³⁴⁴ *Po aty*, f.279.

mendim u shpreh në një nga punimet e Konferencës së Paqes në sy të të gjithë opinionit publik. Por duke shprehur mos pajtueshmërinë për këtë çështje, Moshe Pijade u shpreh se “*ne kurrë nuk do ta lejonim të na e cenojnë Shqipërinë motër*”.³⁴⁵ Por pas këtyre fjalëve nuk dihej se ai nga mbrojtës i pjesës jugore të Shqipërisë, Moshe Pijade synonte ta aneksonte të gjithën, duke mos lejuar ta ndante me askënd dhe duke e bërë gati kabinetin e shtatë në kancelarinë e përgjithshme jugosllave. Shumë vite më vonë, në lidhje me mbrojtjen jugosllave, Enver Hoxha do të shkruante se “*...Konform planit të fshehtë për aneksimet e krejt Shqiptarisë, njerëzit e Titos s’kishin pse të mos dilnin në “mbrojtje” të pjesës jugore që synohej nga Caldari. Ata besonin se punët do të ecnin në favor të tyre dhe, në një rast të tillë, përse të lejonin që e vluara e ëndërruar, Shqipëria, të cenohej edhe nga greku, kur mund ta gëzonin të gjithë vetë*”.³⁴⁶ Kjo babëzi e të huajve u shfaq edhe kur monarku i Greqisë, Pavlo, i bëri Titos propozimin për një ndarje të Shqipërisë. Por kësaj radhe Titoja, në ndryshim nga Moshe Pijade, “nuk e denoncoi propozimin e mbretit grek”.³⁴⁷

Duhet theksuar se vija e marrëdhënieve dhe lidhjeve shqiptaro-jugosllave, në vitet 1945-1948 realizohej përmes kanaleve diplomatike, në radhë të parë me vendosjen e Velimir Stojniçit në detyrën e përfaqësuesit të parë të Qeverisë së Përkohshme të RFJ pranë qeverisë shqiptare. Në këtë kuadër, më 6 shtator 1945, Enver Hoxha, në emër të tij personal dekoroi anëtarë të misioneve ushtarake të Jugosllavisë dhe të Bashkimit Sovjetik, ndër kohë që më 29 shtator, nën ndikimin e presioneve të jugosllavëve dhe me pajtimin e qeverisë shqiptare, Misioni Ushtarak Amerikan e lëshoi Tiranën. Velimir Stojnici, me rastin e dekorimit të tij nga Këshilli Antifashist Shqiptar, kishte premtuar se “*Këto dekorata e përforcojnë miqësinë e vendeve tona dhe dijeni se popujt e Jugosllavisë do të bëjnë ç’është e mundur për sigurimin e pavarësisë kombëtare shqiptare*”.³⁴⁸

Më 12 janar 1945, Gjilasi kishte lajmëruar Velimir Stojniçin se KQ i PKSh mund të vendoste lidhje të drejtpërdrejta me KQ të PKJ, kështu që “*dikush nga “ju” të vijë “këtu” një herë në javë ose çdo dhjetëditë*”.³⁴⁹ Është me rëndësi të theksohet fakti se qeveria jugosllave u tregua e gatshme që, përmes marrëveshjeve të garantonte dhe të mbronte integritetin dhe sovranitetin territorial të Shqipërisë, në rast të kërcënimeve nga pala greke, si dhe që Jugosllavia të përfaqësonte interesat e shtetit dhe qeverisë shqiptare në arenën ndërkombëtare deri në njohjen e kësaj të fundit. Zbatimi i një varg marrëveshjesh ekonomike tregoi se “qeveria jugosllave donte ta vendoste ekonominë shqiptare në funksion të asaj jugosllave, me qëllim përfundimtar përfshirjen e Shqipërisë brenda Federatës Jugosllave”.³⁵⁰ Kjo binte ndesh me qëllimin e udhëheqjes shqiptare të

³⁴⁵ *Po aty*.

³⁴⁶ Enver Hoxha, *Vepra*, Vëll. III, Tiranë, 1969, f.214.

³⁴⁷ E.Hoxha, *Një jetë për kombin...*, f.280-281.

³⁴⁸ *Gazeta Bashkimi*, Tiranë, 6 shtator 1945.

³⁴⁹ B. Petranoviç, *Balkanska Federacija...*, f. 142.

³⁵⁰ *Historia e Popullit Shqiptar...*, f. 238.

asaj kohe, e cila “synonte të ruante pavarësinë territoriale të Shqipërisë në kufirin me Greqinë dhe të njihej si një shtet i pavarur dhe fitues pas Luftës së Dytë Botërore”.³⁵¹

Në mbledhjen e Byrosë Politike të Komitetit Qendror të PKSh, Hoxha u shpreh pozitiv ndaj propozimit jugosllav për krijimin e një federate ballkanike, edhe pse shteti do ta ruante formalisht pavarësinë e tij përmes një Ministrie të Jashtme. Gjithashtu, sipas tij, “politika e jashtme e përbashkët duhet të orientohej nga Bashkimi Sovjetik”.³⁵² Por miratimi i propozimeve të Savo Zllatiç nga ana e Byrosë Politike e vuri në rrezik pavarësinë e shtetit shqiptar. Pyetjes, se cilat ishin masat që u morën në vendin tonë për bashkimin me Jugosllavinë, Koçi Xoxe përgjigjet se “*Nuk u ndërmor asnjë masë për këtë bashkim. Jugosllavia kërkoi të bënte unifikimin e ushtrisë, një bashkëpunim ekonomik, akorde ekonomike dhe politike, si dhe kërkuan një seri masash ushtarake që vendi të ishte i mobilizuar, sikurse ishte edhe lufta imediate, dhe me këtë pretekst të dërgonin këtu regjimente dhe batalione që t’i afroreshin tokës sonë. Në vitin 1948, jugosllavët propozuan që të merreshin masa ekonomike, si për shembull të mos kishte dogana dhe pasaporta. Të gjitha këto çonin drejt Federatës, që ata e kërkuan haptazi, por donin që këtë ta kërkonim ne që të bëhej*”.³⁵³ Tito e parapëlqente Xoxen, “ngaqë ishte i vetmi punëtor në udhëheqjen shqiptare (sipas Titos) dhe se përkrahte planet e Titos për ta tërhequr edhe Shqipërinë në Konfederatën Ballkanike”.³⁵⁴ Bashkimi i të dy vendeve vijoi me bashkimin e ushtrive të tyre në një komandë të përbashkët. Byroja politike e pranoi edhe kërkesën e Titos për vendosjen e një divizioni ushtarak në Korçë, në janar të vitit 1948. “Në njoftimin dërguar Bashkimit Sovjetik, u fol se ky plan u ndalua nga Beogradi.”³⁵⁵ Megjithatë, në mbledhjen e përfaqësuesve të Partive Komuniste të Bashkimit Sovjetik, Bullgarisë dhe Jugosllavisë, në shkurt të vitit 1948, Stalini ishte kundër idesë së vendosjes së divizionit ushtarak në Korçë nga ana e Jugosllavisë, pasi një akt i tillë do të perceptohej si pushtim i Shqipërisë nga Amerika dhe Anglia, gjë që do të nxiste një konflikt të mundshëm mes palëve. “Varianti më i përshtatshëm ishte që Jugosllavia të bashkohej me Shqipërinë përmes Federatës Ballkanike, edhe pse kjo duhet të përgatitej përmes vendimeve parlamentare”.³⁵⁶

Në mars 1948, në një mbledhje të Byrosë u shtrua çështja e bashkimit të vendit me Jugosllavinë. Sipas anëtarëve të Byrosë, shqiptarët nxiteshin nga Dimitrovi, me qëllim që të shtronin çështjen e bashkimit, pasi ishin më afër se Bullgaria³⁵⁷. Në të vërtetë, Bullgaria dhe Jugosllavia e kishin nënshkruar një traktat bashkëpunimi në Bled, lëvizje kjo që u

³⁵¹ Ledion Krisafi, *Marrëdhëniet e Shqipërisë me Jugosllavinë 1945-1948*. Disertacion, Universiteti Evropian i Tiranës, 2016, fq.73. Marrë nga: https://uet.edu.al/images/doktoratura/Ledjon_Krisafi.pdf.

³⁵² *Po aty*, f. 141.

³⁵³ K. Dervishi, *E vërteta e fshehur e një procesi...*, f.35.

³⁵⁴ Bernd J.Fischer, *Diktatorët e Ballkanit*, Tiranë: Botimet AIIS, f.272.

³⁵⁵ *Marrëdhëniet shqiptaro-jugosllave...*, përgatitën L. Malltezi dhe N. Plasari, f. 403.

³⁵⁶ N. Smirnova, *Historia e Shqipërisë...*, f. 333.

³⁵⁷ *Marrëdhëniet shqiptaro-jugosllave...*, përgatitën L. Malltezi dhe N. Plasari, f.407.

kritikua ashpër nga Stalini. Megjithatë, udhëheqja shqiptare ishte para faktit se “marrëveshja e mëparshme e bashkëpunimit mes Jugosllavisë dhe Bullgarisë kishte hasur kundërshtimin e Stalinit”.³⁵⁸

Për vendosjen e divizionit jugosllav në Korçë, Xoxe i tha shokut Enver se situata ishte alarmante dhe se s’duhet ta shtynin ndihmën internacionaliste të vëllezërve jugosllavë. Ndërkohë, përgjigjja e Stalinit për letrën e Hoxhës, lidhur me gjendjen emergjente dhe rrezikun e pushtimit grek, ishte se “*Bashkimi Sovjetik nuk shihet asnjë rrezik nga ana e ushtrisë greke*”.³⁵⁹ Pra, siç duket qartë, ngutja e palës jugosllave nuk vinte nga faktorë të jashtëm, por nga babëzia e tyre për ta përvetësuar Shqipërinë sa më shpejt të mundej. Dokumentet arkivore të kohës tregojnë se “Enver Hoxha i raportoi Bashkimit Sovjetik qëllimin e qeverisë jugosllave për dërgimin e divizionit ushtarak në Korçë, dhe pas kundërshtimit të tij jugosllavët u tërhoqën nga kjo ide”.³⁶⁰ Megjithatë, për të mos e reklamuar prishjen e marrëdhënies me Jugosllavinë, “Stalini, në takimin me Hoxhën në Moskë shprehu padijeninë e tij për dërgimin e divizionit jugosllav në Shqipëri”.³⁶¹

Acarimi i marrëdhënies mes Jugosllavisë dhe Bashkimit Sovjetik u bë i dukshëm në mbledhjen e Byrosë Informative Komuniste në Bukuresht, në qershor të vitit 1948, ku u komunikua devijimi i Jugosllavisë nga ideologjia marksiste e Stalinit, duke e anashkaluar luftën e klasave. Bashkimi Sovjetik, si udhëheqësi i kampit komunist, e shihet si kërcënim politikë asnjënjë të Titos në ato vite, por edhe fuqizimin e pozitës së shtetit jugosllav në Ballkan.

Letra e Komitetit Qendror të Partisë Komuniste të Bashkimit Sovjetik, ku theksohej “qëndrimi antimarksist dhe antisovjetik i ndjekur nga Jugosllavia, kohët e fundit iu komunikua udhëheqjes shqiptare në prill të vitit 1948”.³⁶² Qëndrimi i Bashkimit Sovjetik përputhej me dëshirën e Enver Hoxhës për t’u distancuar nga Jugosllavia, për shkak të presionit të madh të qeverisë jugosllave për përfshirjen e Shqipërisë në tutelën jugosllave.

Qysh në fillim të forcimit të marrëdhënies politike dhe ekonomike me Bashkimin Sovjetik, “ai i miratoi marrëveshjet ekonomike mes këtyre vendeve”.³⁶³ Po ashtu, Bashkimi Sovjetik e qartësoi udhëheqjen komuniste shqiptare që marrëdhëniet mes

³⁵⁸ Dokumentet e Kominformës, ‘*Minutat e tre konferencave 1947/48/49*’, edituar nga Giuliano Procacci, në Fondazione Giangiacomo Feltrinelli, Annali, 1994, Feltrinelli Editore, Milano, ISBN 88-07-99050-4, 1999.

³⁵⁹ E. Hoxha, *Një jetë për kombin...* f.307-309.

³⁶⁰ Brisejda Lala, ‘*Projekti i Federatës ballkanike në marrëdhëniet shqiptare-jugosllave në vitet 1945-1948*’. Revistë Shkencore e Institutit Alb-Shkenca, Aktet VI, Nr. 5, 2013, fq. 488. Marrë nga: http://alpa.mali-it.eu/pub/aktet/vol/vol6/Aktet_Vol_VI_Nr_5_pp_486_490.pdf.

³⁶¹ AMPJ, dosja nr. 15, viti 1949, f. 3.

³⁶² AQSH, Fondi 14, dosja nr. 18, viti 1949, fl. 11.

³⁶³ Leonid Gibianiskii, ‘*The Soviet Bloc and the Initial Stage of the Cold War: Archival Documents on Stalin’s Meetings ë ith Communist Leaders of Yugoslavia and Bulgaria, 1946-1948*’. ColdWar International History Project Bulletin 19, 1998, f.114.

Shqipërisë dhe Bashkimit Sovjetik nuk do të ishin të drejtpërdrejta, por do të kalonin përmes Jugosllavisë. Për shembull, ndihmat ushtarake të Bashkimit Sovjetik për Shqipërinë do të dërgoheshin brenda dërgesave ushtarake të Jugosllavisë. Edhe pse Bashkimi Sovjetik nuk dëshironte që marrëdhëniet mes Shqipërisë dhe Jugosllavisë të shkonin shumë larg, nga ana tjetër ai i nxiste ato. Në një takim të Titos me Stalinin, të mbajtur në maj të vitit 1946, ky i fundit “i sugjeron Titos që fillimisht mund të bëhet një marrëveshje bashkëpunimi dhe miqësie me Shqipërinë, për të mbrojtur pavarësinë dhe tërësinë territoriale të saj”.³⁶⁴ Kjo është e dukshme edhe në shtyrjen e takimit të Hoxhës në Beograd, me qëllim konsultimin e Titos me Stalinin në Moskë, në lidhje me marrëveshjet që duhen nënshkruar me Shqipërinë. Enver Hoxha, nga ana tjetër “ishte konsultuar me Anatoli Lavrentjev, ambasadorin sovjetik në Beograd, për të marrë miratimin për vizitën në Beograd”.³⁶⁵

Në këtë kontekst, duket se hapi i parë i përfshirjes së vendit në Federatën Jugosllave ishte firmosja e marrëveshjes së bashkëpunimit dhe miqësisë mes Shqipërisë dhe Jugosllavisë në Beograd. Në këtë periudhë, “plani sovjetik për krijimin e Federatës së Rumanisë, Federatës së Polonisë me Çekoslllovakinë dhe asaj të Jugosllavisë, Bullgarisë dhe Shqipërisë”³⁶⁶ ishte nxitje për intensifikimin e marrëdhënieve mes Jugosllavisë dhe Shqipërisë.

Në raport me Shqipërinë, “Bullgaria kishte më shumë shanse të krijonte një shtet të përbashkët me Jugosllavinë”.³⁶⁷ Një pikë e rëndësishme e kësaj marrëveshjeje ishte përmbushja e kushteve për krijimin e një shteti të përbashkët federal, i cili do të drejtohej nga një qeveri e përbashkët me përfaqësues nga Jugosllavia dhe Bullgari. Marrëveshjet e tjera të Jugosllavisë me Hungarinë, Poloninë, Çekoslllovakinë dhe Shqipërinë ruanin një sistem sigurie dhe bashkëpunimi të ndërsjellë, që ishte ideuar nga Bashkimi Sovjetik.

Në kohën kur marrëdhënieve mes Jugosllavisë dhe Shqipërisë po iu vinte fundi, u rrit edhe interesi i Bashkimit Sovjetik për Shqipërinë, pasi pozicioni gjeostrategjik i vendit do iu siguronte atyre daljen në detin Adriatik. Sipas dokumenteve arkivore të kohës, “qëndrimi anti-jugosllav i udhëheqjes shqiptare do të ngushtonte rrethin e mbështetësve të Jugosllavisë”.³⁶⁸ Jugosllavia mendonte se mund të luante një rol udhëheqës në Ballkan, gjë së cilës i druhej edhe Bashkimi Sovjetik, duke qenë se ajo e kishte fituar Luftën e Dytë Botërore pa ndihmën e tij. Po ashtu, udhëheqësit e pasluftës në Jugosllavi nuk ishin të importuar nga Bashkimi Sovjetik.

³⁶⁴*Po aty.*

³⁶⁵*Po aty*, f. 122.

³⁶⁶*Po aty*, f. 131.

³⁶⁷ Ledion Krisafi, *Marrëdhëniet e Shqipërisë me Jugosllavinë 1945-1948*, Disertacion, Universiteti Evropian i Tiranës, 2016, fq. 76. Marrë nga: https://uet.edu.al/images/doktoratura/Ledjon_Krisafi.pdf.

³⁶⁸*Historia e Popullit Shqiptar...*, vëllimi IV, f. 245.

Anullimi i marrëveshjeve me Jugosllavinë dhe largimi i ekspertëve jugosllavë nga Shqipëria, në korrik 1948, shërbeu për forcimin e pozitave të Hoxhës brenda PKSh, pas spastrimit të kundërshtarëve politikë pro-jugosllavë, mes tyre edhe Koçi Xoxe. Gjithashtu, ndarja me Jugosllavinë shënoi një akt besnikërie të Hoxhës ndaj ideologjisë marksiste-staliniste dhe Bashkimit Sovjetik, i cili do të ishte aleati i saj politik dhe ekonomik deri në vitin 1961.

KREU III

PRISHJA E MARRËDHËNIEVE SHQIPTARO-JUGOSLLAVE DHE ROLI I KOÇI XOXES NË KËTO MARRËDHËNIE

3.1 Plasaritjet e para dhe fillimi i kthesës në marrëdhëniet shqiptaro-jugosllave

Marrëdhëniet midis Shqipërisë dhe Jugosllavisë, fillimisht kanë pasur natyrë tradicionale, por interesat e përbashkëta të krijuara gjatë Luftës së Dytë Botërore ndikuan në rritjen e marrëdhënieve të ndërsjella midis këtyre dy vendeve. Gjatë kohës së luftës, Jugosllavia i ndihmoi udhëheqësit shqiptarë në themelimin e PKSh, gjithashtu ishte vendi i parë që e njohu qeverinë e Enver Hoxhës.

Procesi i krijimit të PKSh “u intensifikua më tepër pas takimeve këshilluese të grupeve të ndryshme të komunistëve shqiptarë me të dërguarit e PKJ”.³⁶⁹ Në verën e vitit 1940, PKJ kishte dërguar në Shqipëri dy drejtues të Komitetit të saj të Kosovës, Miladin Popoviç dhe Dusan Mugosha, për të marrë përsipër detyrën e koordinimit të grupeve të ndryshme komuniste në Shqipëri dhe krijimin e një baze efektive komuniste. Këto grupe të ndryshme, anëtarësia e të cilave numëronte rreth 200 veta, kishin objektiva dhe prejardhje të larmishme, por, pavarësisht kontakteve të kufizuara ata kishin një qëllim të përbashkët, një “Parti legjitime Komuniste”.

Në fillim të vitit 1941, “dy prej grupeve komuniste që ishin krijuar në Shqipëri konsideroheshin si trockiste”.³⁷⁰ PKJ kishte të ngjarë të motivohej, qoftë edhe pjesërisht, për angazhimin e saj në Shqipëri edhe nga “*andrallat*”, siç do ta quante dhe studiuesi Fischer³⁷¹, që ajo kishte pasur dhe në ngritjen e celulave në Kosovë. Mosbesimi kundrejt sllavëve në radhët e popullsisë shqiptare ishte i lartë, ndaj dhe PKJ ka gjasa të ketë pandehur se krijimi i një partie komuniste shqiptare mund ta ndihmonte ta zgjidhte këtë problem. Kështu, në nëntor të vitit 1941, jugosllavët Popoviç dhe Mugosha shënuan sukses në misionin që ata kishin ndërmarrë për bashkimin e grupeve të ndryshme komuniste në një grup të vetëm që ishte Partia Komuniste Shqiptare. PKSh zgjodhi edhe një Komitet Qendror të Përkohshëm, i përbërë nga 11 anëtarë. Rekrutimi i anëtarëve të rinj të PKSh ishte i hapur dhe u drejtua nga Dushan Mugosha, ndërkohë që Miladin Popoviçi qëndroi pranë Enver Hoxhës për t’i ardhur në ndihmë në organizimin e PK dhe të programit bazë të saj.

³⁶⁹ N. Smirnova, *Historia e Shqipërisë...*, f. 222.

³⁷⁰ *Shënim*: Teoria marksiste siç mbrohej nga revolucionari Rus Leon Trotsky.

³⁷¹ B.J. Fischer, *Diktatorët e Ballkanit...*, f. 264.

Më 24 maj 1944, Fronti Nacionalçlirimtar, duke parashikuar mundjen e Gjermanisë, thirri Kongresin e Parë në Përmet, ku u krijua Këshilli Antifashist Nacionalçlirimtar Shqiptar (KANÇ), si një organ legjislativ-ekzekutiv. “Ky këshill u shndërrua në Qeveri Demokratike të Përkohshme në kongresin e dytë të KANÇ, që u mbajt më 20-23 tetor 1944 në Berat”.³⁷²

Në raportet e Komitetit Qendror, njohja e qeverisë të sapokrijuar shqiptare nga qeveria jugosllave u konsiderua “si një faktor paqeje, si një faktor për përforcimin e pozitive demokratike në Ballkan”.³⁷³ Ajo do të punonte në drejtim “të lidhjes dhe forcimit të raporteve të miqësisë e vëllazërimit me popujt e Ballkanit, me forcat demokratike progresive në Ballkan dhe veçanërisht me Jugosllavinë e Mareshalit Tito, që përfaqëson faktorin kryesor të demokracisë e të paqes në Ballkan”.³⁷⁴ Në këtë kontekst, është më se e qartë se “ishin jugosllavët ata që krijuan për shqiptarët modelin që duhej ndjekur, madje deri tani te përshtatja e parullës “Vdekje fashizmit, Liri popullit”, si dhe kapelës me yllin e kuq”.³⁷⁵ Megjithatë, duhet theksuar se fraksionizmi dhe spastrimet e karakterizuan historinë e PKSh që nga viti i parë i funksionimit të saj. Fraksionizmi u zgjerua shpejt në nivelet më të larta të PK dhe do të vazhdonte kështu deri në vitin 1952. Deri në atë vit, “Enver Hoxha që i vetmi anëtar i mbetur që nga fillimi i Komitetit Qendror të PKSh-së që ishte akoma në pozicion të mirë në këtë parti, krahasuar me fatin e anëtarëve të tjerë të hershëm të këtij Komiteti”.³⁷⁶

Demagogjia e përdorur gjerësisht në mjediset politike dhe propagandistike jugosllave ishte shtrirë edhe në Shqipëri, ku eksponentë të politikës, shtypi dhe forumet drejtuese shqiptare flisnin me gjuhën e Beogradit, duke i thurur lavde e duke hiperbolizuar sukseset, më shumë imagjinare sesa reale. Në mjediset politike dhe propagandistike shqiptare të asaj kohe gjenden me bollëk formulime të tilla, si fitoret e Luftës Nacionalçlirimtare në Jugosllavi ishin forcuar së tepërmi, po ashtu pushteti popullor. Sipas kryetarit të Komisionit të Kontrollit Shtetëror, Eduard Kardeli, “aparati ynë shtetëror po ndërtohet mbi baza të reja, mbi ato baza që u krijuan gjatë Luftës Nacionalçlirimtare... Kushtetuta e RFPJ parashtroi dhe caktoi principet kryesore të organizimit dhe bazat e një shteti të ri në esencë dhe formë, të Republikës Popullore”.³⁷⁷

Pas instalimit të regjimit komunist në Shqipëri, qeverinë e Enver Hoxhës nuk e njihnte asnjë nga fuqitë e mëdha të kohës. Ndaj kërkesës së Enver Hoxhës për ta njohur ndërkombëtarisht qeverinë shqiptare – kërkesë kjo e dërguar më 5 janar 1945 kancelarive të ShBA-së, Britanisë së Madhe – ato tashmë kishin vendosur që Shqipërinë ta linin pa

³⁷² Valentina Duka, *Histori e Shqipërisë 1912-2000*, Tiranë, Botimet: SHBLU, 2007, f. 226.

³⁷³ AQSH, AKQ/PKSH, Fondi Nr. 14, Dosja Nr. 9, Viti 1945, fl. 23.

³⁷⁴ Po aty, fl. 24.

³⁷⁵ B. J. Fischer, *Diktatorët e Ballkanit...*, f. 265.

³⁷⁶ Central Intelligence Agency, “*Current Intelligence Staff Study, Soviet-Albanian Relations 1940-1960*”, ESAU XIX-62, 2007, faqe 2. Marrë nga: <https://www.cia.gov/library/readingroom/docs/esau-19.pdf>.

³⁷⁷ AQSH, AKQ/PKSH, Fondi Nr. 14, Dosja Nr. 3, viti 1948, fl. 66.

mbështetjen e tyre, ndërsa vërejtjet e qeverisë amerikane dhe asaj britanike, se gjendja në Shqipëri ende nuk ishte e qartë dhe se qeveria shqiptare nuk ishte legjitimuar përmes zgjedhjeve të lira, nuk mund të ishte argument i qëndrueshëm. Ndërkohë, histograma bashkëkohore perëndimore, me të drejtë hedh hipotezën se “aleanca e Shqipërisë me Jugosllavinë u shndërrua në një bashkim të detyruar”.³⁷⁸

I ndodhur përballë presionit të fuqive perëndimore, të cilat nuk e njihnin qeverinë e drejtuar prej komunistëve, për shkak se nuk kishte dalë nga zgjedhjet e lira, “Enver Hoxha u detyrua t’i shpallë këto më 2 dhjetor 1945, edhe pse e kishte plotësisht të sigurt fitoren e partisë që ai drejtonte”.³⁷⁹ Megjithatë, këto zgjedhje kishin rëndësi për të përcaktuar regjimin që do të vendosej në Shqipëri. Teorikisht u proklamua pjesëmarrja në zgjedhje e disa grupimeve apo partive politike, por kjo gjë nuk u realizua praktikisht. Organizatat opozitare ilegale jashtë Frontit Demokratik nuk u shndërruan dot në legale dhe të paraqisnin në zgjedhje programin dhe kandidatët e tyre. Trysnia që ushtronte Partia Komuniste Shqiptare ndaj kundërshtarëve politikë ishte mjaft e madhe. Po ashtu, Fronti Demokratik kishte një epërsi më të madhe ndaj kundërshtarëve politikë, organizatës politike ilegale Bashkimi Demokratik, e cila synonte si formë regjimi republikën parlamentare dhe prirjet perëndimore. Kjo epërsi “qëndronte në faktin e figurës së konsoliduar që kishte krijuar në popull Fronti Demokratik, për shkak të luftës dhe fitores mbi fashizmin”.³⁸⁰

Votimet u mbajtën të fshehta, megjithatë ishin vetëm dy kuti, njëra e atyre që kishin fituar pushtetin dhe tjetra kutia e opozitarëve apo e “kundërshtarëve të regjimit komunist”. “Zgjedhjet e dhjetorit 1945 nuk ishin të lira, jo vetëm për shkak të presionit psikologjik ndaj votuesve me ndarjen e kutive, por edhe për shkak të tingujve që shkaktonin votat në formë kokrrash në kutinë e opozitës, e përbërë nga një shtresë metali”.³⁸¹ Në këtë mënyrë, ata që votonin kundër komunistëve ishin lehtësisht të evidentuar.

Shqipëria e kishte kufizuar lëvizjen e personelit amerikan dhe anglez në vend, duke i akuzuar se kishin nxitur kryengritje antikomuniste në malet veriore. Në prill të 1945-s, Britania njoftoi se nuk do të dërgonte asnjë mision diplomatik të saj në Tiranë; ndërkohë edhe Shtetet e Bashkuara e tërhoqën misionin e tyre në Shqipëri, në nëntor të 1945-s. Si Britania dhe ShBA-ja ishin kundër pranimin të Shqipërisë në Kombet e Bashkuara. Pas vitit 1946, “organizatat e inteligjencës amerikane dhe angleze filluan të zbatonin një plan të fshehtë dhe të hollësishëm për rrëzimin e regjimit komunist të Shqipërisë, duke mbështetur forcat antikomuniste dhe mbretërore brenda vendit. Kjo ishte një ndër arsyet pse Shqipëria

³⁷⁸ A. Zogaj, *Marrëdhëniet Shqiptaro- Jugosllave...*, f. 11.

³⁷⁹ V. Duka, *Histori e Shqipërisë...*, f. 231.

³⁸⁰ Gazeta Telegraf, “Përplasja e madhe në zgjedhjet e 2 dhjetorit 1945 në Shqipëri”. Marrë nga: <https://telegraf.al/dossier/perplasja-e-madhe-ne-zgjedhjet-e-2-dhjetorit-1945-ne-shqiperi>.

³⁸¹ Gazeta Standard, “Dokumenti/Si i manipuloi Enver Hoxha zgjedhjet e 2 dhjetorit 1945.” Marrë nga: <https://www.standard.al/2017/02/24/dokumenti-si-i-manipuloi-enver-hoxha-zgjedhjet-e-2-dhjetorit-1945/>

në atë kohë u mbështet fort te Jugosllavia”,³⁸² e cila në atë kohë i kishte forcuar pozitën e veta ndërkombëtare dhe gëzonte një përkrahje relative nga ana e disa prej fuqive të mëdha.

Lidhur me qëndrimin e Jugosllavisë në politikën e jashtme, në Kongresin e Dytë të Frontit Popullor të Jugosllavisë, Tito u shpreh se “*Sot, Republika Federative Popullore e Jugosllavisë zë një vend me rëndësi të madhe në marrëdhëniet ndërkombëtare dhe po bëhet epiqendra ekonomike dhe politike e Europës Qendrore dhe Juglindore, merita këto të politikës së Frontit Popullor Jugosllav me në krye Partinë Komuniste Jugosllave*”. Në një tjetër fjalim të tij, “Mareshali Tito kritikoi frontet popullore, për shkak se nuk kishin pasur unitet veprimi dhe nuk kishin mbajtur qëndrimin e duhur kundër fashizmit”.³⁸³ “... *Këto fronte të mos jenë koalicionet formale partish, ato të realizojnë bashkimin e të gjitha forcave demokratike e paqedashëse të partive, të organizatave dhe masave demokratike, për të luftuar të gjitha tentativat e nxitësve të luftës. Të bëhet fronti i paqes dhe i demokracisë i të gjithë popujve kundër imperializmit, kundër pakicës që nxit në luftë për interesa egoiste dhe kriminale, për sundim dhe shfrytëzim të botës*”.³⁸⁴

Pas zgjedhjeve të vitit 1945, “në janar të vitit 1946 Asambleja Kushtetuese e shpalli Shqipërinë Republikë Popullore dhe më 14 mars 1946 Asambleja Kushtetuese votoi gjithashtu edhe Kushtetutën e Republikës Popullore të Shqipërisë, që do të shërbente si themeli mbi të cilin do të ngrihej shteti komunist”.³⁸⁵ Tashmë, përkrah Enver Hoxhës, ashtu siç ishte lartësuar Stalini në Jugosllavi përkrah Titos, ashtu ishte lartësuar edhe Titoja në Shqipëri. “*Për ne Tito ishte Stalin dhe më shumë se Stalin*”, shkruante E. Hoxha.³⁸⁶ Çfarëdo praktike që Bashkimi i Republikave Socialiste Sovjetike ndiqte në Jugosllavi, nën moton e bashkëpunimit të ndërsjellë dhe internacionalizmit proletar, Jugosllavia i ndiqte në Shqipëri, në emër të ndihmës ideologjike, politike, ekonomike dhe kulturore. Ndërkohë që jugosllavët përshtatnin kushtetutën dhe ligjet sovjetike, modelonin shtetin dhe ekonominë sipas shembullit sovjetik, të njëjtat zgjidhje jugosllave ndiqte edhe Shqipëria e asaj kohe. Ideologjia dhe praktika e komunizmit mbërritën në Shqipëri përmes Partisë Komuniste të Jugosllavisë, anëtarët e së cilës u dërguan në Shqipëri si këshilltarë dhe instruktorë. Euforia politike dhe propagandistike rreth marrëdhënieve shqiptaro-jugosllave mbështetej në fraza të aleancës së “*vulosur me gjak*” dhe miqësisë së pathyeshme,

³⁸² Raymond Zickel dhe Walter R. Iwaskiw, “*Albania a country study*”, Library of Congress Cataloging-in-Publication Data, Washington, 1994, faqe 43, marrë nga: <https://tile.loc.gov/storage-services/master/frd/frdcstdy/so/sovietunioncount00zick/sovietunioncount00zick.pdf>.

³⁸³ AMPJ, Dosja Nr. 1-11, viti 1947, f. 6.

³⁸⁴ AMPJ, Dosja Nr. 1-11, viti 1947, f. 7.

³⁸⁵ V. Duka, *Histori e Shqipërisë...*, f. 232

³⁸⁶ E.Hoxha, *Titistët...*, f. 258.

ndërkohë që problemet e përditshme kamufloheshin me frazeologjinë ideologjike të marksizmit.³⁸⁷

Sipas procesverbalit të një bisede midis Stalinit dhe Titos, më 27 maj 1946, botuar nga studiuesi rus Gibianski,³⁸⁸ Stalini e pyeti Titon nëse Enver Hoxha pajtohet me integrimin e Shqipërisë në Jugosllavi. Pas përgjigjes pozitive të Titos, Stalini e këshilloi atë që “të gjente një formulë për një traktat të ndihmës së ndërsjellë dhe miqësisë”.³⁸⁹ Porse Jugosllavia planifikonte të arrinte një dominim politik, përkatësisht bashkimin politik me Shqipërinë përmes mbështetjes së saj ekonomike dhe diplomatike, projekt që duhej të realizohej sa më shpejt, sepse “Tito kishte ndërhyrje nga Fuqitë e Mëdha ose nga Rusia”.³⁹⁰ Nga ana tjetër, Stalini dhe ndihmësit e tij i paralajmëruan jugosllavët që të mos e shpejtojnë unifikimin, nga “frika e protestave apo e ndonjë ndërhyrjeje të mundshme ushtarake në Shqipëri nga ana e Fuqive të Mëdha”.³⁹¹ Në janar të 1945-s, Stalini i tha një delegacioni jugosllav, të kryesuar nga udhëheqësi komunist kroat Andrija Hebrang, se “Jugosllavia duhet ta vonojë ratifikimin e Traktatit për Miqësi dhe Ndihmë të Ndërsjellë me Shqipërinë, në mënyrë që të shmangen ndërlikimet ndërkombëtare”.³⁹²

Për sa u takon mosmarrëveshjeve të vogla mes udhëheqjes shqiptare dhe asaj jugosllave, edhe pse sovjetikët mbaheshin të informuar, ata nuk ndërhyjnë në marrëdhëniet mes tyre. Përfaqësuesit sovjetikë në Tiranë dhe Beograd (Chuvahin dhe Sadchikov) raportuan të dhëna të hollësishme për këtë temë. Kjo u pasqyrua edhe në bisedën midis Titos dhe Stalinit, në qershor 1946 në Moskë, gjatë së cilës Stalini pyeti në detaje për Shqipërinë dhe udhëheqjen e saj si dhe fraksionet midis Partisë Komuniste Shqiptare (pro dhe kundër politikës jugosllave), si dhe i zbuloi Titos se “shqiptarët synonin të dërgonin një delegacion në Moskë, por ai do t’i dekurajonte ata, derisa t’iu merrte mendimin

³⁸⁷ Momcilo Pavlovic, “Albania between Tito and Stalin”; Në “The Balkans in the Cold War”, edituar nga Vojislav G. Pavlovic, Institute des Etudes Balkaniques, Beograd, 2011, f.160. Marrë nga: <https://books.google.al/books>

³⁸⁸ Albina Dranqoli, “Tito-s attempt to integrate Albania into Yugoslavia, 1945-1948”. History Studies, International Journal of History, Volume 3/2, 2011, f.192. Marrë nga: <https://www.acarindex.com/dosyalar/makale/acarindex-1423902522.pdf>

³⁸⁹ Ana Lalaj, *Çdo gjë për jugosllavizimin e shqiptarëve*, Gazeta Zëri, 29. 12. 2007, f.30.

³⁹⁰ Lon Giaffo, “Albania; Eye of the Balkan”, Vortex, USA, 2000, faqe 384-385 në Albina Dranqoli, “Tito-s attempt to integrate Albania into Yugoslavia, 1945-1948”. History Studies, International Journal of History, Volume 3/2, 2011, f.192. Marrë nga: <https://www.acarindex.com/dosyalar/makale/acarindex-1423902522.pdf>

³⁹¹ **Shënim:** Çështja shqiptare u diskutua përgjatë takimeve midis Stalinit dhe Andrija Hebrang në janar 1945 dhe midis Stalinit dhe Titos në maj 1946. Transkripti i takimit të Stalin-Hebrang në Shqipëri mund të gjendet në AVPRF (Arkivi i Politikës së Jashtme të Federatës Ruse), F. 06, Op. 7, D. 872, P. 53, Ll. 20–21. Minutat e diskutimit midis Stalinit dhe Titos në Shqipëri janë ruajtur në AVPRF, F. 06, Op. 8, D. 952, P. 57, Ll. 9–10. Marrë nga: https://www.zora.uzh.ch/id/eprint/62735/1/Perovic_Tito.pdf Perovic

³⁹² Citim nga transkripti në AVPRF (Arkivi i Politikës së Jashtme të Federatës Ruse), F. 06, Op. 8, D. 952, P. 57, Ll. 9–10. Marrë nga: https://www.zora.uzh.ch/id/eprint/62735/1/Perovic_Tito.pdf Perovic

përfundimtar jugosllavëve”.³⁹³ Udhëheqësit sovjetikë, në mënyrë të përsëritur tregonin se Shqipëria luante vetëm një rol marginal në bllokun sovjetik, dhe se Moska nuk do të kundërshtonte nëse Shqipëria mbështetej më shumë nga Beogradi. Për më tepër, në një bisedë të zhvilluar ndërmjet Stalinit dhe përfaqësuesit të Komitetit Kombëtar të Çlirimit të Jugosllavisë, Herbrang, në lidhje me shqiptarët, Stalini lëshoi një replikë, duke thënë se “*edhe shqiptarët janë sllavë për nga origjina*”.³⁹⁴ Ndërsa anglo-amerikanët, nga ana tjetër e shihnin si të pavend faktin se “shqiptarët, në politikën e jashtme nuk iu drejtoheshin organizatave ndërkombëtare drejtpërdrejt, por nëpërmjet Jugosllavisë, si interpret i tyre”.³⁹⁵.

Marrëdhëniet shqiptaro-jugosllave u shtrinë edhe në aspektin kulturor, pasi qysh në vitin 1945, Komiteti i Partisë vendosi krijimin e shoqërive kulturore për të nxjerrë në pah vlerat e BRSS dhe të Jugosllavisë. “Në këto shoqëri mund të anëtarësoheshin vetëm persona të cilët simpatizonin BRSS dhe Jugosllavinë.”³⁹⁶

Nëse i referohemi tërësisë së traktateve dhe protokolleve të krijuara gjatë periudhës 1946-1947 midis Shqipërisë dhe Jugosllavisë, ato janë të shumta dhe përfshinin shumë sektorë strategjikë. Disa prej tyre janë:³⁹⁷

- Traktati i Miqësisë dhe i Ndihmës Reciproke midis Republikës Popullore të Shqipërisë dhe Republikës Federative Popullore të Jugosllavisë (9 korrik 1946);
- Akord mbi këmbimet tregtare dhe rregullimet e pagesave (1 korrik 1946);
- Akord mbi kredinë që Qeveria e Republikës Federative Popullore të Jugosllavisë i jep Qeverisë së Republikës Popullore të Shqipërisë (korrik 1946);
- Protokoll mbi lëshimin e kredive në dollarë, me anë të Bankës së Shtetit Shqiptar, Bankës Kombëtare të Republikës Federative Popullore të Jugosllavisë. (3 tetor 1946);³⁹⁸
- Traktat mbi koordinimin e planeve ekonomike, të bashkimit doganor dhe të parifikimit të monedhës ndërmjet qeverive (nëntor 1946);
- Akord mbi organizimin e shoqërisë shqiptaro-jugosllave në aksione (korrik 1946);
- Akord për formimin e një shoqërie shqiptaro-jugosllave për kërkimet dhe shfrytëzimin e naftës (1946);
- Protokoll mbi ndërtimin e një centrali hidraulik në Kuçovë (1946);
- Akord mbi themelimin e një shoqërie shqiptaro-jugosllave për kërkime dhe shfrytëzimin e minierave (nëntor 1946);

³⁹³Momcilo Pavlovic, “*Albania between Tito and Stalin*”; Në “*The Balkans in the Cold War*”, edituar nga Vojislav G. Pavlovic, Institute des Etudes Balkaniques, Beograd, 2011, faqe 161. Marrë nga: <https://books.google.al/books>

³⁹⁴*Shqipëria në dokumentat ruse...*, përgatiti I. Lauka dhe E. Ymeri, f. 101.

³⁹⁵*AQSH*, AKQ/PKSH, Fondi Nr. 14, Dosje Nr. 52, viti 1946, fl 16, 17. **Shënim:** Letër-këmbim i Koço Tashkos me Enver Hoxhën.

³⁹⁶*Po aty*, Fondi Nr. 14, Dosje Nr. 138, viti 1946, fl. 3.

³⁹⁷*AMPJ*, Dosja Nr. B/II-1, viti 1947, f. 1.

³⁹⁸*AMPJ*, Dosja Nr. B/II-1, viti 1947, f. 2.

- Akord për ndërtimin dhe shfrytëzimin e rrugëve të hekurta;
- Akord për themelimin e një shoqërie elektriciteti shqiptaro-jugosllave;
- Protokoll në lidhje me ndërtimin e një centrali elektrik në Tiranë;
- Akord për themelimin e Bankës Shqiptaro-Jugosllave, protokoll mbi derdhjen e kapitaleve bazë të shoqërive shqiptaro-jugosllave, protokoll mbi trafikun kufitar;³⁹⁹
- Akord për derdhjen e kapitalit në aksione të shoqërive shqiptaro-jugosllave; (1947)
- Protokoll në lidhje me krijimin e një Komisioni koordinimi Shqiptaro-Jugosllav (qershor 1947); mbi vendosjen e këshillit të arbitrazhit shqiptaro-jugosllav;⁴⁰⁰
- Akord në lidhje me kredinë prej dy miliardë dinarë destinuar për rimëkëmbjen dhe ndërtimin ekonomik të RP të Shqipërisë bërë në Beograd, më 12 qershor 1947, në lidhje me këmbimet tregtare mes vendeve;
- Traktat mbi koordinimin e planeve ekonomike, mbi bashkimin doganor dhe paritetin e monedhave midis qeverisë së Republikës Popullore të Shqipërisë dhe qeverisë së Republikës Federative Popullore të Jugosllavisë (1946);
- Protokoll që bën pjesë integrale të traktatit dhe koordinimin e planeve ekonomike, mbi bashkimin doganor dhe paritetin e monedhave midis Republikës Popullore të Shqipërisë dhe qeverisë së Republikës Federative Popullore të Jugosllavisë, të 27 nëntorit 1946;
- Akord mbi bashkëpunimin ekonomik midis Republikës Popullore të Shqipërisë dhe Republikës Federative të Jugosllavisë (1947);
- Akord mbi themelimin e një shoqërie shqiptaro-jugosllave për ndërtimin dhe shfrytëzimin e hekurudhave⁴⁰¹ (1946);
- Protokoll mbi ndërtimin e hekurudhave (1946);
- Akord mbi themelimin e një shoqërie shqiptaro-jugosllave për kërkime dhe shfrytëzimin e naftës (1946);
- Protokoll mbi ndërtimin e një rafinerie të naftës në Kuçovë (1946);
- Protokoll mbi ndërtimin e një centrali hidraulik në Kuçovë (1946);
- Akord mbi themelimin e një shoqërie shqiptaro-jugosllave për kërkime dhe shfrytëzimin e minierave (1946);
- Akord mbi krijimin e një shoqërie shqiptaro-jugosllave të elektrifikimit (1946);
- Protokoll mbi ndërtimin e një centrali elektrik në Tiranë (1946);
- Akord mbi formimin e një shoqërie shqiptaro-jugosllave të import-eksportit;
- Akord mbi themelimin e Bankës Shqiptaro-Jugosllave;
- Akord lidhur midis dy qeverive mbi derdhjen e kapitalit të aksionit të shoqërive shqiptaro-jugosllave (1947);
- Protokoll mbi ngritjen e një komisioni të koordinimit shqiptaro-jugosllav;

³⁹⁹*Po aty*, f. 3.

⁴⁰⁰*AMPJ*, Dosja Nr. B/II-1, viti 1947, f. 4.

⁴⁰¹*AQSH*, Fondi Këshilli i Ministrave, Dosja Nr. 47, viti 1947, fl. 4.

- Protokoll mbi krijimin e një këshilli të arbitrazhit shqiptaro-jugosllav;
- Akord mbi shkëmbimet tregtare midis Republikës Popullore të Shqipërisë dhe Republikës Federative Popullore të Jugosllavisë.

Ndërkohë, udhëheqësit sovjetikë interesoheshin për marrëdhëniet shqiptaro-jugosllave. Në prill të vitit 1947, ndërsa priste zyrtarin dhe kreun jozyrtar të diplomacisë jugosllave, S. Simic dhe E. Kardelin, së bashku me ambasadorin jugosllav në Moskë, V. Popoviç, Stalini kërkoi përsëri detaje për marrëdhëniet jugosllave-shqiptare dhe në veçanti për E. Hoxhën. Ai e befasoï Kardeljin me pretendimin se Hoxha “*po bënte gjyqe për këshilltarët politikë jugosllavë në ushtrinë shqiptare, të cilat po e dobësonin disiplinën*”.⁴⁰² Kardeli u përgjigj: “*Për ne kjo është e re*” dhe “*ata nuk na thanë asgjë*”.⁴⁰³ Stalini pyeti për E. Hoxhën, pasi ishte i interesuar për besueshmërinë dhe qëndrueshmërinë e tij apo i shqetësuar nëse ai “*do të jetë me ne deri në fund*”, dhe Kardelj iu përgjigj se “*Hoxha është i besueshëm dhe i dashur nga njerëzit, por atij i mungon arsimi marksist-leninist*”.⁴⁰⁴

Kardelj veçoi edhe Koçi Xoxen, si më të mirin brenda udhëheqjes shqiptare, megjithëse nuk kishte arsimim. Molotov u pajtua me këtë fakt. Ambasadorit sovjetik në Shqipëri, D. S. Çuvahin, i cili shërbeu në vendin tonë në vitet 1946 – 1952, “*gjatë shërbimit të tij diplomatik në Shqipëri u shpreh se dy takimet e para në BRSS i zhvilloi Koçi Xoxe. Për këto takime, Koçi Xoxe falënderoi qeverinë sovjetike, për ndihmën që këta të fundit i kishin dhënë Shqipërisë dhe se sa ngrohtë e miqësisht ishte pritur delegacioni shqiptar në Moskë, në verën dhe vjeshtën e 1945-s. Për këto takime, Koçi Xoxe u shpreh se “Ne as e merrnim me mend se qeveria e BRSS-së dhe PK do t’i plotësonin kaq shpejt kërkesat tona të shprehura në takim me Molotovin. Ne kishim nevojë për pajisje dhe specialistë, për të vënë në funksion impiantet e naftës, të cilat ishin të një rëndësie jetike për Shqipërinë, dhe qeveria sovjetike na e dha dorën duke dërguar në mënyrë të shpejtë për vendin sasi të nevojshme në grurë, misër e produkte të tjera. Te ne ndodhi shpërbërja e aparatit shtetëror të vjetër dhe i jemi mirënjohës PK dhe qeverisë sovjetike që dërgoi në Shqipëri specialistë me kualifikim të lartë, për të vënë në funksion ministri të tilla, si Ministria e Financave, e Bujqësisë, Ekonomisë etj. Na u dha mundësia t’i përgatisnim kuadrot direkt në BRSS. Populli ynë asnjëherë nuk do të harrojë gjithçka që ka bërë Bashkimi Sovjetik për ne*”.⁴⁰⁵ Ndërsa, lidhur me çështjen e lidhjeve të jashtme të Shqipërisë, Çuvahin u shpreh se “*Xoxe kritikoi ashpër pozitën e ShBA-së dhe Britanisë së Madhe ndaj Shqipërisë... Janë ata që penguan hyrjen e Shqipërisë në OKB dhe që pengojnë ende deri më sot, janë ata të cilët ngulin këmbë që në përbërjen e qeverisë të përfshihen kolaboracionistët dhe personat që kanë luftuar kundër partizanëve. Anglo-amerikanëve nuk iu pëlqen regjimi i*

⁴⁰²Momcilo Pavlovic, “*Albania between Tito and Stalin*”; Në “*The Balkans in the Cold War*”, edituar nga Vojislav G. Pavlovic, Institute des Etudes Balkaniques, Beograd, 2011, faqe 161. Marrë nga: <https://books.google.al/books>

⁴⁰³ *Po aty.*

⁴⁰⁴ *Po aty.*

⁴⁰⁵D. S. Çuvahin, “*Shërbimi im diplomatik në Shqipëri*”, Tiranë, Botimet: Almera, 2009, f. 31-32

demokracisë popullore në Shqipëri, ndaj nuk duan ta njohin qeverinë e tanishme të Shqipërisë dhe, nëpërmjet agjenturës së tyre bëjnë diversione të llojeve të ndryshme, vazhdojnë e kryejnë punë sabotuese”⁴⁰⁶.

Në bisedat me Çuvahin, Koci Xoxe trajtoi edhe problemet e marrëdhënieve të Shqipërisë me Jugosllavinë. Sipas fjalëve të tij, “shokët jugosllavë përpiqen të ndihmojnë Shqipërinë, të ngrënë në këmbë ekonominë e shkatërruar nga lufta. Aktualisht, ata dërgojnë në Shqipëri specialistët e tyre, pajisje, farëra të zgjedhura. Ata ndihmuan edhe në përgatitjen e reformës agrare”. Por Koci vërejti se “specialistët jugosllavë, ndonjëherë kanë bërë propozime të çuditshme. Ata, për shembull, ngulnin këmbë që të përfshihej në projektligjin për reformën agrare një propozim që parashikonte ruajtjen e sipërfaqeve të mëdha të tokës në pronësi private. Veç kësaj, ne shqiptarëve nuk na pëlqejnë sjelljet e specialistëve jugosllavë. Ata i shohin shqiptarët me një sy tjetër, hiqen si padronë dhe kundërshtimet tona nuk i marrin parasysh”.⁴⁰⁷

Ndërsa jugosllavët filluan ta rrisin ndikimin e tyre politik dhe ekonomik në Shqipëri, udhëheqësit shqiptarë nisën të shqetësoheshin gjithnjë e më shumë. “Partia, me fraksionizëm të theksuar, duke u përpjekur për të vendosur një kontroll mbi një komb të falimentuar, në atë kohë nuk ishte në pozitën e duhur për t’iu rezistuar sulmeve jugosllave.”⁴⁰⁸ Shtypi i huaj shkruante: *“E vërteta është se Mareshal Tito është mbrojtësi i Hoxhës dhe lidhi një traktat, me anën e të cilit Shqipëria vihet nën sundimin e plotë të Jugosllavisë. Kështu filluan të formohen shoqëri të përziera jugosllave-shqiptare për shfrytëzimin e vijave të hekurit, të minierave dhe të fabrikave. S’ka dyshim që disa shqiptarë e vështrojnë këtë përzierje me sy të keq, mbasi kujtojnë se këto hapa u shëmbëlajnë pikë për pikë atyre që mori Italia në kohë të mbretit Zog, dhe nuk harrojnë se këto hapa përfunduan në okupimin e Shqipërisë prej Italisë; dhe po që se historia përsëritet, atëherë Jugosllavia zë vendin e Italisë dhe, në këtë rast padyshim Enver Hoxha do të shahet prej popullit”*.⁴⁰⁹

Në korrik të vitit 1947, i shoqëruar nga Hysni Kapo, Hoxha e vizitoi Moskën për herë të parë dhe mendohet se u zemërua nga bisedat atje për të ndërmarrë një rezistencë ndaj planeve jugosllave, pasi një memorandum konfidencial, që jugosllavët i paraqitën Komitetit Qendror shqiptar në nëntor të 1947-s, kritikonte programin dhe qëndrimin shqiptar. Ky memorandum “e akuzoi palën shqiptare për një politikë anti-jugosllave, duke aderuar një politikë kulturore perëndimore dhe borgjeze, si dhe strehimin e një bashkëpunëtori armik (Nako Spiros). Ai gjithashtu e sulmoi planin pesëvjeçar shqiptar si

⁴⁰⁶*Po aty*, f.32

⁴⁰⁷*Po aty*, f.33

⁴⁰⁸ Central Intelligence Agency, “*Current Intelligence Staff Study, Soviet-Albanian Relations 1940-1960*”, ESAU XIX-62, 2007, f.1. Marrë nga: <https://www.cia.gov/library/readingroom/docs/esau-19.pdf>.

⁴⁰⁹*AMPJ*, Dosja Nr. B/VIII-3/a, viti 1947, f. 2.

autarkik dhe jorealist (është interesante të theksohet ngjashmëria e këtyre akuzave me ato, të cilët sovjetikët rreshtuan kundër Jugosllavisë disa muaj më vonë).⁴¹⁰

Në fillim të vitit 1948, Tito, pasi pa që çështja e bashkimit po zvarritej, planifikoi ta arrinte qëllimin e tij përmes ushtrisë. Përmes një letre, ai e njoftoi Enver Hoxhën se “po dërgonte një toger të përgjithshëm dhe një grup oficerësh për koordinimin e të dy ushtrive, me justifikimin e sigurimit të kufirit jugor shqiptar, në rast të ndonjë provokimi. Ai e paralajmëroi Hoxhën të ishte diskret pasi, nëse kjo zbulohet njerëzit do të reagonin”.⁴¹¹ Për ta arritur sa më shpejt qëllimin e tyre për unifikim, jugosllavët i dhanë mision Koçi Xoxes që të ushtronte ndikim brenda qeverisë shqiptare. Në shkurt të 1948-s, ai thirri mbledhjen e Komitetit Qendror. Plenumi i shkurtit gjithashtu e shkarkoi Mehmet Shehun nga pozicioni i tij, ndërsa “Koçi Xoxe vazhdoi persekutimet e të gjithë të dyshuarve që kundërshtonin marrëdhëniet shqiptaro-jugosllave”.⁴¹² Në prill ai paraqiti një propozim zyrtar për integrimin e Shqipërisë në Jugosllavi. Duke parë përkeqësimin e marrëdhënieve Moskë-Beograd, Enver Hoxha e refuzoi bashkimin.

Në shkurt të 1948-s, Stalini e akuzoi në mënyrë të drejtpërdrejtë udhëheqjen jugosllave se po nxiste ndërtimin e një federate me Shqipërinë pa u konsultuar me Bashkimin Sovjetik, si dhe për ndjekjen e politikave të cilat mund të rrezikonin situatën e përgjithshme në Ballkan. Stalini nxiti shtyrjen e formimit të një federate ballkanike dhe i shtyu jugosllavët që të përqendroheshin në një bashkim me Bullgarinë, në vend të kësaj.

Pavarësisht fasadës së bashkëpunimit të përzemërt midis jugosllavëve dhe shqiptarëve, me kalimin e kohës u vërejt një mosbesim shqetësues dhe pakënaqësi nga ana e udhëheqjes shqiptare e kryesuar nga E. Hoxha. Kjo u manifestua në keqkuptime të ndryshme, të cilat u mbajtën larg publikut. Hoxha e perceptoi ndihmën jugosllave dhe perspektivën e bashkimit me Jugosllavinë si një kërcënim të pozitës së tij brenda partisë së mbushur me liderë pro-jugosllavë. Këtu përfshiheshin Koçi Xoxe, N. Spiro dhe K. Temelko. Vetëm në retrospektivë, Hoxha e racionalizoi këtë frikë si shqetësim për pavarësinë e shqiptarëve. “Qëllimi i fundit i titistëve, - shkroi Hoxha në veprën me të njëjtin titull, - ishte pushtimi i plotë i Shqipërisë.” Ai përmendi që ky qëllim u shpall haptas në vitin 1948 nga kreu i misionit ushtarak jugosllav V. Stojnic në Plenumin e Beratit. Hoxha pohonte vazhdimisht se jugosllavët u përpoqën t'i “nënshtrajnë dhe keqpërdorin” shqiptarët, pavarësisht programit të bashkëpunimit.⁴¹³ Një shembull ishte se “Jugosllavia

⁴¹⁰ Central Intelligence Agency, “*Current Intelligence Staff Study, Soviet-Albanian Relations 1940-1960*”, ESAU XIX-62, 2007, f.5. Marrë nga: <https://www.cia.gov/library/readingroom/docs/esau-19.pdf>.

⁴¹¹ *Marrëdhëniet shqiptaro-jugosllave...*, përgatitën N. Plasari dhe L. Malltezi, f. 207-208.

⁴¹² Albina Dranqoli, “*Tito-s attempt to integrate Albania into Yugoslavia, 1945-1948*”. History Studies, International Journal of History, Volume 3/2, 2011, f.195. Marrë nga: <https://www.acarindex.com/dosyalar/makale/acarindex-1423902522.pdf>

⁴¹³ Momcilo Pavlovic, “*Albania between Tito and Stalin*”; Në “*The Balkans in the Cold War*”, edituar nga Vojislav G. Pavlovic, Institute des Etudes Balkaniques, Beograd, 2011, faqe 162. Marrë nga: <https://books.google.al/books>.

nuk pranoi ta ndihmonte industrinë shqiptare të prodhimit”.⁴¹⁴ Shqiptarët kërkuan fonde investimesh për të zhvilluar industri të lehta dhe një rafineri të naftës, ndërsa jugosllavët donin që shqiptarët të përqendroheshin në bujqësi dhe në nxjerrjen e lëndëve të para. Pasi e kuptoi këtë qëllim, Enver Hoxha deklaroi: *“Pritej të prodhoni për jugosllavët gjithë lëndën e parë që u duhet. Këto lëndë të para do të eksportoheshin në metropolin jugosllav për t’u përpunuar atje në fabrikat jugosllave... Qëllimi i jugosllavëve ishte, pra, ta pengonin vendin tonë të zhvillohej, ose industrinë e tij ose klasën e tij punëtore, dhe ta bënë atë përgjithmonë të varur nga Jugosllavia”*.⁴¹⁵

Sidoqoftë, këto akuza lidhen me frikën e E. Hoxhës për heqjen e pushtetit që ai mbante. Siç duket dhe në deklaratën e tij, *“qëllimi i jugosllavëve ishte largimi im total, udhëheqja jugosllave dëshironte të më eliminonte”*.⁴¹⁶ Pasi u kritikua gjithnjë e më shumë nga bashkëpunëtorët e tij më të afërt, të cilët më pas, i cilësoi si spiunë jugosllavë, E. Hoxha shprehu frikë për sigurinë e tij, si shqetësim për partinë, shtetin dhe popullin shqiptar. E. Hoxha kërkonte mbështetje brenda Partisë Komuniste Shqiptare dhe midis përfaqësuesve sovjetikë në Shqipëri, duke përcjellë më tej detajet nga negociatat jugosllave-shqiptare. Gjithashtu, Hoxha i ftonte vazhdimisht këshilltarët sovjetikë në ushtrinë shqiptare, gjë që shkaktoi rritje të dyshimeve ndaj marrëdhënieve me Jugosllavinë.

Kështu, traktatet në lidhje me harmonizimin ekonomik u vonuan, pasi udhëheqja jugosllave u informua për një ndarje brenda palës shqiptare. Njëra palë drejtohej nga Xoxe, e cila diskutonte për bashkëpunim me Jugosllavinë, dhe tjetra nga Hoxha, që ishte kundër tij. Një pjesë e udhëheqjes shqiptare shprehte dyshime për natyrën e marrëveshjeve të tilla dhe dëmin e mundshëm të tyre për ekonominë shqiptare.⁴¹⁷

Një dyshim i tillë nuk ishte pa bazë. Telegrafi i J. Djerdjes drejtuar Titos tregon se *“nga një burim i informuar, udhëheqja shpreh dyshime për aftësinë e Jugosllavisë për të përmbushur detyrimet e marra... Tregtia midis dy vendeve tona duket se konfirmon pikëpamje të tilla skeptike të injorantëve dhe sabotatorëve, siç është importi nga Shqipëria që kohët e fundit po e tejkalon shumë eksportin tonë”*. Nga ana tjetër, Hoxha duhet të merrte në konsideratë mendimin e figurave të tjera drejtuese në Partinë Komuniste Shqiptare, veçanërisht S. Malëshovës. K. Xoxes arriti në përfundimin se deri në heqjen e

⁴¹⁴ Albina Dranqoli, *“Tito-s attempt to integrate Albania into Yugoslavia, 1945-1948”*. History Studies, International Journal of History, Volume 3/2, 2011, faqe 195. Marrë nga: <https://www.acarindex.com/dosyalar/makale/acarindex-1423902522.pdf>.

⁴¹⁵ Po aty.

⁴¹⁶ Po aty.

⁴¹⁷ Momcilo Pavlovic, *“Albania between Tito and Stalin”*; Në *“The Balkans in the Cold War”*, edituar nga Vojislav G. Pavlovic, Institute des Etudes Balkaniques, Beograd, 2011, f.163. Marrë nga: <https://books.google.al/books>.

tij, Malëshova po e mbante të gjithë situatën në Shqipëri në duart e tij. Ai ishte më i miri ndër komunistët, pasi kishte jetuar dhe mësuar në Rusi”.⁴¹⁸

Malëshova mendonte se bashkëpunimi me Jugosllavinë supozohej të ishte në të njëjtin nivel si bashkëpunimi me fuqitë perëndimore, veçanërisht me Shtetet e Bashkuara dhe Britaninë e Madhe, në mënyrë që të sigurohej njohja e qeverisë shqiptare. Pas largimit të tij, një numër udhëheqësish argumentuan për anashkalimin e Jugosllavisë dhe zhvillimin e marrëdhënieve të menjëhershme midis Shqipërisë dhe Bashkimit të Republikave Socialiste Sovjetike.

3.2 Presioni jugosllav kundër afrimin të Shqipërisë me Bashkimin Sovjetik

Të gjithë faktorët e lartpërmendur kontribuan në përpjekjet e Enver Hoxhës për të vendosur marrëdhënie të drejtpërdrejta me Bashkimin e Republikave Socialiste dhe për të arritur ndarjen nga ndihma jugosllave, të cilën ai e kuptoi si një presion. Vlen të theksohet se, në fillim të tyre marrëdhëniet e Partisë Komuniste të Shqipërisë me Partinë Komuniste sovjetike ishin thuajse minimale. Që nga Lufta e Dytë Botërore, PKSh ishte e përbërë pothuajse ekskluzivisht nga shqiptarë, përvoja dhe trajnimi i të cilëve ishte marrë ose në Shqipëri ose në mërgim dhe nuk kishte asnjë bërthamë të stërvitur sovjetike. “Fitorja e Partisë Komuniste në Luftën e Dytë Botërore nuk ishte fituar nga mbështetja e drejtpërdrejtë e ushtrisë sovjetike, por kryesisht nga një kombinim i përpjekjeve të veta, si dhe me ndihmë të atyre pak udhëzimeve jugosllave.”⁴¹⁹ Kontaktet e para zyrtare midis sovjetikëve dhe shqiptarëve kishin nisur pak para përfundimit të Luftës II Botërore, kur në Shqipëri mbërriti një grup i vogël oficerësh ushtarakë sovjetikë. Marrëdhëniet diplomatike mes Shqipërisë dhe BRSS u rivendosën në nëntor të vitit 1945 (ishin vendosen qysh më 17 shtator 1924. Në prill 1939 u ndërpre, për shkak të pushtimit të Shqipërisë nga Italia fashiste) ku nisën edhe kontaktet zyrtare mes liderëve të të dy vendeve. Por në vitet e pasluftës, BRSS lejoi Titon dhe partinë e tij jugosllave të marrin përsipër detyrën e sigurimit të ndihmës së nevojshme ekonomike dhe udhëzimin politik për PKSh, detyrë të cilën PKJ, tashmë e përfshirë thellë në çështjet shqiptare dhe me mendimin për aneksimin përfundimtar të Shqipërisë në Jugosllavi, e pranoi menjëherë.

Siç u theksua edhe më lart, në korrik të 1947-s Enver Hoxha, i shoqëruar nga Hysni Kapo, vizitoi Moskën për herë të parë. Stalini vazhdimisht kërkonte informacione nga jugosllavët, lidhur me statusin e marrëdhënieve të tyre me Shqipërinë. Deri në pranverën e vitit 1948, kur marrëdhëniet mes Stalinit dhe Titos u acaruan më tej, BRSS filloi hapat e mëtejshme për të rritur ndikimin e tij në Shqipëri. Pavarësisht viteve të bashkëpunimit të

⁴¹⁸Momcilo Pavlovic, “Albania between Tito and Stalin”; Në “The Balkans in the Cold War”, edituar nga Vojislav G. Pavlovic, Institute des Etudes Balkaniques, Beograd, 2011, f.163. Marrë nga: <https://books.google.al/books>

⁴¹⁹ Central Intelligence Agency, “Current Intelligence Staff Study, Soviet-Albanian Relations, 1940-1960”, ESAU XIX-62, 2007, faqe 1. Marrë nga: <https://www.cia.gov/library/readingroom/docs/esau-19.pdf>.

ngushtë politik dhe ndihmës ekonomike në shkallë të gjerë, “kontrolli jugosllav në Shqipëri ishte aq i dobët sa brenda një jave pas zgjidhjes së Kominformës të qershorit 1945, aftësitë dhe pasuritë jugosllave në Shqipëri ishin imobilizuar plotësisht.”⁴²⁰

Me perceptimin e kërcënimit nga pala jugosllave, Enver Hoxha filloi të kërkonte kontakt të drejtpërdrejtë me Moskën përmes përfaqësuesve sovjetikë në Shqipëri. Aksioni i parë ndodhi në maj të 1947-s, gjatë vizitës së delegacionit shqiptar në Moskë. Ky delegacion u drejtua nga N. Spiro dhe qëllimi i tij ishte vendosja e marrëdhënieve ekonomike dhe kulturore me Moskën. Duke qenë se jugosllavët nuk ishin informuar për ato hapa, ata reagueshan duke provokuar edhe incidente. Ambasadori jugosllav në Moskë, Popoviç, kërkoi një shpjegim nga kolegu i tij shqiptar dhe deklaroi se “vizita të tilla po dëmtojnë marrëveshjet e arritura me Jugosllavinë”.⁴²¹ Protesta shqetësoi E. Hoxhën, i cili përcolli mendimet e tij për S. Zlatic, përfaqësuesin special të Jugosllavisë. Incidenti përfundoi me telegramin e Komitetit Qendror të PKJ, i cili vlerësoi se, “nëse informacionet janë të vërteta, ambasadori nuk ka vepruar siç duhet”.⁴²²

Në korrik 1947, Hoxha vizitoi Stalinin dhe së bashku ata nënshkruan një marrëveshje tregtare, e cila përfshinte një kredi modeste për Shqipërinë, si dhe ndihmë për ndërtimin e një fabrike të makinave bujqësore. Hoxha kërkoi gjithashtu instruktorë ushtarakë, por dyshohet se Stalini ia ngarkoi këtë kërkesë Jugosllavisë. “Vizita e delegacionit tonë në Jugosllavi, - shkroi Hoxha më pas, - do të shërbente si një katalizator i fortë për të zbuluar të gjitha papastërtitë e fshehura nga revizionistët e Beogradit në marrëdhëniet tona të ndërsjella.”⁴²³

Megjithëse Stalini po e drejtonte E. Hoxhën drejt bashkëpunimit me Jugosllavinë, ai pa dyshim pati përshtypjen se gëzonte besimin e udhëheqjes sovjetike. Pas kësaj vizite, shtypi shqiptar ishte i mbushur me tekste që favorizonin BRSS dhe shmangnin qartë rëndësinë e mbështetjes jugosllave. Raportet e përfaqësuesit jugosllav në Tiranë pajtoheshin me këto tendenca dhe udhëheqja jugosllave kishte dyshim, lidhur me sinqeritetin e palës shqiptare. Kjo ndodhi pa marrë parasysh sigurinë e dhënë nga sovjetikët.

Jugosllavët vunë re se fotografia e Titos mungonte në festën që Shtabi i Përgjithshëm bëri për 30-vjetorin e Revolucionit të Tetorit, si dhe në disa prej fabrikave

⁴²⁰ Central Intelligence Agency, “Current Intelligence Staff Study, Soviet-Albanian Relations, 1940-1960”, ESAU XIX-62, 2007, faqe 2. Marrë nga: <https://www.cia.gov/library/readingroom/docs/esau-19.pdf>.

⁴²¹ Momcilo Pavlovic, “Albania between Tito and Stalin”; Në “The Balkans in the Cold War”, edituar nga Vojislav G. Pavlovic, Institute des Etudes Balkaniques, Beograd, 2011, faqe 164. Marrë nga: <https://books.google.al/books>

⁴²² Arkivi i Jugosllavisë (më tej: AJ), 507/IX, Albanija, I-1/135, 1947. Marrë nga: <https://books.google.al/books>

⁴²³ Momcilo Pavlovic, “Albania between Tito and Stalin”; Në “The Balkans in the Cold War”, edituar nga Vojislav G. Pavlovic, Institute des Etudes Balkaniques, Beograd, 2011, faqe 164. Marrë nga: <https://books.google.al/books>

shqiptaro-jugosllave. Pas kthimit të E. Hoxhës nga Moska, S. Zlatic shkroi se “*linja shqiptare po përkulet drejt lidhjes direkte me Bashkimin e Republikave Socialiste Sovjetike*”⁴²⁴, çka e bënte të paqartë rolin e marrëveshjes ekonomike me Jugosllavinë. Ai gjithashtu shkroi për tendencën e nënvlerësimit të rolit të Jugosllavisë, që nuk u përmend as në Planin Njëvjeçar dhe as në Planin Pesëvjeçar. Sidoqoftë, ai theksoi edhe dështimet e palës jugosllave, siç janë planet për ndërtimin e një hekurudhe nga Durrësi në Elbasan (“*Ku kemi bërë përshtypje të dobët*”),⁴²⁵ mungesën e teknikëve për ndërmarrjet e përbashkëta, për shfrytëzimin e naftës, vonesat në ndërtimin e fabrikave të planifikuara, dhe dërgesa jo të plota (siç ishte ajo e 40.000 bluzave ushtarake pa pantallona).⁴²⁶

Në anën tjetër, përgjatë turneve nëpër Shqipëri, Enver Hoxha shfaqte ende favorizimin ndaj Jugosllavisë dhe mundësitë për bashkëpunim. Niko Opari, Sekretari i Përgjithshëm pro-jugosllav i qeverisë shqiptare, pohoi tek i dërguari jugosllav, pas largimit të tij nga partia, se zyrtarët shqiptarë “*nuk janë të vetëdijshëm se Jugosllavia është një parakusht objektiv për ekzistencën e Shqipërisë së re*”,⁴²⁷ dhe se nuk parashikohej një bashkim i ardhshëm.

Nën një klimë të tillë vazhduan marrëdhëniet ekonomike midis dy vendeve. Bashkëpunimi ushtarak u forcua gjithashtu. Ky fakt u zbulua gjatë vizitës së përfaqësuesve të vjetër të ushtrisë jugosllave që raportuan për kushtet në ushtrinë shqiptare. Në fillim të vitit 1948, kishin filluar negociatat serioze me qëllim të përmirësimit të kushteve në ushtrinë shqiptare dhe për të forcuar Shqipërinë, në rastin e problemeve të mundshme kufitare me Greqinë. Gjithashtu, në Tiranë, “përfaqësuesi ushtarak jugosllav gjeneral Kupresanin, Zlatic dhe të tjerë patën një takim me Hoxhën për të vendosur një bashkëpunim ushtarak për ndërtimin e rrugëve, urave strategjike dhe depove”.⁴²⁸ Megjithëse Enver Hoxha u pajtua në fillim me këtë fakt, ai e informoi palën jugosllave për t’i shtyrë planet, derisa të mund të merrte mendimin e qeverisë sovjetike. Pala sovjetike i qortoi jugosllavët për dërgimin e trupave në Shqipëri pa u konsultuar me Moskën, pasi ka lidhur marrëveshje për ndihmë të ndërsjellë dhe miqësi. Gjilas i raportoi Titos nga Moska se Stalini këshillonte se duhet të ruhej një formë e pavarësisë shqiptare në mbështetje të

⁴²⁴ *Po aty*.

⁴²⁵ *AJ*, 507/IX, Albanija, I-1/142 dhe 143. Marrë nga: <https://books.google.al/books>). **Shënim:** Informacion mbi marrëdhëniet jugosllave/shqiptare nga 1 gushti 1947. Mesazhi nga Legata e Jugosllavisë në Tiranë në lidhje me deklaratën e Stalinit drejtuar Hoxhës për marrëdhëniet midis tre vendeve nga 27 gushti 1947.

⁴²⁶ *AJ*, 507/IX, Albanija, I-1/142 dhe 143. Marrë nga: <https://books.google.al/books>? **Albania+between+Tito+and+Stalin**) **Shënim:** Informacion mbi marrëdhëniet jugosllave/shqiptare nga 1 gushti 1947. Mesazhi nga Legata e Jugosllavisë në Tiranë në lidhje me deklaratën e Stalinit drejtuar Hoxhës për marrëdhëniet midis tre vendeve nga 27 gushti 1947.

⁴²⁷ Momcilo Pavlovic, “*Albania between Tito and Stalin*”; Në “*The Balkans in the Cold War*”, edituar nga Vojislav G. Pavlovic, Institute des Etudes Balkaniques, Beograd, 2011, faqe 165. Marrë nga: <https://books.google.al/books>.

⁴²⁸ *AJ*, 507 IX, Albanija, III/1 129 Marrë nga: <https://books.google.al/books>? **Momcilo+PavlovicAlbania+ between+Tito+and+Stalin** (parë më 29.06.2020); *AJ*, 507 IX, Albanija, I-1 135, 1947 Marrë nga: <https://books.google.al/books>

vetë E. Hoxhës, si një mënyrë për t’iu kundërvënë thashethemeve se qëllimi jugosllav ishte nënshtrimi i shqiptarëve. Në shkurt 1948, Rankoviç e njoftoi Gjilasin se me vendimin e Stalinit u prish plani i krijimit të bazës ushtarake në Korçë. Në të njëjtën periudhë, “Stalini nuk guxonte t’i sfidonte fuqitë perëndimore, dhe u frustrua edhe me sjelljen rreth çështjes së federatës ballkanike. Stalini sugjeroi se nuk ka asnjë arsye për të bërë presion për një marrëveshje federale, dhe përsëri insistoi që të preferohen planet për një federatë me Bullgarinë nga ana tjetër. Pra, Stalini mendoi se bashkimi i Jugosllavisë me Shqipërinë duhet të realizohej në një fazë të dytë, “hap pas hapi dhe jo papritmas, me çizmet në qafë”.⁴²⁹ Në vend që të dërgonte trupa, Stalini sugjeroi forcimin gradual të ushtrisë shqiptare, “dhe nëse ata sulmohen, kuvendi shqiptar mund t’i thërrasë jugosllavët”.⁴³⁰ Aksioni jugosllav në Shqipëri në fakt “ishte duke prishur planet e tjera të Stalinit dhe po rrezikonte marrëdhëniet e tij të përgjithshme me Britaninë e Madhe dhe Shtetet e Bashkuara”⁴³¹, pra është i kuptueshëm “vlerësimi i tij mbi situatën”.⁴³²

3.3 Përkeqësimi i marrëdhënieve sovjeto-jugosllave, ndikimi në Shqipëri

Konflikti midis Jugosllavisë dhe BRSS, pra midis Stalinit dhe Titos, u materializua fillimisht në territorin e Shqipërisë. Stalini ishte i informuar mirë për politikën jugosllave në këtë vend, si dhe ishte i vendosur t’i ndalte ato dhe ekspansionizmin ideologjik dhe politik jugosllav në Ballkan. Aksioni i përbashkët i *Kominformës* ishte menduar si një mjet për realizimin e këtij qëllimi. Është e vështirë për të vlerësuar rolin e Hoxhës në akuzat e Moskës kundër Titos. Shqipëria nuk ishte anëtare e *Kominformës*, prandaj Enver Hoxha pretendoi se mungesa e kësaj anëtarësie ishte pasojë e insistimit jugosllav. Kështu ai realizoi një takim sekret në Bukuresht me Vishninkin dhe Dejin, në mënyrë që të forconte aktakuzën kundër Titos me provat e tij. Ai e shfrytëzoi këtë mundësi për të përplasur miqtë e mëparshëm dhe për ta kthyer vendin e tij drejt Stalinit të plotfuqishëm.

Në vijim, udhëheqësi bullgar Dimitrov dhe Tito (i cili dërgoi Kardelin në vend të tij) “u thirrën në Moskë dhe u qortuan ashpër nga Stalini për botimin e planeve të tyre për një federatë jugosllavo-bullgare”.⁴³³ Stalini gjithashtu i dënoi jugosllavët për planin e dërgimit të dy divizioneve në Shqipëri pa konsultimin ose informimin e liderëve sovjetikë. Liderët shqiptarë në mbledhjen e Komitetit Qendror, në shkurt, po kërkonin ndihmën

⁴²⁹ Momcilo Pavlovic, “Albania between Tito and Stalin”; Në “*The Balkans in the Cold War*”, edituar nga Vojislav G. Pavlovic, Institute des Etudes Balkaniques, Beograd, 2011, faqe 165. Marrë nga: <https://books.google.al/books>

⁴³⁰ *Po aty*.

⁴³¹ *AJ*, 507 IX, Albanija I-1/143, 1947. Marrë nga: <https://books.google.al/books>

⁴³² E. Hoxha, *Titistët...*, f. 258-260.

⁴³³ Central Intelligence Agency, “Current Intelligence Staff Study, Soviet-Albanian Relations, 1940-1960”, ESAU XIX-62, 2007, f. 5-6. Marrë nga: <https://www.cia.gov/library/readingroom/docs/esau-19.pdf>.

sovjetike për të kundërshtuar planet e Jugosllavisë mbi Shqipërinë. Dhe menjëherë pas kësaj u vu re një rritje e papritur e interesit të sovjetikëve në Shqipëri. Në mars të vitit 1947, një mision ushtarak sovjetik, i kryesuar nga një gjeneral dhe 15 oficerë, mbërriti në Tiranë. Po ashtu u vu re “rritja e vizitave të delegacioneve sovjetike në pranverë, dhe shqiptarët kishin me sa duket mjaft shpresë për rritjen e ndihmës sovjetike dhe mbështetjen, saqë ishin të gatshëm t’i godisnin jugosllavët publikisht”.⁴³⁴

Në vitit 1947, udhëheqësit sovjetikë nuk kishin vendosur akoma ta sulmonin Jugosllavinë. “Komisioni i politikës së jashtme kishte vërejtur “gabimet” e PKJ në një memorandum për Jugosllavinë, të datës 18 mars 1948 (i cili shërbeu si sfond për letrën e dërguar nga Stalin dhe Molotov për udhëheqësit jugosllavë më 27 mars 1948), por komisioni ishte po aq kritik edhe ndaj partive të tjera të Europës Lindore.”⁴³⁵ Stalin dhe Molotov filluan të dyshonin për politikën e Jugosllavisë në Ballkan. Dmitrii Chuvakhin, i dërguari sovjetik në Tiranë, në periudhën 1946-1952, kujtoi se Stalini i tha delegacionit shqiptar që vizitoi Moskën në korrik 1947 se “BRSS nuk ishte dakord me politikën e Beogradit ndaj Shqipërisë dhe se Shqipëria, si një vend i pavarur, duhet të kujdeset vetë për marrëdhëniet e saj me ndërkombëtarët”.⁴³⁶ Në gusht-shtator 1947, qëndrimi i Stalinit përputhej me “shënimin informativ” për Jugosllavinë, sipas së cilit, pavarësisht përfundimit të Traktatit për Miqësi dhe Ndihmë të Ndërsjellë me Shqipërinë, qeveria jugosllave nuk i përmbushi detyrimet e saj ndaj Shqipërisë për një vit të plotë dhe nuk e ndihmoi atë ekonomikisht.

Më 21 janar 1948, ambasadori Lavrent’ev njoftoi Moskën se për vendosjen e propozuar të trupave nuk u ndërmor ndonjë konsultim me këshilltarët ushtarakë sovjetikë.⁴³⁷ Edhe pse mbetet e paqartë se kush ia kaloi këtë informacion ambasadorit Lavrent’ev, “diplomatët sovjetikë në Tiranë morën informacion drejtpërdrejt nga qeveria shqiptare, në lidhje me lëvizjen e planifikuar të trupave”.⁴³⁸ Udhëheqësit sovjetikë

⁴³⁴ *Po aty.*

⁴³⁵ **Shënim:** Dokumenti titullohet “Mbi pikpamjet anti-marksiste të udhëheqësve të Partisë Komuniste Jugosllave në pikpamjet anti-marksiste të udhëheqësve të Partisë Komuniste Jugosllave në çështjet e politikës së brendshme dhe të jashtme”, 18 Mars 1948, ruhet në RGASPI (Arkivi Shtetëror Rus i Historisë Sociale dhe Politike), F. 17, Op. 128, D. 1163, Ll. 9–24. Marrë nga: https://www.zora.uzh.ch/id/eprint/62735/1/Perovic_Tito.pdf

⁴³⁶ **Shënim:** Shih edhe transkriptin e bisedës së Hoxhës me Molotov një ditë para takimit të Hoxhës me Stalinin, 15 July 1947, në AVPRF (Arkivi i Politikës së Jashtme të Federatës Ruse), F. 06, Op. 9, P. 31, D. 431, Ll. 2–15. Marrë nga: https://www.zora.uzh.ch/id/eprint/62735/1/Perovic_Tito.pdf.

⁴³⁷ Memorandum nga Lavrent’ev, 21 janar 1948, në AVPRF (Arkivi i Politikës së Jashtme të Federatës Ruse), F. 059, Op. 20, D. 257, P. 36, Ll. 89–90. Marrë nga: https://www.zora.uzh.ch/id/eprint/62735/1/Perovic_Tito.pdf

⁴³⁸ **Shënim:** Informacion i detajuar mbi lëvizjen e propozuar të trupave jugosllave dhe situatën në kufirin greko-shqiptar është përshirë në një raport dhënë për Misionin Sovjetik në Shqipëri nga qeveria shqiptare, ruajtur në RGASPI (Arkivi Shtetëror Rus i Historisë Sociale dhe Politike), F. 17, Op. 128, D. 472, Ll. 77–83. Marrë nga: https://www.zora.uzh.ch/id/eprint/62735/1/Perovic_Tito.pdf Dokumente të mëtejshme mbi marrëdhëniet sovjetike shqiptare në lidhje me çështjen Spiros dhe ngjarjet e janarit mund të gjenden në

ndiheshin qartësisht të provokuar, dhe reagimi i tyre ishte i ashpër, për shkak se ky nuk ishte lajmi i vetëm shqetësues i Ballkanit të asaj kohe. Një javë më parë, më 15 janar 1948, udhëheqja sovjetike mori njoftimin se Koçi Xoxe kishte treguar privatisht se plani i shkrirjes së ushtrisë jugosllave dhe shqiptare ishte në punim e sipër. Koçi Xoxe gjithashtu tregoi se Jugosllavia, Bullgaria dhe Shqipëria tashmë kishin rënë dakord “të formonin një ushtri të vetme nën një komandë të përbashkët, nëse do e kërkonte situata. Sipas Koçi Xoxes, Enver Hoxha i kishte aprovuar të gjitha këto plane”.⁴³⁹

Më 28 janar, me urdhër të Molotovit, ambasadori Lavrent'ev u takua me Titon për të zbuluar nëse raportet për vendosjen e trupave të propozuara ishin të sakta. Lavrent'ev dorëzoi një mesazh nga Molotov për Titon, duke thënë se “*Anglo-saksonët*” e konsideronin “*lëvizjen e ushtrisë jugosllave në Shqipëri si një veprim të okupimit të Shqipërisë nga ushtria jugosllave dhe një shkelje të sovranitetit të saj*” dhe mund t'i përdorin këto rrethana si “*pretekst*” për ndërhyrje në këtë çështje”.⁴⁴⁰ Pasi mori përgjigjen e Titos, ambasadori raportoi përsëri te Molotov po atë ditë se, sipas mendimit të Titos, monarko-fashistët grekë dhe përkrahësit e tyre duhet të kuptojnë se Jugosllavia do ta mbrojë plotësisht Shqipërinë. Në rast se Jugosllavia nuk e bënte këtë synim të qartë, monarko-fashistët mund ta pushtonin me lehtësi Shqipërinë e Jugut, sepse kufiri shqiptaro-grek në thelb është i pambrojtur. Tito më tej deklaroi se ai pajtohej me pikëpamjen e Moskës. Tito kërkoi që pikëpamjet e tij të bëheshin të ditura në Moskë dhe, në të njëjtën kohë, vendosi ta shtyjë dërgimin e divizioneve në Shqipëri. Nëse Bashkimi Sovjetik e konsideronte të dëshirueshme braktisjen e këtij projekti, Jugosllavia do ta pranonte këtë rekomandim. Por nëse Greqia marshonte në Shqipëri, Tito tha me shaka se “*Jugosllavia së bashku me Bashkimin Sovjetik do ta pastrojnë këtë rrëmuje*”.⁴⁴¹

Tri ditë më vonë, Lavrent'ev i dha Titos një letër tjetër nga Molotov, i cili u shpreh me një ton jashtëzakonisht të prerë. Për herë të parë, Molotov iu referua “*dallimeve serioze*” midis Bashkimit Sovjetik dhe Jugosllavisë, duke thënë se “*Nga biseda juaj me shokun Lavrent'ev është e dukshme që ju e konsideroni normale nëse Jugosllavia, e cila ka nënshkruar një Traktat të Ndihmës së Ndërsjellë me Bashkimin e Republikave Socialiste Sovjetike, jo vetëm beson se mund të heqë dorë nga këshillimi me BRSS për çështjen e*

AVPRF (Arkivi i Politikës së Jashtme të Federatës Ruse), F. 067, Op. 14, D. 6, P. 104, Ll. 51, 73, 81, 93, 97, 99, 151–152. Marrë nga: https://www.zora.uzh.ch/id/eprint/62735/1/Perovic_Tito.pdf.

⁴³⁹ Raporti (“*Top Secret*”) shpërndarë Stalin-it, Molotov-it, Zhdanov-it, Lavrentii Beria-s, Anastas Mikolan-it, Georgii Malenkov-it, dhe Nikolai Voznesenskii-t, ruhet në RGASPI (Arkivi Shtetëror Rus i Historisë Sociale dhe Politike), F. 17, Op. 128, D. 1160, Ll. 1–4. Marrë nga: https://www.zora.uzh.ch/id/eprint/62735/1/Perovic_Tito.pdf.

⁴⁴⁰ *Po aty*.

⁴⁴¹ Jeronim Perovic, “*The Tito-Stalin split: a reassessment in light of new evidence*”. Artikull në: Zurich Open Repository and Archive, University of Zurich, 2007, faqe 50. Marrë nga: https://www.zora.uzh.ch/id/eprint/62735/1/Perovic_Tito.pdf.

vendosjes së ushtrisë së saj në Shqipëri, por as nuk e konsideron të nevojshme të paktën të informojë [Bashkimin e Republikave Socialiste Sovjetike për çështje të tilla]...”⁴⁴²

Lavrent’ev raportoi përsëri në Moskë se pasi e lexoi letrën, Tito u irritua. Sipas ambasadorit, Tito pranoi se ishte një gabim serioz marrja e një vendimi pa u konsultuar me Moskën. Lavrent’ev tha se udhëheqësi jugosllav premtoi të mos i zhvendoste ndarjet jugosllave në Shqipëri dhe të këshillohej me Moskën paraprakisht për të gjitha çështjet e tilla në të ardhmen.

Më 1 shkurt 1948, Lavrent’evi i dha mareshalit jugosllav një letër nga Molotov, duke theksuar se *“ekzistojnë dallime serioze midis nesh në lidhje me çështjet e politikës së jashtme. Duke pasur parasysh situatën e tensionuar ndërkombëtare, ne besojmë se është e nevojshme eliminimi i këtyre dallimeve përmes shkëmbimit të pikëpamjeve në një takim jozyrtar në Moskë. Prandaj kërkohet që të dërgoni dy ose tre zyrtarë të lartë të qeverisë jugosllave në Moskë për një shkëmbim mendimesh.”*⁴⁴³

Tito menjëherë e pranoi ftesën dhe dërgoi një delegacion të rangut të lartë jugosllav në kryeqytetin sovjetik, me Eduard Kardelj, në krye *“njeriu i dytë”*. Gjilas ishte tashmë atje në pritje të tyre dhe iu bashkua delegacionit jugosllav. Në Moskë ishte thirrur gjithashtu edhe një delegacion bullgar, *“në përgjigje të një deklarate të diskutueshme nga lideri i Partisë Komuniste Bullgare, Georgi Dimitrov”*.⁴⁴⁴ Për gazetaret perëndimorë, Dimitrov u shpreh për unifikim të demokracive perëndimore... se është koha e duhur për një federatë ose konfederatë, ku të bënte pjesë edhe Greqia, gjë që ngjalli vëmendje të madhe ndërkombëtare. Reagimi i parë negativ nga ana e kampit socialist nuk erdhi nga Moska por nga Beogradi. Tito argumentoi se fjalimi i Dimitrov ishte *“i dëmshëm”* dhe i kërkoi Gjilasit të sugjeronte që Stalini *“të flasë me shokët bullgarë”*.⁴⁴⁵ Udhëheqësi jugosllav dëshironte të theksonte se qëndrimi i Dimitrov nuk mund të barazohej me atë të Beogradit, veçanërisht në lidhje me Greqinë. Gazeta sovjetike *“Pravda”*, më 23 janar 1948 e përmendi këtë çështje pa e kritikuar Dimitrovin. Megjithatë, dy ditë më vonë, Stalini i dërgoi Dimitrovit një telegram duke e përshkruar deklaratën si një koment *“të nxituar dhe të dëmshëm”* që lehtësonte *“luftën e anglo-amerikanëve kundër demokracive popullore.”*⁴⁴⁶ Më 28 janar, *“Pravda”* përmendi përsëri deklaratën e Dimitrovit, por kësaj radhe i bëri asaj një kritikë të ashpër. Një ditë më pas, qeveria bullgare, përmes agjencisë së saj të shtypit njoftoi se e pranonte plotësisht pozicionin sovjetik. Më 2 shkurt Dimitrov nuk e pranoi deklaratën e tij

⁴⁴² *Po aty.*

⁴⁴³ *Po aty.*

⁴⁴⁴ Jeronim Perovic, *“The Tito-Stalin split: a reassessment in light of new evidence”*. Artikull në: Zurich Open Repository and Archive, University of Zurich, 2007, faqe 51. Marrë nga: https://www.zora.uzh.ch/id/eprint/62735/1/Perovic_Tito.pdf

⁴⁴⁵ **Shënim:** Memorandum nga Lavrent’ev drejtuar Molotov-it, në AVPRF (Arkivi i Politikës së Jashtme të Federatës Ruse), F. 06, Op.7, D. 872, P. 53, Ll. 16–18, 34–35. Marrë nga: https://www.zora.uzh.ch/id/eprint/62735/1/Perovic_Tito.pdf

⁴⁴⁶ *Po aty.*

dhe i shkroi Stalinit “për solidaritetin e tij me qëndrimin sovjetik.⁴⁴⁷ Ndryshimi i papritur i politikës së Bashkimit Sovjetik ndaj deklaratave të Dimitrov kishte pak lidhje me deklaratën e tij. Kur Gjilas u takua me Zhdanov, më 19 janar 1948, për të sqaruar pozicionin jugosllav mbi deklaratën e Dimitrov, Zhdanov nuk tregoi nëse Moska do të justifikohet apo jo për Bullgarinë, dhe ai gjithashtu nuk pranoi të komentonte deklaratën e Dimitrov.⁴⁴⁸ Siç duket, kthimi në politikën sovjetike erdhi kur liderët sovjetikë mësuan lidhur me qëllimin e Titos për të dërguar dy divizione jugosllave në Shqipëri. Pra nuk ishte deklarata e Dimitrov që nxiti rebelim, por drejtimi i përgjithshëm i politikës jugosllave në Ballkan (veçanërisht planet për të dërguar trupa në Shqipëri) ajo që nxiti rebelimin sovjetik nga ana e Dimitrov. Më 10 shkurt 1948, zyrtarët bullgarë dhe jugosllavë u takuan në Moskë me Stalinin, Molotovin, Zhdanovin dhe zyrtarë të tjerë të niveleve të larta sovjetike. “Pjesëmarrësit sovjetikë shprehën kritika të ashpra ndaj veprimeve bullgare dhe jugosllave.⁴⁴⁹ Pika e parë e ngritur nga Molotov ishte Traktati Jugosllavo-Bullgar mbi Miqësinë dhe Ndihmën e Ndërsjellë, i cili ishte nënshkruar në Bled më 1 gusht 1947 pa një konsultim paraprak me Moskën. “Mungesa e konsultimit në lidhje me këtë çështje, argumentoi Molotov, tregon *“dallime serioze”* midis Moskës dhe qeverive jugosllave dhe bullgare”.⁴⁵⁰

Akuza kryesore kundër Jugosllavisë ishte rreth planit të saj për të dërguar dy divizione në Shqipëri. Kur Kardelj u përpoq të justifikonte qëndrimin e Jugosllavisë, duke përmendur kërcënimin ushtarak për Shqipërinë e Jugut nga qeveria greke, Molotov u përgjigj se Moska nuk kishte asnjë informacion në lidhje me këtë çështje. Stalini besonte qartë se ambiciet rajonale të Jugosllavisë përballë Shqipërisë ishin ato që e kishin nxitur vendimin e dhënë. Me *“gjysmë shaka”*, diktatori sovjetik tha se *“jugosllavët ‘kishin frikë’ rusët në Shqipëri dhe kështu po nxitonin për të çuar atje ushtrinë e tyre.”*⁴⁵¹ Stalini iu drejtuar direkt Kardeljit: *“Ju duhet ta merrni Shqipërinë, por me mend në kokë”*. Një nga variantet e kësaj zgjidhjeje të *“mençur”*, sipas Stalinit, ishte futja e Shqipërisë në përbërjen e Jugosllavisë. *“Një bashkim i tillë mund të bëhet që nesër, arsyei ai, por ai duhet të përgatit me vendime parlamentare. Më mirë është të fillohet me bashkimin politik.”*⁴⁵² Në lidhje me Shqipërinë, Stalini u shpreh se *“edhe shqiptarët fitojnë nga federata jugosllave, sepse do të krijohet Shqipëria e bashkuar me gati dyfishin e popullsisë”*.⁴⁵³

⁴⁴⁷ *Po aty*.

⁴⁴⁸ Jeronim Perovic, *“The Tito-Stalin split: a reassessment in light of new evidence”*. Artikull në: Zurich Open Repository and Archive, University of Zurich, 2007, faqe 52. Marrë nga: https://www.zora.uzh.ch/id/eprint/62735/1/Perovic_Tito.pdf

⁴⁴⁹ *Po aty*. **Shënim:** Versionet jugosllave dhe bullgare u mbledhën në fillim të viteve 1990 nga Leonid Ia. Gibianskii, i cili botoi procesverbalet e bisedave me komente të zgjeruara në një seri prej katër artikujsh.

⁴⁵⁰ *Po aty*, f. 52.

⁴⁵¹ Jeronim Perovic, *“The Tito-Stalin split: a reassessment in light of new evidence”*. Artikull në: Zurich Open Repository and Archive, University of Zurich, 2007, faqe 53. Marrë nga: https://www.zora.uzh.ch/id/eprint/62735/1/Perovic_Tito.pdf

⁴⁵² N. Smirnova, *Historia e Shqipërisë...*, f. 333.

⁴⁵³ *Po aty*, f. 334.

Nga dokumentet sovjetike, nuk është plotësisht e qartë se si e perceptonte Stalini politikën e Jugosllavisë në Ballkan gjatë kësaj kohe. Me sa duket, arsyeja kryesore për shqetësimin në rritje në Moskë ishte përkeqësimi i marrëdhënieve Lindje-Perëndim dhe përfshirja në rritje e Jugosllavisë në luftën civile greke. Në verën e vitit 1947, zyrtarët sovjetikë mësuan se Beogradi ishte gati të angazhohej ushtarakisht në Greqi. Ambasadori sovjetik në Beograd, Lavrent'ev, paralajmëroi për mundësinë e një lufte në Ballkan, bazuar në një bisedë që ai pati me Tito më 26 korrik 1947: *“Është absolutisht e qartë se mendimi për të goditur ushtarakisht kundër provokimeve greke tani është në mendjen e Titos”*.⁴⁵⁴ Tito e konsideronte luftën në Greqi si një pretekst për të forcuar praninë e Jugosllavisë në Shqipëri, me arsyetimin se “kufijtë jugosllavë si dhe ata shqiptarë u kërcënuan nga ‘monarko-fashistët grekë’”.⁴⁵⁵ Tito dëshironte të shfrytëzonte luftën civile greke për të ecur përpara me aneksimin e Shqipërisë. Provokimet e armatosura në kufijtë grekë me Shqipërinë, Bullgarinë dhe Jugosllavinë u intensifikuan. Tito mendonte se situata në Ballkan mund të çonte në një konflikt ndërkombëtar. Por në atë kohë Stalini vazhdimisht theksonte temën e luftës civile në Greqi. Për habinë e udhëheqësve jugosllavë dhe bullgarë, Stalini këmbënguli që komunistët grekë *“duhet të ndihmohen, nëse ekziston mundësia për të arritur fitoren, dhe nëse nuk është kështu, duhet të merret në konsideratë për shpërndarjen e lëvizjes partizane.”*⁴⁵⁶ Stalini kërkoi në mënyrë të qartë përfundimin e rebelimit grek. Gjithashtu, Stalini ishte duke sinjalizuar drejtuesit jugosllavë dhe bullgarë se ata duhet të pezullonin të gjithë ndihmën për komunistët grekë. Kjo ishte veçanërisht e rëndësishme për Jugosllavinë, e cila luajti rol kryesor në luftën civile greke. “Mbijetesa e partizanëve grekë varej në masë të madhe nga shkalla e mbështetjes jugosllave.”⁴⁵⁷ Megjithëse asnjë nga veprimet e cituara nga Moska, madje as përparimi i trupave jugosllave në Shqipëri nuk ngjalli drejtpërdrejt rrezikun e luftës, dhe në këtë mënyrë, as të përfshirjes së mundshme ndërkombëtare. Manovrimi mbi luftën civile greke nuk pati potencialin për të shkaktuar një krizë të madhe ndërkombëtare. Drejtuesit sovjetikë ndjenin se fitorja për komunistët grekë mund të arrihet vetëm përmes ndërhyrjes së drejtpërdrejtë ushtarake, e cila do të rrezikonte një konfrontim me fuqitë perëndimore që tashmë po përgatitnin një aleancë ushtarake zyrtare.

Stalini nuk donte t’i përkeqësonte tensionet ndërkombëtare pa shkak. “Ai ishte i vetëdijshëm se Perëndimi e konsideronte luftën civile greke si një tregues të planeve

⁴⁵⁴AVPRF (Arkivi i Politikës së Jashtme të Federatës Ruse), F. 06, Op. 9, D. 1285, P. 82, L. 82–83. Marrë nga: https://www.zora.uzh.ch/id/eprint/62735/1/Perovic_Tito.pdf

⁴⁵⁵**Shënim:** Kjo është e qartë, për shembull, nga Procesverbal i një Bisede midis Lavrent'ev dhe Tito, 23 maj 1947, në AVPRF (Arkivi i Politikës së Jashtme të Federatës Ruse), F. 06, Op. 9, D. 1285, P. 82, Ll. 36–38. Marrë nga: https://www.zora.uzh.ch/id/eprint/62735/1/Perovic_Tito.pdf

⁴⁵⁶Jeronim Perovic, *“The Tito-Stalin split: a reassessment in light of new evidence”*. Artikull në: Zurich Open Repository and Archive, University of Zurich, 2007, faqe 53. Marrë nga: https://www.zora.uzh.ch/id/eprint/62735/1/Perovic_Tito.pdf

⁴⁵⁷Jeronim Perovic, *“The Tito-Stalin split: a reassessment in light of new evidence”*. Artikull në: Zurich Open Repository and Archive, University of Zurich, 2007, faqe 53. Marrë nga: https://www.zora.uzh.ch/id/eprint/62735/1/Perovic_Tito.pdf

ekspansioniste sovjetike.”⁴⁵⁸ Bashkimi Sovjetik filloi të nxiste një konfrontim me Perëndimin. Kremlini ishte vërtet i shqetësuar nga reagimet e mundshme perëndimore. Stalini urdhëroi bashkimin e menjëhershëm të Jugosllavisë dhe Bullgarisë. “Në një datë të mëvonshme do të bashkohej edhe Shqipëria në federatën e Ballkanit”.⁴⁵⁹ Qartësisht, qëllimi i Stalinit për ta transferuar fokusin në Bullgari ishte të prishte përpjekjet e Jugosllavisë për të përfshirë Shqipërinë. “Tito nuk ishte më për një bashkim me Bullgarinë, ashtu siç kishte qenë menjëherë pas luftës.”⁴⁶⁰ Menjëherë pas mbledhjes së Moskës, më 19 shkurt, Byroja Politike e Partisë Komuniste Jugosllave u takua në mënyrë të fshehtë për të diskutuar rreth bisedimeve të Moskës. “Pjesëmarrësit ranë dakord njëzëri se Jugosllavia nuk duhet të formojë një federatë me Bullgarinë.”⁴⁶¹ Kjo ishte hera e parë që Tito kishte refuzuar t’i bindej një porosie direkte dhe të paqartë nga Moska.

Ndërsa shkalla e presionit jugosllav ndaj palës shqiptare gjatë kësaj kohe, e lidhur ngushtë me pakënaqësinë e realizimit të bashkimit të proklamuar mes dy shteteve në një federatë, është e qartë nga teksti i një rezolute të miratuar nga KQ i PKSh në një plenum më 26 shkurt - 8 mars 1948. Rezoluta diskutonte gjerësisht marrëdhëniet jugosllave-shqiptare, duke u përqendruar kryesisht në situatën e brendshme dhe autokritikën e partisë. “Rezoluta mohoi *“elementë të caktuar”* që së bashku me të ndjerin Nako Spiro kishin folur kundër shkrirjes me Jugosllavinë. Rezoluta deklaroi gjithashtu se një orientim pro-jugosllav ishte linja e politikës së jashtme zyrtare të Shqipërisë.”⁴⁶²

Më pas, autoritetet shqiptare miratuan një dokument të fshehtë në lidhje me *“bashkimin e planifikuar të ushtrisë shqiptare me Jugosllavinë”*.⁴⁶³ Arsyetimi për këtë veprim theksonte rrezikun e një pushtimi grek të Shqipërisë së Jugut dhe pretendonte se vendosja e trupave jugosllave për të forcuar kufijtë ishte *“urgjentisht e*

⁴⁵⁸**Shënim:** E rëndësishme në këtë drejtim ishte një fjalim më 22 janar 1948 nga Ministri i Jashtëm britanik Ernest Bevin, i cili i tha Parlamentit se shtetet perëndimore duhet të bashkohen së bashku për të përballuar rrezikun e paraqitur nga Bashkimi Sovjetik. Zyrtarët sovjetikë iu përgjigjën ashpër fjalimit, veçanërisht paralajmërimin të Bevin që "provokimet" nga rebelët komunistë grekë mund të çonin në *“incidente serioze”*. Marrë nga: https://ëëë.zora.uzh.ch/id/eprint/62735/1/Perovic_Tito.pdf

⁴⁵⁹ Jeronim Perovic, *“The Tito-Stalin split: a reassessment in light of new evidence”*. Artikull në: Zurich Open Repository and Archive, University of Zurich, 2007, faqe 55. Marrë nga: https://www.zora.uzh.ch/id/eprint/62735/1/Perovic_Tito.pdf

⁴⁶⁰**Shënim:** Shumica e autorëve perëndimorë dhe jugosllavë kanë pranuar interpretimin e Kardeljit për propozimin e Stalinit për krijimin e një federate Jugosllavo-Bullgare si një mjet për të ushtruar një ndikim më të madh në Jugosllavi përmes udhëheqësve pro-Moskës në Bullgari. Sidoqoftë, teza e Kardelj që Stalini dëshironte të përdorte Bullgarinë si një *“kalë Trojan”* kundër Jugosllavisë ende nuk është vërtetuar nga burime arkivore. Marrë nga: https://www.zora.uzh.ch/id/eprint/62735/1/Perovic_Tito.pdf

⁴⁶¹**Shënim:** Bullgarët mbështetën themelimin e një federate, siç shkruhet në raportin e ruajtur në AVPRF (Arkivi i Politikës së Jashtme të Federatës Ruse), F. 06, Op. 10, D. 1106, P. 79, Ll. 55, 78. Marrë nga: https://www.zora.uzh.ch/id/eprint/62735/1/Perovic_Tito.pdf

⁴⁶²**Shënim:** Teksti i rezolutës është në RGASPI (Arkivi Shtetëror Rus i Historisë Sociale dhe Politike), F. 17, Op. 128, D. 472, Ll. 31–41. Marrë nga: https://www.zora.uzh.ch/id/eprint/62735/1/Perovic_Tito.pdf

⁴⁶³ RGASPI (Arkivi Shtetëror Rus i Historisë Sociale dhe Politike), F. 17, Op. 128, D. 472, Ll. 77–83. Marrë nga: https://www.zora.uzh.ch/id/eprint/62735/1/Perovic_Tito.pdf

nevojshme”.⁴⁶⁴“Ishte e qartë se ardhja e trupave jugosllave në Jug të Shqipërisë – lëvizje të cilën Enver Hoxha tashmë e kishte kërkuar që në qershor të 1946-s – mund të bëhej shkak për një konflikt më të gjerë, jo vetëm midis trupave jugosllave dhe greke, por edhe me “anglosaksonët”, të cilët kishin luftuar në Epir në përkrahje të qeverisë së Athinës, nëse jo edhe me amerikanët, siç mendonte Stalini. Kjo mund ta shndërronte Luftën e Ftohtë në një vatër të nxehtë, me të cilën Bashkimi Sovjetik nuk kishte ndër mend të përballohej, pasi ata po kërkonin mënyra se si mund të bashkëpunonin me ShBA-në”⁴⁶⁵

Një tjetër tregues i konfliktit mes Jugosllavisë dhe Moskës ishte konkluzioni i Titos që lidhej me faktin se sovjetikët nuk donin që t’i plotësonin kërkesat e tyre për armatosjen e forcave të tyre. Një raport i nënshkruar, i shkruar ndoshta nga Tito, tregon se sovjetikët kishin ndryshuar këndvështrimin e tyre për ushtrinë jugosllave: “*Unë jam kundër këtij qëndrimi. Ne duhet të kemi një ushtri të fortë, pasi është garancia e pavarësisë*”.⁴⁶⁶ Në kundërshtim me jugosllavët, për sovjetikët këto plane për zhvillimin e industrisë ushtarake u panë si joreale. Pikëpamja sovjetike ishte se Jugosllavisë nuk i duhej një ushtri e fortë, pasi tashmë ekzistonte ushtria sovjetike. Udhëheqja e PKJ u mbështet në nocionin se pavarësia e vendit varet nga potencialet mbrojtëse të ushtrisë dhe industrisë së saj ushtarake, themelet e së cilës ishin vendosur tashmë në “*Planin pesëvjeçar*”. Megjithëse mbështetej në armatimet e marra nga Bashkimi Sovjetik, “Jugosllavia nuk hoqi dorë nga ndërtimi i industrisë së vet ushtarake, përfshirë ndërtimin e marinës, si bazë e pavarësisë së saj.”⁴⁶⁷ Ndjenja e përkatësisë së jugosllavëve në të njëjtin bllok ushtarak me sovjetikët kishte ekzistuar gjatë periudhës së marrëdhënieve të mira. Në fjalimin e 22 dhjetorit 1947, Tito tha: “*Ne duhet të kërkojmë aleatin tonë të madh, ushtrinë e pathyeshme, heroike sovjetike, ushtrinë që kishte qenë mentori ynë dhe mirëbërësi i madh gjatë gjithë luftës sonë mbinjerëzore, Ne duhet të kujdesemi për traditat e festuara të ushtrisë sonë dhe të ushtrisë sovjetike... Ne nuk jemi më të ndarë nga aleati ynë i madh, Bashkimi Sovjetik*”.⁴⁶⁸ Në një nga fjalimet e tij të mëparshme, ai kundërshtoi akuzat se vendi i tij ishte “*një shtet thjesht satelitor*” dhe tha “*po, Jugosllavia dhe vendet e tjera Lindore ndjekin Bashkimin Sovjetik, por ata e ndjekin sepse e dinë se pavarësia e tyre nuk do të rrezikohet.*”

Konflikti sovjetik-jugosllav, në pranverën e vitit 1948 u bë një konfrontim ideologjik më i mprehtë. Më 18 mars 1948, BRSS tërhoqi këshilltarët e saj ushtarakë nga

⁴⁶⁴ Jeronim Perovic, “*The Tito-Stalin split: a reassessment in light of new evidence*”. Artikull në: Zurich Open Repository and Archive, University of Zurich, 2007, faqe 55. Marrë nga: https://www.zora.uzh.ch/id/eprint/62735/1/Perovic_Tito.pdf

⁴⁶⁵ J. Pirjevec, *Tito dhe shokët...*, f. 254.

⁴⁶⁶ Bojan Dimitrijevic, “*Yugoslav-Soviet Military Relations 1945-1948*”; Në “*The Balkans in the Cold War*”, edituar nga Vojislav G. Pavlovic, Institute des Etudes Balkaniques, Beograd, 2011, faqe 156. Marrë nga: <https://books.google.al/books>

⁴⁶⁷ *Po aty*, f. 157.

⁴⁶⁸ Bojan Dimitrijevic, “*Yugoslav-Soviet Military Relations 1945-1948*”; Në “*The Balkans in the Cold War*”, edituar nga Vojislav G. Pavlovic, Institute des Etudes Balkaniques, Beograd, 2011, faqe 157. Marrë nga: <https://books.google.al/books>

Jugosllavia. Më 27 mars Stalini dhe Molotov dërguan letrën e tyre të parë të famshme drejtuesve jugosllavë, duke i akuzuar ata për një qëndrim anti-sovjetik dhe antimarksist-leninist.⁴⁶⁹

Kur Tito hodhi poshtë akuzat e Moskës, Stalini dhe Molotov i dërguan një kopje të letrës në fund të prillit 1948 drejtuesve të tjerë të Europës Lindore. Ky ishte hapi i parë drejt bashkimit të kampit socialist kundër Jugosllavisë dhe përgatitjes për dënimin zyrtar të Kominformës në qershor. Në mënyrë të dukshme, Stalini dhe Molotov, në shkëmbimet e tyre me Titon, nga marsi deri në maj 1948, nuk pranuan të kritikojnë politikën jugosllave në Ballkan. Tito nuk donte t'i pranonte “*gabimet*” e tij pas fillimit të fushatës ideologjike sovjetike në mars 1948. Është e qartë, nuk ishte në interesin e Titos ta provokonte këtë lloj konflikti. Pretendimi i tij për ndërtimin e socializmit dhe të qeverisjes së Jugosllavisë ishte mbështetur në një aleancë të ngushtë me Bashkimin Sovjetik. Por pas konfrontimit ideologjik që filloi në mars 1948, Tito u përball në thelb me zgjedhjen e së keqes më të vogël: të dorëzohej ose t'i rezistonte Stalinit. Për Stalinin, pas dënimit të Jugosllavisë, roli i Kominformës ishte i rëndësishëm.

Ndërsa mbledhja inauguruese e tij në shtator 1947 kishte për qëllim të shpejtonte sovjetizimin e Europës Lindore, takimi që dënoi Jugosllavinë në fund të qershorit 1948 kishte për qëllim t'iu tregonte të gjithë liderëve komunistë se rregullat e lojës kishin ndryshuar. “Akuzat e ngritura kundër Jugosllavisë sinjalizuan programin e ri organizativ të Stalinit për kampin socialist.”⁴⁷⁰ Letra e 4 majit 1948 nga Stalini dhe Molotov, dërguar drejtuesve të Partisë Komuniste Jugosllave përshkruan të drejtën e Bashkimit Sovjetik për të ndërhyrë në punët e brendshme të shteteve të Europës Lindore. Nuk ka ende një dokument arkivor që të tregojë në mënyrë përfundimtare rolin e vetë Stalinit në konflikt dhe qëndrimin e tij personal ndaj Partisë Komuniste Jugosllave. Qëllimi kryesor i Stalinit nuk ishte rrëzimi i Titos, por izolimi i Jugosllavisë. Ky fakt hedh dyshime në pretendimin e Nikita Hrushovit, në lidhje me supozimin e Stalinit që Tito do të hiqej shpejt. Hrushovi në fjalimin e tij të fshehtë, në Kongresin e njëzetë të Partisë Sovjetike më 1956-n, kur shpërtheu konflikti me Titon dhe Stalinin, tha “...*Nuk do të ketë më Tito. Ai do të bjerë.*”⁴⁷¹ Stalini nuk po nxitohej që ta fuste Jugosllavinë nën kontrollin e plotë sovjetik, për shkak edhe të pikëpamjes së tij për Ballkanin pas Luftës së Dytë Botërore. “Në fillim të luftës, Bashkimi Sovjetik e konsideronte Jugosllavinë dhe Greqinë si jashtë sferës së tij të interesit

⁴⁶⁹Jeronim Perovic, “*The Tito-Stalin split: a reassessment in light of new evidence*”. Artikull në: Zurich Open Repository and Archive, University of Zurich, 2007, faqe 58. Marrë nga: https://www.zora.uzh.ch/id/eprint/62735/1/Perovic_Tito.pdf

⁴⁷⁰ *Po aty*, f. 60.

⁴⁷¹ *Po aty*, f.58. **Shënim:** Citim nga fjalimi i fshehtë i Hrushovit në seancën e mbyllur të Kongresit të Njëzetë të Partisë, Moskë, 25 shkurt 1956.

të menjëhershëm.”⁴⁷² Qëndrimet sovjetike ndryshuan gjatë luftës, kur u bë e qartë se situata po ndryshonte në favor të Moskës.

Më vonë deklaratat dhe dokumentet sovjetike sugjeruan një pozicionim më të qartë të sovjetikëve, kompromis me Perëndimin mbi Jugosllavinë. Strategjia e Stalinit për të izoluar Jugosllavinë forcoi kontrollin e Moskës mbi pjesën tjetër të kampit socialist.

Në fillim të vitit 1948, Bashkimi Sovjetik po përgatitej për të sulmuar udhëheqësit komunistë në Poloni dhe Çekosllovakia. “Duke orkestruar dënimin e Kominformës të Partisë Komuniste Jugosllave, Stalini krijoi një pretekst dhe një precedent për spastrimet vijuese të partive komuniste në vendet e tjera të Europës Lindore. Një seri akuzash pasuan kundër komunistëve të nivelit të lartë, të cilët u dënuan si “titistë”.⁴⁷³ Ndër personat e shumtë që u ekzekutuan për tendenca gjoja pro-titiste (shpesh pas gjyqimeve të shfaqjes dhe “rrëfimeve”) ishte i përfshirë edhe Koçi Xoxe në Shqipëri.

Ndarja me Beogradin gjithashtu e ndihmoi Moskën të arrinte një numër objektivash të rëndësishme në Ballkan. Shqipëria u tërhoq plotësisht nga Beogradi, kështu Moska ishte mbrojtësja e saj e re. Bullgaria u bë një nga kritiket më të forta të Titos dhe aleatet më të afërta të Moskës. Më në fund, Jugosllavia i dha fund ndihmës së saj për guerilët komunistë grekë disa muaj pas rezolutës së Kominformës dhe, në këtë mënyrë kontribuoi në humbjen e komunistëve në Luftën Civile Greke.

Që nga koha kur u krijua Kominforma, në shtator 1947 deri në mars 1948, përkeqësimi gradual i marrëdhënieve midis Moskës dhe Beogradit nuk ishte aspak unik brenda kampit socialist. Bashkimi Sovjetik po vendoste një kontroll shumë më të ashpër mbi të gjitha shtetet e Europës Lindore. Ndryshimi në politikën sovjetike ishte një kusht i domosdoshëm, por jo ai i duhuri për konceptin sovjeto-jugosllav. Vendimi i Stalinit për të veçuar Jugosllavinë u motivua kryesisht nga pakënaqësia e tij për politikën ekspansioniste të Titos në Ballkan, veçanërisht ndaj ambicieve të Beogradit përballë Shqipërisë. Deri vonë, roli i Ballkanit, veçanërisht i Shqipërisë, në ndarjen sovjeto-jugosllave ishte i njohur kryesisht nga bisedat e Gjilas me Stalinin. Sipas dokumenteve të arkivave, “Tito i tha Komitetit Qendror të Partisë Komuniste të Jugosllavisë se “konflikti i parë midis Moskës dhe Beogradit shpërtheu për shkak të Shqipërisë”.⁴⁷⁴

Ballkani Jugor paraqiti kështu një sfidë për Moskën jo vetëm për shkak të luftës civile në Greqi, por edhe për shkak të etnisë dhe mosmarrëveshjeve territoriale që mund të shkaktonin një konflikt më të madh. Përpjekjet për të frenuar ndikimin në rritje të Jugosllavisë në Ballkan u bënë gjithnjë e më të rëndësishme në një kohë kur Stalini u

⁴⁷² Jeronim Perovic, “*The Tito-Stalin split: a reassessment in light of new evidence*”. Artikull në: Zurich Open Repository and Archive, University of Zurich, 2007, faqe 58. Marrë nga: https://www.zora.uzh.ch/id/eprint/62735/1/Perovic_Tito.pdf (parë më 13.05.2020)..

⁴⁷³ *Po aty*.

⁴⁷⁴ *Po aty*, f. 42.

përpoq të forconte kontrollin mbi të gjithë kampin socialist. Por jugosllavët duket se nuk kishin dëshirë të braktisnin ambiciet e tyre për Shqipërinë dhe, në fillim të vitit 1948 çështja nxiti një përplasje midis Moskës dhe Beogradit. Më 29 qershor 1948 bota u përball me tronditjen e parë brenda bllokut komunist. “Blloku sovjetik e përjashtoi Titon nga Internacionalja Komuniste, duke e akuzuar për gjithfarësoj deviacionesh, madje edhe për nacionalizëm borgjez⁴⁷⁵. Atë ditë, shtypi sovjetik botoi një rezolutë të titulluar “*Situata në Partinë Komuniste Jugosllave*”, që ishte miratuar disa ditë më parë në një takim të Byrosë Komuniste në Rumani (Kominformë). Rezoluta akuzoi liderët komunistë në Beograd se “*kishin ndjekur kohët e fundit politika të punëve të brendshme dhe të jashtme që devijojnë rrënjësisht nga linja marksiste-leniniste*” dhe “*kështu kishin vendosur veten dhe Jugosllavinë jashtë familjes së partive të tjera komuniste, jashtë frontit të bashkuar komunist dhe, rrjedhimisht edhe jashtë Kominformës*”.⁴⁷⁶ Kjo ngjarje ishte tepër befasuese, sepse Jugosllavia në përgjithësi konsiderohej aleati më besnik i Moskës midis “*demokracive të popujve*” të krijuar rishtazi. Komunistët jugosllavë ishin ndjekësit më aktivë të vendosjes së socializmit në vendin e tyre, krahasuar me aleatët e tjerë të kampit socialist.⁴⁷⁷ Bashkimi Sovjetik dukej se kishte një interes të fortë për të ruajtur marrëdhënie të mira me Jugosllavinë. Udhëheqësi sovjetik, Josif Stalin, e llogariste Jugosllavinë si një aleate të besueshme që shërbente si një model për demokracitë e popujve të tjerë në zhvillimin e tyre të brendshëm. Përpara se të hapeshin arkivat e ish-bllokut komunist, konflikti sovjeto-jugosllav i vitit 1948 ishte diskutuar gjerësisht në historiografinë e Luftës së Ftohtë Perëndimore.

Sipas literaturës jugosllave, prishja me Moskën u arrit sepse Jugosllavia po ndiqte një rrugë të veçantë drejt socializmit që nuk mund të pajtohej me konceptin hegjemonik sovjetik të organizimit hierarkik të bllokut socialist. Të dhënat e epokës së Titos tregojnë se “Jugosllavia kishte qenë duke e ndjekur socializmin që nga ditët e para të rezistencës partizane, në vitin 1941, dhe jo që prej vitit 1948. Ky version është pranuar nga shumë studiues perëndimorë, të cilët kanë shkruar për ndarjen Tito-Stalin.⁴⁷⁸ Ambicia në rritje e Stalinit për të kontrolluar kampin socialist pas Luftës së Dytë Botërore provokoi tensione midis Moskës dhe shteteve të tjera. Nga dokumentet sovjetike, megjithatë, nuk është e qartë nëse rrënjët e mosmarrëveshjes sovjeto-jugosllave burojnë nga pikëpamje të ndryshme ideologjike, në lidhje me zhvillimin e socializmit apo nga arsye të tjera më të forta. As burimet e ndryshme nuk përmbajnë ndonjë indikacion, i cili të theksojë se marrëdhënia në thelb harmonike midis Moskës dhe Beogradit ishte në rrezik serioz para fundit të vitit 1947.

⁴⁷⁵ B. J. Fischer, *Diktatorët e Ballkanit...*, f. 317.

⁴⁷⁶ Jeronim Perovic, “*The Tito-Stalin split: a reassessment in light of new evidence*”. Artikull në: Zurich Open Repository and Archive, University of Zurich, 2007, faqe 32. Marrë nga: https://www.zora.uzh.ch/id/eprint/62735/1/Perovic_Tito.pdf

⁴⁷⁷ *Po aty*.

⁴⁷⁸ *Po aty*, f. 34.

Bashkimi Sovjetik kishte çdo arsye të interesohej për marrëdhënie të mira me Jugosllavinë, pasi ajo shërbeu si një model për zhvillimin e brendshëm të shteteve të tjera të Europës Lindore dhe ishte një aleate e vendosur që ndante pikëpamjet e Moskës për të gjitha çështjet kryesore ndërkombëtare pas luftës. “Kur Bashkimi Sovjetik filloi sovjetizimin e detyruar të Europës Lindore në fund të vitit 1947 dhe 1948, fillimisht Jugosllavia ishte pro kësaj politike.⁴⁷⁹ Të paktën deri në themelimin e Kominformës, në shtator 1947, udhëheqësit sovjetikë e paraqitën Jugosllavinë si një model për t’u ndjekur.

Në fund të vitit 1947, qëndrimi i Moskës filloi të ndryshojë. “Kominforma ishte organi koordinues që bashkonte të gjitha partitë komuniste europiane, përfshirë Italinë dhe Francën. Stalini hodhi poshtë Planin Marshall.”⁴⁸⁰ Rezoluta e Kominformës së 28 qershorit 1948 i akuzoi jugosllavët për devijim nga linja marksiste-leniniste. Me këtë rezolutë u bashkuan mjaft vende dhe personalitete të bllokut komunist, pasi miratimi i këtij dokumenti u bë i detyrueshëm edhe për to. Ndërlidhjet komplekste të Jugosllavisë me vendet e bllokut sovjetik, si në parti ashtu edhe në fushën e marrëdhënieve shtetërore, filluan të degradonin gradualisht. Po ashtu, edhe planet e përbashkëta në ekonomi, si dhe në politikën e jashtme u braktisën. Shtypi i huaj i vendeve të bllokut komunist e paraqiti situatën në disfavor të Jugosllavisë. “Gazeta “*Pravda*” botoi letrën mbi dorëheqjen e ambasadorit të Jugosllavisë në Rumani, Goluboviç”⁴⁸¹, i cili u shpreh se “*Faktet vërtetojnë që Komiteti Qendror i Partisë Komuniste Jugosllave mban në këto çështje një qëndrim të gabuar, prandaj të gjitha këto çështje mund të konsiderohen si gabime të bëra nga komunistët në aktivitetin e tyre praktik... Kuptohet lehtësisht që Tito dhe të tjerët e kanë orientuar partinë tonë në rrugën e mosmarrëveshjeve dhe të armiqësisë kundrejt vendeve të tjera komuniste motra, me vendet e demokracive popullore në Bashkimin Sovjetik, në rrugën që të shpie në përçarjen e fronit të proletariatit revolucionar.*”⁴⁸² Edhe studentët jugosllavë në BRSS aprovuan dhe përkrahën plotësisht rezolutën e byrosë informative mbi gjendjen e partisë komuniste të Jugosllavisë. Sipas tyre, “*Me politikën e tyre anti-sovjetike dhe nacionaliste, Tito, Bordel, Gjilas Rankoviç janë duke tradhtuar atdheun tonë, janë duke shkatërruar shtetin tonë demokratik të krijuar nga popujt e Jugosllavisë me ndihmën aktive të BS*”.⁴⁸³ Kundër qëndrimeve antimarksiste të udhëheqjes së tanishme të Partisë Komuniste të Jugosllavisë u drejtua edhe personeli i ambasadës jugosllave në Pragë: “*Ne u qëndrojmë besnikë parimeve të internacionalizmit të vërtetë komunist të kryetarëve të mëdhenj të klasës punëtore, Marks, Engels, Lenin, Stalin*”.⁴⁸⁴ Sigurisht që edhe Komiteti Qendror i Partisë Komuniste Shqiptare vijoi ta dënonte qëndrimin: “*...e udhëheqësve të Partisë*

⁴⁷⁹ *Po aty*, f. 40.

⁴⁸⁰ Jeronim Perovic, “*The Tito-Stalin split: a reassessment in light of new evidence*”. Artikull në: Zurich Open Repository and Archive, University of Zurich, 2007, faqe 40. Marrë nga: https://www.zora.uzh.ch/id/eprint/62735/1/Perovic_Tito.pdf

⁴⁸¹ *AMPJ*, Dosja nr. B/IV-a/2, viti 1948, faqe 12.

⁴⁸² *Po aty*, f. 9.

⁴⁸³ *Po aty*, f. 2.

⁴⁸⁴ *Po aty*, f. 11.

Komuniste Jugosllave, të cilët kanë tradhtuar marksizëm-leninizmin, kampin e socializmit dhe janë në luftë të hapur me atdheun e lavdishëm të socializmit, me partinë e lavdishme të Lenin-Stalinit, me kampin demokratik dhe anti-Imperialist".⁴⁸⁵ Në një komunikim të legatës shqiptare në Moskë shkruhet se "E vërteta është se, qëndrimi që mori Komiteti Central i partisë sonë kundrejt udhëheqësve tradhtarë të Partisë Komuniste Jugosllave bëri përshtypje të thellë si te masat sovjetike ashtu edhe në trupin diplomatik, veçanërisht midis përfaqësuesve të demokracive popullore. Anëtarët e përfaqësive demokratike tregonin habinë e tyre për tonin e qartë dhe të fortë të akuzës të komunikatës të Komitetit Central të partisë sonë dhe e cilësonin atë (Komunikatën) si më të rreptën dhe më të fortën e më të guximshmen nga të gjitha komunikatat e partive të tjera."⁴⁸⁶

Ndërkohë, Bullgaria pati një përjasje më bashkëpunuese ndaj Jugosllavisë. Edhe pse interesi i Jugosllavisë për krijimin e një federate të përbashkët ballkanike me Bullgarinë, e cila ishte diskutuar tashmë në vitet 1944-'45, u zbeh deri në vitin 1948, vetëm pala bullgare vazhdoi të zhvillojë në mënyrë aktive idenë e një shtate dypalëshe ose atë të një federate shumëpalëshe. Një federatë e ngushtë me Jugosllavinë do t'i lejonte Bullgarisë të rigjallëronte ekonominë e saj. Për sa u takon deklaratave të Kominformës kundër Jugosllavisë, në një komunikatë të agjencisë bullgare shkruhet se "*Vendimi i komisionit në lidhje me partinë komuniste jugosllave nuk i ndryshon aspak marrëdhëniet miqësore që ekzistojnë midis republikave popullore të Bullgarisë dhe të Jugosllavisë. Qeveria bullgare do të vazhdojë në mënyrë të ndershme dhe të sigurtë të bashkëpunojë me qeverinë jugosllave, në përputhje me traktatin e miqësisë, bashkëpunimit dhe ndihmës reciproke të përfunduar midis dy vendeve, i cili pajtohet me interesat jetike të dy popujve*".⁴⁸⁷

Sigurisht që udhëheqja e Beogradit reagoi ndaj sulmeve të mësipërme të vendeve komuniste. Në një artikull të "*Borbës*", më 10 korrik 1948, shkruhet se "*trupat udhëheqëse të disa partive komuniste nga Byroja Informative, gjoja në emër të mbrojtjes së pastërtisë së principeve revolucionare, kanë marrë rrugën e të pavërtetës dhe shpifjeve. Udhëheqësit e partive motra në disa vende e dinë shumë mirë se ne deri më sot nuk jemi të lajmëruar zyrtarisht mbi rezolutën e Byrosë Informative, se ajo as që nuk i është dërguar partisë sonë nga ana e tyre, por na është dashur ta marrim nga komunikimet e agjencive*".⁴⁸⁸ Sipas udhëheqjes jugosllave, gazetatat "*Se suar*" dhe "*Imanite*" bënë trillime të poshtira mbi marrëveshjet e ndryshme të Jugosllavisë të lidhura me imperialistët, ndërkohë që sipas tyre "*Vorposi ekonomik*" i prillit 1948, në kryeartikullin e saj shkruante se "*Të gjitha rrugët të çojnë drejt komunizmit*", se "*shteti sovjetik nisët nga mundësia dhe dëshira e bashkëpunimit në mes sistemit socialist dhe sistemit kapitalist*".⁴⁸⁹ Në vijim të kësaj politike, në gusht të 1948-s "*Reuter*" njoftoi se "*Organi zyrtar i Partisë Komuniste*

⁴⁸⁵ *Po aty*, f. 136.

⁴⁸⁶ *AMPJ*, Dosja nr. B/1-3, viti 1948, f. 2.

⁴⁸⁷ *AMPJ*, Dosja nr. B/IV-a/2, viti 1948, f. 161.

⁴⁸⁸ *Po aty*, Dosja nr. B/II-8, viti 1948, f. 2.

⁴⁸⁹ *Vorpsi ekonomik*, nr.2, viti 1948, f. 14.

Jugosllave, 'Borba' bënte thirrje për një 'dhjetëfishin të vigjilencës kundra armiqve të hapur dhe të fshehtë të Partisë sonë dhe të atdheut tonë'. Në gjirin e ushtrisë jugosllave po bëhen spastrime të mëdha, me qëllim që të heqë nga gjiri i saj gjithë ata që kanë simpati për Kominformës".⁴⁹⁰ Ndërsa në rezolutën e adoptuar në Asamblenë Plenare të Komitetit Qendror të Partisë Komuniste Shqiptare, më 19 korrik 1948,⁴⁹¹ thuhej se udhëheqja e Partisë Komuniste Jugosllave "... hedh poshtë plotësisht rezolutën e Byrosë Informative, mbasi ajo bazohet mbi shpifje, mbi mungesën e njohjes së gjendjes së vendit tonë, mbi shtrembërimin e vijës së Partisë Komuniste të Jugosllavisë. Ne e dënojmë me energjinë më të madhe qëndrimin jo të përshtatshëm për komunizmin, të rezolutës së Byrosë Informative ku anëtarët e Partisë sonë ftohen që të ngrenë krye kundër Komitetit Qendror të Partisë Komuniste të Jugosllavisë; kundra byrosë politike me në krye shokun Tito...". Jugosllavia e konsideroi një sulm të tillë si të drejtuar kundër unitetit partiak dhe atij të popujve të saj. Pavarësisht situatës së krijuar, "...ne [udhëheqja jugosllave] do të punojmë me të gjitha forcat tona për rivendosjen e marrëdhënieve sa më të mira midis partisë sonë dhe partisë komuniste të Bashkimit Sovjetik".⁴⁹²

Për sa u takon letrave të botuara e të shkëmbyera nga liderët sovjetikë dhe jugosllavë, nga marsi deri në maj 1948, ato ishin thjesht një prelud i rezolutës së Kominformës, ndërsa në qershor të po atij viti ishin tërësisht ideologjike. Letrat sovjetike sulmuan sistemin jugosllav dhe akuzonin liderët jugosllavë që ndiqnin rrugën e tyre për ndërtimin e socializmit, në vend që t'i përmbaheshin modelit sovjetik. Si përgjigje, jugosllavët këmbëngulën se ata nuk po devijonin në asnjë mënyrë nga linja marksiste-leniniste. Kur Tito u përpoq të forconte mbështetjen e brendshme për udhëheqjen e tij dhe t'i jepte modelit jugosllav një justifikim të ri ideologjik, ai përqafoi argumentin se ndarja ndodhi për shkak të rrugës së vetë Jugosllavisë drejt socializmit. Në verën e vitit 1952, lidhur me mosmarrëveshjen sovjeto-jugosllave, Tito tha se "është e qartë se deri në vitin 1941, që nga fillimi i revolucionit tonë, elemente të fërkimeve midis nesh dhe tyre tashmë ekzistonin".⁴⁹³ Megjithatë, politikat e brendshme dhe të jashtme të Titos nuk i dëmtoan seriozisht marrëdhëniet bilaterale jashtëzakonisht të ngushta mes tyre deri në disa muaj para ndarjes me Bashkim Sovjetik. Tito zhvilloi luftë kundër trupave okupuese gjermane me frymëzim nga komunizmi i stilit sovjetik dhe ideologjia marksiste-leniniste. "Ndoshta Stalini nuk e miratoi vendimin e Titos për të formuar një qeveri në nëntor 1943, nga frika e tendosjes së marrëdhënieve me Shtetet e Bashkuara dhe Britanisë së Madhe (megjithëse nuk ka prova të qarta arkivore për të mbështetur këtë interpretim), por të gjitha provat

⁴⁹⁰AMPJ, Dosja nr. B/IV-a/2, viti 1948, f. 13.

⁴⁹¹Po aty, f. 1.

⁴⁹²AMPJ, Dosja nr. B/IV-a/2, viti 1948, f. 17.

⁴⁹³ Jeronim Perovic, "The Tito-Stalin split: a reassessment in light of new evidence". Artikull në: Zurich Open Repository and Archive, University of Zurich, 2007, faqe 36. Marrë nga: https://www.zora.uzh.ch/id/eprint/62735/1/Perovic_Tito.pdf

sugjerojnë që Tito i informonte udhëheqësit sovjetikë në lidhje me qëllimet e tij para se të merrej vendimi në Jajce.”⁴⁹⁴

Komunistët jugosllavë synuan ta ndërtonin socializmin sipas modelit stalinist. Jugosllavia ndoqi me përpikëri modelin sovjetik në krijimin e organeve të planifikimit ekonomik, sistemin gjyqësor, burokracinë shtetërore, sistemet e kujdesit shëndetësor dhe arsimor dhe sferat kulturore e arsimore. “Kushtetuta jugosllave e vitit 1946 ishte në thelb një kopje e kushtetutës sovjetike të vitit 1936.”⁴⁹⁵ Për të qenë të sigurt, liderët e Partisë Komuniste të Jugosllavisë ishin pragmatikë, pasi ata kuptuan se jo të gjitha aspektet e modelit sovjetik iu përshtateshin rrethanave të veçanta të Jugosllavisë. “Deri në fund të vitit 1947, zyrtarë të lartë të PKJ besuan se kolektivizimi i bujqësisë në Jugosllavi duhet të ndiqte një rrugë të ndryshme, më pak të dhunshme sesa në Bashkimin Sovjetik, por shprehën dyshime se arsimit sovjetik dhe modelet kulturore ishin e vetmja zgjidhje e përshtatshme për Jugosllavinë.”⁴⁹⁶ Pikëpamjet e liderëve jugosllavë lidhur me qëllimet e një shoqërie socialiste (komuniste) ndonjëherë mund të kenë qenë larg atyre të udhëheqësve sovjetikë, por askush në Beograd nuk e vuri në dyshim qëllimin e tyre. Në të vërtetë, komunistët jugosllavë e ndoqën më me fanatizëm “*ndërtimin e socializmit*” sesa shtetet e tjera të Europës Lindore.⁴⁹⁷ Edhe për politikën bujqësore, një pikë e kritikuar ashpër nga pala sovjetike në letrat e akuzave të 1948-s ishte se Jugosllavia kishte ecur më shumë drejt kolektivizimit të plotë sesa shtetet e tjera të Europës Lindore. Historiani kroat Ivo Banac tregon se deri në fillim të vitit 1948 “*asnjë vend i Europës Lindore, përveç ndoshta Bullgarisë, nuk qëndroi më afër se Jugosllavia në pragun e kolektivizimit të përgjithshëm bujqësor*”.⁴⁹⁸

“Partia Komuniste Jugosllave gjithashtu e shtypi opozitën në mënyrë më të pamëshirshme sesa partitë komuniste në vendet e tjera të Europës Lindore.”⁴⁹⁹ Në mes të shkurtit 1946, ambasadori sovjetik në Beograd, Ivan Sadchikov, raportoi në Moskë se, “sipas Milovan Gjilas, 200.000 njerëz që bashkëpunonin me forcat okupuese u likuiduan pas çlirimit të Jugosllavisë. Sipas ministrit të Brendshëm jugosllav, Aleksandër-Marko Rankoviç, 11.000 anëtarë të formacioneve të armatosura u shkatërruan, dhe të gjithë komandantët përkatës që shërbenin nën komandantin Cetnik Draza Mihajloviç ose u arrestuan, ose u qëlluan”.⁵⁰⁰ Tito kontrollonte pushtetin dhe nuk kërcënohej brenda vendit. Për shkak se Jugosllavia, si vendi i parë i Europës Lindore që krijoi një politikë komuniste,

⁴⁹⁴ *Po aty*, f. 37.

⁴⁹⁵ *Po aty*.

⁴⁹⁶ *Po aty*.

⁴⁹⁷ *Po aty*.

⁴⁹⁸ Jeronim Perovic, “*The Tito-Stalin split: a reassessment in light of new evidence*”. Artikull në: Zurich Open Repository and Archive, University of Zurich, 2007, faqe 38. Marrë nga: https://www.zora.uzh.ch/id/eprint/62735/1/Perovic_Tito.pdf

⁴⁹⁹ *Po aty*.

⁵⁰⁰ *AVPRF* (Arkivi i Politikës së Jashtme të Federatës Ruse), F. 06, Op. 7, D. 867, P. 53, L.9. Marrë nga: https://www.zora.uzh.ch/id/eprint/62735/1/Perovic_Tito.pdf

Tito e konsideronte veten aleatin më të fortë të Moskës. Pretendimet e tij territoriale ndaj fqinjëve të tij nuk ishin menduar si një sfidë për Bashkimin Sovjetik. Përkundrazi, ai po vepronte mbi bazën e konsideratave nacionaliste specifike. As Tito dhe drejtuesit e tjerë të Partisë Komuniste Jugosllave nuk e vunë në dyshim udhëheqjen e Moskës për botën socialiste. Zyrtarët jugosllavë e konsideronin veten si ndjekës të devotshëm të Bashkimit Sovjetik. Tito vazhdimisht e shpalli aleancën sovjeto-jugosllave si tipar kryesor të politikës së jashtme të Jugosllavisë, një parim që u mbajt deri në prishjen e marrëdhënieve të tyre në vitin 1948.

“Dëbimi i Jugosllavisë nga kampi socialist ishte befasues jo vetëm për diplomatët dhe vëzhguesit perëndimorë”,⁵⁰¹ por edhe “për drejtuesit e Partisë Komuniste Jugosllave.”⁵⁰² Edhe pas dëbimit të Jugosllavisë nga Kominforma, Tito siguroi në Kongresin e Pestë të Partisë Popullore Jugosllave, në korrik 1948, se “*besnikëria e palëkundur e palës jugosllave ndaj shkencës së Marks-Engels-Lenin-Stalinit do të dëshmonte në praktikë se Partia Komuniste Jugosllave nuk devijon nga rruga e asaj shkence*”.⁵⁰³

Ndërsa “fundi i marrëdhënieve midis Stalinit dhe Titos e shpëtoi Shqipërinë nga integrimi i saj në Jugosllavi.”⁵⁰⁴ Po ashtu, sipas studiuesve të fushës, kjo shpëtoi edhe Enver Hoxhën, i cili ishte “udhëheqësi i parë i vendeve të Europës Juglindore që doli kundër titizmit jugosllav”.⁵⁰⁵ Më 1 korrik 1948, Komiteti Qendror i Partisë Komuniste Shqiptare mbajti një qëndrim, sipas së cilit thoshte se ai “... *dënon ashpër tradhtinë e Partisë Komuniste Jugosllave, e cila ka tradhtuar marksizmin-leninizmin, socializmin, dhe ndodhet në një luftë të turpshme kundër partisë së Lenin-Stalinit. Komiteti Qendror i Partisë Komuniste Shqiptare ka qenë gjithnjë në luftë me Komitetin Qendror të Partisë Komuniste Jugosllave, i cili vazhdimisht i impononte vendit tonë politikën e tij të tradhtisë. Partia Komuniste Jugosllave insistoi me politikën e saj antimarksiste për të shkelur pavarësinë e vendit tonë dhe partisë sonë.*”⁵⁰⁶ Ministria për Punë të Jashtme e RPSH i komunikoi delegacionit të Republikës së Jugosllavisë vendimin e qeverisë shqiptare për përfundimin e të gjitha marrëveshjeve me Republikën Federative Kombëtare të Jugosllavisë. Theksohej se qeveria jugosllave, për fat të keq, i përdori këto marrëveshje mbi bazë kapitaliste, shfrytëzuese dhe antishqiptare. Në përgjigjen e tyre, “Ministria jugosllave e Punëve të Jashtme theksoi se akuza të tilla janë produkt i një propagande të

⁵⁰¹ Po aty.

⁵⁰² Po aty.

⁵⁰³ Po aty.

⁵⁰⁴ Albina Dranqoli, “Tito-s attempt to integrate Albania into Yugoslavia, 1945-1948”. History Studies, International Journal of History, Volume 3/2, 2011, f.195. Marrë nga: <https://www.acarindex.com/dosyalar/makale/acarindex-1423902522.pdf>

⁵⁰⁵ A. Zogaj, *Marrëdhëniet Shqiptaro- Jugosllave...*, f.37

⁵⁰⁶ Albina Dranqoli, “Tito-s attempt to integrate Albania into Yugoslavia, 1945-1948”. History Studies, International Journal of History, Volume 3/2, 2011, f.195. Marrë nga: <https://www.acarindex.com/dosyalar/makale/acarindex-1423902522.pdf>

organizuar kundër Jugosllavisë”,⁵⁰⁷ dhe për këtë arsye Tito dhe udhëheqja jugosllave duhej t’i konsideronin marrëdhëniet e përgjithshme shqiptaro-jugosllave si një gabim të qeverisë jugosllave. Situata e krijuar në Jugosllavi shihej ndryshe nga udhëheqësit shqiptarë. Në një raport të përgjithshëm të vitit 1948, shkruhet se “*Situata e re është një pozitë armiqësore karshi vetë popujve të Jugosllavisë, karshi kampit demokratik, Bashkimit Sovjetik dhe Shqipërisë. Jugosllavinë e shohim jo si një fuqi aktive të kampit demokratik. Jugosllavia është në një terren politik armiqësor, në pikëpamjet anti-marksiste... Vendi ynë, që ka pasur shumë marrëdhënie me këta, u gjend në pozitën armiqësore kundrejt këtyre – nga politika e tyre kolonizatore dhe armiqësore karshi vendit tonë... Si komunistë të mirë, duhet t’i ndihmojmë jugosllavët në përmbysjen e Komitetit Central*”.⁵⁰⁸

Për më tepër, “në një dokument të ATSh-së, më 22 korrik 1948⁵⁰⁹, i cili flet për acarimin e marrëdhënieve mes qeverisë shqiptare dhe përfaqësuesve jugosllavë në Shqipëri, parashtrohet se “*qeveria shqiptare qysh në gjysmën e vitit 1948 dhe sidomos këto dy vjetët e fundit ka filluar dhe ka përforcuar vënien e masave diskriminuese dhe qëndrimet e ndryshme armiqësore kundrejt Legatës së Republikës Federative Popullore të Jugosllavisë në Tiranë, me qëllim që sa më shumë ta rëndojë dhe definitivisht ta bëjë të pamundur çdo punë të përfaqësisë jugosllave në Shqipëri. Gjithashtu, Ministria e Punëve të Jashtme të Shqipërisë e ka lënë zvarrë dhe ka refuzuar që të pranojë përfaqësuesit diplomatikë të Republikës Federative Popullore Jugosllave dhe, në këtë mënyrë pengonte dhe e bënte të pamundur kontaktin e punës normale, rishikimin dhe zgjidhjen e disa çështjeve të marrëdhënieve reciproke. Për arsye të regjimit të padurueshëm të masave diskriminuese, të cilat qeveria shqiptare i vijoi dhe më tej t’i përdorë me anën e organeve të saj ndaj legatës së Republikës Federative Popullore Jugosllave në Tiranë, u bë e pamundur çdo funksionim i saj i mëtejshëm*”.⁵¹⁰

Nga ana tjetër, pas përfundimit të marrëdhënieve me Jugosllavinë, Shqipëria do të binte nga protektorati jugosllav nën protektoratin rus. Në këtë situatë, “Enver Hoxha i dha vetes pozicionin e liderit të Shqipërisë, ndërsa të gjithë ata që u dënuan më parë për politikë anti-jugosllave, u shpallën heronj që e shpëtuan Shqipërinë nga aneksimi jugosllav”.⁵¹¹ Ndarja sovjetike me Jugosllavinë më 1948-n krijoi një mundësi të re për komunistët shqiptarë, të udhëhequr nga Enver Hoxha, që të pranonin me kënaqësi një tutor të ri dhe ta forconin pushtetin brenda partisë duke pastruar Koçi Xoxen dhe mbështetësit e tij si titistë. Tashmë Stalini i kishte bërë të gjitha përpjekjet për forcimin e kontrollit të Moskës mbi PKSh.

⁵⁰⁷ *Po aty*, f. 196.

⁵⁰⁸ *AMPJ*, Dosja nr. A-6/a, viti 1948, f. 5.

⁵⁰⁹ *Po aty*, Dosja nr. Nr. B(I-1), viti 1950, f. 1.

⁵¹⁰ *Po aty*, f. 5.

⁵¹¹ *Marrëdhëniet shqiptaro-jugosllave...*, përgatiti N. Plasari dhe L. Malltezi, f. 16-208.

3. 4 Fundi i marrëdhënieve shqiptaro-jugosllave

Në periudhën e tensionimit të marrëdhënieve jugosllavo-sovjetike dhe jugosllavo-shqiptare u shtuan dhe u ashpërsuan raportet e armiqësisë kundër teknikëve dhe këshilltarëve jugosllavë. Jugosllavët nuk ishin të kënaqur me trajtimin e përgjithshëm të programit të ndihmave jugosllave, veçanërisht me angazhimin në rritje të ekspertëve dhe instruktorëve sovjetikë në strukturat ekonomike dhe ushtarake të Shqipërisë. Ndikimi dhe ndihma politike, ekonomike dhe ushtarake sovjetike arritën shpejt një nivel të krahasueshëm me atë të jugosllavëve. Në periudhën korrik-dhjetor të vitit 1948, në Shqipëri ky numër ishte zgjeruar në rreth 3000 këshilltarë ushtarakë dhe civilë sovjetikë.⁵¹² “*Ne i japim paratë dhe ata sundojnë*”, tha Tito në seancën e Byrosë Politike qysh në nëntor 1947.⁵¹³ Tito arriti në përfundimin se marrëdhëniet me Shqipërinë nuk ishin të kënaqshme dhe po përkeqësohen edhe më tej, pasi Shqipërisë i mungonte sinqeriteti, dhe nuk ishin në frymën e vëllazërimit dhe unitetit. Në seancën e 1 marsit 1948 të Byrosë Politike, Tito ishte i bindur se: “*Shqipëria duhet të mbahet fort pasi ne kemi investuar shumë në vend dhe ka rëndësi për ne... Ne kemi të drejtë të kontrollojmë ato që bëjnë shqiptarët, cilat traktate ata bëjnë... Shqipëria duhet të respektojë përgjegjësitë e saj dhe, nëse dëshiron të ketë kontratat e veta, ajo duhet të koordinohet me Jugosllavinë*”.⁵¹⁴

Tito u përpoq ta ruajë ndikimin në Shqipëri për shkak të pozicionit të tij gjeopolitik dhe sasisë së investimeve nga pala jugosllave. Në prill të po atij viti, pati një shkëmbim letrash midis Titos dhe Enver Hoxhës, sipas të cilave përgjegjësia për përkeqësimin e marrëdhënieve u zhvendos nga njëri te tjetrin. Në të njëjtën kohë, Hoxha duhet të ishte tashmë në dijeni për kritikën e politikave jugosllave nga Moska. “Për dhënien e udhëzimeve ushtarake, Tito përmendi mungesën e besimit për arsyet e sinqerta të synimeve të tyre në Shqipëri. Së dyti, udhëheqja komuniste shqiptare pohoi mirënjohjen ndaj sakrificave që bëri Jugosllavia për të rindërtuar Shqipërinë, por sipas Titos, në realitet veprime në kah të kundërt me këtë pohim. Prandaj, sipas Titos, ishte e qartë se ata nuk mund të vazhdonin ta ndihmonin Shqipërinë në kurriz të popullit të tyre, pa parë ndonjë përmirësim të marrëdhënieve mes Shqipërisë dhe Jugosllavisë. Përkundrazi, ai shihte përkeqësim të marrëdhënieve duke mos e fajësuar palën jugosllave në këtë drejtim. Së treti, tashmë këto marrëdhënie ishin në kundërshtim me realitetin. Prandaj Tito argumentoi se bashkëpunimi mes të dy vendeve duhet të vendosej mbi baza të reja. Shkëmbimi i letrave shënoi fazën e fundit të marrëdhënieve jugosllavo-shqiptare.”⁵¹⁵ Mosmarrëveshjeje midis dy qeverive sa vinte epo shtoheshin. Me rastin e ditëlindjes së Titos nuk u dërgua asnjë urim zyrtar. “Shoqata kulturore jugosllavo-shqiptare zhvilloi një festë për këtë rast, por shtypi shqiptar

⁵¹²Central Intelligence Agency, “*Current Intelligence Staff Study, Soviet-Albanian Relations, 1940-1960*”, ESAU XIX-62, 2007, f.12. Marrë nga: <https://www.cia.gov/library/readingroom/docs/esau-19.pdf>.

⁵¹³ *Po aty.*

⁵¹⁴ *Po aty.*

⁵¹⁵*AJ, 507/IX, Albanija, I-174 dhe letra e Hoxhës dërguar Titos në 22 prill 1948; AJ, 507/IX, Albanija, I-175. Marrë nga: <https://books.google.al/books>. **Shënim:** Letra e Hoxhës dërguar Titos në 18, 21 prill 1948.*

i kushtoi asaj vetëm pesë rreshta dhe nuk renditi asnjë anëtar të partisë si pjesëmarrës. Në të njëjtën mbrëmje u mbajt një mbledhje e shoqërisë kulturore sovjeta-shqiptare. Shtypi i kushtoi tre rreshta eventit dhe listoi Hoxhën, Xoxen dhe drejtuesit e tjerë të partisë si pjesëmarrës.”⁵¹⁶ Më 31 maj 1948, ministri i Industrisë Tuk Jakova njoftoi se një fabrikë tekstili do të ndërtohej në vitin 1949 me makineri të furnizuar nga BRSS, “*e cila, sipas nesh është ndihmë shumë e madhe nën vëmendjen e Stalinit*”.⁵¹⁷ Marrëdhëniet shumë të afërta dhe miqësore ndërmjet udhëheqësve të RPSH dhe BRSS dëshmohen “nga korrespondencat dhe telegramet e urimeve të shkëmbyera ndërmjet tyre”.⁵¹⁸

Qershori i vitit 1948 shënoi prishjen e interesave dhe marrëdhënieve ndërmjet RPSH dhe RFPJ. Ishte pikërisht Enver Hoxha, i cili në mbledhjen e Këshillit të Ministrave, në fjalën e tij vuri në dukje qëndrimin e udhëheqësve jugosllavë kundrejt kampit dhe demokracisë popullore, duke thënë: “*Politika e tyre ka qenë dhe është armiqësorë karshi vendit tonë dhe antishqiptare. Këto i kemi me fakte. Ata janë ambiciozë, megalomanë, armiq të klasës punëtore, që në sajë të gjakut të popullit dëshirojnë të sundojnë me terror mbi popujt e Jugosllavisë. Udhëheqësit jugosllavë kujtuan se nuk kishin nevojë për marksizmin, për Bashkimin Sovjetik, për Partinë Bolshevike dhe Stalinin, për ndihmën e demokracive popullore, ata ishin të bindur se ishin të zotë ta ndërtonin vetë socializmin. Ata kanë dashur të shkurorëzojnë Bashkimin Sovjetik, Ushtrinë e Kuqe, të luftonin politikën e Bashkimit Sovjetik, ata janë kundra demokracive popullore. Politika e tyre ka qenë antishqiptare, ata me pretekstin e një kredie kanë dashur të zhdukin independencën e vendit tonë, të bëjnë një politikë koloniale, shfrytëzimi, të zhdukin independencën tonë politike dhe ekonomike*”.⁵¹⁹ Të njëjtin mendim ndante edhe Molotovi, i cili u shpreh që “*ky mendim është plotësisht i drejtë. Jugosllavët, në të vërtetë, bëjnë një politikë koloniale në qëndrimin ndaj Shqipërisë*”.⁵²⁰ Më tej, Enver Hoxha i komunikoi Këshillit të Ministrave që, “për arsye të kësaj tradhtie nga ana e udhëheqësve jugosllavë marrëdhënia me to duhej shkëputur menjëherë. Duke pasur parasysh shkallën e nënshtrimit shqiptar ndaj Jugosllavisë para majit të vitit 1948, duket mjaft qartë se liderët shqiptarë kishin marrë garanci për ndihmën dhe mbështetjen sovjetike, si dhe vendimin për të hedhur poshtë zgjedhën jugosllave. Shqipëria në këtë mënyrë “kaloi nga varësia jugosllave në varësinë sovjetike, gjë që realisht, në planin e rrezikimit të integritetit dhe sovranitetit territorial të Shqipërisë dukej se kishte më pak rreziqe”.⁵²¹

⁵¹⁶Central Intelligence Agency, “*Current Intelligence Staff Study, Soviet-Albanian Relations, 1940-1960*”, ESAU XIX-62, 2007, f. 6. Marrë nga: <https://www.cia.gov/library/readingroom/docs/esau-19.pdf>

⁵¹⁶AQSH, Fondi: Këshilli Ministrave, Dosja Nr. 223, viti 1947.

⁵¹⁷Central Intelligence Agency, “*Current Intelligence Staff Study, Soviet-Albanian Relations, 1940-1960*”, ESAU XIX-62, 2007, f.6. Marrë nga: <https://www.cia.gov/library/readingroom/docs/esau-19.pdf>.

⁵¹⁸AQSH, Fondi: Këshilli Ministrave, Dosja Nr. 223, viti 1947.

⁵¹⁹AQSH, Fondi: Këshilli Ministrave, Dosja Nr. 49, viti 1948, f.1, 2.

⁵²⁰Shqipëria në dokumentat ruse..., përgatiti I. Lauka dhe E. Ymeri, f. 177.

⁵²¹A. Zogaj, *Marrëdhëniet Shqiptaro- Jugosllave...*, f.45.

Brenda një jave shqiptarët i kishin ndërprerë plotësisht të gjitha lidhjet me Jugosllavinë, përveç Traktatit të Miqësisë dhe Ndihmës së Ndërsjellë (Kjo nuk u anulua derisa Jugosllavët kryen anulimin në vitin 1949).⁵²² Hoxha propozoi mohimin e të gjitha marrëveshjeve, protokollet dhe traktatet ekonomike me Jugosllavinë; dyqani i librave jugosllave u mbyll dhe shitja e “Borbës” u ndalua; emri i Titos u largua nga të gjitha librat shkollorë dhe fotografitë e tij u hoqën nga vendet publike; u ndërmorën masa rigorozë përgjatë kufirit; teknikët dhe këshilltarët jugosllavë u dëbuan. Në një radiogram drejtuar legatave shqiptare Moskë-Beograd-Paris-Sofje shkruhet: *“Kryeministria me qarkore të posaçme njofton të gjithë dikasteret dhe entet qeveritare për heqjen nga zyrat dhe vitrinat fotografinë e Titos, për arsye të qëndrimit të tij dhe të qeverisë së tij anti-shqiptare, anti-sovjetike dhe anti-marksiste”*.⁵²³ Ministria e Punëve të Jashtme të Jugosllavisë, me anë të shkresës nr. 252/9, datë 4.7.1948, drejtuar autoriteteve shqiptare shprehej se *“organet shqiptare kanë bërë në territorin e Shqipërisë një seri veprimesh të vrazhda dhe ofenduese me qëllim të uljes së prestigjit të RFPJ pa kurrfarë shkak... të cilat do të ishin të pakuptueshme dhe të pa tolerueshme edhe ndërmjet vendeve, raportet e të cilave përkufizohen vetëm me tolerancën miqësore... megjithatë, kjo nuk do t’i ndryshojë ndjenjat e popujve të Republikës Federative Popullore të Jugosllavisë karshi popullit shqiptar”*.⁵²⁴ Në organet e shtypit “Borba” dhe “Politika” *“vihet re një tjetër rast i qëndrimeve armiqësore të Shqipërisë ndaj Jugosllavisë, ku thuhej se, “Më 24 qershor 1948, koloneli Shpiro Srzentiç, instruktor i Drejtorisë së Përgjithshme Politike të Armatës Jugosllave pranë Drejtorisë Publike të Armatës Shqiptare, edhe pse me kërkesë të palës shqiptare, i është komunikuar se duhet të largohet menjëherë nga Shqipëria. Kjo përfaqëson një shkëlqje të vrazhdët të marrëveshjeve dhe dëmton seriozisht marrëdhëniet miqësore ndërmjet dy vendeve tona”*.⁵²⁵

Pas takimit të Komitetit Qendror i PKSH-së, i cili mbështeti *“unanimisht dhe tërësisht”* rezolutën e Kominformës, u ashpërsua qëndrimi i PKSh ndaj palës jugosllave. Më 11 korrik, *“Shqipëria urdhëroi dëbimin e të gjithë zyrtarëve jugosllavë që kishin mbetur në Shqipëri dhe pesë ditë më vonë dëbuan edhe brigadat rinore jugosllave”*.⁵²⁶ Në Arkivin e Ministrisë së Punëve të Jashtme mes përfaqësuesve shqiptarë dhe atyre jugosllavë ka mjaft letërkëmbime për probleme të ndryshme në marrëdhëniet mes dy vendeve. *“Më 28 shtator 1948, qeveria shqiptare i hoqi të drejtën qeverisë jugosllave për të kërkuar të internuarit shqiptarë në Gjermani dhe Austri, po ashtu, qeveria jugosllave deklaroi se nuk do t’i mbronte më interesat e Shqipërisë dhe të shtetasve të saj në vendet e huaja.”*⁵²⁷ Lidhur me *“denoncimin që qeveria e RPSH iu bëri të gjitha traktateve, marrëveshjeve dhe*

⁵²² AQSH, Fondi: Këshilli Ministrave, Dosja Nr. 49, viti 1948, faqe 1, 2.

⁵²³ AMPJ, Dosja Nr. B/I-8, viti 1948, f. 1.

⁵²⁴ Po aty, f. 2.

⁵²⁵ Po aty.

⁵²⁶ Central Intelligence Agency, *“Current Intelligence Staff Study, Soviet-Albanian Relations, 1940-1960”*, ESAU XIX-62, 2007, faqe 7. Marrë nga: <https://www.cia.gov/library/readingroom/docs/esau-19.pdf>.

⁵²⁷ AMPJ, Dosja nr. B/1-8, viti 1948, f. 2.

protokolleve ekonomike, të lidhura me qeverinë e RFPJ, përmes notës së datës 1 korrik 1948”,⁵²⁸ kjo e fundit shprehet se Traktati mbi Koordinimin e Planeve Ekonomike, Bashkimit Doganor dhe Unifikimit të Valutës dhe Traktatit mbi Bashkëpunimin Ekonomik mes dy vendeve, parashihnin një kohëzgjatje 30-vjeçare pa mundësinë e denoncimit unilateral të palëve. Kështu, veprimin e Shqipërisë për denoncimin e traktateve, Jugosllavia e quajti si “shkelje të vrazhdë të traktateve në fuqi, gjë që është në kundërshtim të hapur me parimet bazë të së drejtës ndërkombëtare mbi respektimin e angazhimeve ndërkombëtare... Përkundrazi, ajo ka qenë e detyruar që në konformitet me art. 5 të Traktatit të Miqësisë dhe Ndihmës Reciproke, i cili obligon të dyja qeveritë të gjejnë mënyrën më të sinqertë dhe më miqësore... për rregullimin e të gjitha çështjeve të paraqitura reciprocisht, e prandaj pra edhe të një mosmarrëveshjeje të këtrillë”.⁵²⁹

Pala shqiptare i paraqiti një sërë kritikash palës jugosllave për sa i takon zbatimin të marrëveshjeve dhe traktateve të përbashkëta lidhur me “mosrealizimin e planit të prodhimit dhe investimit, mos përmbushjen e angazhimeve jugosllave për të sjellë instalime dhe makineri në Shqipëri, faktin se jugosllavët vunë vetëm kapitalin bazë dhe atë në dinarë dhe u bënë pjesëtarë vetëm me kapitale mikroskopike në shoqëritë shqiptaro-jugosllave; mos mbajtjen e angazhimeve për ferovinë, për centralët elektrikë dhe shoqërinë e elektrikut; shkëputjen e shoqërive nga drejtimi i qeverisë shqiptare në atë të Komisionit të Koordinimit, në shkelje të parimit të paritetit; shfrytëzimi i kromit sa më lirë; caktimi i një kursi të ulët lidhur ngushtë me dobësimin e fuqisë blerëse të popullit; mosrespektimi i afateve dhe kontraktimeve për dorëzimin e mallit; kredia 2 milionëshe që do vinte në Shqipëri për materiale konsumi dhe investimi në makineri të ndryshme erdhi vetëm për naftë, goma e disa gjëra të vogla; mosrealizimi i kredisë dhe efektet në planin e investimeve dhe prodhimit gjatë viteve 1947-‘48 etj”.⁵³⁰

Mes autoriteteve jugosllave dhe atyre shqiptare jepen detaje edhe për aktivitetin e ideologjisë propaganduese të studentëve shqiptarë në Jugosllavi dhe trajtimin që iu bëhej nga pala jugosllave. Sipas një note verbale, “Në shkollën e tankeve, komisari i shkollës N/Kolonel Vraniç Mirko ka mbledhur studentët ushtarakë shqiptarë dhe i ka kërcënuar se s’duhet të merren me çështje politike; kurse komandanti i shkollës është sjellë akoma më brutalisht duke i kërcënuar haptas studentët shqiptarë se do t’i fuste në burg”.⁵³¹ Po ashtu, një dokument tjetër mbi qëndrimin e autoriteteve jugosllave karshi shtetasve shqiptare në Jugosllavi bënte fjalë për zhdukje, arrestime dhe ekspulsime nga organet e shtetit jugosllav të studentëve shqiptarë: “pa vënë aspak në dijeni legatën shqiptare në Beograd”⁵³², ndërkohë që legata e RFPJ shprehej se “studentët në fjalë janë arrestuar nga shkakun e propagandës dhe aktivitetit anti-jugosllav, pasi iu është gjetur material me përmbajtje anti-

⁵²⁸AMPJ, Dosja nr. B/1-8, viti 1948, f. 2.

⁵²⁹Po aty, f. 4.

⁵³⁰Po aty, f. 3.

⁵³¹Po aty, f. 38.

⁵³²Po aty, f. 27.

jugosllave”.⁵³³ Në një dokument tjetër shkruhet se: “Këshilltari jugosllav proteston për gjestin e disa nënshtetasve shqiptarë që po futen në çështjet e brendshme të shtetit tonë duke thirrur jugosllavë të ndryshëm t’u flasin gabim mbi çështjet e ndryshme në Jugosllavi. në mënyrë që t’i mashtrojnë.”⁵³⁴ Një tjetër notë verbale tregon se edhe ndaj kursantëve shqiptarë të Shkollës së Hekurudhave në Pulje është mbajtur “... një qëndrim krejt armiqësor provokues dhe fytes”.⁵³⁵ Në një relacion mbi marrëdhëniet me Jugosllavinë, që nga shtatori 1948 deri në dhjetor 1948 shkruhet se kursantët, studentët dhe ushtarakët e kthyer në Shqipëri “kanë pësuar trajtimin më çnjerëzor nga ana e autoriteteve jugosllave, duke qenë të ndjekur e të vëzhguar nga agjentët e UDB-së, të cilët i kanë provokuar e fyer vazhdimisht; shpeshherë janë lënë pa bukë dhe janë detyruar të flenë në rrugë”.⁵³⁶ Gjithashtu, janë dokumentuar edhe raste të mbajtjes së të hollave dhe sendeve nga dogana në kufi ndaj shtetasve shqiptarë, si në rastin e “delegacionit që shkante për në Budapest kryesuar nga dr. Thoma Harito, të cilët kishin me vete një sasi dinarësh të pajisur edhe me lejë eksportimi nga Banka e Shtetit, dhe autoritetet jugosllave të aerodromit Zemun ua mbajtën duke u lëshuar një dëftesë. E njëjta ngjarje ndodhi me studentët”.⁵³⁷ Një rast i ngjashëm i raportuar ishte ai i shtetasit Leonidha Boçi i kthyer nga Argjentina, i cili “me arritjen në Fiume të Jugosllavisë, kishte sjellë me vete tre baule (valixhe plot me tesha veshmbathje, pse sikur dihet nuk na lejonin të sillnim të holla”, autoritetet jugosllave nuk më lejuan që t’i marrë me vete baulet me pretekst se do t’i dërgojnë më pas”.⁵³⁸ Sipas palës shqiptare, ka pasur qëndrime arbitrare nga ana e palës jugosllave edhe për sa i takon pajisjes së shtetasve shqiptarë me pasaporta dhe dokumente të tjera jugosllave”.⁵³⁹ Për më tepër, “Ushtarë dhe civilë të armatosur jugosllavë, gjatë kësaj kohe kanë kryer tre provokacione të armatosura në kufi kundër RPSH”.⁵⁴⁰

Një tjetër ankesë ndaj autoriteteve jugosllave të kufirit vinte nga banorët e zonave rurale shqiptare, pasi ata “kanë ndaluar fshatarët e katundit Bllatë e Poshtme dhe Reshan të pajisur me kartat e pronësisë, që të mos kalojnë kufirin në rrugën afër katundit të tyre, siç kanë bërë deri më sot, por i kanë detyruar të kalojnë në rrugën e Bllatës së sipërme, e cila ndodhet në një largësi prej 10 km”.⁵⁴¹ Pavarësisht se qeveria shqiptare kishte rënë dakord me atë jugosllave për sa i takonte rregullimit të tokave kufitare, sërish ishin raportuar problematika. Sipas dokumentit, Hysni Kapo⁵⁴² shprehu aprovimin e qeverisë shqiptare “mbi çështjen e rregullimit të tokave në kufirin shqiptaro-jugosllav. Për tokat që iu janë marrë nga reforma agrare, si banorëve të njëjës anë ashtu edhe banorëve të anës

⁵³³Po aty, f. 31.

⁵³⁴AMPJ, Dosja Nr.B/V-2, viti 1948, f. 1.

⁵³⁵AMPJ, Dosja Nr.B/I-8, viti 1948, f. 39.

⁵³⁶Po aty, f. 29.

⁵³⁷AMPJ, Dosja Nr. B/II-8, viti 1948, f. 18.

⁵³⁸Po aty, f. 18.

⁵³⁹AMPJ, Dosja Nr.B/I-8., viti 1948, f. 3.

⁵⁴⁰Po aty, f. 29.

⁵⁴¹AMPJ, Dosja Nr. B/II-3, viti 1948, f. 10.

⁵⁴² Ministri i Punëve të Jashtme në atë kohë (1947-1949)

tjetër, duke përjashtuar ato që bëjnë pjesë në një formë shtetërore dhe që nuk ka mundësi t'iu jepen, do t'iu jepet një tokë tjetër e përshtatshme. Për arsye të vështirësive që hasin pronarët e tokave në të dy anët, duke u detyruar të kalojnë në disa pika të caktuara do të jetë mirë që të rregullohet në mënyrë që ata të bëjnë rrugën më të shkurtër për të shkuar në tokat e tyre”.⁵⁴³ Sipas një njoftimi të seksionit të grumbullimit të Ministrisë së Tregtisë: “Komiteti Ekzekutiv i Partisë Komuniste në rrethin e Peshkopisë na njofton se për efekt të ngjarjeve të fundit në Republikës Popullore Federative të Jugosllavisë ka mbetur jashtë kufirit një sasi e konsiderueshme tokash të mbjella me baret dhe, si rrjedhim edhe prodhimi i tyre ka mbetur jashtë kufirit... kështu që plani i grumbullimit të drithërave të mos realizohet. Komiteti i sipërm na njofton gjithashtu se për efekt të prerjes së ujit, në atë anë të kufirit prodhimi i disa tokave tona është dëmtuar rëndë. Raste të tilla ndodhin edhe në Rrethin e Shkodrës dhe ka të ngjarë edhe në rrethe të tjera bri kufirit”.⁵⁴⁴

Më tej, autoritetet shqiptare sqarojnë se, “Në bazë të Konventës ekonomike dhe të akordeve të tjera ekonomike, qeveria jugosllave angazhohej të ndihmonte për ngritjen e zhvillimit ekonomik të vendit tonë të shkatërruar nga lufta, por nuk i ka mbajtur këto angazhime.”⁵⁴⁵

Për sa u takon marrëdhënieve me Kosovën, ekzistojnë disa burime arkivore të udhëheqjes shqiptare të asaj kohe. Në një letër të dërguar Hysni Kapos nga legata shqiptare në Jugosllavi, specifikisht nga përfaqësuesi i saj Peço Kagjini, shkruhet se “Konstatohet nga legata se në Kosovë populli nuk zhvillon urrejtje për Shqipërinë, atje pëshpëritet çështja e bashkimit me Shqipërinë... Por populli ka edhe frikë, mbasi në agjitacionin e tyre udhëheqësit e Kosovës e trembin popullin duke e paraqitur vendin tonë me një qëndrim armiqësor karshi Jugosllavisë... Si argumente përdorin të ashtuquajturën sakrificë që bënte Jugosllavia karshi nesh dhe qëndrimin aventurier tonin... duan t' i mbushin mendjen popullit se Shqipëria është në një pozitë të vështirë ekonomike dhe politike dhe pa Jugosllavinë s' bën dot se është izoluar etj”.⁵⁴⁶ Në vijim, një tjetër përgjigje: “Një fushatë e gjerë anti-shqiptare bëhet në minoritetin shqiptar të Maqedonisë, dhe se udhëheqja shqiptare mban qëndrim armiqësor karshi Partisë Komuniste Shqiptare dhe RPSH. Kjo politikë urrejtjeje karshi kampit socialist në vetvete ka për qëllim të përgatisë partitë dhe masat në rrugën e tyre të tradhtisë dhe të degjenerimit të Republikës Jugosllave në një republikë borgjeze... Megjithatë... nga populli thonë se ‘Shqipëria qëndron me Bashkimin Sovjetik dhe ajo s' vepron pa dijeninë e Stalinit’”.⁵⁴⁷ Në një tjetër komunikim mes autoriteteve shqiptare të legatës shqiptare në Jugosllavi dhe Partisë Komuniste Shqiptare, në tetor 1948 shkruhet: “Fushata kundër demokracive popullore, forcave demokratike dhe Bashkimit Sovjetik është zhvilluar në një mënyrë tepër të gjerë nga shtypi (posaçërisht

⁵⁴³ AMPJ, Dosja Nr. B/II-3, viti 1948, f. 9.

⁵⁴⁴ AMPJ, Dosja Nr. B/II-3, viti 1948, f. 9.

⁵⁴⁵ AMPJ, Dosja Nr. B/V-2, viti 1948, f. 7.

⁵⁴⁶ AMPJ, Dosja nr. A-6/a, viti 1948, f. 3.

⁵⁴⁷ AMPJ, Dosja nr. B/1-8, viti 1948, f. 13.

“Borba” e “Politika”); është zhvilluar me anë të punëve manifestative si mitingje; konferenca, protesta, telegrame; me anë të fjalimeve zyrtare; me anë të qëndrimeve zyrtare dhe komunikatave; me anë të agjitacionit të vogël dhe të shtypit të vogël. Fushata anti-socialiste e trockistëve të Beogradit ka qëlluar pa përjashtim të gjitha demokracitë e reja, veç këtyre forcat demokratike të Triestes, të Francës dhe të Kanadasë, si dhe së fundi është ndërmarrë dhe kundra Bashkimit Sovjetik”.⁵⁴⁸

Fushata kundër Republikës Popullore të Shqipërisë kaloi edhe në akuza të tipit se, “në Shqipëri ka terror dhe vriten ata që janë me Titon, siç thoshte artikulli i “Pobjedës”, se shqiptarët ngjallin ndjenja shqiptaro-mëdha dhe dërgojnë banda për të vepruar në Kosovë, siç thoshte po ai artikull se Shqipëria ka pozita të dobëta ndërkombëtare dhe gjeografike siç kërkonte të nxirrte promemorien me të cilën tregonin se s’mbrojnë më interesat tona jashtë; se në Shqipëri është gjendje e keqe ekonomike e shkaktuar nga prishja e marrëdhënieve me Jugosllavinë”.⁵⁴⁹

Përgjithësisht, histografia komuniste shqiptare i ka idealizuar dhe himnizuar marrëdhëniet shqiptaro-jugosllave përgjatë viteve 1945- 1948, ndërsa pas prishjes së këtyre marrëdhënieve (1948) këto marrëdhënie midis dy shteteve dhe dy popujve i ka interpretuar duke ua hedhur plotësisht fajin palës jugosllave, e cila kurrë nuk pushoi së zhvilluari politikë tinëzare, gllabëruese ndaj popullit shqiptar, ndaj hapësirave jetike dhe terroriste shqiptare. Të dyja “këto pikëvështrime dhe trajtime, qoftë nga histografia komuniste shqiptare, qoftë nga ajo jugosllave, janë të njëanshme dhe të politizuara”.⁵⁵⁰

Fundi i marrëdhënieve shqiptaro-jugosllave intensifikoi marrëdhëniet e Shqipërisë me Bashkimin Sovjetik. Në gusht-shtator 1948, një delegacion tregtar shqiptar, i kryesuar nga ministri i Industrisë Tuk Jakova, vizitoi Moskën dhe përmbylli marrëveshjen e parë tregtare midis dy vendeve. Gjatë vitit të ardhshëm, të gjithë satelitët e Europës Lindore nënshkruan marrëveshje tregtare dhe kulturore dhe morën përsipër të ndanin në programin sovjetik për të nënshkruar ekonominë shqiptare. Në shkurt 1949, Shqipëria u përfshi po ashtu në Këshillin për Ndihmë Ekonomike të Ndërsjellë. Ndihma ushtarake shënoi edhe programin fillestar të ndihmës sovjetike – shumica e të cilave ishte planifikuar për mbështetjen e luftës guerile greke që po e ndihmonin shqiptarët. “Deri në vitin 1951, BRSS dhe satelitët po subvenciononin një të tretën e buxhetit shqiptar dhe siguronin mallrat kapitale të nevojshme për të ndërmarrë projektet ambicioze industriale, të cilën Shqipëria e filloi më 1949-n, në bazë të planit të saj 2-vjeçar.⁵⁵¹ Deri në vitin 1954, “personeli sovjetik në Shqipëri raportohet se përfshinte ambasadorin dhe katër misione të veçanta nën

⁵⁴⁸ AMPJ, Dosja nr. B/1-8/8, *Situata në Jugosllavi gjatë këtyre javëve të fundit*, tetor 1948, f. 1.

⁵⁴⁹ *Po aty*, f. 11.

⁵⁵⁰ A. Zogaj, *Marrëdhëniet Shqiptaro- Jugosllave...*, f. 11.

⁵⁵¹ Central Intelligence Agency, “*Current Intelligence Staff Study, Soviet-Albanian Relations, 1940-1960*”, ESAU XIX-62, 2007, f. 12. Marrë nga: <https://www.cia.gov/library/readingroom/docs/esau-19.pdf>.

mbikëqyrjen e tij”.⁵⁵² Ndërsa lidhjet ekonomike dhe ushtarake u zgjeruan, po ashtu u zgjeruan edhe kontaktet politike.

⁵⁵² Po aty, f. 13.

KREU IV

QËNDRIMET PRO-JUGOSLLAVE TË KOÇI XOXES DHE FUNDI I TIJ POLITIK

4.1 Spastrimi i fajtorëve në Partinë Komuniste Shqiptare

Si “vendosmëri heroike” e sundimit komunist është likuidimi i të gjithë kundërshtarëve shoqërisht, politikisht dhe fizikisht. Nuk asgjësoheshin vetëm armiqtë aktualë dhe ata të mundshëm, por edhe çdo person tjetër që mendonte apo vepronte në mënyrë të pavarur dhe të dënueshme, sipas Nenit 58 të Kodit Penal Sovjetik. Të kategorizuar si armiq të popullit, dënimi me vdekje apo shfarosja u përdor masivisht gjatë sundimit komunist në vende të ndryshme. Përmendim këtu “*Terrorin e Madh*” të viteve 1930 të ndërmarrë nga Stalini. “*Spastrimet*” e herëpashershme të partive komuniste dhe strukturave të tyre të pushtetit janë unike në histori dhe përfshijnë gjyqet e internimit dhe dëbimit, denoncimet e ndërsjella të palëve dhe autokritikat e të akuzuarve. Kështu, “*Terrori* nuk ishte vetëm një instrument politik që ushtrohej rregullisht, por edhe kusht psikologjik i nënshtimit të masave popullore.”⁵⁵³ Stalini përdorte mekanizmin e spastrimeve në udhëheqje, nëpërmjet metodës së abrekëve, banditëve kaukazianë, se ai që kishte vënë në shenjë ishte armik, e më pas e nxiste që të sulmonte tjetrin, duke i premtuar vendin e atij. Në fund e eliminonte edhe atë që kishte përdorur. Këtë metodë Stalini e përdorte për të iniciuar goditjen e njeriut që donte të eliminonte. Ky njeri i përdorur mund të ishte një udhëheqës ose një njeri i thjeshtë, sipas rastit. “Tito dhe udhëheqja e Partisë Komuniste Jugosllave bënë shkollën e “*zbulimit*” të kompleteve në Bashkimin Sovjetik dhe i mësuuan këto metoda.”⁵⁵⁴ Sigurisht që Partia Komuniste Shqiptare, e ndërtuar me ndihmën e jugosllavëve, bazuar mbi modelin sovjetik, do ndiqte të njëjtën linjë spastrimesh bazuar edhe në fraksionizmin brenda saj, të nxitur edhe nga ndikimi jugosllav. Detyra kryesore e Jugosllavisë në periudhën para krijimit të PKSh dukej se ishte bashkimi i grupeve komuniste, pavarësisht pikëpamjeve të tyre në një parti të vetme bazuar në modelin sovjetik. Koçi Xoxe ishte mbështetësi kryesor për vendosjen e marrëdhënieve ekonomike dhe politike me Jugosllavinë. Ai theksonte vazhdimisht rëndësinë e ndjekjes së udhëzimeve të jugosllavëve dhe, në mënyrë të veçantë të mareshalit Tito për rimëkëmbjen e vendit të dalë nga lufta në një gjendje të vështirë ekonomike. Ai do të shprehej se, “*për sa i përket etapës së pas Luftës Nacionalçlirimtare, ishte e nevojshme të evitoheshin përhapja në parti e një fryme sektarizmi, kështu që gabimet duhet të evidentoheshin dhe të*

⁵⁵³ Gerd Koenen, “*Komunizmi në Epokën e tij, Broshurë ekspozite*”, Përgatitur nga Fondacioni Federal për Studimin e Diktaturës në Gjermani, Muzeu Historik Gjerman dhe Instituti për Demokraci, Media dhe Kulturë. Marrë nga: <https://www.idmc.al/assets/komunizmi.ne.epoken.e.tij-broshura.pdf>.

⁵⁵⁴ K. Myftaraj, *Jeta e Fshehur e Enver Hoxhës...*, f. 442.

korrigjoheshin".⁵⁵⁵ Enver Hoxha kërkonte "të krijonte një hendek mes Koçi Xoxes dhe Sejfulla Malëshovës, duke qenë se të dy ishin pretendentë për postin e sekretarit të përgjithshëm të partisë, i pari si punëtor dhe i dyti si ideolog që kishte studiuar në Bashkimin Sovjetik".⁵⁵⁶ Gjithashtu po në Plenumin e Beratit u kritikuan edhe Liri Gega dhe Nako Spiro. Si rezultat i mbajtjes së këtij Komiteti Antifashist Nacionalçlirimtar, i formuar në Kongresin e Përmetit, u kthye në qeveri të përkohshme me në krye Enver Hoxhën. Malëshova u promovua në politikë-buro.

Në shtator 1947, pa dijeninë e jugosllavëve, sovjetikët njoftuan në mënyrë të drejtpërdrejtë Koçi Xoxen, lidhur me themelimin e Informbyrosë prej përfaqësuesve të Partive Komuniste të Bashkimit Sovjetik, Jugosllavisë, Hungarisë, Rumanisë, Çekosllovakisë, Polonisë, Bullgarisë, Francës dhe Italisë (pa pjesëmarrjen e Partisë Komuniste të Shqipërisë), si dhe i vunë në dispozicion procesverbalin e mbledhjes së parë të byrosë. Jugosllavët patën besimin se në Shqipëri ekzistonte një vijë që, sipas tyre ishte politike dhe jo ekonomike, e cila sheh me dyshim marrëdhëniet me Jugosllavinë. Sipas tyre, ky qëndrim iu referohej aktivistëve shqiptarë nga njerëz me pozita mjaft të rëndësishme dhe këta, në bazë të kësaj, shpeshherë mbanin në punën e përditshme një qëndrim anti-jugosllav. Nga përbërja e Byrosë Politike prej gjashtë vetash, në thelb punonin vetëm Enveri, Koçi Xoxe dhe Nako Spiro, kurse treshja tjetër - Bedri Spahiu, Pandi Kristo dhe Tuk Jakova, si rregull, nuk merrnin pjesë fare në diskutimet e Byrosë Politike dhe në të gjitha rastet pranonin gjithçka që iu propozohej.

Referuar fraksionizmit partiak, Enver Hoxha paraqiti marrëdhënien e ashpërsuar mes Koçi Xoxes dhe Nako Spiros. Ai tha: "*nganjëherë kam qenë i detyruar të të ndërprisja seancat e Byrosë Politike, pa marrë kurrfarë vendimesh*". Sipas fjalëve të Enver Hoxhës, Koçi Xoxe e pret me sedër çdo lloj kritike të veprimtarive të veta nga ana e Nako Spiros; për më tepër, kur disa masa ose propozime të Enver Hoxhës nuk i pëlqejnë Koçi Xoxes, atëherë edhe në këtë rast ai mundohet të shfajësohet me intrigat e Nako Spiros, duke menduar se propozime të tilla Enver Hoxhës i janë diktuar nga ana e Nako Spiros dhe janë drejtuar kundër tij, Koçi Xoxes. Tipar negativ i Koçi Xoxes, sipas fjalëve të E. Hoxhës, është fakti se "*ai i mbivlerëson tej mase aftësitë e veta dhe gjërat i shikon me një optimizëm të tepruar*".⁵⁵⁷

Tensionet mes zyrtarëve të lartë, në nëntor të vitit 1947 u rritën, duke qenë se liderët jugosllavë hidhnin akuza ndaj Byrosë Politike të Partisë Komuniste Shqiptare për adoptimin e një qëndrimi armiqësor ndaj Jugosllavisë. Ashtu siç u theksua edhe më lart, këto akuza u drejtuan kryesisht ndaj Nako Spiros, përkrahës i një linje anti-Beograd. Në takimin me ambasadorin sovjetik, Tito fajësoi Nako Spiron për politikën e tij anti-

⁵⁵⁵ AQSH, Fondi 14, Dosja Nr. 2, viti 1944, fl. 248.

⁵⁵⁶ K. Myftaraj, *Jeta e Fshehur e Enver Hoxhës...*, f. 450.

⁵⁵⁷ *Shqipëria në dokumentat ruse...*, përgatitën I. Lauka dhe E. Ymeri, f. 138.

jugosllave, dhe se do të kërkonte nga udhëheqja shqiptare që ta përjashtonte atë nga Partia Komuniste Shqiptare, si pasojë e politikës së tij anti-jugosllave dhe antimarksiste; dhe për këtë “ftoi në Beograd Hoxhën dhe Xoxen. Sipas shkrimeve të ambasadorit sovjetik, Lavrentjevi nuk i dha një përgjigje Titos lidhur me përjashtimin e Nako Spiros, por vetëm e dëgjoi”.⁵⁵⁸ Sipas mendimit të jugosllavëve, “Nako Spiro, Fadil Paçrami e të tjerë kanë luajtur një rol të dukshëm në dobësimin e marrëdhënieve me Jugosllavinë”.⁵⁵⁹ Gjithashtu, në një raport të dërguar udhëheqjes shqiptare, Savo Zllatic shkruan se “*ka ardhur koha për eliminimin e Nako Spiros*”.⁵⁶⁰ Po ashtu, Zllatic tha se ishte koha edhe për masat e tjera, duke paralajmëruar kështu rritjen e trysnisë mbi udhëheqjen shqiptare. Siç dihej tashmë, Koçi Xoxe ishte kundërshtari më i fortë i Nako Spiros. Ai ushtroi ndikim ndaj Enver Hoxhës, në mënyrë që ky i fundit të niste një hetim ndaj Nako Spiros. Raporti i Enver Hoxhës në mbledhjen e Byrosë Politike të KQ të PKSh e konsideronte Nako Spiron si frymëzues i tendencave anti-jugosllave në Shqipëri. Ky i fundit akuzoi Enver Hoxhën dhe Koçi Xoxen për “*ndryshimin rrënjësor të qëndrimeve të tyre në çështjen jugosllave. Tani të gjithë më janë turrur mua, unë jam fajtor për gjithçka, paçka se për të gjitha çështjet parimore që kam zgjidhur gjithmonë kam marrë pëlqimin e Enver Hoxhës dhe të Koçi Xoxes. Mos vallë ata nuk janë në dijeni të gjërave të tilla? Gjithmonë kam vepruar sipas direktivave të tyre.*”⁵⁶¹ Në mbyllje të fjalës së tij ai tha se e quan të padrejtë atë vijë që po ndjek tani Enver Hoxha dhe, bashkë me të, edhe të gjithë anëtarët e tjerë të Byrosë Politike të KQ të PKSh, duke pranuar plotësisht pikëpamjet e jugosllavëve”.⁵⁶²

Në lidhje me Nako Spiron, Enver Hoxha paraqiti disa momente në fjalimin e tij për çështjen e Plenumit të Beratit të KQ të PKSh, sipas të cilave “Nako Spiroja përpiquej ta konfliktonte atë me Koçi Xoxen, zmadhonte gabimet e jugosllavëve etj. Sipas tij, “*Çështja e Nako Spiros u ka mësuar shumë gjëra udhëheqësve të partisë shqiptare*”. Ishte tepër domethënës fakti se kur Enver Hoxha po fliste për të gjitha këto gjëra, Koçi Xoxe mendohej të tregonte se ishte në një mendje me Enver Hoxhën për gjithçka”⁵⁶³. Në punimet e Plenumit VIII të KQ të PKSh, të zhvilluara në periudhën 26 shkurt-2 mars 1948, i cili u thirr për arsye se KQ i Partisë Komuniste të Jugosllavisë i paraqiti udhëheqjes së Partisë Komuniste të Shqipërisë një akuzë për veprimtari anti-jugosllave, duke specifikuar ish-ministrin e Byrosë Politike të KQ të PKSh, Nako Spiron, i cili u akuzua për veprimtari antipopullore dhe armiqësore. “Qëndrimi i Xoxes në rrethanat e asaj kohe ndikoi edhe në qëndrimin armiqësor që mbante Enver Hoxha ndaj Nako Spiros.”⁵⁶⁴ Nako Spiro vdiq në

⁵⁵⁸ Ledion Krisafi, “*Marrëdhëniet shqiptaro-jugosllave 1945-1948, Mitet, Faktet dhe Dyshimet*”, Shtëpia botuese “Naimi”, Tiranë 2017, faqe 186.

⁵⁵⁹ *Marrëdhëniet shqiptaro-jugosllave...*, përgatitën N. Plasari dhe L. Malltezi, f. 123.

⁵⁶⁰ Ledion Krisafi, “*Marrëdhëniet shqiptaro-jugosllave 1945-1948, Mitet, Faktet dhe Dyshimet*”, Shtëpia botuese “Naimi”, Tiranë 2017, faqe 192.

⁵⁶¹ *Shqipëria në dokumentat ruse...*, përgatitën I. Lauka dhe E. Ymeri, f. 157.

⁵⁶² *Po aty*, f. 158.

⁵⁶³ *Po aty*, f. 166.

⁵⁶⁴ *Po aty*, f. 178.

rrethana misterioze. Sipas të dhënave zyrtare, ai kreu vetëvrasje vetëm disa ditë para përfundimit të procedurës. Kjo ngjarje u paraqit si aksidentale. Vdekja e tij ishte politikisht e rëndësishme, sepse ai kishte mbajtur kontakte të ngushta me misionin sovjetik në Tiranë dhe kishte respektuar rregullisht udhëzimet e misionit. Pak para vdekjes së tij, ai raportohet se vizitoi misionin për t'u këshilluar me zyrtarët sovjetikë për situatën e tij. Pas vdekjes së Spiros, Tito udhëzoi ambasadorin jugosllav në Moskë, Vladimir Popovic, të afrohej menjëherë me Stalinin për çështjen shqiptare. Ambasadori jugosllav u takua dy herë me anëtarin e Byrosë Politike Sovjetike, Andrei Zhdanov. Popovic e quajti Spiron tradhtar, i cili në aktivitetet e tij anti-jugosllav kishte përdorur metodat “*imperialiste*”. Ambasadori jugosllav theksoi bashkëpunimin e ngushtë të Spiros me misionin sovjetik në Tiranë dhe në këtë mënyrë indirekt shprehu pakënaqësinë e tij për praninë sovjetike në Shqipëri. Ai theksoi se Shqipëria mori të gjithë ndihmën e nevojshme nga Jugosllavia. Popoviç i tha Zhdanov se, në dritën e “*vetëvrasjes*” së Spiros, qeveria jugosllave do t'i ofronte “*ndihmë thelbësore*” Partisë Komuniste Shqiptare për të pastruar dhe konsoliduar radhët e saj. Komentet e Popoviçit kishin një qëllim të qartë: të siguronin pranimin e Moskës për pozicionimin e Shqipërisë në sferën e përfshirjes jugosllave. Zhdanov e raportoi diskutimin të Stalinin, i cili nga ana e tij, më 23 dhjetor 1947, i dërgoi një telegram Titos, duke i kërkuar që të dërgonte në Moskë “*një shok të përgjegjshëm, për shembull Gjilas ose ndonjë person tjetër që të njihej me situatën në Shqipëri*”.⁵⁶⁵

Duke qenë se Shqipëria ishte për Jugosllavinë një vatër shumë e rëndësishme gjeografike dhe strategjiko-ushtarake, udhëheqja jugosllave shqetësohej mjaft për përbërjen e udhëheqjes shqiptare. Sipas Titos, “Enver Hoxha mund të bjerë lehtësisht në ndikime të ndryshme, ndërsa Xoxja ishte një udhëheqës më i fortë dhe konsekuent”.⁵⁶⁶ Duke qenë se Titoja informohej që mes udhëheqjes shqiptare nuk ekzistonte harmonia e duhur, ai ishte i mendimit se kjo nuk duhet të lejonte që të ndodhnin mosmarrëveshje mes Jugosllavisë dhe Shqipërisë. Sipas mendimit të Titos, “Hoxhës dhe Xoxes iu duhet thënë se ndihma e Bashkimit Sovjetik për Shqipërinë nuk duhet vlerësuar si shfaqje e faktit se Bashkimi Sovjetik dëshiron shpërbërjen e Shqipërisë nga Jugosllavia, por, përkundrazi, duhet parë si ndihmë për afrimin mes dy vendeve fqinje”.⁵⁶⁷ Koçi Xoxe do të shprehej se, “në kushtet e një ndryshimi rrënjësor të regjimit,⁵⁶⁸ pjesa më e madhe, për të mos thënë të gjithë anëtarët e Komitetit Qendror ishin pa eksperiencë dhe të papërgatitur për drejtimin e Partisë. Një mungesë e tillë eksperience dhe përgatitjeje çoi në rezultate të tilla që

⁵⁶⁵*Shënim:* Draftet e telegramit të Stalinin drejt Titos, në shkrimin me dorë të Zhdanov, janë ruajtur në RGASPI (Arkivi Shtetëror Rus i Historisë Sociale dhe Politike), F. 77, Op. 3, D. 99, Ll. 6–7. *Shih:* Jeronim Perovic, “*The Tito-Stalin split: a reassessment in light of new evidence*”, Zurich Open Repository and Archive, Zyrih, faqe 47, marrë nga: https://www.zora.uzh.ch/id/eprint/62735/1/Perovic_Tito.pdf

⁵⁶⁶Shqipëria në dokumentat ruse..., përgatitën I. Lauka dhe E. Ymeri, f. 154.

⁵⁶⁷Po aty.

⁵⁶⁸AQSH, Fondi 14, Dosja Nr. 2, viti 1944, fl. 51.

Komiteti Qendror dhe Byroja të mos funksiononin siç duhej, asnjëri prej këtyre organeve nuk ishte mbledhur ndonjëherë për të shtruar problemet e partisë⁵⁶⁹.

Sipas të dhënave të AQSht në vitin 1944, Koçi ishte shprehur se “Në mbledhjet e Byrosë, asnjëherë nuk iu dhanë udhëzime dhe këshilla për shokët e partisë, për mënyrën se si ata duhet të punonin; kjo për shkak të shokëve dhe shoqeve që ishin anëtarë të saj. Pozita e shokëve të partisë nuk ishte e qartë. Për shembull, shoqja Liri shquhej në komitet për cilësitë e saj, megjithatë në punën e saj shfaqej një dozë e lartë sektarizmi, ajo konsiderohej nga të gjithë shokët si zëri i autorizuar i Partisë, fjala e saj zbatohet pa diskutime.”⁵⁷⁰ Për të gjitha këto mangësi fajin e kishin Miladinit, Dushanit, Enveri, Liria dhe Baca, madje Liria shprehej edhe që sekretari organizativ Koçi Xoxe duhej ndërruar.⁵⁷¹ Kështu, “organizatat e Partisë kanë pasur mangësi shumë të dukshme në lidhje me organizimin dhe qeverisjen e vendit, madje në disa raste edhe kanë stepur apo mbytur iniciativën e organeve të qeverisjes”.⁵⁷²

Vite më vonë, në përfundim të Plenumit VIII të Byrosë Politike të KQ së PKSh, Enver Hoxha do të shprehej se “udhëheqja trockiste jugosllave paraqitet me të gjitha tiparet e trockizmit në konditat e sotme, domethënë me fraksion në gjirin e Kampit të Socializmit dhe anti-sovjetizëm. Metoda dhe puna e tyre trockiste janë futur në Partinë tonë me anën e agjentëve kryesorë Koçi Xoxe dhe Pandi Kristo, përgjegjësit kryesorë që kanë punuar vazhdimisht në këtë drejtim”.⁵⁷³ Përkundër këtyre të fundit, sekretari i përgjithshëm i partisë, Enver Hoxha, ashtu si edhe Mehmet Shehu, Tuk Jakova, Liri Belishova, Bedri Spahiu etj., u etiketuan si mbrojtës të socializmit dhe të së ashtuquajturës “vijë të drejtë” të partisë. Ish-anëtarët e udhëheqjes shqiptare të asaj kohe shpreheshin se veprimtaria e Koçi Xoxes ngrihej në një luftë me plan dhe me qëllim të caktuar qysh prej Plenumit II të Beratit. Kjo gjë doli qartë në raportin e prezantuar nga Tuk Jakova. Sipas tyre, Koçi Xoxe i përdori të gjitha mjetet që i siguroi pozita e tij e privilegjuar si Sekretar Organizativ dhe ministër i Brendshëm. Po ashtu, ish-anëtarët e udhëheqjes shqiptare të asaj kohe shpreheshin se Koçi Xoxe dhe Pandi Kristo luftuan për ta kthyer partinë në një parti të bindur të udhëheqjes trockiste jugosllave, mirëpo ata hasën në rezistencën e një pjese të Komitetit Qendror dhe, në radhë të parë të Sekretarit të Përgjithshëm Enver Hoxhës⁵⁷⁴. Kështu, këndvështrimet e ndryshme çuan në fillimin e procesit të përçarjes së Byrosë Politike. Në mbledhje, aktorët kryesorë ishin Koçi Xoxe, Liri Gega, Nako Spiro dhe Enver Hoxha. Koçi Xoxa propozoi që të mos nguteshin lidhur me mbajtjen e Plenumit të ardhshëm. Liri Gega, nga ana tjetër, e kritikoi Xoxen për moskryerjen e detyrës së tij, gjë që e pranoi edhe Xoxe, duke u shprehur se kishte punuar i mënjanuar. Megjithatë, me

⁵⁶⁹Po aty, fl.14.

⁵⁷⁰Po aty, fl. 17.

⁵⁷¹Po aty, fl. 34.

⁵⁷²AQSH, Fondi 14, Dosja Nr. 2, viti 1944, fl. 66.

⁵⁷³Po aty, Fondi 14, Dosja Nr. 9, viti 1948, fl. 17.

⁵⁷⁴Po aty, Fondi 14, Dosja Nr. 14, viti 1948, fl. 2.

propozimin e Enver Hoxhës dhe Nako Spiros u hodh poshtë propozimi i Liri Gegës dhe Koçi Xoxe u këshillua që t'i përvishej punës dhe të afirmohej në punë e sipër. Ndërkohë jugosllavët i njihnin prej kohësh mosmarrëveshjet brenda partisë dhe vepronin herë pas here për nxitjen e tyre. Në shtator-tetor të vitit 1944, “për të mos mbajtur asnjë përgjegjësi për vijën “sektare” të partisë ata tërhoqën menjëherë edhe Dushan Mugoshën nga Shqipëria.”⁵⁷⁵ Byroja Politike në tërësi nuk i kuptoi synimet e mbrapshta të udhëheqjes komuniste jugosllave, e dukshme kjo në përmbajtjen e raportit, si dhe diskutimet në Plenum. “Ata që ndikuan më tepër në hartimin e këtij raporti, Sejfulla Malëshova, Nako Spiro e Koçi Xoxe, e detyruan Enver Hoxhën të bënte vërejtjet e tij”⁵⁷⁶. Koçi Xoxe donte që në referat të pasqyrohej ndihmesa e Titos “*për ecjen përpara të partisë sonë... ndihma shpëtimtare e shokëve jugosllavë, që nga themeli i partisë e deri më sot... që të dallojmë gabimet e mëdha të mëparshme e aktuale*”.⁵⁷⁷

Duke qenë se Naku Spiro dhe Koçi Xoxe nuk ishin në një mendje me Liri Gegën dhe me qëndrimin e Ramadan Çitakut, “propozuan largimin e tyre nga Byroja dhe zëvendësimin e tyre me Sejfulla Malëshovën dhe Pandi Kriston”.⁵⁷⁸ Krahas kundërshtimeve të mësipërme, mes Enver Hoxhës dhe Koçi Xoxes ka pasur edhe një luftë për pushtet, duke qenë se “Xoxe, si njeriu numër dy në parti, në pozicionin e sekretarit organizativ të partisë kishte në dorë emërimet në të gjithë hierarkinë shtetërore si dhe shërbimin sekret”.⁵⁷⁹ Në këtë mënyrë, “Koçi Xoxe ishte pretendenti kryesor për të zënë vendin e Enver Hoxhës”.⁵⁸⁰

Deri më 1944, Enver Hoxha kishte qenë “*gjahtari*”, por dukej se rolet qenë ndërruar dhe Koçi do të ishte “*preja*”.⁵⁸¹ Klika reagoi duke përgatitur goditjen vendimtare kundër klanit tjetër, eliminimin e Koçi Xoxes nga udhëheqja. Në Plenumin e Beratit, Enver Hoxha deklaroi: “*Filluan ato mbledhjet me Velon (Velimir Stoiniçin). Erdhi puna e sekretarit organizativ. Sekretar organizativ ishte Koçi, por unë kisha mendimin se Koçi nuk e kishte aftësinë për ta kryer këtë detyrë. Kisha mendimin se Koçi nuk ishte i vendosur në mendimet e tij, se ai ishte i lidhur pak me punën. Kjo çështje u hap një natë përpara mbledhjes. Ishim unë Liria dhe Baca. U shtrua çështja se kush do të kryente detyrën e personelit.*⁵⁸² *Këtë detyrë i binte ta kryente Koçi, por unë kisha mendimin se a do ta bënte dot. Por, meqenëse ai ishte sekretar organizativ, duhej ta bënte dhe ta ndihmonte Liria. Liria nuk pranonte në këtë mënyrë. Ose ta bëj vetë këtë, thoshte, ose të gjejmë ndonjë solucion tjetër.*” Kështu, klika e Enverit brenda partisë kishte kryer një takim paraprak,

⁵⁷⁵ Demir Dyrmishi, “*Studime Historike*”, Instituti i Historisë, Akademia e Shkencave e Republikës së Shqipërisë, Tiranë, 2003, faqe 82.

⁵⁷⁶ *Po aty*.

⁵⁷⁷ *Po aty*, f.83.

⁵⁷⁸ *Po aty*.

⁵⁷⁹ K.Myftaraj, *Jeta e Fshehur e Enver Hoxhës...*, f. 451.

⁵⁸⁰ *Po aty*, f. 452.

⁵⁸¹ *Po aty*, f. 442.

⁵⁸² *Po aty*, f. 443.

duke menduar që Liri Gega të zinte postin numër dy në parti, atë të sekretarit organizativ të partisë, të cilin deri tani e mbante Koçi Xoxe. Ky pozicion ishte mjaft i rëndësishëm, pasi mbajtësi i tij ishte edhe drejtor i Drejtorisë së Mbrojtjes së Popullit, organ paraardhës i Sigurimit të Shtetit. Megjithatë, në Plenumin e Beratit, Enver Hoxha do të shprehej: “*Liria kërkoi që kjo çështje të diskutohej e të vendosej. Unë atëherë thashë që për këtë të mblihdhim Byronë, ku të diskutojmë dhe të vendosim. E bëmë mbledhjen e Byrosë. Nakoja dhe Koçi qëndrojnë në njërën anë, Liria dhe Baca në anën tjetër. Unë mora anën e Nakos dhe të Koçit, duke thënë se kjo ishte një çështje me rëndësi, se atë duhej ta kryente Koçi, por ai të kishte kujdes*”.⁵⁸³ Megjithatë, kur Koçi u fut në burg, “puna kryhej prej Miladinit, Enverit dhe Liri Gegës dhe mbas daljes së tij nga burgu, ku nuk aktivizohet, punën e tij e bënte Liri Gega”.⁵⁸⁴ Më vonë, ai do të shprehej në lidhje me Lirinë, se “ajo kishte dëmtuar konspiracionin e partisë”.⁵⁸⁵

Nga fillimi i vitit 1948, Enver Hoxha e kishte kuptuar se pakënaqësitë e tij dhe hapat e ndërmarra nga jugosllavët e kishin përkeqësuar pozitën e tij; kësisoj, udhëtoi drejt Moskës, çka bëri që Tito dhe Xoxe t’i dyfishonin përpjekjet për fajësimin e tij. Në mars ngjarjet kishin mbërritur në një pikë të atillë sa Enver Hoxha u detyrua të pranonte gabimet e bëra. Sikur të mos kishte ndodhur prishja midis sovjetikëve dhe jugosllavëve, gjë që jo vetëm i shpëtoi jetën atij vetë, por edhe pavarësinë e Shqipërisë, Enver Hoxha me siguri që kishte për të përfunduar para ndonjëres prej skuadrave të pushkatimit të Koçi Xoxes. Pa humbur kohë, ai i prishi të gjitha marrëveshjet ekonomike që kishte me jugosllavët dhe ndërmori një fushatë të ashpër kundër Jugosllavisë, e cila praktikisht do të zgjaste deri në fund të sundimit të tij.

Në Plenumin V të KQ, Enver Hoxha shprehu druajtjen e tij se “*disa punonjës të KQ, të Byrosë Politike (Koçi Xoxe) dhe Komisioni i Kuadrove, duke qenë punonjës besnikë të partisë, nuk e marrin parasysh gjithë seriozitetin e gjendjes që është krijuar brenda partisë, nuk i kushtonte vëmendje antagonizmit që po lind madje mes anëtarëve të veçantë të Byrosë Politike (Koçi Xoxes dhe Nako Spiros)*”. Lidhur me këtë çështje, Enver Hoxha theksoi se dyshon lidhur me frytshmërinë e vizitës së Koçi Xoxes në Moskë, meqenëse, sipas tij, ai nuk është krejtësisht i përgatitur për t’i paraqitur PKJ një tablo të plotë se si qëndrojnë punët tani në Shqipëri dhe në Partinë Komuniste të Shqipërisë, si edhe për të përcaktuar detyrat e saj të menjëhershme.

Kjo dëshmon sërish se marrëdhëniet brenda Byrosë Politike e sidomos mes Enver Hoxhës dhe Koçi Xoxes nuk ishin krejt të shëndosha. “Enver Hoxha trembej se në

⁵⁸³ *Po aty*, f. 444.

⁵⁸⁴ *Marrëdhëniet Shqiptaro Jugosllave...*, f. 325.

⁵⁸⁵ *AQSH*, Fondi 14, Dosja Nr. 2, viti 1944, fl. 79.

kongresin e partisë që do të pasonte”⁵⁸⁶Koçi Xoxe do të mundte të përgatiste kundër tij një diskutim përkatës, “*duke shfrytëzuar me këtë rast vendimet e Konferencës së Beratit dhe, kësisoj, t’i forcojë edhe më shumë pozitat e veta në parti*”.⁵⁸⁷Hoxha i bëri të ditur Titos se disa nga përfaqësuesit e PKJ dhe sidomos Velimir Stojniçi kanë bërë shumë gabime, si “mënjanimin faktik të Enver Hoxhës nga drejtimi i partisë pas Konferencës së Beratit, përfshirja në Byronë Politike e oportunistit Sejfulla Malëshova dhe përkrahja e mëvonshme e tij nga ana e Stojniçit, përfshirja në Byronë Politike e disa njerëzve të paaftë për punë, si dhe disa gabime të tjera”.⁵⁸⁸ Sipas Hoxhës, Titoja i kishte deklaruar se Koçi Xoxja duhet t’i kuptonte këto gjëra dhe në KQ të merret vetëm me çështje organizative dhe të mos bëjë kurrfarë politike. Megjithatë, ai duhet “të paraqitej në Beograd për t’u njohur me metodat e punës së Sekretarit Organizativ të Partisë Komuniste të Jugosllavisë”.⁵⁸⁹

Pavarësisht nga fakti, ai njofton Koçi Xoxe se sektarizmi, fryma e grupit dhe tendencat kanë qenë të pranishme në partinë komuniste. “Megjithëse në shumë drejtime janë shmangur, prapëseprapë, deri tani, uniteti i vërtetë në udhëheqjen e partisë komuniste nuk ekziston”.⁵⁹⁰Koçi Xoxe nuk përkrahte qëndrimin pro-imperialist ndaj amerikanëve dhe anglezëve, të cilët paraqisnin rrezik për partinë. Për më tepër, detyra e ndërtimit të socializmit në Shqipëri nuk është bërë themeli i vijës së përgjithshme të partisë për shkak të anëtarëve të Byrosë Politike, si Sejfulla Malëshova dhe të tjerë që mendonin se “*Spastrimi i ardhshëm i partisë, sipas mendimit të udhëheqjes së KQ, do të ndihmojë për të shpëtuar nga elementë të paqëndrueshëm dhe do ta forcojë unitetin dhe disiplinën e partisë*”.⁵⁹¹

Me prishjen e marrëdhënieve shqiptaro-jugosllave, Komiteti Qendror i Partisë Komuniste Shqiptare informoi edhe komitetet qarkore nëpërmjet dërgimit të proces verbaleve. Kështu, më 1948-n, iu dërgua një procesverbal aktivëve të rretheve “për punimin e rezolucionit të Byrosë Informative të partive komuniste e punëtore mbi tradhtinë e Partisë Komuniste Jugosllave”.⁵⁹² Në komitetet qarkore më pas u organizua një sërë takimesh për punimin e kësaj rezolute. Ndër to spikat ai i organizuar në Korçë me pjesëmarrjen e sekretarit organizativ, Koçi Xoxe, i cili e shpjegon kështu tradhtinë e Partisë Komuniste Jugosllave: “*Udhëheqësit e Partisë Komuniste Jugosllave kanë dalë nga rruga socialiste me në krye Titon, dhe janë hedhur kundër Bashkimit Sovjetik, ushtrisë së tij, udhëheqësve të Partisë Bolshevike dhe kampit demokratik, devijime këto që çojnë në*

⁵⁸⁶**Shënim:** Edhe pse Pleniumi i V i KQ mori vendimin për thirrjen e Kongresit të Parë të Partisë më 25 maj 1946, për shkak të luftës politike ai u shty deri në nëntor të vitit 1948. **Shih:** *Shqipëria në dokumentat ruse...*, përgatitën I. Lauka dhe E. Ymeri, f. 118.

⁵⁸⁷*Shqipëria në dokumentat ruse...*, përgatitën I. Lauka dhe E. Ymeri, f. 119- 120.

⁵⁸⁸*Po aty*, f. 125.

⁵⁸⁹*Po aty*, f. 126.

⁵⁹⁰*Po aty*, f. 131.

⁵⁹¹*Shqipëria në dokumentat ruse...*, përgatitën I. Lauka dhe E. Ymeri, f. 132.

⁵⁹²*AQSH, AKQ/PKSH, Fondi Nr. 14, Dosje Nr. 70, viti 1948, fl. 1.*

arsenalin e imperializmit".⁵⁹³ Tito dhe Jugosllavia kërkonin të dilnin mbi Bashkimin Sovjetik dhe të bëheshin forca kryesore në Ballkan. Sipas deklaratës së Xoxes, qëllimet të cilat e nxitën tradhtinë e Partisë Komuniste Jugosllave, ishin "të diskreditohej Bashkimi Sovjetik, të shkurorëzohej ndërtimi i socializmit dhe të nxirret Jugosllavia si e vetme për ndërtimin e socializmit".⁵⁹⁴ Gjithashtu, në gjysmën e dytë të vitit 1948, Komiteti Qendror nisi dërgimin e telegrameve për organizimin e mbledhjeve me anëtarët e komuniteteve qarkore lidhur me veprimet dhe mendimet e Koçi Xoxes që binin në kundërshtim me ato të Partisë dhe udhëheqësit të saj Enver Hoxha, si dhe me pyetje si "*Cilat ishin arsytet që i shtynë Koçin dhe Pandin të vepronin në atë mënyrë? A kishte Koçi qëllim t'i zinte vendin Enverit? Përse kishte kaq besim të madh te Jugosllavia?*"⁵⁹⁵ Anëtarët e partisë ishin të mendimit se Koçi dhe Pandi u përdorën nga jugosllavët për qëllimet e tyre në Shqipëri, si edhe për të përçarë udhëheqjen komuniste shqiptare. Për sa i përket dëmtimit të udhëheqjes së vendit dhe besimit të Hoxha, përgjithësisht mbizotëronte mendimi që ishin Koçi, Nako, Pandi, Liri Gega dhe Baca, ata të cilët u përfshinë në një gjë të tillë. Për më tepër, "një pjesë e anëtarëve të partisë shpreheshin të zhgënjyer me masën aq të lehtë që fillimisht u mor për Pandin dhe Koçin".⁵⁹⁶

Në rrëfimet e tij, shkrimtari Petro Marko shkruan: "*Kur u largova nga zyrat e qeverisë, që ishin në sarajet e Vrionasve, Koçi doli bashkë me mua dhe rrugës po bisedonim. Më tha: 'S'kemi ç'bëjmë, o Petro! Na janë futur kontrabandë në Parti ca vagabondë dhe të poshtër'. E pyeta se si ishte e mundur dhe cilët ishin ata. 'Ja, për shembull, ai që pe ti, Enver Hoxha, një njeri i dyshimtë, më tepër nga ana politike, që nuk ka qenë më parë komunist. Se si arriti të jetë në krye të këtyre punëve, një Zot e di!' Unë i thashë se nuk e njihja, por kisha dëgjuar për të që në Francë, dhe se duhej parë çështja e këtyre lloj njerëzve në parti*".⁵⁹⁷

4.2 Gjyqi i Koçi Xoxes

Me mbarimin e Luftës së Dytë Botërore, pas një periudhe disavjeçare dashurie, varësie dhe bashkëpunimi midis Partisë Komuniste Shqiptare dhe asaj jugosllave, marrëdhëniet midis këtyre dy vendeve nisën të ftoheshin. Kështu, në vitin 1948 vjen divorci i tyre, por që do të merrte nga pas edhe viktimat e tij të para. Njëri prej tyre ishte Koçi Xoxe, ai që u vendos në krye të grupit të Gjyqit Special e që do të gjykonin të gjithë ata që u cilësuan kriminelë të Luftës në vitet 1945-1948 si kundërshtarë të pushtetit. Si kryetar i këtij Grupi Special, ai ishte mbikëqyrës i gjithë seancave gjyqësore ku, bashkë me

⁵⁹³ *Po aty*, fl. 76.

⁵⁹⁴ *Po aty*, fl. 78.

⁵⁹⁵ *AQSH*, AKQ/PKSH, Fondi 14, Dosje Nr. 76, viti 1948, fl. 1.

⁵⁹⁶ *Po aty*, fl. 2.

⁵⁹⁷ Gazeta Telegraf, "*Prapaskenat e Luftës Nacional-Çlirimtare, ja pse Koçi Xoxe urrente Enverin*", Dossier, datë 23 dhjetor 2019. Marrë nga: , <https://telegraf.al/dossier/398356/>

Prokurorin e Përgjithshëm, Bedri Spahiu, si dhe porositë e Enver Hoxhës, dhanë dënimet më të rënda për shumë persona. I konsoliduar si njeriu më i besuar i Enver Hoxhës dhe bashkëpunëtori më i ngushtë i tij, me një pushtet politik absolut, Koçi Xoxe kishte qenë në marrëdhënie tepër të mira edhe me jugosllavët. Por prishja e marrëdhënieve me jugosllavët pati efekt edhe te marrëdhëniet e Enver Hoxhës me Koçi Xoxen. Nuk vonoi shumë dhe ai u sulmua e u etiketua nga Hoxha dhe klika e tij drejtuese si një agjent me rrezikshmëri të lartë e që kishte devijuar nga ajo që quhej “vija e Partisë”. Sulmin ndaj gjenerallejtnant Koçi Xoxe, bashkëpunëtorit të tij më të afërt, një ndër ushtarakët më të lartë, Enver Hoxha e filloi në prag të Kongresit të Parë të PKSh-së. Më 12 maj 1949 filluan procedurat e gjyqimit të Koçi Xoxes, si ministër i Brendshëm në atë kohë. Po ashtu, kjo periudhë shënoi edhe fillimin e gjyqeve të “shfaqjes” staliniste të pasluftës, siç do i quante autori George Hodos.

Gjyqi i Xoxes dhe ndjekësve të tij u realizua në një fshehtësi të madhe në Partinë Komuniste Shqiptare. Në plan më të gjerë, “ekzekutimi i Koçi Xoxes, si njeriu më i besuar i Jugosllavisë (titist i pastër)”⁵⁹⁸, i përket tërësinë së spastrimeve të ndërmarra në Europën Lindore. Gjithashtu, ekzekutimi i tij ishte një tregues në kulmin e acarimit të marrëdhënieve sovjeto-jugosllave. Në kujtimet e ambasadorit rus Çuvahin përmendet se “Vetëm pas procesit gjyqësor ndaj Xoxes, atij i veshën tiparet e komplotistit, tradhtarit dhe agjentit direkt të Titos, kurse fjala ‘politika pro-jugosllave’ tingëllonte si sinonim i anti-sovjetizmit. Në korrik-gusht situata ishte krejt ndryshe. Nuk ishte tjetërkush veç Koçi Xoxes që nënshkroi të parin dokument të KQ të PKSh për mbështetjen pa diskutim të Rezolucionit të Byrosë Informative. Ishin gjerësisht të njohura simpatitë e tij për BRSS, përpjekjet për bashkëpunim me komunistët sovjetikë. Duke qenë Sekretar Organizativ i KQ të PKSh, gjatë vitit 1947 ai ishte konsultuar me KQ të PK të BS për problemet e ndërtimit të partisë, përgatitjes së Kongresit, përpunimin e statutit për politikën e kuadrit dhe ndërtimin e ushtrisë”.⁵⁹⁹Në strukturën themelore, gjyqi i Xoxes është një kopje e pastrimeve klasike staliniste të pas luftës të viteve 30 të shekullit XX, të transferuar në një vend ballkanik. Platforma ideologjike që ai përfaqësoi ishte falsifikuar në spiunazh, tradhti dhe sabotim, aspekt në të cilin “fati i Xoxes nuk ndryshonte nga ai i Bukharinit dhe viktimave të tjera të gjyqeve “trockiste” në Bashkimin Sovjetik. Ai ishte kundër Stalinit në Shqipëri dhe humbi. Gjyqi Xoxe i përket qartë llojit klasik”.⁶⁰⁰ Gjyqi shqiptar, në të njëjtën kohë është një urë lidhëse midis spastrimeve të vjetra dhe atyre të reja, e lidhur nga përmbajtja specifike anti Tito e gënjeshtreve dhe shtrembërimeve. Gjyqi i Koçi Xoxes ishte sekret dhe me dyer të mbyllura. Në një letër drejtuar Enver Hoxhës dhe përfaqësuesit sovjetik Cuvakin, gjatë periudhës së hetuesisë, Koçi Xoxe mbrohet me fjalët se, “Unë vetë, kur dëgjoj sot, më vjen të pëlças nga torturat e bëra dhe, nga shumë metoda të turpshme e të poshtra të ngrihet

⁵⁹⁸ George H. Hodos, “*Show trials, Stalinist Purges in Eastern Europe, 1948-1954*”, Praeger Publishers, New York, 1987, f.10. Marrë nga: <https://books.google.al>

⁵⁹⁹D.S.Cuvahin, “*Shërbimi im diplomatik në Shqipëri*”, Tiranë, Botimet: Almera, 2009, f.88

⁶⁰⁰ Po aty.

leshhtë e kokës”.⁶⁰¹ Por a është përgjegjës Koçi Xoxe për terrorin e egër komunist që ndodhi gjatë viteve 1945-1948, kur ai ishte në postin e ministrit të Brendshëm e ku u eliminuan apo u zhdukën fizikisht një pjesë e madhe e bashkëpunëtorëve të ngushtë të Hoxhës, pa përmendur këtu kundërshtarët e krahut tjetër politik, apo Xoxe ka qenë thjesht një zbatues i bindur i shefit të tij në të gjithë ato krime?

Roli i Koçi Xoxes në organizimin e veprimtarisë së Partisë Komuniste Shqiptare dhe Frontit Nacionalçlirimtar ishte i rëndësishëm. Ai fillon që prej themelimit të saj dhe vazhdon në rritje, deri në kohën e eliminimit të tij. Në Kongresin e parë të Frontit Nacionalçlirimtar, që u mbajt më 5 gusht 1945, “Koçi Xoxe u emërua pjesë e Sekretariatit të Frontit Demokratik në pozicionin e nënpresidentit. Po ashtu, ai mbante gradën e gjenerallejtënant”.⁶⁰² Në një prej referateve të mbajtura prej tij, ai trajtoi dy çështje me rëndësi, atë të frontit dhe punën e organizatave të partisë. Për sa i përket Frontit, Xoxe e trajton si një mënyrë për të përfunduar pushtetin e partisë, si edhe për të izoluar borgjezinë dhe të gjitha grupet e ngritura kundër Luftës Nacionalçlirimtare. Koçi Xoxe afirmonte kështu kahun “*proletar*” të udhëheqjes komuniste të asaj kohe. “Sipas mendimit të Koçi Xoxes, zgjedhjet për në organet e Frontit Demokratik u zhvilluan në një mënyrë të organizuar, përqindja e pjesëmarrjes në to, në zona të veçanta arrinte deri në 95 dhe 100%, dhe se “*fituan*” kandidatët që kishte caktuar udhëheqja.”⁶⁰³

Që nga momenti i anëtarësimit të tij në Parti dhe emërtimit në postin e Sekretarit Organizativ, “Koçi Xoxe kishte mbajtur komunikim dhe bashkëpunim të vazhdueshëm me të gjithë anëtarët dhe mbështetësit e partisë”.⁶⁰⁴ “Komunikimi i tij nuk ka qenë vetëm me anëtarët e partisë të angazhuar në vend, por edhe me të batalioneve që ishin dërguar në Jugosllavi për të luftuar përkrah Ushtrisë së Kuqe të udhëhequr nga Stalini.”⁶⁰⁵ Në një nga komunikimet e Dhori Panaritit për kryesinë e partisë të bërë në lidhje me një mbledhje të celulës të mbajtur më 24 maj 1945, Koçi Xoxe është përshkruar kështu: “*Ka kulturë. I plogësht. Pak timid. I arsyetueshëm. Ecën përpara*”.⁶⁰⁶ Sipas letrave të këmbyerë me Hysni Kapon, Koçi Xoxe ishte mjaft i angazhuar dhe i interesuar për sa i përket trajtimit të Shqipërisë në kongreset jashtë vendi. Një gjë e tillë mund të konfirmohet edhe në komunikimin më poshtë: “*Përpiqu që me anën e jugosllavëve të na informosh rreth delegacionit tonë në Londër. Çfarë bëhet atje? Të mbahet kontakt nëpërmjet tyre me ata, se ne s’kemi asnjë informatë ç’bëhet qoftë në Kongres, qoftë për çështje të tjera. Bëj çmos që të marrësh kontakt*”. Më tej angazhimi i Xoxes në lidhje me situatën e brendshme të vendit dhe, në mënyrë specifike në lidhje me gjendjen e komiteteve qarkore të PKSh, konfirmohet nga një letër që ai iu dërgon këtyre të fundit më 23 gusht 1945: “*Para disa*

⁶⁰¹ Bashkim Shehu, “*Liri Belishova dhe koha e saj*”, Tiranë, Botimet: UET, 2020, f. 90

⁶⁰² AQSH, AKQ/PKSH, Fondi 14, Dosje Nr. 9, viti 1945, fl. 38.

⁶⁰³ *Shqipëria në dokumentat ruse...*, përgatitën I. Lauka dhe E. Ymeri, f. 139.

⁶⁰⁴ AQSH, AKQ/PKSH, Fondi 14, Dosje Nr. 92, viti 1945, fl. 1.

⁶⁰⁵ *Po aty*, fl. 2.

⁶⁰⁶ *Po aty*, fl. 9.

kohe iu janë dërguar nga pushteti formularët me hollësira për dëmet e luftës që na janë bërë nga italianët dhe gjermanët dhe jeni të urdhëruar që të formoni komisionet për të marrë në shqyrtim këtë; nuk dimë ç'është bërë, por fakti është se gjer më sot nuk ka asgjë konkrete mbi këtë çështje me kaq rëndësi të madhe politike e ekonomike për vendin tonë e veçanërisht në këto momente që bëhet Konferenca e Londrës e që do të shihet çështja e Italisë... Kërkonti ndihma nga çdo anë, pushtet, ushtri etj., edhe njerëz mund të lënë punën, por kjo do mbarohet brenda afatit në mos më parë. Pritet përfundimi e këtu do të njihet kujdesi juaj”.⁶⁰⁷ Kjo kërkesë e Xoxës u prit me shumë gatishmëri nga ana e kryetarëve të qarkoreve, të cilët nuk ngurruan të angazhoheshin në plotësimin e formularëve brenda afatit të vendosur prej tij. “Kjo gjë verifikohet në korrespondencat ndërmjet Xoxes dhe kryetarëve të qarkoreve të PKSh”.⁶⁰⁸

Për sa i përket rolit dhe qëndrimit të Koçi Xoxes në radhët e Partisë, ato shpeshherë bëheshin motiv për mosmarrëveshje dhe konflikte. Në një letër drejtuar Komitetit Qendror të Partisë, Koçi Xoxe përshkruhet kështu: “Shoku Koçi, i cili në cilësinë e një ministri mendon që të gjitha vendimet duhet t’i marrë ai dhe pjesa tjetër duhet thjesht t’i plotësojë ato, një tjetër aspekt në të cilin mendimet e anëtarëve të legatës dhe shokut Koçi binin në kundërshtim, ishte mbi organizimin e mbledhjeve, si edhe për sa i përket pjesëmarrjes në mbledhje të atasheut ushtarak”.⁶⁰⁹ Megjithatë, në sytë e jugosllavëve, Koçi Xoxe ishte më racional dhe më i besueshëm. Këtë e konfirmon dhe Svetozar Vukmanovic Tempo. Pas takimit me drejtuesit e Partisë Komuniste Shqiptare, Tempos i bëri përshtypje se, pavarësisht ndarjes tradicionale të udhëheqësve të partisë në “intelektualë”, ku përfshiheshin mes të tjerëve Mehmet Shehu dhe Sejfulla Malëshova, dhe në “punëtorë”, ku përfshiheshin Koçi Xoxe dhe të tjerë, në udhëheqje ishin pothuajse të gjithë intelektualë dhe nuk kishte punëtorë. Vlerësimi me superlativa për Koçi Xoxen nga ana e jugosllavëve vihet re edhe në takimin e jugosllavëve me Stalinin, në maj të 1946-s, ku sipas dokumentit jugosllav thuhet se “shokët e Byrosë Politike nuk e konsiderojnë Enver Hoxhën njeri me partishmëri fort të mjaftueshme dhe prandaj gjithnjë ngulin këmbë që me atë të vijë Koçi Xoxe, si anëtari më i vjetër i partisë në Byronë Politike”.⁶¹⁰

Roli i Koçi Xoxes në organizimin e punëve të partisë dhe në mënyrë të veçantë në lidhje me politikën e saj të jashtme ishte i rëndësishëm. Nëse iu referohemi korrespondencave që përfaqësues të Jugosllavisë kanë pasur me qeverinë shqiptare dhe PKSh, emri më i përmendur, për të mos thënë i vetmi është ai i Xoxes; një gjë e tillë “mund të konfirmohet edhe në korrespondencat që Xoxe pati me përfaqësuesit e Ministrisë së Jashtme të Jugosllavisë gjatë vitit 1947, Rankoviç, Markos etj.”⁶¹¹ Të pasurit e një kontrolli të tillë mbi të gjitha çështjet e marrëdhënieve dhe politikës së jashtme i lejoi Xoxes edhe

⁶⁰⁷AQSH, AKQ/PKSH, Fondi Nr. 14, Dosje Nr. 133, viti 1945, fl. 1.

⁶⁰⁸Po aty, Fondi Nr. 14, Dosje Nr. 92, viti 1945.

⁶⁰⁹Po aty, Fondi Nr. 14, Dosje Nr. 52, viti 1946, fl. 9.

⁶¹⁰Shqipëria dhe Kosova në arkivat ruse..., përgatitën H. Kaba dhe E. Çeku, f. 27.

⁶¹¹AQSH, AKQ/PKSH, Fondi Nr. 14, Dosja Nr. 1, viti 1947.

mundësinë e krijimit të marrëdhënieve të fshehura ose, thënë në një mënyrë më të qartë e të drejtpërdrejtë, i lejoi mundësinë të krijonte kontakte personale dhe t'i zhvillonte ato edhe për qëllime që ishin në kundërshtim me parimet e Partisë Komuniste Shqiptare dhe udhëheqësve të saj. Ndër korrespondencat me persona të shumtë nga përfaqësuesit jugosllavë, spikat emri i Rankoviç, me të cilin Xoxe ka pasur një komunikim dhe bashkëpunim të vazhdueshëm gjatë vitit 1946. Njëpërmjet këtyre letërkëmbimeve, “Rankoviç e mban Xoxen të informuar mbi zhvillimet në Jugosllavi, mbi ligjet, gjendjen dhe trajtimin e gjeneralëve, oficerëve, admiralëve, armatës jugosllave etj.”⁶¹² Komunikimi ndërmjet Rankoviç dhe Xoxes vazhdon, përsëri në muajin prill ai e njofton Xoxen në lidhje me ndryshimet e bëra në misionin e UNRRA-s në Shqipëri dhe në maj të 1946, në radiogramin pasardhës e njofton mbi vizitën e Vllakoviç në Shqipëri dhe përgatitjen e tij të madhe në lidhje me organizimin e punëve të partisë⁶¹³. Letërkëmbimet e Koçi Xoxes, me përfaqësuesit jugosllavë, vazhduan edhe gjatë vitit 1947⁶¹⁴.

Përveç jugosllavëve, “Koçi Xoxen e mbanin të informuar edhe shqiptarët që ndodheshin në Jugosllavi.”⁶¹⁵ Nako Spiro ishte një prej personave më të angazhuar në lidhje me punët e qeverisë shqiptare në Jugosllavi, pasi letërkëmbimet e tij nuk kanë qenë vetëm me Koçi Xoxen, por edhe të drejtpërdrejta me Enver Hoxhën. Në një prej këtyre letrave trajtohet edhe një prej tri pikave të Konventës Ekonomike me Jugosllavinë, ajo e parifikimit. Nako Spiro në këtë letër shpreh edhe mendimin e tij, që “parifikimi, domethënë barazimi i vlerës së lekut me dinarin, do të ishte i zorshëm, pasi një gjë e tillë duhej të ndodhte vetëm nëse, ose kur të gjallërohej ekonomia shqiptare”.⁶¹⁶ Ndaj PKSh, që nga viti 1948 filluan të lindnin dhe të shfaqeshin pakënaqësitë e para ndaj punës së saj. Një gjë e tillë mund të konfirmohet edhe nga një letër në të cilën “janë paraqitur disa prej parullave kryesore të nxjerra nga elementët që kundërshtonin punën e Partisë”.⁶¹⁷ Në mesin e këtyre letrave dhe parullave të partisë spikat edhe një letër, në lidhje me largimin e Koçi Xoxes nga Partia Komuniste, dhe heqjen e tij nga posti i ministrit të Punëve të Brendshme. Në këto parullat thuhet që “Koçi Xoxe hoqi dorë nga Partia, pasi nuk mund të plotësonte dot nevojat e popullit dhe devijoi nga rruga e partisë; ai ankohej në mënyrë që të rregullohej puna e popullit”.⁶¹⁸

Por tashmë le të analizojmë akuzat e Enver Hoxhës mbi aktivitetin e Koçi Xoxes, të cilin Enver Hoxha e analizon me detaje në çdo mbledhje të fundit të Byrosë Politike, nga ku jo vetëm Enveri, por edhe çdo anëtar i byrosë bëri akuzat dhe kritikën e tij, së bashku me rreth 84 letra, ku kërkoheshin sqarime të mëtejshme nga vetë Koçi për ato që kishte

⁶¹²AQSH, AKQ/PKSH, Fondi Nr. 14, Dosje Nr. 7, viti 1946, fl. 8.

⁶¹³Po aty, fl. 16.

⁶¹⁴Po aty, Fondi 14, Dosje Nr. 1, viti 1947.

⁶¹⁵Po aty, Fondi 14, Dosje Nr. 11, viti 1946, fl. 16, 17.

⁶¹⁶Po aty, Fondi 14, Dosje Nr. 12, viti 1946, fl. 12.

⁶¹⁷Po aty, Fondi 14, Dosje Nr. 118, vitit 1948, fl. 1.

⁶¹⁸Po aty, fl.175.

bërë. Enver Hoxha vuri në dukje marrëdhënien që Xoxe kishte me jugosllavët, si edhe mënyrën se si ai i raportonte Tempos në lidhje me zhvillimet e brendshme të PKSh. Për këtë arsye, edhe “Miladin Popoviç vendosi të largohej nga Shqipëria e të vinte Velimir Stojnić, i cili që në fillim gëzoi mbështetjen e Koçi Xoxes, si edhe zhvilloi Plenumin e Beratit”.⁶¹⁹ Në raportin e tij, Enver Hoxha shkruan se “*Goditja e vijës së drejtë të Partisë Kongresin e Parë të Partisë Komuniste të Shqipërisë mbi punën e Komitetit Qendror dhe detyrat e reja të partisë, u përgatit prapa krahëve nga ana e Velimir Stojnić, Koçi Xoxes, Nako Spiros, Pandi Kristos dhe Sejfulla Malëshovës. Goditja e Beratit ka pasur platformën e saj politike të diktuar nga përfaqësuesi jugosllav dhe të aprovuar plotësisht nga grupazhet me në krye Koçi Xoxen, Pandi Kriston, Nako Spiron dhe Sejfulla Malëshovën. Në takimet e tyre diskutohet se komandanti nuk ishte i zoti dhe nuk duhej të vazhdonte ta mbante më të njëjtin pozicion.*” Platforma politike e këtij grupazhi mbështetej në faktin se “gjatë periudhës së luftës ishin faktuar gabime të rënda principi në vijën e partisë, në të cilën ishte shfaqur sektarizëm dhe oportunizëm, kishte pasur punë personale dhe jo punë marksiste-leniniste. Sipas tyre, partia po merrte tiparet e një “*partie të degjeneruar banditësh e teoristësh*”,⁶²⁰ dhe të gjitha fajet për këtë binin mbi komandantin, i cili nuk meritonte të vazhdonte të qëndronte në të njëjtin post. Megjithatë, këto akuza cilësoheshin si të pabaza nga ana e Enver Hoxhës. Sipas tij, ndikimi i të ashtuquajturve “trockistë” jugosllavë ishte shumë i dukshëm te Koçi, i cili “kishte në program ta shndërronte shtetin popullor në një shtet policor dhe anti-demokratik, ku ligji të zëvendësohej me provokacionin, terrorin dhe plumbin”.⁶²¹

Enver Hoxha i akuzonte trockistët si sabotues të punëve të partisë, të cilët synonin goditjen e vijës së saj në të gjitha drejtimet, duke vënë nën kontroll jo vetëm partinë, por edhe Sigurimin dhe ushtrinë”.⁶²² Koçi Xoxe, si njëri prej përfaqësuesve të grupit nacionalist “trockist” të Titos, duke qenë dakord me pikëpamjet e Tempos, “binte në kundërshtim me vijën e Komitetit Qendror të mbrojtur nga Enver Hoxha dhe Miladin Popoviç”.⁶²³ Ky ishte një tregues i mungesës së unitetit në udhëheqje. Sipas Hoxhës, “*puna trockiste e Komitetit Central Jugosllav, që prej vitit 1944 e deri më 1947-n, ishte një punë armiqësore e egër e grupit trockist Tito, të ndihmuar me koshiencë nga Koçi Xoxe dhe Pandi Kristo, pas një pune imtësisht të përgatitur brenda në partinë tonë dhe, në komitetin central dhe në Byronë Politike të saj, e arriti kulmin në Plenumin VIII të Komitetit tonë Central*”.⁶²⁴ Sipas Hoxhës, Komiteti Qendror i Jugosllavisë, nëpërmjet asistencës së Koçi Xoxes dhe Pandi Kristos, kërkonin të dëmtonin përfundimisht pavarësinë e vendit. “Enver Hoxha tregonte

⁶¹⁹ Enver Hoxha, *Raport në Kongresin e Parë të Partisë Komuniste të Shqipërisë mbi punën e Komitetit Qendror dhe detyrat e reja të partisë*, Botim i Komitetit Qendror të Partisë së Punës së Shqipërisë, Tiranë, 1948, f. 238.

⁶²⁰ *Po aty*, f. 240.

⁶²¹ *Po aty*, f. 252.

⁶²² *Po aty*.

⁶²³ *Po aty*, f. 238.

⁶²⁴ *AQSH*, Fondi.14, Dosja Nr. 8.1, viti 1948, fl. 391.

se Titoja, duke shfrytëzuar besimin te Koçi Xoxe dhe Pandi Kristo, arriti deri aty sa ta akuzonte atë si shkaktar të prishjes së marrëdhënieve me Jugosllavinë dhe njëkohësisht shkaktar të përçarjes në Byro.”⁶²⁵. Sipas Enverit, grupi nacionalist trockist, i drejtuar nga Tito, ndërhyri thellë në punët e partisë, ndërhyrje që nisi me akuzat e Tempos kundër Komitetit Central të partisë për qëndrim oportunist kundrejt Ballit, me qëllim përçarjen e Partisë. Më vonë, në rezolucionin e Plenumit IX, u zbulua se “*ishte Koçi Xoxe, që e mbante të informuar Tempon, në lidhje me gjendjen e partisë*”.⁶²⁶ E gjithë puna oportuniste e bërë në prapaskenën e Beratit e kishte zanafillën te postet, sidomos të atij të sekretarit të përgjithshëm si edhe te ndërhyrja armiqësore e përfaqësuesit jugosllav. Megjithatë, në këtë përçarje është komentuar sikur edhe Koçi Xoxe ka dhënë kontributin e tij, madje në lidhje me Nako Spiron, i cili përfundoi në vetëvrasje, për të nxitur qëndrime të dyshimta tek Enver Hoxha, të cilit i ishte shprehur sikur Nako Spiro kishte thënë se, “*në rast se Enver Hoxha nuk iu bindet urdhrave tona, atëherë e bindim me kobure kresë*”.⁶²⁷ Sipas Enverit, “kjo është një nga sjelljet trockiste që shfaqte Koçi Xoxe”.⁶²⁸

Në lidhje me prapaskenat e Beratit, Enver Hoxha shprehet se Koçi Xoxe nuk kishte vepruar i vetëm, por bashkë me të kishte qenë edhe Pandi Kristo, të cilët kishin mbështetur veprën armiqësore të Velimir Stoiniçit. “Taktika e Pandi Kristos dhe Koçi Xoxes ishte të degjeneronin shokët e tjerë të Partisë, si Nako Spiron, Enver Hoxhën dhe Tuk Jakovën, me qëllim që të arrinin të realizonin idetë e tyre trockiste dhe të dëmtonin vijën e drejtë të partisë.”⁶²⁹ Koçi Xoxe, madje pak ditë pas vetëvrasjes së Nako Spiros, i kishte thënë sekretarit të përgjithshëm se “*Nako Spiro iu kishte shpënë në dorë jugosllavëve tezat e Enver Hoxhës, me qëllim që t’i bënte të kuptonin se si Hoxha atakon jugosllavët dhe Komitetin Qendror Jugosllav*”.⁶³⁰ Në momentin kur sekretari i përgjithshëm filloi të kuptonte se sa shumë ishte rënduar situata, propozoi zgjerimin e byrosë me anëtarë të rinj të sprovuar në luftë, me qëllim që të rivendoste qetësinë dhe unitetin brenda saj. Megjithatë, duke qenë se Koçi Xoxe dhe Pandi Kristo e shikonin si një dëmtim të pozitave të tyre, e kundërshtuan me forcë një gjë të tillë. Më tej, kur Byroja kërkoi nga Xoxe të raportonte në lidhje me punën organizative të Partisë, Xoxe u gjend përpara një momenti shumë të vështirë dhe u mundua në të gjitha format ta shmangte përgatitjen dhe prezantimin e këtij raporti. Me mbështetjen e trockistëve jugosllavë, “Xoxe dhe Kristo arritën të shmangnin raportimin për punën organizative, duke shmangur njëkohësisht edhe zbulimin e të gjitha veprave të tyre anti-partiake, anti-shqiptare dhe anti-ideologjike marksiste-leniniste, por me ndihmën e jugosllavëve ata arritën t’i diskreditonin anëtarët e partisë, të cilët mbronin vijën e drejtë rreth sekretarit të përgjithshëm të partisë, duke shpifur për Nako Spiron dhe Mehmet Shehun, për Berdri Spahiun dhe të eliminon Tuk Jakovën etj., për të përjashtuar

⁶²⁵Po aty, f. 395.

⁶²⁶Po aty, f. 399.

⁶²⁷ AQSH, Fondi 14, Dosja Nr. 8.1, viti 1948, faqe 402.

⁶²⁸Po aty.

⁶²⁹Po aty, fl. 403.

⁶³⁰Po aty.

mundësinë e zbulimit të tyre”.⁶³¹ Pandi Kristo dhe Koçi Xoxe e kishin krijuar me bindje dhe dijeni të plotë këtë situatë të turbullt në parti. Lidhur me ndërtimin dhe organizimin e punëve të partisë, “trockistët jugosllavë synonin të sillnin në udhëheqje Koçi Xoxen dhe Pandi Kriston”.⁶³²

Sipas pikëpamjes nxjerrë nga dokumentet e CIA-s, nuk kishte asnjë provë që Xoxe kishte kryer ndonjë veprim për të kryer një grusht shteti titist. Përkundrazi, ai vazhdoi të bënte referencat e tij të zakonshme për “*udhëheqësin e dashur Hoxha*”, në fjalimet e tij publike përgjatë gjithë periudhës dhe “për të intensifikuar fushatën anti-jugosllave”.⁶³³ Ndërsa provat nuk mbështesin domosdoshmërisht pretendimet e pas vitit 1948, se Xoxe ishte njeriu i Titos, ka pak dyshim se ndërhyrja e Moskës në Shqipëri më 1948-n ishte një faktor i madh në përcaktimin e fatit të tij. Meqenëse partia shqiptare ishte ushqyer dhe drejtuar nga Jugosllavia, ajo dhe drejtuesit e saj duhet të ishin të dyshuar në Moskë. Ndërsa ishte qartësisht anti-jugosllave dhe i ishte drejtuar Moskës për mbështetje, një udhëheqje e re do të duhej të grumbullohej për të siguruar besueshmërinë e saj afatgjatë, dhe kështu të pastroheshin dhe radhët e vjetra të partisë. Në marrjen e vendimeve nga ana e Hoxhës për dënimin e Xoxes, Moska mund të ketë qenë duke zgjedhur njeriun që e konsideronte më të dobëtin e të dyve, dhe që nuk mund të ishte i përshtatshëm për drejtimin e vendit. Mehmet Shehu mund të ketë qenë njeriu i zgjedhur nga Moska si shqiptari më i besueshëm dhe më i shoqërueshëm për të udhëhequr partinë. Kjo mund të shpjegojë promovimin e tij të papritur në pozicionin numër dy në parti. Ai kishte qenë komandant shumë i suksesshëm në luftën partizane dhe kishte studiuar në Akademinë Ushtarake (1945-‘46) në BRSS. Pas kthimit të tij ai u emërua Shef i Shtabit të Përgjithshëm, por para nëntorit 1948 kurrë nuk kishte mbajtur ndonjë pozitë në parti më të lartë se anëtar i Komitetit Qendror.

Tashmë le të analizojmë vetë-autokritikën dhe mendimet e Koçi Xoxes, kur deklaroi se do të zbulonte në kongresin e partisë lidhjet e veta me udhëheqësit trockistë të Partisë Komuniste Jugosllave, si gjatë kohës së punimeve të Plenumit të Beratit të KQ PKSh, të zhvilluar në tetor të vitit 1944, ashtu edhe në periudhën para atij Plenumi. Këtu Koçi Xoxe nuk harroi të thoshte se me trockistin jugosllavë Svetozar Vukmanoviç Tempo ai qe lidhur që në vitin 1943, dhe se ai ia pati vënë veshin me shumë kujdes gjithçkaje që thoshte Tempoja. Sipas fjalëve të Koçi Xoxes, ky i ka kallëzuar shumë gjëra Vukmanoviç Tempos për situatën në Partinë Komuniste të Shqipërisë, për veprimet e udhëheqësve të veçantë shqiptarë, për punën e gabuar, sipas fjalëve të tij, të përfaqësuesit të KQ të PKJ Miladin Popoviç. “*Pikërisht ajo kohë, çasti i njohjes sime të parë me Svetozar Vukmanoviç Tempon, - tha Koçi Xoxe, - duhet vlerësuar si fillim i tatëpjetës sime.*” Për më tepër, deklaroi Xoxe, “kritikat e Vukmanoviç vazhdova t’i përkrah, pavarësisht se ato

⁶³¹*Po aty*, fl. 404.

⁶³²*Po aty*, fl. 388.

⁶³³ Central Intelligence Agency, “*Current Intelligence Staff Study, Soviet-Albanian Relations, 1940-1960*”, ESAU XIX-62, 2007, f. 9. Marrë nga: <https://www.cia.gov/library/readingroom/docs/esau-19.pdf>.

kundërshtonin edhe Miladin Popoviç dhe Enverin”. Për Enverin ai kishte përkrahur kritika të bëra në lidhje me ndërhyrjet e tij të konsideruara të tepruara në punët e brendshme. “Kjo goditje, - shpjegon, - ai u shoqërua me dy pasoja të rëndësishme dhe negative, “*dobësimi i besimit tim tek Enveri dhe Miladini*”⁶³⁴, *si edhe rritja e besimit tim te Tempo Vukmanoviç dhe Partia Komuniste Jugosllave.*”⁶³⁵“Kritikat, për sa i përket shokut Enver, Miladinit dhe mënyrës se si ato i organizonin punët e partisë filluan të shtoheshin me kalimin e kohës, dhe unë ato nisa t’i diskutoja me Nako Spiron. Këto kritika bëheshin në lidhje me mënyrën se si Enveri, Miladini dhe Liri Gega në Veri po zhvillonin punët e partisë, pasi këta i bënë të gjitha punët bashkë dhe kishin besim vetëm te njëri-tjetri. Gabimi im qëndron që këto dyshime dhe kritika nuk i shtrova në Byro, por i diskutova në mënyrë konfidenciale me Nako Spiron. Kështu, me të drejtë Enveri në Plenumin XI na akuzoi për opozicion të heshtur”.⁶³⁵

Gjatë autokritikës së tij, Xoxe mundohet të argumentojë dhe t’i justifikojë veprimet e tij kundër Enver Hoxhës, duke thënë që “*është arrogante, se në partinë tonë ka drejtuar Miladini e të tjerë, dhe kurdoherë ata dhe ne ishim dakord, sëpata na binte në një vend. Ata e kishin drejtuar kritikën te Miladini dhe Enveri, edhe unë dhe shoku Nako e shokë të tjerë atje e kishim drejtuar*”. Në vazhdim të kësaj autokritike, ai shprehet që “*Unë e them sinqerisht para Partisë që nga delegatët jugosllavë nuk kam dëgjuar as nuk kam biseduar mbi çështjen se duhet hequr shoku Enver dhe duhet zëvendësuar me filan shokë ose me një shok tjetër. Çdo kritikë nga ana ime i ishte bërë shokut Enver si në pazotësi, si në gabime të rënda, dhe ata nuk kanë kursyer asgjë kundra shokut Enver. Është folur pas Beratit në mes nesh, Nako, Koçi dhe Pandi, që Enveri me gjithë këto gabime qëndroi përsëri Sekretar i Përgjithshëm i Partisë*”.⁶³⁶ Kritika e Xoxes ndaj Enverit mbështetet në “kritikën që delegati jugosllav Velmir Stojniç bëri për gabimet në Mukje, duke vënë në dukje sektarizmin, për mos plotësimin e direktivave të Komitetit plotësisht, si edhe kritika të tjera për pushtetin, ushtrinë dhe frontin. Kështu, u kritikua puna e “pa perspektivë” e Byrosë; mungesa e unitetit dhe bashkëpunimit; puna e Miladinit që kishte prerë iniciativën dhe shfaqej kudo, ndërsa Byroja dhe Komiteti Qendror nuk ndiheshin; përkrahja që i bënte Enverit, Lirisë dhe Bacës; gabimet e Enverit në lidhje me Miladinin dhe sektarizmin e Lirisë, si edhe për çështjen se çfarë jep Baca në Byro”.⁶³⁷ Pas Plenumit të Dytë të partisë, udhëheqja doli pa unitet në diskutimin e çështjeve të mësipërme dhe Sekretari i Përgjithshëm me një pozicion formal. E njëjta situatë vazhdoi edhe në Byronë Politike, ku u shfaqën edhe tentativa nga shokët e Byrosë, në mënyrë të veçantë nga Sejfulla Malëshova, Nako Spiro dhe vetë Xoxja, se kush do të ishte garancia në Byro. Xoxe u shpreh se “*Raportet e mia në Byro nuk kanë qenë të plota mbi çështjet organizative, për më tepër me karakter informativ. Veprime që duhet të merrej aprovimi i Byrosë ose i*

⁶³⁴AQSH, Fondi Nr.14, Dosje Nr. 9.1, viti 1948, fl. 2.

⁶³⁵Po aty, fl. 3.

⁶³⁶AQSH, Fondi Nr.14, Dosje Nr. 9.1, viti 1948, fl. 6.

⁶³⁷Po aty, fl. 7.

*Sekretarit të Përgjithshëm janë bërë me iniciativën time. Kjo metodë pune që unë praktikoj nga ky post me rëndësi të Partisë ka dëmtuar pikësëpari punën e Partisë, ka shkaktuar që puna në Byro të bëhet e keqe, vazhdimisht ka shkuar në dobësim e unitetit të Byrosë, të autoritetit të Sekretarit të Përgjithshëm, me shmangien nga kritika dhe autokritika dhe me një punë indipendente. Një gjë e tillë krijonte në Parti opinione të ndryshme se kush drejton, Enveri apo Koçi”.*⁶³⁸

Ndërmjet Koçit dhe Enverit ekzistonin mospërputhje, për sa i përket vlerësimit të çështjes së Beratit. Koçi dhe Nako u angazhuan në shqyrtimin e çështjeve organizative. Nga kjo platformë personale që ishte anti-partiake, jashtëzakonisht e rrezikshme, Xoxes i ishte krijuar mendimi i padrejtë, i pabazë, që këtë e ka bërë Enveri nën influencën e Nakos. Koçi u shpreh se ai “kishte pasur besim dhe e kishte respektuar Enverin, por në analizën e thellë të punëve ai kuptoi se ajo dashuri dhe respekt nuk ka të bëjë aspak me atë besim që duhej në njohjen e rolit drejtues tek Enveri në bashkëpunimin e plotë”.⁶³⁹ Gjatë autokritikës së tij, Koçi pohoi se, në bashkëpunim me Nakon dhe Pandin kishte punuar kundër partisë dhe parimeve marksiste-leniniste. Koçi tha se, “nën dritën e këtyre zhvillimeve ne kuptuam qëllimet e vërteta të udhëheqësve trockistë të Partisë Komuniste Jugosllave, në lidhje me Partinë tonë dhe mbi vendin tonë”.⁶⁴⁰ Sipas tij, qëllimet e jugosllavëve ishin kolonizuese, pasi ata mundoheshin të mbillnin në mesin e shqiptarëve një ndjenjë inferioriteti. Për më tepër, ata ishin përpjekur të ngulisin në mendjen e shqiptarëve idenë se Shqipëria nuk mund të mbijetojë pa mbështetjen e Jugosllavisë; nëpërmjet përdorimit të frazave marksiste kërkonin ta nënshtronin dhe shfrytëzonin Shqipërinë. Megjithatë, jo vetëm Shqipëria, por “edhe popuj të tjerë të Ballkanit u mashtruan nga përdorimi i marksizëm-leninizmit nga ana e Jugosllavisë, duke menduar që ajo ishte mbështetja më e madhe e Bashkimit Sovjetik”.⁶⁴¹ “Nën të njëjtat ndikime dhe presione, - shprehet Xoxe, - në analizën e organizimit të brendshëm e theksova akoma më tepër kritikën në fjalimin tim në Shkollën e Partisë.”⁶⁴² Gjithashtu, gjatë këtij fjalimi Koçi Xoxe shtroi edhe çështjen e vendosjes së Nako Spiros në drejtimin e Partisë, duke shpjeguar që ai është mbështetur tek Enver Hoxha dhe e ka influencuar atë. Gjatë autokritikës së tij, Koçi Xoxe shpjegoi dy faktorë, sipas të cilit kishin nxitur tek ai mendime të tilla. “Faktori kryesor ishte akuza jugosllave ndaj udhëheqësit të partisë; i të njëjtit mendim ishte edhe Nako Spiro, i cili mendonte që ata kishin qëllime të shkëpusnin lidhjet me Jugosllavinë. Ndërsa faktori i brendshëm, përsëri i lidhur me Nako Spiron, për të cilin Xoxja dhe Pandi mendonin që ai ka po të njëjtën sjellje në të gjitha drejtimet.”⁶⁴³

⁶³⁸Po aty, fl. 11.

⁶³⁹Po aty, fl. 15.

⁶⁴⁰Po aty, fl. 16.

⁶⁴¹AQSH, Fondi 14, Dosje Nr. 9.1, viti 1948, fl. 17.

⁶⁴²Po aty.

⁶⁴³AQSH, AOU, Fondi 14, Dosje Nr. 9.1, Viti 1948, fl. 20.

Sipas Xoxes, Nako Spiro filloi të shfaqte anën e tij oportuniste, duke shfrytëzuar rininë e Partisë për të forcuar pozitat e tij në Komitetin Qendror dhe në Byro. Kjo anë e tij u shfaq hapur kur ai propozoi për të anëtarësuar në komitet Ramiz Alinë, Niko Oparin dhe Fadil Paçramin. Në po të njëjtën kohë ai propozoi si anëtare byroje, Liri Gegën. Dyshime të tjera për Nako Spiron u krijuan në lidhje me vendosjen e kuadrit prej tij, si në sektorët e partisë, të ekonomisë dhe të shtetit, të cilat Xoxe i komenton si *“tendenca të thella për pushtet”*.⁶⁴⁴

Në një mbledhje të Byrosë së Komitetit Qendror, të mbajtur më 30 dhjetor 1947, e cila u drejtua nga Koçi Xoxe, ai nuk ngurroi të kritikonte veprimtarinë e partisë dhe sidomos të Nako Spiros, të cilën e konsideron si vepër armiku. Ai tha që vepra e tij mbetet e tillë, pavarësisht se arriti deri në vetëvrasje. Tiparet e fraksionit ekzistues e vendosin partinë para një lufte kundër borgjezisë, kundër armikut më të rëndësishëm të saj. *“Në këtë moment, kur kemi vënë nën këmbë armiqtë më të mëdhenj të partisë, duhet të jemi më të bashkuar dhe të vendosur se kurrë kundrejt tyre.”*⁶⁴⁵.

Në vazhdim të kësaj mbledhjeje, Xoxe nxori në pah edhe një herë rëndësinë që i atribuon Jugosllavisë dhe udhëheqësve të saj, duke thënë se ardhja e tyre në Shqipëri ishte e çmuar dhe duhej vlerësuar eksperiencia e tyre. Në po të njëjtën mbledhje, Xoxe dha mendimin e tij në lidhje me Liri Gegën, e cila, sipas tij, ishte *“kryetare e Partisë”*⁶⁴⁶. Gjithashtu, sipas Xoxes, ajo *“nuk kishte ndonjë aftësi të madhe, ajo “thjesht ishte e zonja të kopjonte”*.⁶⁴⁷ Më tej, ai vazhdoi mendimin e tij për Sejfulla Malëshovën, për kritikën e tij ndaj vijës së Partisë. Sipas Xoxes, *“ai u përfshi në punët e qeverisë pasi dëshironte të bëhej i plotfuqishëm”*.⁶⁴⁸ Po në këtë mbledhje, Koçi bëri një kritikë të përgjithshme pothuajse për të gjithë shokët e partisë, përfshirë edhe Enverin, duke nxjerrë në pah *“mangësitë në drejtimin e partisë, si dhe vlerësimin që Enveri kishte kundrejt shokëve”*.⁶⁴⁹ Koçi iu dha rëndësi dy prej çështjeve të trajtuara në atë mbledhje, *“rehabilitimin e Enverit dhe zgjerimin e Komitetit Qendror”*.⁶⁵⁰ Analiza e tij për shokët e partisë vazhdoi me Nakon, për të cilin thoshte që kishte arritur të krijonte një republikë sovjetike, duke u shkëputur nga Jugosllavia. Sipas tij, *“nuk mund të largoheshim në këtë mënyrë nga jugosllavët, duhej të kishim biseduar edhe me ata”*.⁶⁵¹ Për këtë ai shpjegon se e kishte diskutuar edhe me Enverin dhe se ai i kishte propozuar se ishte me rëndësi ta diskutonin në Byro. Në bisedimet me Enverin, Xoxe insistoi që çështja e Jugosllavisë të shtrohej për diskutim vetëm në planin ekonomik dhe jo politik. Megjithatë, gjatë kërkimeve të bëra me Enverin ata arritën të

⁶⁴⁴Po aty.

⁶⁴⁵AQSH, Fondi Nr.14, Dosje Nr. 52, viti 1947, fl. 204.

⁶⁴⁶Po aty, fl. 207.

⁶⁴⁷Po aty, fl. 208.

⁶⁴⁸AQSH, Fondi Nr.14, Dosje Nr. 52, viti 1947, fl. 208.

⁶⁴⁹Po aty, fl. 209.

⁶⁵⁰Po aty, fl. 212.

⁶⁵¹Po aty, fl. 213.

nxirrinn në dritë një sërë gjërash, sidomos për rolin e Nakos në këtë çështje. Ndër të tjera, ai shpjegon që “në takim e bërë me Enverin diskutuan pothuajse mbi të gjithë anëtarët e partisë dhe ‘qëndrimet e tyre në lidhje me vijën e partisë dhe të rinisë’”⁶⁵². Gjatë kësaj bisede, ai i vuri në dukje Enverit të gjitha rastet kur ka marrë vendime të gabuara, ose ka hequr dorë nga vendimmarrja. Ai përsëriti në mënyrë të vazhdueshme që në plenumet e partisë kur është diskutuar për anëtarësimet e reja apo edhe qëndrimet ndaj Jugosllavisë dhe Bashkimit Sovjetik, ata kishin pasur “mendime të kundërta”.⁶⁵³ Xoxegjithashtukomenton se “Nakodilte si avokat mbrojtës i mbeturinave të borgjezisë dhe armiqve të partisë. Ai nuk ishte angazhuar mjaftueshëm për forcimin e partisë, përbërjes së saj... Është e vërtetë që Nako jep mendimet e tij më të mira, por ky është një veprim krejt tendencioz... Në Plenumin V ai doli mbi Enverin, të njëjtën gjë bëri edhe Liri Belishova, duke bërë komente në revistën ‘Pararoja’ që të linin të kuptoje se ajo e kuptonte punën më mirë se Enveri”.⁶⁵⁴

Nako Spiro pati një mbështetje të madhe nga Mehmet Shehu, të cilin e kishin sjellë në parti vetëm për arsye ushtarake, pasi ai ishte ushtarak i mirë, por jo komunist i mirë. Sipas Xoxes, “ai shitej si komandant dhe sikur kishte gjithçka në dorë, gjithashtu mburrte edhe Nakon, të cilin e reklamonte te studentët e Partisë. Prandaj ai nuk duhej të ishte as në krye të ushtrisë”.⁶⁵⁵ Për një tjetër anëtar të PK, Xoxe u shpreh se në të “predominonte fryma anti-jugosllave, madje në Kongresin e Rinisë Ballkanike doli sikur ne ishim edhe më të përgatitur sesa jugosllavët”.⁶⁵⁶ Duke u referuar te mendimi i Xoxes për Nakon, ai thoshte se “Nako në punën e komitetit del si sekretar dhe të tjerët si shërbëtorët e tij. Ai iu jepte përshtypjen e raporteve të çrregullta midis Rinisë dhe Partisë, se cila drejton mirë dhe cila drejton keq, dhe një gjë e tillë nuk është e drejtë. Rinia nuk drejton shtetin, sindikatat, gruan, frontin, Partia po. Nëpërmjet një interpretimi të tillë ai ka dashur të mbështesë qëllimet e tij prej egoisti për të dalë në krye”.⁶⁵⁷ Në këtë mënyrë arrinte ta shpjegonte Xoxe prioritetin e Nakos. Në mbledhjen e radhës, të mbajtur në janar të 1948-s, në mënyrë të vazhduar “Koçi kritikoi Enverin, në lidhje me qëndrimin e tij ndaj problemeve dhe mangësive në mbarëvajtjen e punëve. Në të njëjtën kohë ai luajti edhe rolin e mbrojtësit të Enverit, kundrejt anëtarëve të tjerë të Partisë”.⁶⁵⁸

Qëndrimi i Nako Spiros, në lidhje me raportin dhe rëndësinë e Partisë kundrejt Rinisë u kritikua ashpër e me sulme nga ana e Koçi Xoxes, i cili shprehet se, “Thuhej që në manifestime duheshin nxjerrë fotot e Enverit, ndërsa gjetkë nëpër zyra mundet edhe

⁶⁵²Po aty, fl. 214.

⁶⁵³Po aty, fl. 215.

⁶⁵⁴Po aty, fl. 217.

⁶⁵⁵Po aty, fl. 222.

⁶⁵⁶Po aty, fl. 223.

⁶⁵⁷AQSH, Fondi Nr.14, Dosje Nr. 52, viti 1947, fl. 224.

⁶⁵⁸Po aty, fl. 237.

fotot e Nakos".⁶⁵⁹ Nëpërmjet kësaj ai donte të nxirrte në pah tendencën e Nako Spiros për të dalë mbi të gjithë, madje edhe mbi Enverin. Një tjetër aspekt i Nakos, i cili nga ana e Enverit dhe Koçit cilësohej shqetësues, ishte marrëdhënia e ngushtë me Lirinë, "*pasi ata pretendonin që punët e partisë duhet të ishin të ndara nga çështjet familjare*".⁶⁶⁰ Jo vetëm marrëdhënia me Lirinë, për Koçin dhe Enverin ishte e papranueshme, por edhe qëndrimi i tij kundrejt bashkëpunëtorëve jugosllavë, siç ishte Zlatiç, i dërguar nga Mareshali Tito, me kërkesë të Enverit për të asistuar në punët e Komitetit Qendror.

Ndërsa Enver Hoxha, kur bëhej fjalë për vëllain e tij të madh, mbështetësin e tij kryesor që e caktoi në krye të udhëheqjes shqiptare, shprehet se "Çështja e partisë zgjidhet kur të gjitha çështjet i shtrojmë mbi baza federative. Sekretar i përgjithshëm nuk jam unë, por Mareshali Tito. Ne jemi parti si partitë e republikave të tjera (të federatës jugosllave), me sekretarët e saj, me të njëjtën vijë me të tjerat". Lidhur me këtë, Koçi Xoxe, numri dy në pushtet, shprehu rezerva ndaj fjalëve të Hoxhës, duke u shprehur se "Marrëdhëniet ekonomike, kulturore, ushtarake etj., do të na çojnë si dy popuj drejt bashkimit, drejt socializmit. Për sa i përket formës, shtet federal ose tjetër, kjo është çështje tjetër. Kjo është çështje e Stalinit, e kampit anti-imperialist. Ne mund të propozojmë, kjo është e të gjithëve, është e Bullgarisë, e Hungarisë, e Jugosllavisë, e Titos". Dy udhëheqësit kryesorë të PKSh-së rivalizojnë mes tyre: kush e kush të jetë më servil ndaj Titos."⁶⁶¹ Në lidhje me çështjen e Beratit, Koçi dhe Enveri mendojnë që Nako ishte i pakënaqur, pasi pretendonte se Enveri ua kishte zënë vendin. Koçi më tej shton se "*Nako e shfrytëzoi këtë rast për të forcuar pozitën e tij*".⁶⁶² Sipas Koçit, të gjitha fajet për dëmtimin e unitetit të partisë, si edhe të udhëheqjes së saj bien mbi Nako Spiron dhe Sejfulla Malëshovën. Koçi tregon gjithashtu se Enveri ishte i influencuar nga ata e të tjerë. Më pas, me çështjen e Beratit u zbuluan edhe të gjitha këto "*prapaskena*".⁶⁶³ Të gjitha veprimet e Nakos, sipas Koçit, "*kishin një qëllim të vetëm: t'ia merrnin nga duart Koçit të gjitha detyrat, dhe më pas të shtypte edhe komandantin*".⁶⁶⁴ Vendimet e marra për eliminim apo vrasjen e personave të caktuar, të cilët pretendoheshin të kishin pasur një ndikim negativ në punët e partisë, sipas Koçit, "*nuk mund të konsideroheshin terrorizëm, por vendime dhe veprime të ndërmarra për të mirën e popullit*".⁶⁶⁵ Në lidhje me vetëvrasjen e kryer nga Nako Spiro, Koçi mbajti qëndrim dhe shtroi disa arsye. Pikë së pari, sipas tij, Nako e kreu vetëvrasjen pasi nuk dëshironte të mbante përgjegjësi para Partisë për veprat e tij. Ndër veprat e tij më të rënda Koçi radhit moskryerjen e detyrës që i ishte ngarkuar Nakos, devijimin nga vija e Partisë, qëndrimin e tij në lidhje me marrëdhënien ekonomike me Jugosllavinë, dorëzimin e vendit në duart e personave borgjezë dhe mikroborgjezë. Sipas Koçit, "*aktiviteti dhe mënyra e veprimit e*

⁶⁵⁹AQSH, Fondi Nr.14, Dosje Nr. 53, viti 1948, fl. 290.

⁶⁶⁰Po aty, fl. 292.

⁶⁶¹ Bashkim Shehu, "*Liri Belishova dhe koha e saj*", Tiranë, Botimet: UET, 2020, f.51.

⁶⁶²AQSH, Fondi Nr.14, Dosje Nr. 53, viti 1948, fl. 302.

⁶⁶³Po aty, fl. 303.

⁶⁶⁴Po aty, fl. 304.

⁶⁶⁵Po aty, fl. 308.

*ndjekur nga Nako ka pasur ndikime negative, ka dëmtuar partinë, ka dëmtuar marrëdhëniet e brendshme të saj, ka penguar zhvillimin ekonomik të vendit. Nako dëshironte të sundonte vetë dhe aspironte të bëhej kryeministër. Në këtë mënyrë, puna dhe sjellja e tij mund të konsiderohen shoviniste-borgjeze. Nako që në fillim ka shfaqur tendenca për të dalë i pari, për të drejtuar gjithçka dhe për ta marrë partinë në dorë. Pra, vetëvrasja e Nakos vulos tradhtinë që ai i kishte bërë Partisë”.*⁶⁶⁶

Gjatë veprimtarisë së tij Nako nuk kishte qenë i vetëm, ai u mbështet tek elementë borgjezë dhe mikroborgjezë. Si rezultat, mund të themi që edhe “kontributi i Mehmet Shehut, një nga personat më të afërt me Nakon, nuk është edhe aq pozitiv për partinë. Mehmeti, sipas Koçit, kishte zhvilluar një aktivitet kundra partisë dhe kundra Jugosllavisë”.⁶⁶⁷ Po sipas Koçit, “Nako kishte pasur një ndikim të madh te Mehmet Shehu, por edhe tek anëtarët e tjerë të Byrosë, pasi fryma që ai paraqiste në Byro ishte kundra Jugosllavisë”.⁶⁶⁸ Sipas Koçit, “ishte marsi i vitit 1946 kur Nako nisi ta kundërshtonte momentin që mund të konsiderohet dhe të pranohet si momenti fillestar i devijimit të Nakos nga vija e Partisë”.⁶⁶⁹ Xoxe flet për “rëndësinë e lidhjes së marrëveshjeve në sektorë të ndryshëm me Jugosllavinë, si edhe faktin që duhet pasur një kujdes i jashtëzakonshëm që të mos përsëriten gabimet e Nakos dhe të vazhdohet të krijohet fryma e mbështetjes së borgjezëve dhe imperializmit”.⁶⁷⁰ Nako thekson se Jugosllavia dhe mbështetja e saj për vendin tonë të vogël janë të domosdoshme, pasi janë një garanci për zhvillimin e tij. Gjithashtu, ai vë në dukje edhe se Bashkimi Sovjetik është “fuqia kryesore” e kampit demokratik. Sipas tij, “që të sigurohemi që në parti dhe në rini të mos kemi një Nako të dytë, është e rëndësishme të studiohen e të analizohen me kujdes të gjithë emrat e propozuar. Në parti na nevojiten njerëz besnikë dhe me ide të shëndosha; kjo është mënyra e vetme për të luftuar borgjezinë dhe imperializmin”.⁶⁷¹ Problemi më i madh i Xoxes ishte “humbja e besimit tek Enveri, Sekretari i Përgjithshëm i Partisë... megjithatë, nuk kisha qëllim që të zija pozicionin e tij në parti. Por situatën e krijuar dhe tendencat e shokëve për udhëheqjen i mendoja të rrezikshme për Partinë tonë. Ndikimi i vazhdueshëm i Jugosllavisë, të cilët e kritikonin Enverin që po gabon në mënyrë të vazhduar në drejtimin e partisë dhe nuk është i zoti si Sekretar i Përgjithshëm. Ata nuk kishin besim te shoku Enver dhe mezi prisnin ta sulmonin dhe t’i vinin shokët e Partisë kundra tij”.⁶⁷²

Një tjetër rast, kur besimi i Xoxes tek Enver Hoxha dhe Nako u trondit, ishte në momentin e marrjes së një vendimi të përbashkët, ku ishte përfshirë ai, Enveri dhe Savo Zllatiç. Xoxe dhe Savo ishin të mendimit se Nako nuk po i shkruante vendimet ashtu siç i

⁶⁶⁶AQSH, Fondi Nr.14, Dosje Nr. 53, viti 1948, fl.356.

⁶⁶⁷Po aty, fl. 357.

⁶⁶⁸Po aty, fl. 363.

⁶⁶⁹Po aty, fl.403.

⁶⁷⁰Po aty, fl. 406.

⁶⁷¹Po aty, fl. 407.

⁶⁷²AQSH, Fondi Nr.14, Dosje Nr. 9.1, viti 1948, fl. 22.

kishin vendosur ata, kështu që, i shtyrë nga kjo ngjarje, Xoxe dhe Savo ishin të mendimit se “duhej të mësonim nga eksperiencia e Jugosllavisë, pasi ajo gjithashtu kishte mbështetur Bashkimin Sovjetik dhe nuk përbënte rrezik për independencën e vendit”.

Gjatë procesit të tij gjyqësor, Koçi Xoxe shprehet se, “Unë e kam akuzuar Nako Spirun për politikë shkëputëse nga Jugosllavia, njësoj siç e akuzuan shokë të tjerë të Byrosë”. Pyetjes së prokurorit Bedri Spahiu, lidhur meurvejimin e punës së Nako Spirut, ai i shprehet se, “Për çështjen e Nako Spirut kam biseduar me Enver Hoxhën”⁶⁷³. Sipas Xoxes, “Këto janë edhe dëshmi që unë kam mbështetur dhe kam qenë në anën e politikës së jugosllavëve, por kjo gjë ka ndodhur duke qenë se ata shfaqeshin të gatshëm të na ndihmonin në ndërtimin e vendit. Gjithashtu, jugosllavët kishin krijuar të njëjtin mendim me mua, në lidhje me Nako Spiron, pasi ata thoshin se Nako në Jugosllavi kishte punuar prapa krahëve të partisë dhe kundër komandantit”.⁶⁷⁴ Në këtë mënyrë, nëpërmjet Xoxes jugosllavët informoheshin mbi zhvillimet e brendshme, kundërshtimet dhe gjithçka tjetër. Ai deklaronte se simpatinë dhe besimin që udhëheqësit jugosllavë kishin ndaj Xoxes dhe, nga ana tjetër urrejtjen ndaj Enverit, nuk linin asnjë rast pa e shfaqur. Ata e këshillonin shokun Enver që për çështjet e ekonomisë të punonte bashkë me Koçin, “pasi ata kishin njohur tek unë nuhatjen e klasës dhe të dëshirës për të ecur përpara. Unë me sinqeritet dhe siguri mund të them që të gjitha vendimet e marra prej meje në Plenumin VIII janë marrë në interes të Partisë dhe popullit.”⁶⁷⁵. Xoxe u shpreh se nuk kishte qenë i vetëm në marrjen e këtyre vendimeve, pasi shumë shokë e kishin mbështetur, dhe se ishin shkruar edhe letra nga shokët e Byrosë dhe shumë prej tyre duhet të mbanin përgjegjësi mbi ato që ishin shkruar. “Gjatë gjyqit të Koçi Xoxes, prokurori Bedri Spahiu, në të njëjtën kohë dhe anëtar i Byrosë Politike, e pyeti Xoxen: “A ke pasur ti, i pandehur, ndonjë kundërshtim për akuzat që sollën jugosllavët?” Koçi Xoxe u përgjigj se “Akuzat e jugosllavëve i ka pranuar Sekretari i Përgjithshëm, dhe pastaj unë.”⁶⁷⁶ Ai gjithashtu pranon se ka gabuar rëndë dhe që ndërgjegjja e tij është shumë e ngarkuar, për shkak të veprimeve të tij në dëm të partisë, të shokëve të Partisë dhe Bashkimit Sovjetik. Ai deklaroi që nuk do të lodhet duke punuar “në interes të popullit”,⁶⁷⁷ derisa t’i shlyejë gabimet e bëra. Në analizën e tij, në lidhje me dëmin që i kishte shkaktuar Shqipërisë duke mbështetur Jugosllavinë, Xoxe e justifikon se e ka bërë në interes të vendit, dhe se asnjëherë nuk mendonte që “Jugosllavia donte thjesht ta izolonte Shqipërinë nga Bashkimi Sovjetik, dhe të bëhej fuqi kryesore në Ballkan, në Europën Qendrore e Juglindore”.⁶⁷⁸ Xoxe shprehet se “Gabimi më i rëndë ishte që unë i mbështeta konkluzionet e Jugosllavisë, të cilat kritikonin shokun Enver, shokun Nako Spiro dhe që dëmtonin ndërtimin e socializmit, vendin dhe partinë”.⁶⁷⁹ Për ta mbyllur

⁶⁷³ Bashkim Shehu, “Liri Belishova dhe koha e saj”, Tiranë, Botimet: UET, 2020, f.84-85

⁶⁷⁴ AQSH, Fondi Nr.14, Dosje Nr. 9.1, viti 1948, fl. 23.

⁶⁷⁵ Po aty, fl. 24.

⁶⁷⁶ Bashkim Shehu, “Liri Belishova dhe koha e saj”, Tiranë, Botimet: UET, 2020, f.83.

⁶⁷⁷ AQSH, Fondi Nr.14, Dosje Nr. 9.1, viti 1948, fl. 28.

⁶⁷⁸ Po aty, fl. 36.

⁶⁷⁹ Po aty, fl. 37.

autokritikën e tij, Xoxe, kërkoi të shfajësohet, në lidhje me kritikën që i kishte bërë shokut Enver, për të cilin theksoi se *“kishte punuar me maturi dhe vendosmëri, në shqyrtimin e çështjeve të rëndësishme ka mbajtur qëndrime të drejta dhe të prera. Unë e fajësoj vetën pse nuk arrita të përfitoj nga drejtësia dhe mirëkuptimi i shokut Enver”*.⁶⁸⁰

Në deklaratën e tij para Komitetit Qendror, Xoxe pranoi që nuk kishte qenë kurrë anti-sovjetik. “Në një letër drejtuar Komisionit të Posaçëm Hetimor, me të cilën plotëson pohimet e tij gjatë marrjes në pyetje nga hetuesia, ai shkruan se, “Kur ishte çështja për të ndihmuar Republikën dhe independencën e Partisë, unë kam qëndruar përherë në mbrojtjen e këtyre në vijën e Bashkimit Sovjetik, herë vetë, herë me Sekretarin e Përgjithshëm kundër qëllimeve dhe tentativave të maskuara të jugosllavëve”. Gjithashtu: “Me anën e këtyre ndërhyrjeve ata (jugosllavët) kanë dashur të okupojnë Shqipërinë dhe të realizojnë qëllimet e tyre. Këtyre qëllimeve u kemi qëndruar dhe hedhur poshtë, në radhë të parë shoku Enver dhe unë, dhe pastaj Byroja, me përjashtim të qëndrimit të hapur pro-jugosllav të Kristo Themelkos dhe të ndonjë lëkundjeje të Hysni Kapos, që ka qenë pa rëndësi.” Qëndrimi i Koci Xoxes ka brenda një të vërtetë, sepse qëndrimet e tij kanë qenë të njëjta me qëndrimet e Enver Hoxhës dhe të anëtarëve të tjerë të Byrosë Politike.”⁶⁸¹ Duke pranuar se gjithë veprimtaria e tij në të kaluarën, në postin e Sekretarit Organizativ të KQ dhe të ministrit të Punëve të Brendshme i ka shkaktuar një dëm të madh partisë, se kjo veprimtari ishte drejtuar edhe kundër partisë, se kjo veprimtari ishte drejtuar edhe kundër Bashkimit Sovjetik, Koçi Xoxe tha se ai gjithmonë ka qenë dhe mbetet besnik i Bashkimit Sovjetik dhe partisë bolshevike, dhe sado që të mundohen t’i veshin atij etiketën e antisovjetikut, ai nuk mund ta pranonte asnjëherë një gjë të tillë. Me shumë emocion, Koçi Xoxe u shpreh se *“Unë jam gati të jap jetën, për të vërtetuar se nuk kam qenë antisovjetik, se me vetëdije asnjëherë nuk kam vepruar kundër Bashkimit Sovjetik”*.⁶⁸² Lidhur me faktin se ditët e fundit agjencia *Rojter*, duke iu referuar Beogradit, kishte filluar të fliste shumë për ngjarjet në Tiranë si edhe për *“fushatën”* kundër adhuruesve të Titos në Shqipëri, Koçi Xoxe u pyet nëse ishte në dijeni të propagandës angleze dhe, nëse po, atëherë cili ishte qëndrimi i tij ndaj kësaj propagande. Koçi Xoxe tha se e kishte mësuar një gjë të tillë nga anëtari i Byrosë Politike Bedri Spahiu, dhe se pas bisedës me këtë të fundit kishte përgatitur projektin e një letre të hapur për redaksinë e gazetës *“Bashkimi”*. Sipas fjalëve të Koçi Xoxes, në këtë projekt të përgatitur ai dënonte rreptë propagandën e anglezëve, damkoste veprimtarinë tradhtarë të nacionalistëve jugosllavë, me Titon në krye, dhe deklaronte solidaritetin me vendimet e partisë dhe të qeverisë për këtë çështje. Me kaq biseda u mbyll dhe *“Koçi Xoxe u largua nga ndërtesa e misionit sovjetik me një gjendje shpirtërore të rënduar”*.⁶⁸³

⁶⁸⁰*Po aty*, fl. 40.

⁶⁸¹Bashkim Shehu, “Liri Belishova dhe koha e saj”, Tiranë, Botimet: UET, 2020, f. 84.

⁶⁸²*Shqipëria në dokumentat ruse...*, përgatitën I. Lauka dhe E. Ymeri, f. 182.

⁶⁸³*Po aty*, f. 183.

Ndërsa Presidenti i Presidiumit të Kuvendit Popullor, Omer Nishani, u shpreh se “*pas demaskimit të veprimeve të paligjshme të organeve të Sigurimit të Shteti, të cilat i drejtonte Koçi Xoxe, populli sikur filloi të marrë frymë më me lehtësi, ndjeu njëfarë qetësimi*”.⁶⁸⁴ Sipas fjalëve të tij, puna kishte arritur deri aty, sa që njerëzit nuk ishin më të sigurt, çdo njeri përgjohej, njerëzit nuk donin të takoheshin me miqtë dhe të njohurit e tyre, nga frika se mos ngjallnin dyshimin nga ana e “*policisë së kudondodhur të Koçi Xoxes. Tani nuk është sekret që organet e Sigurimit të Shtetit dhe Koçi Xoxe nuk i respektonin ligjet, ata e kishin harruar Kushtetutën. Pa ngritur kurrfarë akuzash, njerëzit i rrasnin nëpër burgje*”⁶⁸⁵. “*Njerëz të tillë, si puna e Koçi Xoxes, harruan se, në rast të ndonjë rreziku të ri që mund t’i kërcënohet vendit, udhëheqësve, përsëri do të duhet t’i bëhet thirrje popullit. Populli duhet respektuar*”.⁶⁸⁶ Në këtë kontekst, “arrestimi dhe ekzekutimi i Koçi Xoxes ndodhi në kohën kur mbi një e katërta e anëtarëve të PKSh-së u arrestuan ose u ekzekutuan”.⁶⁸⁷

Por vetëm pas procesit gjyqësor kundër Koçi Xoxes, në maj-qershor 1949, ai filloi të quhej komplotist, armik i popullit dhe agjent i drejtpërdrejtë i Titos. Ndërsa në korrik-gusht 1948, qëndrimi ndaj tij ishte tjetër. “Zgjedhjet e reja në prag të fillimit të Kongresit të Parë të PKSh-së duhet t’i siguronin udhëheqjes një shpërndarje të tillë të kuadrit në të gjitha shkallët e hierarkisë partiake, që do të përjashtonte shfaqjen e dyshimeve në drejtësinë e të ashtuquajturave masa për kthesën 180-gradëshe”.⁶⁸⁸ Pra po diskutohej për mbajtjen e zgjedhjeve në mënyrë të fshehtë, pa rënë në sy. Ndërsa Xoxe vazhdonte të akuzohej për shmangien e Sekretarit të Përgjithshëm dhe të anëtarëve të tjerë të Byrosë Politike, për përvetësimin e pushtetit dhe se, duke qenë ministër i Punëve të Brendshme, kishte vënë partinë nën kontrollin e organeve të Sigurimit. Në prag të çeljes së Kongresit I të PKSh, në nëntor të vitit 1948, Koçi Xoxe shkoi te D. S. Çuvahin për këshillë, si ta ndërtonte sa më mirë fjalën e vet të pendimit. Ai tha se ishte plotësisht dakord me vendimet e partisë, dhe se ishte gati të zbulonte lidhjet e tij me udhëheqjen trockiste të PKJ-së, duke filluar që nga Plenumi i Beratit. “Me lot në sy, - siç thekson Çuvahin, - Xoxe foli për veprimtarinë antimarksiste të përfaqësuesve jugosllavë në Shqipëri dhe për ata që atij përpiqen t’i ngjitin damkën e antisovjetikut, por këtë nuk mund ta bënte kurrkush.” Si ai ishte ngatërruar, duke u munduar të shpëtonte dhe duke llogaritur që do ngjallte ndjenjën e drejtësisë të bashkëluftëtarët e partisë. Mirëpo, gjithë sistemi i marrëdhënieve të ndërsjella në lëvizjen komuniste botërore presupozonte një reaksion zinxhir të tradhtisë, spiunëve dhe akuzave nga më fantastiket.⁶⁸⁹ Duke gjykuar sipas kujtimeve të Çuvahin, ai “donte ta shpëtonte Xoxen nga ndëshkimi i përgjakshëm, për çka u thirr në Moskë për përpunimin përkatës. Por në të gjitha vendet e tjera satelite, udhëheqja sovjetike e partisë dhe qeverisë

⁶⁸⁴Po aty, f. 186.

⁶⁸⁵Po aty.

⁶⁸⁶Po aty, f. 187.

⁶⁸⁷B. J. Fischer, *Diktatorët e Ballkanit...*, f. 276.

⁶⁸⁸N. Smirnova, *Historia e Shqipërisë...*, f. 337.

⁶⁸⁹D.S.Çuvahin, “*Shërbimi im diplomatik në Shqipëri*”, Botimet: Almera, Tiranë 2009, f.88

inspiroi proceset ndaj “agjentëve të Titos”. Kurse këtu në Shqipëri, gjyqet ndodhnin në mënyrë të natyrshme, vetvetiu, me kërkesën e anëtarëve të thjeshtë të indinjuar të partisë. Nga situata e krijuar, Hoxha nxori përfitimin maksimal. Të gjitha dështimet në ekonomi, në punën ideo-politike të partisë, në shtator të vitit 1948, Plenumi XI i KQ të PKSh ua faturoi jugosllavëve dhe agjenturës së tyre që kryesoheshin nga Grupi Xoxe – Kristo”.⁶⁹⁰

Në Kongresi e Parë të PKSh-së, në vitin 1948, “Koçi Xoxe dhe Kristo diskutuan, por nuk u pasqyrua thelbi i diskutimeve të tyre”.⁶⁹¹ Kongresi përjashtoi nga partia Koçi Xoxen dhe Pandi Kriston, “*si elementë trockistë*”, ndërsa “Kuvendi Popullor mori vendimin për shkarkimin e Koçi Xoxes dhe Pandi Kristos, si nënkryetar dhe anëtar të Presidiumit të Kuvendit Popullor” dhe heqjen e mandatit si deputetë”.⁶⁹² Më 28 nëntor 1948 “u shpall Dekreti Nr. 724, për heqjen e imunitetit parlamentar të Koçi Xoxe dhe Pandi Kristos”.⁶⁹³ Në brendësi të këtij dekreti thuhej: “Në mbështetje të artikullit 49 të Statutit të Republikës së Shqipërisë, mbi propozimin e qeverisë, Presidiumi i Kuvendit Popullor dekreton: Heqjen e imunitetit parlamentar Koçi Xoxes dhe Pandi Kristos, deputetë të qendrës së Korçës”.⁶⁹⁴ Megjithatë, Tempo u shpreh se, pas Miladinit dhe Dushanit, Koçi Xoxe, edhe pse u akuzua për vrasje ishte komunisti më i mirë në Shqipëri. Edhe pas prishjes së marrëdhënieve Shqipëri-Jugosllavi, konsideratën e lartë për Koçi Xoxen, Tempo ia bëri të ditur Hrushovit, duke i thënë se njeriu që kishin vrarë, përveçse ishte një komunist i mirë, ishte edhe punëtor dhe revolucionar.

“Menjëherë mbas Kongresit, u mbajt në Tiranë Konferenca e Partisë, ku çështja kryesore që u diskutua ishte zhvillimi ekonomik i vendit. Mirëpo që në diskutimet e para, delegatët në këtë konferencë treguan se ata i shqetësonte, para së gjithash jo gjendja ekonomike, por qëndrimi dhe vendi i Xoxes, Kristos dhe përkrahësve të tyre, madje kritika ndaj këtij grupi kishte karakter të mprehtë dhe të ashpër, që arriti deri në kërkesën për t’i çuar në gjyq.”⁶⁹⁵

Për sa i takon gjyqit, vendimet e plenumit nuk u bënë publike deri më 21 tetor, por më 2 tetor, një mbledhje e Këshillit të Ministrave kishte njoftuar se Xoxe ishte hequr nga posti i tij i ministrit të Brendshëm dhe ishte emëruar ministër i Industrisë. Hoxha dhe Jakova dominuan në plenum; dhe Enver Hoxha u zhvendos me shpejtësi pas kësaj për të konsoliduar kontrollin e tij mbi partinë. Në Kongresin e Parë të Partisë në nëntor, Xoxe dhe mbështetësit e tij në Komitetin Qendror u dëbuan nga të gjitha postet e partisë dhe të shtetit. “Përveç Xoxes dhe Pandi Kristos, Kristo Themelko dhe Nesti Kerenxhiu u hoqën nga postet e tyre të politikës dhe qeverisë, Pullumb Dishnica, Xoxhi Blushi dhe Vasko

⁶⁹⁰ *Po aty*, f.89

⁶⁹¹ N. Smirnova, *Historia e Shqipërisë...*, f. 340.

⁶⁹² AQSH, Fondi: Presidiumit të Kuvendit Popullor, Dosja Nr. 17, viti 1949. *Shënim*: Vendimi Nr. 675, datë 3.3.1949- Kuvendi Popullor.

⁶⁹³ AQSH, Fondi: Presidiumit të Kuvendit Popullor, Dosja Nr. 115, viti 1949, f. 1.

⁶⁹⁴ *Po aty*, f. 2.

⁶⁹⁵ D.S.Cuvahin, “*Shërbimi im diplomatik në Shqipëri*”, Tiranë, Botimet: Almera, 2009, f.52

Koleci u hoqën nga Komiteti Qendror dhe postet e tyre qeveritare dhe u gjykuan si punëdhënës të klikës së nacionalizmit trockist të Titos. Vetëm Xoxe u dënua me vdekje”.⁶⁹⁶ Kështu filluan të identifikoheshin dhe të spastroheshin drejtuesit titistë. Spastrimi i Xoxes i kishte të gjitha shenjat e një spastrimi “të bërë në Moskë”⁶⁹⁷. “Pas mbërritjes në Tiranë të letrave informuese të Stalinit për ‘tradhtinë e madhe’ të jugosllavëve, ishte koha kur dikush duhet të shkonte në satër për pro jugosllavizmin e theksuar. Por kush, cilët, në një kohë kur e gjithë udhëheqja e Partisë Komuniste Shqiptare, duke filluar nga Enver Hoxha, ishte pro jugosllavëve? Atëherë, betejën për ekzistencë e fiton klani më i fortë dhe ndëshkohet ai më i dobëti. Fiton klani i Enver Hoxhës dhe humbet ai i Koçi Xoxes”⁶⁹⁸.

Bazuar në udhëzimin e ambasadorit sovjetik, në qershor 1948, “Hoxha urdhëroi mbylljen e Byrosë Jugosllave të Informacionit dhe, më 1 korrik 1948, katër ditë pas rezolutës së Kominformi mbi “*Titon dhe klikën e tij*”, ai shfuqizoi marrëveshjet tregtare me Jugosllavinë dhe urdhëroi dëbimin e menjëhershëm të të gjithë specialistëve dhe këshilltarëve jugosllavë”.⁶⁹⁹ Me një mbështetje të plotë politike dhe ekonomike nga Bashkimi Sovjetik, Enver Hoxha tani u kthye kundër rivalit të tij të mëparshëm partiak Koçi Xoxe. Xoxe u përpoq të parandalonte të pashmangshmen, ofroi vetë-kritikë, afirmoi besnikërinë e tij ndaj Bashkimit Sovjetik dhe rezolutën e Kominformit, si dhe urdhëroi shërbimin sekret të gjurmonte e të arrestojë titistët. Por kjo nuk ishte e dobishme, për ta shpëtuar atë nga gjykimi. “Komiteti Qendror revokoi rezultatet e Plenumit të Tetë, rehabilitoi të gjithë komunistët kryesorë të spastruar nga Xoxe, vendosi të shkarkonte Xoxen nga posti i tij si ministër i Brendshëm dhe e zëvendësoi atë me ish-viktimën e tij, Mehmet Shehu”.⁷⁰⁰ Mbështetësit e Xoxes u shkarkuan shpejt, vendet e tyre në shërbimin sekret u mbushën nga të besuarit e Mehmet Shehut dhe agjentët e policisë sekrete sovjetike. Më 22 tetor, pas një vendimi unanim të Kongresit të Partisë, ai u përjashtua nga Partia Komuniste.

Pas prishjes së marrëdhënieve me Jugosllavinë, në vitin 1948 nis faza e gjyqeve politike, ku Xoxe gjykohet nën drejtimin e Bedri Spahiut, i cili kishte qenë së bashku me Koçin në grupin e Gjyqit Special dhe ku kishin dënuar shumë figura të asaj kohe. Shumë elementë brenda Komitetit Qendror me origjinë punëtorë ishin të lidhur me miqësi personale me Koçi Xoxen. Ky i fundit, në pozicionin e ministrit të Brendshëm, kishte organizuar një seri gjyqesh, në të cilat planifikoi përfshirjen e elementëve që do të përdroreshin më vonë kundër Nako Spiros, Mehmet Shehut, Enver Hoxhës etj. Por Hoxha

⁶⁹⁶ Central Intelligence Agency, “*Current Intelligence Staff Study, Soviet-Albanian Relations, 1940-1960*”, ESAU XIX-62, 2007, f. 8. Marrë nga: <https://www.cia.gov/library/readingroom/docs/esau-19.pdf>.

⁶⁹⁷ *Po aty*.

⁶⁹⁸ K. Dervishi, *E vërteta e fshehur e një procesi...*, f. 78

⁶⁹⁹ George H. Hodos, “*Show trials, Stalinist Purges in Eastern Europe, 1948-1954*”, Praeger Publishers, New York, 1987, f.5. Marrë nga: <https://books.google.al>

⁷⁰⁰ *Po aty*.

pati mundësinë jo vetëm të ruante pozitat e tij brenda Partisë Komuniste dhe të shmangte një dënim të mundshëm, por edhe të vepronte duke marrë hak ndaj Xoxes.

Në një shkallë më të gjerë, gjyqi i Koçi Xoxes ishte ndaj Jugosllavisë, e cila, sipas udhëheqësve të asaj kohe zhvilloi një veprimtari politike dhe ekonomike me qëllime kolonizuese që cenonin pavarësinë e vendit. Njëherësh, gjykimi i Xoxes u krye në përputhje me problemet e brendshme dhe të jashtme të Shqipërisë së asaj kohe. Enveri e kishte paraqitur veten si kundërshtar të Beogradit, kur në fakt kundërshtari i vërtetë i Beogradit ishte Nako Spiro. Ai asokohe ishte vetëm një person neutral në çështje, duke marrë meritat e Nako Spiros, si kundërshtar i hershëm i Beogradit dhe shpëtimtar i PKSh-së. Xoxe i humbi pozitat e tij brenda partisë, së bashku me mbështetësit e tij si Pandi Kristo, Vaskë Koleci, Nesti Kerenxhi, Kristo Themelko, si dhe persona me poste më të ulëta, si Vangjo Mitrojorgji, Nuri Huta, Niko Opari etj. Ata shfuqizohen nga postet politike dhe akuzohen se kanë tradhtuar partinë dhe popullin.

Pas arrestimit të Koçi Xoxes, më 28 nëntor 1948, si Armik i Popullit, zhvishet nga të gjitha ofiqet dhe funksionet. Me akuzat më të rënda, ato të bashkëpunimit me jugosllavët dhe shkelje e parimeve të Partisë, duke u bërë pjesë e agjenturave të huaja, u mbajt nën masa të rrepta sigurie në burgun e ri të Tiranës. “Gjyqi i Koçi Xoxes dhe i ndjekësve të tij filloi më 12 maj 1949”.⁷⁰¹ Sipas aktakuzës, i pandehuri kishte bërë “komplot me Titon në përmbysjen e qeverisë shqiptare, të organizonte vrasjen e Enver Hoxhës dhe të drejtuesve të tjerë të partisë, likuidimin e Shqipërisë si një shtet sovran dhe përfshirjen e saj në Jugosllavi, për të formuar, me udhëzime të imperialistëve anglo-amerikanë, një bastion të bashkuar anti-sovjetik në Ballkan. Xoxe “*pranoi*” se në vitet ‘30 ai ishte rekrutuar nga policia monarkiste e Mbretit Zog, si një informator, dhe gjatë luftës, nga agjencitë e inteligjencës angleze dhe amerikane”.⁷⁰² Kreu i misionit ushtarak britanik në Shqipëri në vitin 1943, përhap fjalë se “Tito ishte agjenti i tyre sekret, dhe me udhëzimin e Shërbimit të Inteligjencës Sekrete Britanike ai zhvilloi bisedime të shumta konspirative me anëtarin e Byrosë Politike të Maqedonisë dhe spiunin imperialist Tempo. Në ato bisedime është rënë dakord që, pasi të fitojë pushtetin në të dy vendet, Xoxe duhet të drejtojë politikën e palës shqiptare në drejtim të thithjes së Shqipërisë në Jugosllavi, si Republika e saj e Shtatë Federale. Me ndihmën e anëtarit të Byrosë Politike, Pandi Kristo, kreu i Komisionit të Kontrollit, ai i emëroi bashkëpunëtorët e tij në poste drejtuese dhe udhëzoi Vargo Mitrojorgjin, shef të policisë së Sigurimit të Shtetit, për të arrestuar anti-titistët”.⁷⁰³ Detyra e Nesti Kerenxhit, një tjetër anëtar i Byrosë Politike në krye të Komitetit të Planifikimit të Shtetit, kishte qenë të sabotonte ekonominë dhe të përgatiste integrimin e saj në sistemin jugosllav. Kur në pranverën e vitit 1948, Komiteti Qendror sovjetik filloi të kritikojë

⁷⁰¹*Po aty*, f. 10.

⁷⁰²*Po aty*, f. 11.

⁷⁰³George H. Hodos, “*Show trials, Stalinist Purges in Eastern Europe, 1948-1954*”, Praeger Publishers, New York, 1987, f.11. Marrë nga: <https://books.google.al>.

politikën trockiste të partisë jugosllave, Tito udhëzoi Xoxen që të zbatonte menjëherë planet e paracaktuara, vrasjen e kryetarit të partisë shqiptare dhe pushtimin e vendit nga Jugosllavia”.⁷⁰⁴

Në fillim të majit të 1949-s shpallet fajtor për të gjitha akuzat dhe nga Gjykata e Lartë i jepet dënimi kapital, me vdekje. Pushkatohet më 11 qershor 1949, në moshën 38-vjeçare. “Fjalët e tij të fundit, në çastin para ekzekutimit, janë: “Rroftë Republika! Rroftë Stalini!”.⁷⁰⁵Liri Belishova u shpreh se, “me pushkatimin e Koçi Xoxes nuk i duket se drejtësia u vu në vend. “Marrëdhëniet me Jugosllavinë u prishën, Xoxe u dënua, po të tjerët, thuajse të gjithë, me Enver Hoxhën në krye dhe me pushtetin total të Njëshit në Parti, mbetën”.⁷⁰⁶Ndërsa “Pandi Kristo mori një dënim me njëzet vjet punë të rëndë, Nesti Kerenxhi, Vagjo Mitrojorgji, zëvendësministri i Brendshëm, Vaskë Koleci, dhe kreu i propagandës së Komitetit Qendror, Nuri Huta, u dënuan me burg afatgjatë”.⁷⁰⁷

Gjyqi i Xoxes në Tiranë duket se shërbeu për tre qëllime. Së pari, ai ishte menduar si një parapërgatitje për të gjithë të mos-bindurit e mundshëm në vendet satelitore komuniste: kushdo që përpiqet të shkëputet nga Moska, të kërkojë të heqë nënshtrimin e tij ose të zhvillojë koncepte të pavarura, do të trajtohet në po atë mënyrë. Së dyti, u përpoq të markonte këdo që shfaqte dallime mendimesh si një kriminel të zakonshëm ose si një agjent të imperializmit, të shtrembëronte dallimet taktike si tradhtinë, sabotazhin dhe spiunazhin. Qëllimi i tretë, i menjëhershëm dhe mbizotërues, ishte ta “*demaskonte*” Titon me ndihmën e rrëfimeve të rreme; Tito duhej të dëshmohej jo vetëm si një devijues nga linja e vetme korrekte e Moskës, jo vetëm objektivisht si një ndihmës i forcave anti-sovjetike, por edhe subjektivisht një tradhtar, një agjent i vetëdijshëm, i kohës së vjetër të imperialistëve. Gjyqi i Xoxes e arriti plotësisht qëllimin; bashkëpunëtorët e Titos duhej të paguanin çmimin e vdekjes, burgosjen dhe poshtërimet.

Tashmë, me “*këshilltarët*” sovjetikë të ngarkuar nga Sigurimi, karakteri i spastrimit ndryshoi rrënjësisht. Deri në atë kohë, gjyqet e “*shfaqjeve*” ishin të panjohura në vendet e Europës Lindore, madje edhe në Shqipëri, si nën-satelitë e Jugosllavisë. Në lëvizjen e copëtuar komuniste shqiptare, të mbushur me luftëra të fraksioneve, tradita arkaike e një populli malor i vendosi llogaritë me kundërshtarët në një mënyrë brutale, siç dëshmojnë vrasjet e përmendura tashmë të Lulos, Fundos dhe Gjinishit. Spastrimet në luftën për pushtet Hoxha-Xoxe për udhëheqjen e partisë çuan në burgosjen e kundërshtarëve - jo me akuza të trumbetuara dhe me “*rrëfime*” të rreme, por si eksponentë të vërtetë të fraksionit anti-jugosllav. Vrasja e Nako Spiros vërtetoi vetëm prapambetjen e policisë sekrete të

⁷⁰⁴*Po aty*.

⁷⁰⁵ Bashkim Shehu, “Liri Belishova dhe koha e saj. Idealizmi, humnerat e pushtetit, katarsis”, Botimet: UET, Tiranë 2020, f.91

⁷⁰⁶*Po aty*, f. 92

⁷⁰⁷George H. Hodos, “*Show trials, Stalinist Purges in Eastern Europe, 1948-1954*”, Praeger Publishers, New York, 1987, f.11. Marrë nga: <https://books.google.al>.

Xoxes: “ata ende nuk e kishin zotëruar teknikën e vrasjes përmes gjyqeve “të shfaqjeve”, kështu që kryenin një vrasje të zakonshme”.⁷⁰⁸

Mirëpo spastrimi i Xoxes duhej të ishte ndryshe; “duhej të përshtatej në skenarin e përgjithshëm të përgatitur pak më parë nga Stalini dhe Beria. Nuk ishte e mjaftueshme për ta vrarë atë. Titisti Xoxe duhej të shndërrohej në një “titist” në thonjëza. Ai duhej të tregohej jo si kreu i orientimit jugosllav, në kundërshtim me vijën e pavarur të Hoxhës, por si një kriminel i zakonshëm, tradhtar i vendit të tij, një mjet i imperialistëve. Mbi të gjitha, Xoxe nuk duhet të jetë i akuzuari kryesor, por më tepër Tito, duke qenë “i pamaskuar” përmes aleatit të tij shqiptar si krye-agjenti i përgjithshëm i inteligjencës perëndimore –një imperialist”.⁷⁰⁹ Koçi Xoxe ishte vetëm pjesërisht i vendosur në skenarin e Moskës për të ekspozuar Titon si udhëheqës të një komploti antisovjetik të Lindjes, në shërbim të fuqive imperialiste. Ai ishte njeriu i Titos në Shqipëri, një titist i vërtetë; nga ana tjetër, edhe Enver Hoxha ishte i dyshuar. Për më tepër, Shqipëria kishte disavantazhin e madh për të qenë larg Bashkimit Sovjetik, e rrethuar nga fqinjët armiqësorë ndaj Moskës, Jugosllavisë dhe Greqisë. Më në fund, “duhej të bëhej izolimi i Shqipërisë. Kombi i pazhvilluar, me një popullsi prej 1.2 milionë, ishte një pikë e vogël në hartën europiane, pa asnjë marrëdhënie diplomatike me botën perëndimore dhe pothuajse me asnjë lidhje politike ose ekonomike me ndonjë shtet socialist, përveç Jugosllavisë. Sidoqoftë, Sigurimi bëri punën më të mirë të mundur në rrethanat e dhëna. Nga fundi i nëntorit 1948, Xoxe dhe grupi i tij u torturuan ditë e natë; hetuesve iu deshën pesë muaj për ta thyer rezistencën e tyre”.⁷¹⁰

Në fund të marsit 1949, “Enver Hoxha u ftua në Moskë për të marrë udhëzime se si të përgatiste provën e shfaqjes përgjatë vijave të paracaktuara”.⁷¹¹ Shumë gjyqe sekrete më të vogla, në të cilat u “likuiduan qindra titistë të mirëfilltë dhe të pretenduar, shoqëruan gjykimin kryesor, të ndjekur nga një spastrim i dytë “konsolidues” me anëtarin e Byrosë Politike Abedin Shehu, si viktimë qendrore. Brenda një viti, i gjithë krahu jugosllav i partisë shqiptare ishte në burg ose në kampe përqendrimi, dhe krahu nacionalist i Enver Hoxhës plotësisht në kontroll”.⁷¹² Këshilltarët sovjetikë nuk e dinin akoma, por “ata kishin ndihmuar ardhjen në fuqi të një marke tjetër të “anti-Tito-titizmit”, e cila u kthye kundër tyre më shumë se një dekadë më vonë”.⁷¹³ Stalini mburrej në konfliktin me Jugosllavinë, duke u shprehur me fjalët “Unë vetëm duhet të lëviz gishtin tim të vogël, dhe Tito ka mbaruar”.⁷¹⁴

⁷⁰⁸ George H. Hodos, “Show trials, Stalinist Purges in Eastern Europe, 1948-1954”, Praeger Publishers, New York, 1987, f.10. Marrë nga: <https://books.google.al>

⁷⁰⁹Po aty.

⁷¹⁰Po aty.

⁷¹¹Po aty.

⁷¹²Po aty, f.11.

⁷¹³Po aty.

⁷¹⁴Po aty.

Për shkak të rëndësisë periferike të Shqipërisë për perandorinë sovjetike në Europën Lindore, “grykimi i shfaqjes publike nuk mund të shërbente për një qëllim të dobishëm, dhe procedurat sekrete, përmes një paralajmërimi brutal, të pakuptueshme për drejtuesit e partisë satelitore, e privuan atë nga shumica e vlerës së saj të propagandës. Izolimi gjeografik dhe politik i Shqipërisë çoi në një situatë ku nuk mund të kërcënoheshin titistë të tjerë të mundshëm - duhej të mbetej një rrugicë e verbër dhe pa dalje në satelitët e Europës Lindore”.⁷¹⁵ Në udhëheqjen e re, e cila doli nga Kongresi i Parë i Partisë, ishte e qartë se Enver Hoxha kishte dalë fitimtar në luftën e tij brenda partisë me Xoxen, por një rival i ri i mundshëm ishte shfaqur në personalitetin e Mehmet Shehu, i cili ishte promovuar në pozitën numër në parti dhe shtet.

4.3 Pasojat e gryqit dhe lufta kundër pro-jugosllavëve

Partia Komuniste Shqiptare ishte e rrënuar nga fraksionizmi gjatë periudhës së mbizotërimit të Jugosllavisë. “Ky fraksionizëm ndoshta buronte më shumë nga dallimet në lidhje me taktikat gjatë luftës partizane, rivalitetet personale dhe armiqësitë midis liderëve të partisë dhe ato personale, duke bërë xhiro për pushtet, sesa nga ndonjë rezistencë e përbashkët, nga ndonjë palë fraksioni ndaj sundimit jugosllav.”⁷¹⁶ Spastrimet anti-titiste të anëtarëve të Komitetit Qendror dhe deputetëve të Asamblesë Popullore në masën 25% të anëtarësisë së mëparshme, bënë që “Jugosllavia t’i kundërpërgjigjej kësaj shtate me një kundërshtim propagandistik, duke anuluar traktatin e miqësisë me Shqipërinë, si dhe duke e tërhequr misionin e saj diplomatik nga Tirana në vitin 1950. Megjithatë, PKSh e arriti me shpejtësi një stabilitet të jashtëzakonshëm”.⁷¹⁷

Byroja e re politike, e zgjedhur në Kongresin e nëntorit 1948, përbëhej nga katër anëtarë të vjetër: Enver Hoxha, Tuk Jakova, Hysni Kapo dhe Gogo Nushi, si dhe 5 anëtarë të rinj: Mehmet Shehu, Liri Belishova, Beqir Balluku, Bedri Spahiu dhe Spiro Koleka. Nga anëtarët e vjetër, Jakova u dëbua nga Byroja Politike në vitin 1951 dhe nga Komiteti Qendror dhe Partia më 1955-n. Kështu, Byroja Politike përfshiu për dhjetë vjet vetëm tri figura: E. Hoxha, H. Kapo dhe G. Nushi, të cilët ishin anëtarë të Byrosë Politike në epokën e mbizotërimit jugosllav. Kapo u promovua në Byronë Politike në vitin 1946, ndërsa Nushi u shtua më pas. Midis verës së vitit 1948 dhe prillit 1952, u ndërmor dhe përfundoi një spastrim i plotë i anëtarëve të dyshuar pro-jugosllavë. Jugosllavët kurrë nuk i kanë mohuar kritikën ndaj Hoxhës, por kjo duhet t’iu shërbejë edhe qëllimeve të tyre, për të pretenduar se ata e kishin kuptuar qysh në vitin 1944 se ai nuk ishte një komunist i besueshëm. E gjithë

⁷¹⁵ George H. Hodos, “*Show trials, Stalinist Purges in Eastern Europe, 1948-1954*”, Praeger Publishers, New York, 1987, f.12. Marrë nga: <https://books.google.al>.

⁷¹⁶ Central Intelligence Agency, “*Current Intelligence Staff Study, Soviet-Albanian Relations, 1940-1960*”, ESAU XIX-62, 2007, f.3. Marrë nga: <https://www.cia.gov/library/readingroom/docs/esau-19.pdf>.

⁷¹⁷ Po aty, f. 10.

kjo duket se bie ndesh me faktin se E. Hoxha mbeti udhëheqës i partisë dhe një mjet i pajtueshëm i jugosllavëve përgjatë gjithë periudhës para 1948-s. “Plenumi, diskutimi, kritikata dhe gjyqi i Xoxes në tërësi drejtoheshin në një shkallë më të gjerë ndaj Jugosllavisë, e cila, sipas drejtuesve shqiptarë të asaj kohe zhvilloi një veprimtari politike dhe ekonomike me qëllime kolonizuese që cenonin pavarësinë e vendit.”⁷¹⁸

Pas gjyqit të Xoxes, Komiteti Qendror dhe lideri i Partisë në Shqipëri që nga ajo datë “ka qenë jashtëzakonisht i qëndrueshëm. Në Kongresin e Dytë të Partisë, në prill 1952, Hoxha njoftoi se partia, e cila kishte numëruar 2800 anëtarë në vitin 1944 dhe 29.137 në nëntor 1945, tani kishte 44.180 anëtarë”.⁷¹⁹ Ai gjithashtu deklaroi se “6000 anëtarë ishin larguar që nga viti 1943. Në shkurt të vitit 1961, anëtarësimi i përgjithshëm numëronte 53.659, por është e pamundur të përcaktohet se sa prej tyre ishin anëtarë në vitin 1952”.⁷²⁰ Nga Komiteti Qendror prej 59 anëtarësh, i zgjedhur në vitin 1952, 3% ishin anëtarë të ulët. Dhjetë anëtarët e vitit 1943 kishin rënë në vitet ndërhyrëse. Prej vitit 1952, vetëm gjashtë anëtarë u rrëzuan, ndërsa u shtuan anëtarë të rinj. Gjashtë anëtarët e vitit 1952 që u rrëzuan më pas ishin: Bedri Spahiu dhe Tuk Jakova, të cilët u rrëzuan nga partia dhe Komiteti Qendror në vitin 1955 për “*paaftësi*.” Ata më vonë u etiketuan ‘pararendësit e elementëve revizionistë jugosllavë “*në parti*”. “Në vitin 1960, Liri Belishova dhe burri i saj Maqo Çomo u përjashtua nga pozicionet e tyre përgjegjëse në parti dhe qeveri për pikëpamjet e tyre pro-sovjetike. Në pranverën e vitit 1957, gjeneralmajor Panajot Plaku u arratis në Jugosllavi.”⁷²¹ Udhëheqësit komunistë të asaj kohe i luftuan pro-jugosllavët pasi, sipas tyre, “ata kishin tradhtuar partinë dhe ideologjinë marksiste-leniniste, bazuar në politikën e KQPKJ që cenonte pavarësinë e vendit”.⁷²² I takonte “PKSh që të luftonte ndaj çdo kundërshtari të mundshëm, sipas tyre”.⁷²³

Në vazhdimësi, regjimi i ashpër diktatorial dyzetvjeçar i Partisë së Punës, me në krye Enver Hoxhën, u karakterizua nga mbyllja totale e Shqipërisë ndaj botës, nga izolimi i saj jo vetëm me Perëndimin, por edhe me aleatët e saj të dikurshëm të Lindjes, nga zhdukja e opozitës politike dhe intelektuale, nga represioni i vazhdueshëm politik, ku përfshiheshin kampet e detyrueshme të punës, pushkatimet pa gjyq dhe ekzekutimet e antikomunistëve të piketuar. Dënimet e kundërshtarëve të tij politikë me vdekje ose me burgime të gjata, si dhe dëbimet e familjeve të tyre nga shtëpitë ku jetonin dhe internimet e vazhdueshme në fshatra të thella, ku kontrolloheshin vrazhdë dhe me rreptësi nga policia dhe famëkeqi Sigurimi i Shtetit, bëjnë përgjegjës për të gjitha këto krime Enver Hoxhën

⁷¹⁸**Shënim:** Për më tepër shih: AQSH, Fondi Nr.14, Dosja Nr. 48, viti 1948, fl. 1, 3.

⁷¹⁹ Central Intelligence Agency, “*Current Intelligence Staff Study, Soviet-Albanian Relations, 1940-1960*”, ESAU XIX-62, 2007, f.10. Marrë nga: <https://www.cia.gov/library/readingroom/docs/esau-19.pdf>.

⁷²⁰*Po aty*.

⁷²¹*Po aty*, f.11.

⁷²²AQSH, Fondi Nr.14, Dosja Nr. 48, viti 1948, fl. 1.

⁷²³AQSH, Fondi Nr.14, Dosja Nr. 48, viti 1948, fl. 3. **Shënim:** Marrë nga Broshura: “*Komunikata dhe deklarata të KQ të PKSH*”, botim i vitit 1948. Botuar dhe në gazetën “*Bashkimi*”, Nr. 1094, datë 30.6.1948-1.7.148.

dhe gjithë sistemin diktatorial që ai krijoi dhe e mbajti gjatë me dorë të hekurt. Gjithashtu, kjo diktaturë e gjatë komuniste u karakterizua kryesisht edhe nga metodat staliniste të asgjësimit të bashkëpunëtorëve të tij, të cilët kërcënonin pushtetin e tij personal. Pjesa më e madhe e kësaj shtypjeje u bë përmes armës së Sigurimit të Shtetit.

PËRFUNDIME

Afrimi me shtetet e Europës Lindore, të cilat formonin Bllokun Socialist, kryhej nën përhapjen e një fryme dhe propagande politike socialiste. Në periudhën 1945-1948, Shqipëria i forcoi akoma më shumë lidhjet e ngushta me Jugosllavinë, të krijuara qysh nga koha e krijimit të Partisë Komuniste të Shqipërisë. Këto vite karakterizohen nga problematika dhe qëndrime të ndryshme. Interesat e të dyja palëve, bashkëpunimi, mosbashkëpunimi, intrigat dhe prapaskenat politike e kishin përfshirë plotësisht jetën në vend. Regjimi komunist i Tiranës, duke ndjekur rrugën jugosllave dhe udhëhequr nga Partia Komuniste Shqiptare, ishte ngritur mbi baza ideologjike marksiste-leniniste, ndërsa Shqipëria gjatë historisë së saj nuk pati shumë shanse historike për t'iu bashkuar Bllokut Lindor. Gjatë këtyre viteve, synimi i komunistëve që kishin marrë pushtetin në vend përfshinte diskreditimin, por edhe zhdukjen fizike të kundërshtarëve partiakë, gjë që tregon se Partia Komuniste Shqiptare, me në krye Enver Hoxhën, varej plotësisht nga Partia Komuniste Jugosllave, e kryesuar prej Titos.

Në tezën time të doktoraturës kam arritur të analizoj, të argumentoj dhe të konkludoj mbi disa hipoteza të rëndësishme të marrëdhënieve shqiptaro-jugosllave. Arsytet e orientimit të Shqipërisë kah Jugosllavisë kishin një qëllim madhor midis dy popujve të shtypur nga i njëjti armik, nga agresori fashist, për të përmbysur qeveritë kukulla që qeverisnin vendet e tyre e që ishin vegla po të tyre, si dhe të merrej pushteti në duart e masave popullore. Të gjitha këto qëllime të përbashkëta u arritën vetëm në sajë të luftës së përbashkët, ndërsa fitorja mbi fashizmin e çelikosi shumë mirë bashkëpunimin ndërmjet dy vendeve gjatë Luftës Nacionalçlirimtare, sidomos me shkuarjen e divizioneve të partizanëve deri në Vishegrad në Jugosllavi, për t'i dhënë goditjen përfundimtare nazizmit e duke kontribuar kështu në fitoren vendimtare të Europës ndaj nazizmit. Pas kësaj fitoreje të përbashkët mbi nazi-fashizmin, për të dy popujt tashmë dolën detyra të reja. Tashmë duhej nisur nga rindërtimi i të dy vendeve të shkatërruara, sidomos të Shqipërisë së varfër që dilte jo vetëm nga një prapambetje feudale, por edhe e shkatërrimeve që la pas lufta. Kësaj detyre imediate i shtohet edhe mbrojtja e pavarësisë nga kërcënimet dhe ndërhyrjet e huaja ekonomike e ushtarake, që doemos kërkonte forcimin e pushteteve të ngritura gjatë

luftës. Kjo rrugë ishte e vështirë dhe pa përvojë, sidomos për Shqipërinë, së cilës i mungonin edhe kuadrot e përgatitur në fusha të caktuara. Shumë nga figurat e ditura dhe intelektuale që kishin studiuar, kulturuar dhe formuar profesionalisht në vende të ndryshme të Europës, pjesa më e madhe në Perëndim, nga pushteti i ri popullor i sapo-vendosur, por që e kishte marrë formën e qeverisjes së mëvonshme qysh gjatë Luftës, u shpallën armiq dhe sabotatorë, nisur nga modeli i famshëm famëkeq komunist i Stalinit. Të dy popujt, nën parullat dhe direktivat e udhëheqësve të tyre, nisën të ecin krah njëri-tjetrit. Nisi bashkëpunimi i dyanshëm për ta ndihmuar njëri-tjetrin dhe për t'i kaluar të gjitha vështirësitë që iu dilnin gjatë kësaj rruge të përbashkët, si dhe duke e propaganduar bujshëm kontributin e madh e të përbashkët që këto vende dhanë në çështjen madhore të fitores së luftës. Kështu ata shtruan trasenë e një rrugë të re për të dy vendet, rrugën drejt socializmit, rrugë kjo që e forcoi edhe më shumë vëllazërimin dhe bashkimin ndërmjet tyre.

Nga mesi i vitit 1945, kur vendi ynë kërcënohej nga uria, Shqipëria u përfshi në sferën ekskluzive të Jugosllavisë. Popujt e Jugosllavisë, të sapo dalë nga lufta e që kishin vetë nevojë për t'u ndihmuar, nën sloganet e solidaritetit dhuruan me qindra kuintalë bereqet për vendin tonë. Kjo ishte ndihma e parë jugosllave e menjëhershme e pasluftës, ndërsa me përmirësimin e kushteve të tyre ekonomike, në vitin 1946 filloi në të gjithë Jugosllavinë një fushatë e madhe ndihme solidariteti, e cila u prit dhe u vazhduar me një dashuri të jashtëzakonshme nga të gjitha masat popullore, si një provë tjetër e dashurisë dhe e ndihmës së njëri-tjetrit.

Siç dihet, Shqipëria pas luftës u ndodh në një situatë shumë kritike, në të gjitha aspektet, si të brendshme ashtu edhe të jashtme. Prapambetja e thellë ekonomike e kulturore e trashëguar nga e kaluara, si dhe shkatërrimet dhe dëmtimet që solli lufta çuan në një krizë e paralizë thuajse të plotë të tërë jetës së vendit. Shqipëria tashmë nisi rrugën e gjatë të përluljes e të pranimit të çdo marrëveshjeje ekonomike – së pari me Jugosllavinë e më pas të aleatëve të tjerë të saj, rrugë e vështirë me plot zigzage e që zgjati për dekada të tëra. U nënshkruan traktatet e njëpasnjëshme të bashkëpunimit ekonomik ndërmjet Shqipërisë dhe Jugosllavisë, me pikënisjen e një bashkëpunimi më të ngushtë dhe më të organizuar ndërmjet dy vendeve. Të dyja qeveritë angazhohen që të nxitin shkëmbimin e mallrave ndërmjet tyre, pasi ekonomia jonë ishte e paralizuar dhe tregjet qenë të

boshatisura. Në arenën ndërkombëtare nisi menjëherë bojkotimi dhe lufta e hapur kundër Shqipërisë. Në këto rrethana të vështira që po kalonte vendi, “miqtë” jugosllavë u përpoqën ta shfrytëzonin për qëllimet e tyre, sigurisht duke ndjekur rrugë dhe metoda të tjera të rafinuara. Gjithnjë nën tryshinën e madhe të Partisë Komuniste Jugosllave dhe shkallës së lartë të indokrinimit pro-jugosllav të një bërthamë e udhëheqjes së Partisë Komuniste Shqiptare, të cilën e përfaqësonte Koçi Xoxe, vazhdonin të thelloheshin marrëdhëniet me jugosllavët. Tito ishte kryesuesi i shkallëzimit dhe i garantëve të vijës së re, por ai kishte filluar marrëdhënie edhe me qeveri të tjera komuniste. Enver Hoxha donte që njerëzit të mendonin se mes të mëdhenjve të Lindjes, ai ishte i barabartë mes të barabartëve.

Politika e jashtme e Shqipërisë në vitet e para të pas Luftës së Dytë Botërore dhe qëllimi i Enver Hoxhës në këtë politikë u shqua jo vetëm në lidhje me Jugosllavinë, por edhe me Bashkimin Sovjetik, që deri në atë kohë e kishte përdorur Partinë Komuniste të Jugosllavisë si ndërlidhëse me vendet e Bllokut Komunist. Ndërsa Koçi Xoxe, megjithëse me shumë kontribute në lëvizjen komuniste në Grupin e Korçës, si kuadër që vinte nga radhët e klasës punëtore, i burgosur nga burgjet e fashizmit, arriti në Byronë Politike të Partisë Komuniste vetëm në vitin 1944, pasi të gjithë emisarët jugosllavë që ndiqnin dhe kontrollonin vijën politike të PKSh-së mbështesnin vetëm Enver Hoxhën. Në dallim nga Enver Hoxha, i cili njihej për paraqitjen dhe oratorinë, Koçi Xoxe nuk shfaqej hapur në masë, por njihej si aktivist i fortë i partisë.

Por njëherësh, udhëheqësit jugosllavë, me anë të agjentëve të tyre në Partinë Komuniste Shqiptare, përfshi Koçi Xoxen, i cili e kishte përqendruar udhëheqjen e partisë në duart e tij, synonin ta mënjanonin Enver Hoxhën nga drejtimi i punëve të Partisë. Xoxe shquhej për ashpërsinë ndaj kundërshtarëve politikë brenda Partisë, si dhe shndërrimin e Sigurimit në një armë të profilizuar kriminale, sektare, krahinore, madje edhe me preferenca fetare. Koçi Xoxe, ky komunist i devotshëm, që gjatë një periudhe relativisht të gjatë i qëndroi besnik Enver Hoxhës, nuk e kishte menduar se edhe ai vetë do të ishte një prej viktimave të tij. Gjatë periudhës së angazhimit të tij politik, jugosllavët nuk ngurronin të flisnin me vlerësime të larta për Koçi Xoxen, i cili kryesoi luftën ndaj atyre anëtarëve të partisë që kundërshtonin marrëdhëniet shqiptaro-jugosllave. Sipas Miladin Popoviç dhe Dushan Mugoshës, komunisti më i mirë në Partinë Komuniste Shqiptare ishte Koçi Xoxe.

Roli i tij në organizimin e punëve të partisë dhe, në mënyrë të veçantë në lidhje me politikën e saj të jashtme, ishte i rëndësishëm. Të pasurit e një kontrolli të tillë mbi të gjitha çështjet e marrëdhënieve dhe politikës së jashtme i lejoi Xoxes edhe mundësinë e krijimit të marrëdhënieve të fshehura, mundësinë të krijonte kontakte personale dhe t'i zhvillonte ato për qëllime që ishin në kundërshtim me parimet e Partisë Komuniste Shqiptare dhe udhëheqësve të saj.

Në këto marrëdhënie Shqipëri - Jugosllavi i është dhënë një rëndësi shumë e madhe dhe e veçantë procesit politik të Koçi Xoxes, duke u nisur nga roli i tij kyç në të. Trajtimi i thelluar i këtij roli në këto marrëdhënie, si edhe pikëpyetjet e shumta që janë ngritur për të, si një pro-jugosllav i devotshmëm, kanë qenë të një rëndësie të veçantë në këtë studim. Të gjithë ata që u cilësuan kriminelë të Luftës, në vitet 1945-1948, u gjykuan nga Koçi Xoxe, si kryetar i grupit special mbikëqyrës i të gjitha seancave gjyqësore, ku bashkë me Prokurorin e Përgjithshëm, Bedri Spahiu, dhanë dënime shumë të rënda për shumë persona. Nga shumë dëshmitarë të asaj kohe, dënimet që jepeshin nga ky grup ishin të gjitha të paramenduara. Por Koçi Xoxe ishte vegël e një regjimi të egër që po instalohesh në Shqipëri, me në krye Hoxhën. Pas përfundimit të këtyre gjyqeve tepër delikate për personat që dënoheshin, Koçi Xoxe u konsolidua si njeriu më i besuar i Enver Hoxhës dhe bashkëpunëtori më i ngushtë i tij, me një pushtet politik absolut. Kështu, përveç postit të zëvendëskryeministrit ai u emërua dhe ministër i Brendshëm dhe gjithashtu ishte dhe në funksionin e Sekretarit Organizativ të PKSh-së, duke qenë numri dy pas Enver Hoxhës, i cili ishte Sekretar i Përgjithshëm. Raportet midis Xoxes, si anëtar i vjetër i Partisë Komuniste Shqiptare, dhe Hoxhës nuk mund të quhen si veprime pa miratimin e Enverit, pasi edhe në shumë veprimtari të tjera apo akte tepër delikate, që kryheshin në vend e që ishin tepër sensitive për popullatën, si krijim prej këtyre të dyve, sipas fjalëve të hapura – po mes njerëzve në krye të pushtetit – i skemës së zhdukjes së njerëzve të fesë. Këto ngelen në kuadrin e misterit, pasi prishja e marrëdhënieve me jugosllavët e pati këtë efekt edhe te marrëdhëniet e Enver Hoxhës me Koçi Xoxen. Enver Hoxha e shfrytëzoi këtë rast, për t'i forcuar më tej marrëdhëniet me Bashkimin Sovjetik, si dhe që të spastronte nga radhët e partisë kundërshtarët e tij pro-jugosllavë, ku midis tyre ishte edhe Koçi Xoxe. Udhëheqësit jugosllavë, me anë të agentëve të tyre në Partinë Komuniste Shqiptare, përfshi Koçi Xoxen, synonin ta mënjanonin Enver Hoxhën nga drejtimi i punëve të partisë, në atë kohë

Sekretar i Përgjithshëm, duke u justifikuar me ngarkesën e madhe të tij në punët shtetërore, edhe si kryetar i Këshillit të Ministrave. Midis Enver Hoxhës dhe Koçi Xoxes kishte nisur një luftë e ashpër për pushtet, pasi Xoxe, si Sekretar Organizativ i Partisë që ishte dhe që vendoste për çdo gjë rreth çështjeve të kuadrove, në emërimet e tyre në të gjithë hierarkinë shtetërore, por edhe si drejtor i Drejtorisë së Mbrojtjes së Popullit, aso kohe shërbimit sekret, kishte në dorë gjithçka të mundur që e bënte atë të plotfuqishëm. Ndaj edhe ky pushtet i tij u bë i rrezikshëm për Enver Hoxhën dhe ndjekësit e tij.

Qëndrimin e tij pro-jugosllav Koçi Xoxe e kishte shfaqur në shumë raste, edhe kur ai ishte pjesë e një delegacioni qeveritar të kryesuar nga Enver Hoxha në Sofje, për të nënshkruar Traktatin e Miqësisë, Bashkëpunimit dhe Ndhmës Reciproke mes Republikës Popullore të Shqipërisë dhe Republikës Popullore të Bullgarisë. Ai u përpoq të ndikonte në dispozitat e traktatit, me qëllim që pëlqimi paraprak i Jugosllavisë të merrej për çdo veprim të përbashkët të Shqipërisë me Bullgarinë, gjë që u hodh poshtë. Por pas ndërrimit të kursit të marrëdhënieve midis Bashkimit Sovjetik dhe Jugosllavisë, edhe Koçi Xoxe mbajti një qëndrim pro-partiak, në dënim të politikës antishqiptare jugosllave. Por Koçi Xoxe nuk mund të arrinte më larg sesa kaq, pasi ligjin tashmë e bënte Komitetit Qendror i Partinë, kryesisht vetë Enver Hoxha, që ka qenë vazhdimisht lideri numër një i kësaj partie, pra komandanti i saj.

Pas prishjes me Titon, në vitin 1948, që ndodhi menjëherë pas letrës publike të Informbyrosë, sa herë që i jepej rasti Enver Hoxha e mohonte rolin dhe kontributin e Dushanit dhe të Miladinit. Ai e mohoi Titon më 1948-n, Hrushovin më 1961-shin dhe Mao Ce Dunin më 1977-n, si dhe i ekspozoi ata si armiq të komunizmit me të njëjtën furi dhe vrull, siç e mbrojti Stalinin gjatë gjithë jetës së tij. Ai mohoi çdo gjë rreth “vëllezërve të tij komunistë”, por ai harroi se ka dokumente arkivore që dëshmojnë për qëndrimin indiferent të tij dhe të shtetit që ai vetë e drejtonte ndaj çështjes kombëtare. Partia e Punës, Enver Hoxha, por edhe historiografia gjithnjë e kanë kritikuar Titon, i cili nuk e mbajti fjalën e dhënë, se çështja e Kosovës do të zgjidhej pas luftës. Edhe në këto vite, nga Ramiz Alia pranohet se, “për Partinë Komuniste Shqiptare ekzistonte çështja e shqiptarëve që jetonin në Jugosllavi, të Kosovës e të viseve të tjera, por kishim bindje se me udhëheqjen e Jugosllavisë së re antifashiste mund të diskutohej e të zgjidhej drejt edhe ky problem i trashëguar nga historia”. Historiografia marksiste-leniniste, por edhe historiografia zyrtare

bashkëkohore, kanë parë dhe stigmatizuar vetëm njërin anë, atë të politikës antikombëtare të partisë e shtetit jugosllav, në qëndrimin ndaj çështjes së pazgjidhur të Kosovës dhe përpjekjeve për ta bërë Shqipërinë Republikë të Shtatë të Jugosllavisë. Dhe nuk mund të vihet në dyshim kjo e vërtetë historike. Veçse problemi ka edhe anën tjetër të medaljes, që asnjëherë nuk trajtohet, atë të qëndrimit të Partisë Komuniste Shqiptare ndaj çështjes së Kosovës, dhe integritit të Shqipërisë në Federatën Ballkanike. Pra jugosllavët gjetën në vendin tonë truall të përgatitur mirë për realizimin e planeve të tyre antikombëtare ndaj Shqipërisë.

Pas prishjes së marrëdhënieve me Jugosllavinë, në vitin 1948, nis faza e gjyqeve politike, ku Koçi Xoxe gjykohet nën drejtimin e Prokurorit të Përgjithshëm Bedri Spahiu. “Prokurori Bedri Spahiu kërkon që ta paraqesë Byronë Politike, duke përfshirë edhe vetë Enver Hoxhën, si objekt përndjekjeje nga Koçi Xoxe nëpërmjet Sigurimit, por Koçi Xoxe e kundërshton. Prokurori ngulmon që ai të përgjigjet “për të gjitha veprimet që Koçi ka kryer për survejimin e udhëheqësve”, ndërsa Xoxe përgjigjet se “Disa nga anëtarët e Komitetit Central janë vënë në survejim me urdhër të Byrosë dhe të Sekretarit të Përgjithshëm”. I akuzuar si titist, bashkëpunëtor i jugosllavëve, arrestimi dhe ekzekutimi i Koçi Xoxes ndodhi në kohën kur mbi një e katërta e anëtarëve të PKSh-së u arrestuan ose u ekzekutuan. Gjyqi i Xoxes ishte menduar si një parapërgatitje për të gjithë të mos-bindurit e mundshëm në vendet komuniste: kushdo që përpiqet të shkëputet nga Moska, të kërkojë të heqë nënshttrimin e tij ose të zhvillojë koncepte të pavarura, do të trajtohet në po të njëjtën mënyrë. Partia e ndëshkoi Koçin me etiketimin “tradhtar” për raportet e tij me Jugosllavinë; duke qenë sekretar organizativ, Koçi akuzohej për “sektarizëm” dhe përdorim të metodave jugosllave. Porse Koçi nuk kishte asnjë dallim nga një pjesë tjetër e udhëheqjes, kundërshtues të nivelit të lartë, si Nako Spiro në fushën e ekonomisë dhe Mehmet Shehu për ushtrinë, të cilin e hoqën nga detyra e Shefit të Shtabit të Ushtrisë, pasi ishte shprehur kundër bashkimit të dy ushtrive. Ndaj Nako Spiros, udhëheqja komuniste arriti deri në mënjanim e tij fizik, duke e çuar atë në vetëvrasje, pasi, për fatin e keq të Nakos, rrethanat e krijuara nuk ishin në favor të tij.

Gjyqi i Koçi Xoxes e arriti plotësisht qëllimin; bashkëpunëtorët e Titos duhej të paguanin çmimin e vdekjes, burgosjen dhe poshtërimet. Nga viti 1945 e deri në qershor të

vitit 1948, për kundërshtarët politikë apo për ata që nuk përkrahnin Frontin Demokratik filluan në vend reprezaljet, gjyqet me dënime me vdekje, shfarosje pa gjyqe, tortura çnjerëzore e të kundërligjshme, u hapën kampe të shumta përqendrimi, grabitje me dhunë e pasurive, si dhe shumë krime të tjera. Për fat të keq të shqiptarëve, jeta e mëvonshme në Shqipëri vërtetoi se Enver Hoxha e mori pushtetin me mbështetjen e jugosllavëve, të cilëve iu shërbeu besnikërisht deri në vitin 1948. Pra, deri më 1948-n, Stalini i kishte lënë dorë të lirë Titos mbi Shqipërinë. Por nga Moska e Stalinit po vinin çdo ditë në Tiranë informacione për ‘tradhtinë e madhe’ të jugosllavëve, ndaj me çdo kusht duhej të dënoheshin e të bëheshin shembuj të gjithë ata që po mbështesnin politikën jugosllave e quheshin titistë. Direktivat nga Moska vinin se, në të gjithë Lindjen Komuniste duhej të nisnin procese kundër titistëve. Absurdi po ndodhte në Shqipëri, pasi deri në atë kohë, e gjithë udhëheqja e Partisë Komuniste Shqiptare, duke filluar nga Enver Hoxha, ishte pro jugosllavëve. Byroja Politike e Shqipërisë duhej të ndiqte të njëjtën histori si ajo e Bashkimit Sovjetik. Kështu që nuk vonoi shumë, u gjetën dhe u sajuan disa procese, si dhe nisi beteja për ekzistencë, të mbisundonte klani më i fortë, ai i Enver Hoxhës, e të ndëshkohej ai më i dobëti, i Koçi Xoxes, edhe pse ky “klan”, përgjatë gjithë këtyre viteve vepronte e ndiqte konsultimet e Enver Hoxhës në politikën e jashtme të Shqipërisë. Çështja e Koçi Xoxes dhe e Enver Hoxhës ndeshet në dy plane, në aspektin partiak dhe në atë të funksioneve shtetërore.

Pas prishjes së Titos me Stalinin, Shqipëria u bë aleate e ngushtë e BRSS-së. Me pushtetin e tij absolut, përmes armës së Sigurimit të Shtetit, Enver Hoxha u afrua me Moskën dhe Stalinin, për likuidimin e qindra titistëve të mirëfilltë apo të quajtur si të tillë. Për t’u pajtuar plotësisht tashmë me politikën e Stalinit, që kishte filluar hapur konfliktet me Titon, nisi fushata antitiste se Jugosllavia do ta përfshinte Shqipërinë e vogël dhe të varfër në federatën e saj. Dokumentet arkivore tregojnë se iniciator i kësaj fushate ishte Enver Hoxha. Pikërisht në këtë periudhë, nisi edhe i gjithë procesi ndaj Koçi Xoxes, si protagonist kryesor në marrëdhëniet shqiptaro–jugosllave përgjatë kohës 1945–1948, për sa iu takon përgjegjësi shtetërore, partiake apo raporteve me jugosllavët, edhe pse vazhdimisht në miratim të plotë me Enver Hoxhën. Por tashmë, mjeshtëria e Hoxhës ishte përdorimi i të gjithë kundërshtarëve që kishte Koçi Xoxe, duke e akuzuar atë, si dhe një shpurë të tërë, për marrëdhëniet e fshehta shqiptaro–jugosllave, organizimin shtetëror të

Republikës Popullore të Shqipërisë, politikën antikombëtare të PKSh-së së këtyre viteve, si dhe rolin famëkeq të Sigurimit të Shtetit në jetën e vendit.

Në historinë e PPSH-së dhe të Sigurimit të Shtetit, ky proces është i pari i goditjeve të grupeve anti-parti të pas luftës, të karakterizuara si procese politike të ashpra, që dënuan kundërshtarët e regjimit. Më pas, në vitin 1956, nisi procesi ndaj Tuk Jakovës dhe Bedri Spahiut, dhe në faza të ndryshme e me zigzage, deri në vitin 1983, nën survejimin e Sigurimit të Shtetit, vazhduan procese të tjera të grupeve të ashtuquajtura sabotuese në ekonomi, ushtri apo agjenturore.

Në vazhdimësi, regjimi i ashpër diktatorial dyzetvjeçar i Partisë së Punës, me në krye Enver Hoxhën, u karakterizua nga mbyllja totale e Shqipërisë ndaj botës, nga izolimi i saj jo vetëm me Perëndimin, por edhe me aleatët e saj të dikurshëm të Lindjes, nga zhdukja e opozitës politike dhe intelektuale, nga represioni i vazhdueshëm politik, ku përfshiheshin kampet e detyrueshme të punës, pushkatimet pa gjyq dhe ekzekutimet e antikomunistëve të piketuar. Dënimet e kundërshtarëve politikë me vdekje ose me burgime të gjata, si dhe dëbimet e familjeve të tyre nga shtëpitë ku jetonin dhe internimet e vazhdueshme në fshatra të thella, ku kontrolloheshin vrazhdë dhe me rreptësi nga policia dhe famëkeqi Sigurimi i Shtetit, bëjnë përgjegjës për të gjitha këto krime Enver Hoxhën dhe gjithë sistemin diktatorial që ai krijoi dhe e mbajti gjatë me dorë të hekurt.

BIBLIOGRAFIA

I. BURIME ARKIVORE

1- Arkivi Qendror Shtetëror i Republikës së Shqipërisë (AQSH)

- Fondi 14, Komiteti Qëndror
- Fondi 494, Ministria e Ekonomisë
- Fondi 505, Ministria e Financave
- Fondi 588, Legata Jugosllave.
- Fondi AP/14OU, Organet Udhëheqëse.
- Fondi 490, Këshilli i Ministrave.
- Fondi 506, Banka e Shqipërisë.
- Fondi 489, Presidiumi i Kuvendit Popullor.

2- Arkivi i Ministrisë për Evropën dhe Punët e Jashtme i Republikës së Shqipërisë (AMEPJ)

- Vitet 1946-1950.

3- Arkivi Jugosllav (AJ), 507 IX, Albanija I-1/143, 1947.

4- AVPRF (Arkivi i Politikës së Jashtme të Federatës Ruse), F. 06, Op. 9

II. GAZETA

- Gazeta *Bashkimi*, Tiranë, 1945, 1946.
- Gazeta *Borba*, Beograd, 1946.
- Gazeta *Dita*, Tiranë, 2015.
- Gazeta *Luftëtari*, Tiranë, 1948.
- Gazeta *Politika*, Beograd, 1946.
- Gazeta *Zëri*, Tiranë 2007.

III. LITERATURA HISTORIOGRAFIKE

- Agani, Fehmi - *Demokracia, kombi, vetëvendosja*, Pejë, 1994.
- Albina Dranqoli, “*Tito-s attempt to integrate Albania into Yugoslavia, 1945-1948*”.
- Aleksandar, Zivotic -*Jugosllavija, Albanijai Velike Sile*, Arhipelag, Beograd, 2011.
- Alia, Ramiz - *Vija e drejtë e Partisë – burim i sukseseve tona*, Tiranë, 1984.

- Bashkurti, Lisen - *Diplomacia shqiptare në fillimet e Luftës së Ftohtë, 1945-1961*, Tiranë: Botimet: “Geer”, 2003.
- Benanti, Franko- *Luftamë e gjatë*, përktheu LuanMalaj, Tiranë, Botimet: Naimi, 2012.
- Central Intelligence Agency, “*Current Intelligence Staff Study, Soviet-Albanian Relations, 1940-1960*”, ESAU XIX-62, 2007. Marrë nga: <https://www.cia.gov/library/readingroom/docs/esau-19.pdf>
- Çami, Foto –*Partia Komuniste e Shqipërisë në luftë për rimëkëmbjen e vendit dhe për zhvillimin e mëtejshëm të Revolucionit, 1945-1948*
- Çuvahin, Dimitr S. -*Shërbimi im diplomatik në Shqipëri*, Tiranë: Almera, 2009.
- Dedijer, Vladimir - *Marrëdhëniet shqiptaro-jugosllave 1939-1948*, Beograd: Shtëpia Botuese ‘Prosveta’, 1949.
- Dervishi, Kastriot - *E vërteta e fshehur e një procesi*, Tiranë, Botimet: “55”, 2009.
- Dervishi, Kastriot - *Historia e Shtetit Shqiptar 1912-2005*, Tiranë, Botimet: “55”, 2006.
- Dervishi, Kastriot - *Sigurimi i Shtetit 1944-1991: Historia e policisë politike të regjimit komunist*, Tiranë: Shtëpia Botuese “55”, 2012.
- Dervishi, Kastriot - *Lëvizja komuniste në vitet 1924-1944 dhe formimi i PKSH-së*, Tiranë, Botimet: “55”, 2016.
- Dimitrijevic, Bojan - *Yugoslav-Soviet Military Relations 1945-1948*, në “*The Balkans in the Cold War*”, edituar nga Vojislav G. Pavlovic, Institute des Etudes Balkaniques, Beograd, 2011.
- *Dokumenta kryesore të PPSH, Rezolucioni i Mbledhjes së grupeve komuniste të Shqipërisë*, vëll.I, Tiranë, 1960.
- Dokumentet e Kominformës, ‘*Minutat e tre konferencave 1947/48/49*’, edituar nga Giuliano Procacci, në Fondazione Giangiacomo Feltrinelli, Annali, 1994, Feltrinelli Editore, Milano, ISBN 88-07-99050-4, 1999.
- Duka, Valentina - *Histori e Shqipërisë 1912-2000*, Tiranë, Botimet: Albas, 2014.
- Duka, Valentina - *Histori e Shqipërisë 1912-2000*, Tiranë, Botimet: SHBLU, 2007.
- Dyrmishi, Demir “*Studime Historike*”, Instituti i Historisë, Akademia e Shkencave e Republikës së Shqipërisë, Tiranë, 2003.
- Fischer, Bernd. J - *Shqipëria gjatë luftës 1939-1945*, Tiranë: Botimet Çabej, 1999.
- Fischer, Bernd.J. - *Diktatorët e Ballkanit*, Botuar nga Instituti Shqiptar për Studime Ndërkombëtare (AIIS), Tiranë: 2009.
- Fishta, Iljaz - *Ndërhyrja e kapitalit tëhuaj dhe pasojat e saj skllavëruese nëShqipëri (1931-1936)*. Tiranë, 1989.
- Fishta, Iljaz dhe Ziu, Mihal - *Historia e Ekonomisë së Shqipërisë 1944-1960*, Tiranë: Shtëpia Botuese “Dita”, 2004.
- Frashëri, Mehdi - *Kujtime (1913-1922)*, Tiranë, 2005.
- Gardiner, Leslie - *The eagle spreads his claws*, Edinburgh dhe London, 1966.

- George H. Hodos, “*Showtrials, Stalinist Purges in Eastern Europe, 1948-1954*”, Praeger Publishers, New York, 1987, faqe 10. Marrë nga: <https://books.google.al>
- Gibianiskii, Leonid - ‘*The Soviet Bloc and the Initial Stage of the Cold War: Archival Documents on Stalin’s Meetings with Communist Leaders of Yugoslavia and Bulgaria, 1946-1948*’. ColdWar International History Project Bulletin 19, 1998.
- Godart, Justin - *L’Albanie en 1921*. Paris, 1922.
- Gjeçovi, Xhelal –*Shteti Shqiptar dhe çështja e Kosovës*, Tiranë: BOTIMPEX, 1998.
- Gjeçovi, Xhelal -*Marrëdhëniet shqiptaro-jugosllave në vitet e Luftës Antifashiste Nacionalçlirimtare*. Nëntor 1941 - Nëntor 1944, Akademia e Shkencave e RPS të Shqipërisë, Instituti i Historisë, Tiranë, 1986.
- Gjilas, Milovan - *Vlast I Pobuna*, Beograd, 1991.
- Gjinaj, Agustin dhe Lila, Fejzi - *Lidershipi shqiptar përmes historisë së Ushtrisë*’, Tiranë: Geer, 2012.
- Hadri, Ali - *Historia e Popullit Shqiptar*, II, Enti i Teksteve dhe Mjeteve Mësimore i KSAK (Krahina Socialiste Autonome e Kosovës) , Prishtinë, 1979.
- *Historia e Partisë së Punës së Shqipërisë*’, Vëll. II, Instituti i Studimeve Marksiste-Leniniste pranë KQ-së së PPSH-së, Tiranë: “8 Nëntori”, 1981.
- *Historia e Popullit Shqiptar*, vëll.IV, Grup autorësh, Tiranë: Toena, 2009.
- *Historia e Shqipërisë 1912-1939*, vol. III, botim i Akademisë së Shkencave, Instituti i Historisë. Tiranë: 1984.
- Hoti, Izber - *Qëndrimi i diplomacisë italiane ndaj Shqipërisë dhe shqiptarëve 1930-1997*, Prishtinë:1999.
- Hoxha, Çelo - *Fillimet e Diktaturës Komuniste në Shqipëri 1944-1948*’, Tiranë: West Print, 2013.
- Hoxha, Enver - *Kur u hodhën themelet e Shqipërisë së re (Kujtime e shënime historike)*, Tiranë, 1984.
- Hoxha, Enver - *Raport në Kongresin e Parë të Partisë Komuniste të Shqipërisë mbi punën e Komitetit Qendror dhe detyrat e reja të partisë*”, Botim i Komitetit Qendror të Partisë së Punës së Shqipërisë, Tiranë: 1948.
- Hoxha, Enver - *Titistët*, Tiranë: 8 Nëntori, 1982.
- Hoxha, Enver - *Vepra*, Vëll. III, Tiranë: 8 Nëntori, 1969.
- Hoxha, Enver - *Vepra*, Vëll. IV, Tiranë: Naim Frashëri, 1970.
- Hoxha, Enver - *Vepra*, Vëll. V, Tiranë: Naim Frashëri , 1970
- Hoxha, Enver – *Vepra*, Vëll. XIX, Viti 1975
- Hoxha, Enver- *Një jetë për kombin*, Tiranë: Neraida, 2008.
- Hoxha, Nexhmije - *Jeta ime me Enver Hoxhën*, Tiranë, 1989.
- Hrabak, Bogumijl - *Arbanske Studije*, knj, I-V, Beograd 2005.
- Hrabak, Bogumijl - *Medjunarodni položaj Albanije 1945-1947 i Jugosllavija*, Izdrzhivanja br.13, Novi Sad 1990.

- Kaba, Hamit - *UNRRA në Shqipëri 1944-1947*, Tiranë: Shkenca, 2000.
- Kaba, Hamit & Çeku, Ethem – *Shqipëria dhe Kosova në arkivat ruse*, Tiranë, Botimet: “Flamuri”, 2017.
- Kasoraho, Amik - *Një anktë gjysmëshekullor, Shqipëria e Enver Hoxhës*, Tiranë: Botimet Çabej, 1996.
- Krisafi, Ledion - *Marrëdhëniet e Shqipërisë me Jugosllavinë 1945-1948*, Disertacion, Universiteti Evropian i Tiranës, 2016. Marrë nga: https://uet.edu.al/images/doktoratura/Ledjon_Krisafi.pdf.
- Lala, Brisejda - *Projekti i Federatës ballkanike në marrëdhëniet shqiptare-jugosllave në vitet 1945-1948*, Revistë Shkencore e Institutit Alb-Shkenca, Aktet VI, Nr. 5, 2013.
- Lauka, Islam & Ymeri, Eshref - *Shqipëria në dokumentet e arkivave ruse*, Tiranë, Botimet: TOENA, 2006.
- Lon Giaffo, “*Albania; Eye of the Balkan*”, Vortex, USA, 2000, faqe 384-385 në Albina Dranqoli, “*Tito-s attempt to integrate Albania into Yugoslavia, 1945-1948*”.
- History Studies, International Journal of History, Volume 3/2, 2011, faqe 192. Marrënga: <https://www.acarindex.com/dosyalar/makale/acarindex-1423902522.pdf>
- Lory, Bernard - *Europa Ballkanike nga 1945 në ditët e sotme*, Tiranë: Dituria, 2007.
- Marko, Petro - *Intervistë me vetëveten: retë dhe gurët*, Tiranë: OMSCA, 2000.
- Marxists Internet Archive, “*Partia Komuniste e Shqipërisë në luftë për rindërtimin e vendit dhe për zhvillimin e revolucionit socialist*”. Marrë nga: <https://www.marxists.org/shqip/subjekt/dokumente-shqiptare/ppsh/historia/iii/1-5.pdf>
- *Marrëdhëniet shqiptaro-jugosllave 1945-1948 Dokumente*, përgatitur për botim nga Ndreçi Plasari dhe Luan Malltezi, Drejtoria e Përgjithshme e Arkivave, Tiranë: 1996.
- Milo, Paskal - *Politika e Jashtme e Shqipërisë I*, Tiranë: Botimet Toena, 2013.
- Myftaraj, Kastriot - *Enigmat e sundimit të Enver Hoxhës 1944-1961*, vëll.II, Tiranë:Plejad, 2009.
- Myftaraj, Kastriot - *Jeta e Fshehur e Enver Hoxhës 1908- 1944*, Tiranë, Botimet: Plejad, 2008.
- Najbor, Patrice - *Monarkia Shqiptare 1928-1939*, Botim i Qendrës së Studimeve Albanologjike, Instituti i Historisë, Tiranë: Botimet Toena, 2011.
- Neubacher, Hermann - *Guvernatori i Hitlerit për Ballkanin*, Tiranë: BOTART, 2017
- Nushi, Gogo - *Vepra të zgjedhura*, vëll.I, Tiranë: Shtëpia Botuese ‘8 Nëntori’, 1980.
- O’Donnel, James S. - *A coming of Age. Albania Under Enver Hoxha*, East European Monographs, 1999.
- Pavlovic, Momcilo - “Albania between Tito and Stalin”; Në “*The Balkans in the Cold War*”, edituar nga Vojislav G. Pavlovic, Institute des Etudes Balkaniques, Beograd, 2011. Marrë nga: <https://books.google.al/books>
- Pearson, Owen - *Albania and King Zog*, London, 2004.
- Petranoviç, Branko - *Balkanska Federacija 1943-1948*, Beograd, 1991.

- Pirjeveç, Jozhe - *Tito dhe shokët*, Tiranë, Botimet: BOTART, 2020
- Plaku, Panajot - *Dhuna ndaj revolucionit në Shqipëri*, Prishtinë, 1985.
- Plasari, Ndreci - '*Studime Historike*', 1994(1-4)
- Puto, Arben - *Nëpër analet e diplomacisë angleze*, Botimi II, Tiranë: 1980.
- Puto, Arben - *Shqipëria Politike 1912-1939*, Tiranë: Botimet Toena, 2009.
- Reuter, Jens - *Die Albanen in Jugoslawien*, Munchen, 1982.
- Selenica, Teki - *Shqipëria më 1927*, Tiranë: 1928.
- Simonard, André - *Essai sur l'indépendance albanaise*, Paris: 1942.
- Smirnova, Nina - *Historia e Shqipërisë përgjatë shekullit XX*, Tiranë: Botimet Ideart, 2004,
- Shalari, Klement - *(Mos)Marrëveshja e Mukjes kullon ende gjak*, Tiranë: 1996.
- Shehu, Bashkim - *Liri Belishova dhe koha e saj*, Tiranë: UET Press, 2021.
- Tempo, Svetozar V. - *Lufta për Ballkanin*. Lubjanë: 1981.
- Tempo, Svetozar Vukamanoviç- *Revolucija koja teče, Memoari*, knjiga 1, Beograd: 1971.
- Tonnes, Bernhard - *Sonderfall Albanien*, 1980.
- Trenova, Bashkim - '*Studime Historike*', vëll. III, 1990, fq.58.
- Vickers, Miranda & Pettifer, James - *Shqipëria nga anarkia në një identitet ballkanik*, Tiranë: Botimet: Toena, 1998.
- Xhixha, Hajdi - *Marrëdhëniet shqiptaro-jugosllave*, Disertacion, Universiteti i Tiranës, 2018, Marrë nga: <https://unitir.edu.al/marrëdhëniet-shqiptaro-sovjetike-1949-1960/>.
- Zavalani, Tajar - *Historia e Shqipërisë*, Tiranë: Phoenix & Shtepia e Librit, 1998.
- Zogaj, Agim - *Marrëdhëniet shqiptaro-jugosllave dhe çështja e Kosovës 1945-1948*, Prishtinë, Botimet: Kosova PEN Center, 2015

IV. FAQE INTERNETI

- Gazeta Standard, "*Dokumenti/Si i manipuloi Enver Hoxha zgjedhjet e 2 dhjetorit 1945.*" Marrë nga: <https://www.standard.al/2017/02/24/dokumenti-si-i-manipuloi-enver-hoxha-zgjedhjet-e-2-dhjetorit-1945/>
- Gazeta Shqiptare, Balkanweb, Zef Bushati, <https://www.balkanweb.com/roli-i-diplomacise-nderkombetare-ne-kuvendin-e-mukjes/>, 1 Gusht 2016.
- Gazeta Telegraf, "*Përplasja e madhe në zgjedhjet e 2 dhjetorit 1945 në Shqipëri*". Marrë nga: <https://telegraf.al/dosier/perplasja-e-madhe-ne-zgjedhjet-e-2-dhjetorit-1945-ne-shqiperi/>
- Gazeta Telegraf, "*Prapaskenat e Luftës Nacional-Çlirimtare, ja pse Koçi Xoxe urrente Enverin*", Dossier, datë 23 dhjetor 2019. Marrë nga: , <https://telegraf.al/dosier/398356/>

- History Studies, International Journal of History, Volume 3/2, 2011, faqe 192. Marrë nga: <https://www.acarindex.com/dosyalar/makale/acarindex-1423902522.pdf>
- Koenen, Gerd - *“Komunizmi në Epokën e tij, Broshurë ekspozite”*, Përgatitur nga Fondacioni Federal për Studimin e Diktaturës në Gjermani, Muzeu Historik Gjerman dhe Instituti për Demokraci, Media dhe Kulturë. Marrë nga: <https://www.idmc.al/assets/komunizmi.ne.epoken.e.tij-broshura.pdf>
- Perovic, Jeronim - *“The Tito-Stalin split: a reassessment in light of new evidence”*. Artikull në: Zurich Open Repository and Archive, University of Zurich, 2007. Marrë nga: https://www.zora.uzh.ch/id/eprint/62735/1/Perovic_Tito.pdf
- Raymond Zickel dhe Eäalter R. Iwaskiw, *“Albania a country study”*, Library of CongressCataloging-in-PublicationData, Washington, 1994, marrë nga: <https://tile.loc.gov/storage-services/master/frd/frdcstdy/so/sovietunioncount00zick/sovietunioncount00zick.pdf>